

NVE Rev. 2

**Klasifikimet Statistikore të Aktiviteteve
Ekonomike**

NOMENKLATURA E
VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

Drejtor Botimi: Dr. GJERGJI FILIPI

Copyright © INSTAT 2014

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Botuar nga: INSTAT
INSTITUTI I STATISTIKAVE
Blv. “Zhan D’Ark”, Nr. 3, Tiranë
Tel: +355 4 2222411 / 2230484
Fax: +355 4 2228300

Përpunimi në kompjuter: Mariana Vllau, Teuta Topi

Kopertina Mariana Vllau

INSTAT është Instituti i Statistikave të Shqipërisë. Misioni i tij është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Si institucioni që disponon burimin më të madh të informacionit statistikor në Shqipëri, INSTAT përpiqet t'u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje, kërkime dhe arsimim në Shqipëri. Gjithashtu, INSTAT ndihmon komunitetin e interesuar ndërkombëtar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor, të sigurt dhe të krahasueshëm.

Programi i botimeve të INSTAT përbëhet nga një sërë përmbledhjesh:

Njoftime për shtyp të cilat ofrojnë informacion të shpejtë përmbledhës mbi treguesit kryesorë ekonomikë, socialë, bujqësorë, demografik.

Botime mujore që ofrojnë informacion mbi treguesit kryesorë ekonomikë.

Botime tremujore me të dhëna statistikore dhe komente.

Botime me të dhëna statistikore të cilat ju vijnë në ndihmë përdoruesve me një paketë të dhënash statistikore bazë mbi një fushë specifike.

Rezultate statistikore të shoqëruara edhe me shpjegime metodologjike.

Të gjitha publikimet e INSTAT mundësohen për shkarkim pa pagesë në formatin PDF nga faqja elektronike <http://instat.gov.al>. Përveç kësaj, atje janë vënë në dispozicion pa pagesë të dhënat e bazave, ku gjenden tabela me përdorim më të shpeshtë dhe indikatorët afatshkurtër dhe afatgjatë me kërkueshmëri më të madhe.

Parathënie

Statistikat e besueshme dhe krahasuese ndërkombëtare mund të përpilohen dhe të vendosen në dispozicion të bizneseve, administratës publike, institucioneve financiare, qeverisë dhe tërë përdoruesve të tjerë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, vetëm në rast se mbështeten tek standarde të përbashkëta statistikore.

NVE është element thelbësor i sistemit të integruar ndërkombëtar të klasifikimeve ekonomike, i cili mbështetet tek klasifikimet e Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara (UNSTAT), tek ato të Eurostatit, sikundërse edhe tek klasifikimet kombëtare; të gjitha këto klasifikime lidhen fuqimisht me njëri-tjetrin, duke krijuar kështu mundësinë e krahasimit të statistikave ekonomike të përpiluara nga institucione të ndryshme të mbarë botës.

Versioni aktual NVE Rev. 2, i cili është një version i ri i rishikuar i NVE Rev. 1 dhe i përditësimeve të vogla të NVE Rev. 1.1., është fryt i një rishikimi më të gjerë i sistemit të integruar ndërkombëtar të klasifikimeve ekonomike, i cili zu vend mes viteve 2000-2007. NVE Rev. 2 pasqyron zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë, duke bërë të mundur modernizimin e bashkësisë së statistikave dhe duke kontribuar, përmes të dhënave më të rëndësishme dhe më të krahasueshme, në përmirësimin e administrimit ekonomik qoftë në nivel komunitar, qoftë në nivel kombëtar.

NVE Rev. 2 u krijua duke u mbështetur tek ISIC Rev. 4 dhe u përshtat me kontekstin Evropian nga ana e një grupi ekspertësh të klasifikimeve statistikore të Shteteve Anëtare, të Shteteve Kandidate, si dhe vendeve anëtare të TPE-së, me mbështetjen dhe udhëheqjen e sektorit të klasifikimeve pranë Eurostat.

Krahas klasifikimit, ky botim përmban edhe udhëzimet hyrëse, duke përmbledhur në vetvete konceptet themelore, kontekstin historik dhe parimet metodologjike, të cilat do të ndihmojnë në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të NVE Rev. 2, sikundërse edhe përshkrimin e detajuar të njësive të ndryshme të klasifikimit.

Lista e Shkurtimeve

BEC	Klasifikimi i mallrave sipas Kategorive Kryesore Ekonomike të Kombeve të Bashkuara
CN	Nomenklatura e Kombinuar – Klasifikimi Evropian i Mallrave
CPA	Klasifikimi Evropian i Produkteve sipas Aktiviteteve
CPC	Klasifikimi i Produkteve Kryesore të Kombeve të Bashkuara
EEC	Komuniteti Ekonomik Evropian
KKN	Komisioni i Nomenklaturave
EP/C	Këshilli dhe Parlamenti Evropian
ESA	Sistemi European i Llogarive Rajonale dhe Kombëtare
EU	Bashkimi Evropian
HS	Sistemi i Harmonizuar i Mallrave dhe Sistemi i Kodimit të organizatës Botërore Doganore
ISIC	Klasifikimi Industrial Ndërkombëtar i të gjitha Aktiviteteve Ekonomike
KAU	Njësia sipas llojit të Aktivitetit
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Këshilli Evropian
BE	Bashkimi Evropian
NACE	Klasifikimi Evropian i Veprimtarive Ekonomike
NVE	Klasifikimi Shqiptar i Veprimtarive Ekonomike
NP	Nomenklatura e Produkteve
NKM	Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave
PRODCOM	Sistemi Evropian i statistikave të prodhimit për industrinë nxjerrëse dhe prodhuese
SITC	Klasifikimi Standart i Tregtisë Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara
SNA	Sistemi Ndërkombëtar i Llogarive Kombëtare
SPC	Komiteti i Programit Statistikor
UN	Kombet e Bashkuara

Përmbajtja

PJESA I – NVE : Udhëzime hyrëse

Kapitulli 1: NVE : Hyrje dhe sfondi

- 1.1 NVE dhe sistemi i integruar i Klasifikimit të Veprimtarive ekonomike dhe Produkteve
Sistemi ndërkombëtar i klasifikimeve ekonomike
- 1.2 NVE: Shtrirja dhe karakteristikat
Klasifikimet statistikore
NVE si klasifikimi i BE-së për aktivitetet ekonomike
Shtrirja dhe kufizimet e NVE
Struktura dhe kodimi i NVE
- 1.3 NVE: Historiku dhe kuadri ligjor
Nga NICE tek NVE Rev.2
Rregullorja e NVE: Karakteristikat kryesore
- 1.4 Rishikimet e NVE

Kapitulli 2: NVE : Përkufizime dhe parime

- 2.1 Kriteret e pranuar për zhvillimin e NVE
Kriteret për klasat
Kriteret për grupet dhe ndarjet
- 2.2 Aktivitetet kryesore, dytësore dhe ndihmëse
- 2.3 Përkufizimet e njësive statistikore

Kapitulli 3: Rregullat e klasifikimit për aktivitetet dhe njësitë

- 3.1 Rregullat bazë të klasifikimit
Zëvendësuesit e vlerës së shtuar
- 3.2 Veprimtaritë e shumëfishta dhe të integruara
Metoda nga “lart-poshtë”
Ndryshimet e veprimtarisë kryesore të njësisë
Trajtimi i aktiviteteve të integruara vertikalisht
Trajtimi i aktiviteteve të integruara horizontalisht
- 3.3 Rregullat për aktivitete specifike
Aktivitetet e ndërmarra mbi bazë ndërmjetësimi ose kontrate dhe aktivitete deleguese
Trajtimi i veprimtarive prodhuese të delegurara në CPA
Instalimi dhe montimi në vënd
Riparimi dhe mirëmbajtja
- 3.4 Rregulla dhe përkufizime specifike sipas seksioneve
Seksioni A: Bujqësia, pemtaria dhe peshkimi
Seksioni G: Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Seksioni K: Veprimtaritë financiare dhe të sigurimimeve

Seksioni M: Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike
 Seksioni O: Administrimi dhe mbrojtja publike; Sigurimi shoqëror i detyruar
 Seksioni T: Veprimtaritë shtëpiake; Veprimtaritë e prodhimit të mallrave dhe shërbi
 meve të padiferencuara të familjeve për përdorim vetjak

Kapitulli 4: Lidhja ndërmjet NVE Rev. 2 dhe klasifikimeve të tjera

- 4.1 Ndërlidhja me klasifikimet ndërkombëtare
 Tërësia e klasifikimeve ekonomike dhe sociale ndërkombëtare
 Sistemi i integruar i klasifikimeve të aktiviteteve dhe produkteve të Kombeve të Bashkuara
 Ndërlidhja e NVE me ISIC
 Ndërlidhja e NVE me të tjera klasifikime ndërkombëtare
- 4.2 Ndërlidhja me klasifikimet e BE
 Klasifikimi i Produkteve sipas Aktiviteteve – CPA
 Klasifikimi i Kombinuar – CN
 PRODCOM
 Grupimet Kryesore Industriale – MIGs
 Bilanci i pagesave: Klasifikimi për Statistikat e Investimeve të huaja direkte
- 4.3 Ndërlidhja me klasifikime të tjera shumëkombëshe NAICS
 NAICS
 ANZSIC
 Klasifikime të tjera
- 4.4 Strukturat të agreguara për llogaritë kombëtare

Kapitulli 5: Ndryshimet ndërmjet NVE REV. 1.1 dhe NVE REV. 2

- 5.1 Ndryshimet në strukturë
- 5.2 Tabelat e korrespondencës: shtrirja dhe përdorimi

Kapitulli 6: Fjalorth

PJESA II – Struktura e përmbledhur e NVE REV.2

PJESA III – Struktura e detajuar e NVE REV.2

PJESA IV – NVE REV.2 – Shënime Shpjeguese dhe Struktura

ANEKS I – Kuadri Ligjor

ANEKS II – Kryerje nga të tretë (Delegimi)

NVE UDHËZIME HYRËSE

pjesa



NVE:
Hyrje dhe
sfondi

kapitulli 1


1.1 NVE dhe sistemi i integruar i Klasifikimeve të Veprimtarive Ekonomike dhe Produkteve

1. NVE është shkurtimi që përdoret për të përcaktuar klasifikimet e ndryshme statistikore të aktiviteteve ekonomike të zhvilluara që nga viti 1970 në Bashkimin Evropian. NVE ofron kornizën për mbledhjen dhe paraqitjen e një gamë të madhe statistikore. Të dhënat sipas aktivitetit ekonomik në fushën e statistikave ekonomike (p.sh., të prodhimit, të punësimit, llogaritë kombëtare) dhe në fusha të tjera statistikore.

2. Statistikat e prodhuara në bazë të NVE janë të krahasueshme në nivel Evropian dhe në përgjithësi, në nivel botëror. Përdorimi i NVE është i detyrueshëm në kuadër të Sistemit Evropian të Statistikës.

Sistemi ndërkombëtar i klasifikimeve ekonomike

3. Krahasueshmëria në nivel botëror të statistikave të prodhuara në bazë të NVE është për shkak të faktit se NVE është pjesë e një sistemi të integruar të klasifikimit statistikor, zhvilluar kryesisht nën kujdesin statistikor të Divizionit të Kombeve të Bashkuara. Nga pikëpamja Evropiane, ky sistem mund të përfaqësohet siç vijon më poshtë.



Ku:

- ISIC është Klasifikimi Ndërkombëtar Standard Industrial i Kombeve të Bashkuara për të gjitha aktivitetet ekonomike.
- CPC është Klasifikimi Qendror i Produkteve të Kombeve të Bashkuara.
- HS është Harmonizimi i Përshkrimit të Mallrave dhe sistemit të Kodimit, i përdorur nga Organizata Botërore e Doganave.
- CPA është Klasifikimi Evropian i Produkteve sipas Aktiviteteve.
- PRODCOM është klasifikimi i prodhimit të mallrave të përdorura për statistikat në prodhimin industrial në BE.
- CN qëndron për Nomenklaturën e Kombinuar, një klasifikim Evropian i mallrave i përdorur për statistikat e tregtisë të jashtme.

4. Ky sistem i integruar mundëson krahasimin e statistikave të prodhuara në fusha të ndryshme statistikore. Si pasojë për shembull, statistikat për prodhimin e mallrave (raportuar në BE në bazë të sondazheve PRODCOM) mund të krahasohen me statistikat e tregtisë (në BE prodhuar sipas CN). Më shumë detaje mbi sistemin dhe komponentet e tij janë dhënë në Kapitullin 4.

5. NACE rrjedh nga ISIC, në kuptimin që ai është më i detajuar se ISIC. ISIC dhe NACE kanë saktësisht të njëjtët artikuj në nivelet më të larta, ku NACE është më i detajuar në nivele më të ulëta.

6. Për të siguruar krahasueshmërinë ndërkombëtare, përkufizimet dhe udhëzimet e përcaktuara për përdorimin e NACE brenda BE-së janë në përputhje me ato të publikuarat në hyrje të ISIC.

1.2 NACE: Shtrirja dhe karakteristikat

Klasifikimet statistikore

7. Të gjitha vëzhgimet që janë të përshkruara në drejtim të statistikave, kërkojnë klasifikim sistematik. Klasifikimet ndajnë universin e vrojtimit statistikore në përputhje me grupet që janë po aq homogjene sa është e mundur në lidhje me karakteristikat e objektit të vrojtimit statistikor.

8. Klasifikimet statistikore janë karakterizuar nga:
- a. mbulimi i plotë i universit të vrojtuar;
 - b. kategoritë reciprokisht ekskluzive: secili element duhet të klasifikohet vetëm në një kategori të klasifikimit;
 - c. Parimet metodologjike të cilat lejojnë ndarjen e vazhdueshme të elementeve të kategorive të ndryshme të klasifikimit.

9. Më konkretisht, klasifikimet hierarkike janë karakterizuar sipas nënndarjeve më shumë të hollësishme të kategorive, të cilat bejnë të mundur mbledhjen dhe paraqitjen e informacionit në nivele të ndryshme të grumbullimit.

NVE si klasifikim i BE-së për aktivitetet ekonomike

10. NVE është klasifikimi European standart i aktiviteteve ekonomike prodhuese. NVE paraqet universin e aktiviteteve ekonomike ndarë në mënyrë të tillë që një kod NVE mund të shoqërohet me një njësi statistikore.

11. Një aktivitet ekonomik ndodh kur burime të tilla si mallrat kapitale, puna, teknikat e prodhimit ose produktet ndërmjetës janë të kombinuara për të prodhuar mallra ose shërbime specifike. Kështu, një aktivitet ekonomik është i karakterizuar nga një kontribut i burimeve, një proces të prodhimit dhe një prodhim të produkteve (mallra ose shërbime).

12. Një aktivitet siç është përcaktuar këtu mund të përbëhet nga një proces i thjeshtë (për shembull endje), por gjithashtu mund të mbulojnë një gamë të tërë të nën-proceseve, të përmendur në çdo klasifikim të kategorive të ndryshme (për shembull, prodhimi i një makine përbëhet nga aktivitete specifike të tilla si derdhje, farkëtim, saldim, montim, lyerje etj.). Nëse procesi i prodhimit është i organizuar si një seri e integruar e aktiviteteve elementare brenda së njëjtës njësi statistikore, i gjithë kombinimi konsiderohet si një aktivitet.

13. NVE në vetvete nuk jep kategori për lloje të veçanta të njësive statistikore: njësitë mund të kryejnë disa aktivitete ekonomike dhe mund të përkufizohen në mënyra të ndryshme sipas karakteristikave të veçanta (lidhur p.sh. me vendndodhjen, shih seksionin mbi “njësitë statistikore” më poshtë).

Shtrirja dhe kufizimet e NVE

14. NVE nuk bën dallime sipas llojit të pronësisë së një njësie prodhimi ose llojit të organizimit juridik apo mënyrës së veprimit sepse kriteret e tilla nuk lidhen me karakteristikat e aktivitetit të vetë. Njësitë e angazhuara në të njëjtin lloj të aktiviteti ekonomik janë klasifikuar në kategoritë e njëjta të NVE, pavarësisht nëse janë (pjesë e) ndërmarrjeve të përfshira, pronarëve individualë ose qeverisë, nëse janë apo jo ndërmarrje mëmë është një entitet i huaj. Prandaj, nuk ka lidhje mes NVE dhe Klasifikimin e njësive Institucionale në sistemin e Llogarive Kombëtar (SNA) ose në Sistemin Evropian të Llogarive (ESA).

15. Aktivitetet prodhuese janë përshkruar të pavarura edhe nëse puna është kryer nga një makineri ose me dorë, ose nëse ajo është bërë në një fabrikë apo në një familje. Modernja kundrejt tradicionales nuk është një kriter për NVE.

16. NVE nuk bën dallime midis formales dhe joformales ose midis legales dhe ilegales të njësive prodhuese. Klasifikimi sipas llojit të pronësisë ligjore, llojit të organizimit apo mënyra e operimit mund të ndërtohet e pavarur. Klasifikimi sipas NVE mund të sigurojë informata ekstra të dobishme.

17. Në përgjithësi, NVE nuk bën dallim ndërmjet aktiviteteve tregtare dhe jo-tregtare, siç përcaktohet në SNA/ESA, edhe në qoftë se ky dallim është një tipar i rëndësishëm i SNA/ESA. Një ndarje e aktiviteteve ekonomike sipas këtij parimi është e dobishme në çdo rast ku të dhënat janë mbledhur për aktivitete që zhvillohen në bazë tregtare dhe jo tregtare. (Ky kriter duhet pastaj të jetë ndër-klasifikuar me kategoritë e NVE-s). Shërbimet jo-tregtare në NVE janë dhënë vetëm nga organizatat qeveritare ose institucionet jo-fitimprurëse që u shërbejnë familjeve, kryesisht në fushën e arsimit, shëndetësisë, punëve sociale, etj.

18. NVE përfshin kategoritë për prodhimin e padiferencuar të mallrave dhe shërbimeve nga familjet për përdorimin e tyre. Këto kategori mund t'i referohen, megjithatë, vetëm një pjese të aktiviteteve ekonomike të familjeve, pasi aktivitetet familjare më qartë të identifikueshme janë të klasifikuara në pjesë të tjera të NVE.

Strukturimi dhe kodimi i NVE

19. NVE konsiston në një strukturë hierarkike, në udhëzimet hyrëse dhe shënimet shpjeguese. Struktura e NVE është e përshkruar në rregulloren e NVE-s si më poshtë:

- i. - niveli i parë është i përbërë nga tituj të cilët janë të identifikuar nga një kod alfabetik, (seksione),
- ii. - niveli i dytë është i përbërë nga tituj të cilët janë të identifikuar me kode 2-shifrore numerike, (ndarje)
- iii. - niveli i tretë është i përbërë nga tituj të cilët identifikohen nga kode 3 shifrore numerike, (grupe)
- iv. - niveli i katërt është i përbërë nga tituj të cilët identifikohen me kode 4 shifrore numerike, (klasat).

Kodi për nivelin e seksionit nuk është i integruar në kodin NVE që identifikon ndarja, grupi dhe klasa për të përshkruar një aktivitet specifik. Për shembull, Aktiviteti “Prodhimi i ngjitjes” është identifikuar me kodin 20.52, ku 20 është Kodi për ndarjen, 20.5 është kodi për grupin dhe 20.52 është kodi i klasës; Seksioni C, në të cilën kjo klasë i përket, nuk shfaqet në këtë kod.

20. Ndarjet janë të koduara në rresht. Megjithatë, disa “boshllëqe” janë dhënë për të lejuar futjen e ndar-

jeve shtesë pa ndryshuar kodimin NVE. Këto mangësi janë futur në nenet që kanë më shumë gjasa për të nxitur nevoja për ndarje shtesë. Për këtë qëllim, shifrat e kodit më poshtë kanë mbetur të papërdorura në NVE Rev 2: 04, 34, 40, 44, 48, 54, 57, 67, 76, 83 dhe 89.

21. Në rastet kur në një nivel të dhënë klasifikimi nuk është nënklasifikuar më tej, është përdorur “0” në pozicionin e kodit për nivelin e ardhshëm më të detajuar. Për shembull, kodi për klasën “Aktivitete veterinare” është 75.00 sepse ndarja “Aktivitete veterinare” (Kodi 75) nuk ndahet as në grupe, as në klasa. Ndërsa klasa “Prodhimi i birrës” është koduar si 11.05 sepse ndarja “Prodhimi i pijeve” (Kodi 11) nuk është e ndarë në grupe, por grupi “Prodhim i pijeve” (kodi 11.0) është ndarë në klasa.

22. Kurdo që është e mundur, grupet e mbetura ose klasa të “të tjerët” të tipit dhe/ose p.k.t (të paklasifikuara vend tjetër) janë karakterizuar nga shifra 9 (për shembull grupi 08.9 “Nxjerrje nga minierat dhe karrierat të mineraleve të tjera, p.k.t.” dhe klasa 08.99 “Industri të tjera nxjerrëse p.k.t.”).

1.3 NVE: Historiku dhe konteksti ligjor.

Nga NICE në NVE Rev.2

23. Ndërmjet vitit 1961 dhe 1963, mori zhvillim “Nomenclature des Industries établies dans les Communautés Européennes” (NICE), (Klasifikimi i Industrive themeluar në Komunitetin Evropian). Versioni origjinal (1961) kishte ndarje me të gjera, të cilat paraqiteshin me 3 shifra pas presjes. Versioni rishikuar (1963) kishte nënndarje më të detajuara. NICE mbulonte industritë nxjerrëse, energji-prodhuese përpunuese dhe ndërtim.

24. Në 1965, “Nomenclature du commerce dans la CEE” (NCE) (Klasifikimi i Tregtisë dhe Tregtia në Komunitetin Evropian) u zhvillua për të mbuluar të gjitha aktivitetet tregtare.

25. Në vitin 1967, u zhvillua një klasifikim për shërbimet, i ndjekur nga një klasifikim për bujqësinë. Të dyja këto u zhvilluan në ndarje më të detajuara.

26. Në vitin 1970, u zhvillua shumë “Nomenclature générale des activités économiques dans les Communautés Européennes” (NVE - Klasifikimi i Përgjithshëm i aktiviteteve Ekonomike në kuadër të Komunitetit Evropian). Ashtu sikurse dhe nga vetë emri i saj, ajo përbënte një klasifikim i cili mbulonte të gjithë gamën e aktivitetit ekonomik.

27. Versioni i parë i NVE pati dy të meta kryesore:

- Ashtu sikundër ajo nuk ishte e themeluar si pjesë e legjislacionit të komunitetit, të dhënat shpesh janë mbledhur sipas klasifikimeve ekzistuese kombëtare dhe më pas janë transformuar në formatin NVE me anë të konvertimit të pikave më të rëndësishme, të cilat nuk prodhonin të dhëna të krahasueshme të kënaqshme
- Sikundër NVE Rev 1970 nuk ishte zhvilluar brenda një kuadri të pranuar ndërkombëtar, ajo solli krahasueshmëri të dobët me klasifikime të tjera ndërkombëtare të aktiviteteve ekonomike.

28. Me pas u vendos që të merrej në konsideratë shtrirja e NVE në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përmes një pune të përbashkët në grup ndërmjet Zyrës së Statistikave të Kombeve të Bashkuara dhe Eurostat, Eurostat dhe përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të BE-së kanë qenë të përfshirë nga afër në rishikimin e tretë të Klasifikimit Industrial Standard Ndërkombëtar të të gjitha veprimtarive Ekonomike (ISIC Rev 3), e cila u miratua nga Komisioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara në shkurt 1989.

29. Më pas, një grup pune të nxitur nga Eurostat me përfaqësuesit e anëtarëve nga shtetet pjesëmarrëse zhvilluan një version të ri të NVE, të quajtur NVE Rev 1. duke u bazuar në strukturën e ISIC Rev 3, detajet u shtuan për të pasqyruar në të se aktivitetet evropiane ishin të përfaqësuara në mënyrë joadekuate në ISIC. NVE Rev 1 është themeluar nga Rregullorja e Këshillit Nr 3037/90 të datës 9 tetor 1990.

30. Në vitin 2002, u themelua një përditësim i vogël i NVE Rev 1, i quajtur NVE Rev 1.1,. Në NVE Rev 1.1 u futën disa tema të tjera dhe u bënë ndryshime në disa tituj. Qëllimi i përditësimit ishte për të nxjerre në pah:

- Aktivitete të reja të cilat nuk ekzistonin kur NVE Rev 1 u zhvillua (p.sh. qendrat telefonike).
- Aktivitetet të cilat patën një rritje të dukshme që kur NVE Rev 1 ishte zhvilluar, ose për shkak të ndryshimeve teknologjike apo organizative.
- Korrigjimi i gabimeve në NVE Rev 1.

31. Në vitin 2002, filluan aktivitetet për rishikimin NVE . Rregullorja për krijimin NVE Rev 2 u miratua në dhjetor 2006, dhe teksti i tij është paraqitur në Aneksin II. Ajo përfshin dispozita për zbatimin e NVE Rev 2 duke koordinuar NVE Rev 1.1 me NVE Rev 2 në fusha të ndryshme statistikore. NVE Rev 2 u hartua për t'u përdorur, në përgjithësi, për statistika që kanë të bëjnë me veprimtaritë ekonomike të kryera nga 1 Janar 2008 e tutje (Neni 8 i Rregullores NVE jep detaje mbi zbatimin).

Rregullorja NACE: Karakteristika kryesore

32. Shtetet Anëtare dhe Komisioni vërtetuan se përdorimi i NVE duhet të jetë i detyrueshëm në BE. Prandaj, rregulloret e vendosur NVE përfshinë dispozita për këtë. Statistikat e grumbulluara nga Shtetet Anëtare të BE që përfshijnë klasifikimin sipas aktivitetit ekonomik duhet të jenë të hartuara në përputhje me NVE apo me një klasifikim kombëtar që rrjedh prej saj.

33. Rregullorja e NVE lejon Shtetet Anëtare për të përdorur një version kombëtar që rrjedh nga NVE për qëllime kombëtare. Versione të tilla kombëtare duhet të zenë një vend kryesor në kuadrin strukturor dhe hierarkik të NVE. Shumica e shteteve anëtare kanë zhvilluar versionet kombëtare, zakonisht duke shtuar një shifër 5 për qëllime kombëtare.

34. Komisioni dhe Komiteti i përfaqësuesëve të Shteteve Anëtare (SPC) janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Rregullores, duke bërë ndryshime të vogla (për shembull për të pasqyruar ndryshimin teknologjik) duke bashkërenduar me organizatat ndërkombëtare shqetësimin në lidhje me klasifikimin e aktiviteteve ekonomike.

1.4 Rishikimet e NVE

35. Ndryshimet në strukturat dhe organizimet ekonomike, si dhe zhvillimet teknologjike, japin mundësi të rriten aktivitetet dhe produktet e reja, të cilat mund të zëvendësojnë ato ekzistuese. Këto ndryshime nënkuptojnë një sfidë të vazhdueshme për hartimin e klasifikimeve statistikore. Në intervalet mes rishikimeve, pushimi nuk duhet të jetë shumë i gjatë, pasi rëndësia e klasifikimit zbehet me kalimin e kohës, e as nuk duhet të jetë shumë e shkurtër, pasi ndryshe krahasueshmëria e të dhënave me kalimin e kohës do të ndikohet negativisht. Çdo rishikim i klasifikimit, veçanërisht nëse ajo përfshin ndryshime strukturore, të çon në pushime të serive kohore.

36. Një rishikim i madh i klasifikimeve ndërkombëtare dhe evropiane të aktiviteteve ekonomike dhe produkteve, i njohur si "Operacioni 2007", u zhvillua midis viteve 2000 dhe 2007. Rishikimi në fjalë përfshiu të gjitha klasifikimet e sistemit të integruar ekonomik siç përshkruhet në nenin 1.1. Kriteret kryesore që drejtuan rishikimin ishin:

- Rëndësia për ekonominë aktuale botërore,
- Krahasueshmëria e mirë me klasifikime të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare
- Vazhdimësia me versionet e tyre të mëparshme.

Disa konsultime janë organizuar që nga viti 2002, me të gjithë palët e aksionerëve, duke përfshirë departamentet e Komisionit Kombëtar, institutet statistikore kombëtare, si dhe Biznesin Evropian dhe Shoqatat tregtare, duke kërkuar për propozime dhe ndryshime të NVE Rev 1.1.

37. Karakteristikat e përgjithshme të NVE mbeten të pandryshuara. NVE Rev 2 arriti një balancë ndërmjet nivelit të kërkuar të detajeve nga përdoruesit kryesorë dhe ngarkesës me punë në Institutet Statistikore.

38. Detajet mbi ndryshimet kryesore nga NVE Rev 1.1 deri në NVE Rev 2 janë paraqitur në Kapitullin 5.

NVE:
Përkufizime
dhe parime

kapitulli 2

2.1 Kriteret e pranuar për zhvillimin e NVE-s

39. Kriteret e përdorur për përcaktimin dhe përshkrimin e klasifikimit të kategorive të çdo niveli, varen nga shumë faktorë, siç janë: përdorimet e mundëshme të klasifikimeve dhe vlefshmëria e të dhënave. Këto kritere aplikohen në mënyra të ndryshme në nivele të ndryshëm klasifikimi: kriteret për nivele të detajuara të agregimit konsiderojnë ngjashmeritë në procesin aktual të prodhimit, ndërsa kjo është tërësisht e parëndësishme në nivele më të agreguara të klasifikimit.

Kriteret për klasat

40. Kriteret, lidhur me mënyrën se si aktivitetet janë kombinuar në njësitë prodhuese dhe alokuar midis tyre, janë kryesore në përcaktimin e klasave (kategorive më të detajuara) të NVE. Ato synojnë të sigurojnë që klasat e NVE do të jenë relevante për klasifikimet e detajuara industriale të njësive dhe që njësitë e vendosura në çdo klasë do të jenë aq të ngjashme, sipas aktiviteteve që ato kryejnë, siç është e realizueshme.

41. NVE Rev.2, duke reflektuar versionin e katërt të ISIC, përgjithësisht i jep më shumë rëndësi procesit të prodhimit në përcaktimin e klasave individuale. Kjo nënkupton që aktivitetet janë grupuar bashkë kur ato ndajnë një proces të përbashkët për prodhimin e mallrave ose shërbimeve, duke përdorur teknologji të njëjta.

42. Për më tepër, klasat e NVE përcaktohen të tilla që dy kushtet e mëposhtme të plotësohen në se është e mundur:

- a. Produkti i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve që karakterizon një klasë të dhënë llogaritet për madhësi të outputit të njësive të klasifikuar sipas kësaj klase.
- b. Klasa përmban njësi që prodhojnë shumicën e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve që karakterizojnë atë.

43. Një tjetër konsideratë kryesore që duhet përfshirë në përcaktimin e klasave në NVE është rëndësia relative e aktiviteteve. Në përgjithësi klasa të veçanta sigurohen për aktivitete që janë mbizotëruese në shumicën e vendeve të BE-së, ose që janë të një rëndësie të veçantë në ekonominë botërore. Për të siguruar krahasueshmëri ndërkombëtare, klasa të njëjta janë paraqitur në strukturat e ISIC dhe prej andej janë përfshirë në NVE.

Kriteret për grupet dhe ndarjet

44. Ndryshe nga klasat, proceset dhe teknologjitë aktuale të prodhimit të përdorura në aktivitetet prodhuese bëhen më pak të rëndësishme, si një kriter për grupimin e tyre në nivele më të agreguara. Në nivelin më të lartë (seksionet) karakteristikat e përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara, si dhe të përdorura potencialisht për statistikat, për shembull në kuadrin e SNA dhe ESA, bëhen një faktor i rëndësishëm.

45. Kriteri kryesor që përdoret në përshkrimin e grupeve dhe të ndarjeve të NVE lidh karakteristikat e mëposhtme të aktiviteteve të njësive prodhuese:

- Karakteri i mallrave dhe shërbimeve të prodhuara,
- Përdorimet tek të cilat mallrat dhe shërbimet janë vendosur dhe
- Inputet, proceset dhe teknologjitë e prodhimit

46. Në rastin e karakterit të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara, llogaria është marrë nga përbërja fizike, stadi i fabrikimit të artikujve dhe nevojat e shërbyera nga ato. Dallimi i kategorive të NVE sipas natyrës së mallrave dhe shërbimeve të prodhuara siguron bazën për grupimin e njësive prodhuese sipas ngjashmërisë dhe lidhjeve midis materialeve bruto të konsumuara, burimeve të kërkuara dhe tregjeve për artikujt.

47. Pësia e caktuar në kriterin e përshkruar më sipër varion nga një kategori tek një tjetër. Në një sërë rastesh (për shembull në industritë e përpunimit të ushqimeve, të tekstilëve, të veshjeve dhe lëkurëve, prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, si dhe në industritë e shërbimeve) të tre aspektet specifike janë aq ngushtësisht të lidhura sa që problemi i caktimit të peshave për kriterin nuk ngrihet. Në rastin e produkteve të ndërmjetme, përbërjes fizike, si dhe stadi të fabrikimit të artikujve, shpesh u është dhënë pësia më e madhe. Në rastin e mallrave me procese të komplikuar prodhimi, përdorimit përfundimtar, teknologjisë dhe organizimit të prodhimit të artikujve shpesh i është dhënë prioritet mbi përbërjen fizike të mallrave.

2.2 Aktivitete kryesore, dytësore dhe ndihmëse

48. Një njësi mund të performojë një ose më shumë aktivitete ekonomike të përshkruara në një ose më shumë kategori të NVE.

49. Aktiviteti kryesor i një njësie statistikore është aktiviteti që kontribuon më shumë në totalin e vlerës së shtuar të asaj njësie. Aktiviteti kryesor përcaktohet sipas metodës nga lart-poshtë (shiko seksionin 3.1) dhe nuk është e nevojshme të llogaritet për 50% ose më shumë të totalit të vlerës së shtuar të njësisë.

50. Një aktivitet dytësor është çdo aktivitet i njësisë, outputet e të cilit janë mallra ose shërbime të cilat janë të përshtatshme për t'u shpërndarë tek të tretët. Vlera e shtuar e aktiviteteve dytësore duhet të jetë më e vogël se ajo e aktivitetit kryesor.

51. Një dallim duhet bërë ndërmjet aktiviteteve kryesore dhe dytësore nga njera anë dhe aktiviteteve ndihmëse nga ana tjetër. Aktivitetet kryesore dhe dytësore përgjithësisht kryen me mbështetjen e një sërë aktiviteteve ndihmëse, siç janë financa, transporti, ruajtja, blerja, promovimi i shitjeve, riparimi dhe mirëmbajtja. Kështu, aktivitete ndihmëse janë ato që ekzistojnë vetëm për të mbështetur aktivitetet ekonomike kryesore ose dytësore të një njësie, duke siguruar mallra ose shërbime për përdorim vetëm nga kjo njësi.

52. Një aktivitet është ndihmës nëqoftëse ai përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:

- I shërben vetëm njësisë ose njësive të lidhura me të
- Inputet kontribuojnë në kostot e njësisë
- Outputet (zakonisht shërbimet, të mira të rralla) nuk janë pjesë e produktit përfundimtar të njësisë dhe nuk gjenerojnë formim të kapitalit fiks bruto
- Një aktivitet i krahasueshëm në një shkallë të njëjtë performohet në njësi prodhimi të njëjta

53. Shembujt e mëposhtëm nuk duhet të konsiderohen si aktivitete ndihmëse:

- Prodhimi i mallrave dhe shërbimeve që janë pjesë e formimit të kapitalit, për shembull puna ndërtuese për llogari të vetë, e cila duhet të klasifikohet veças nga ndërtimi nëqoftëse të dhënat janë të vlefshme, dhe prodhimi i software-ve.
- Prodhimi i outputeve, një pjesë e rëndësishme e të cilave shitet në treg, madje edhe nëse pjesë të saj konsumohen në lidhje me aktivitetet kryesore.
- Prodhimi i mallrave ose shërbimeve i cili në mënyrë të vetëdijëshme bëhet një pjesë integrale e outputit të aktivitetit kryesor apo dytësor (p.sh prodhimi i kutive nga një department i një ndër-marrjeje për paketimin e produkteve të tij)
- Prodhimi i energjisë (një stacion elektrik ose uzinë koksi) edhe nëse i gjithë outputi konsumohet nga njësi mëmë)
- Blerja e mallrave për rishitje në një gjendje të pandryshuar
- Kërkimi dhe zhvillimi, meqenëse këto aktivitete nuk sigurojnë një shërbim që konsumohet në kushtet e prodhimit aktual

54. Në të gjitha këto raste, ku të dhëna të veçanta janë të vlefshme, njësitë e veçanta duhet të dallohen dhe të njihen si njësi sipas llojit të aktivitetit (shiko seksionin tjetër) dhe atëherë të klasifikohen sipas aktivitetit të tyre.

2.3 Përkufizimet e njësive statistikore

55. Në mënyrë që të japim një pamje complete statistikore të ekonomisë, kërkohet një informacion i gjerë dhe një nivel organizimi në të cilin kjo është e mundur për të mbledhur informacion varion sipas tipit të të dhënave. Për shembull, të dhënat e fitimit për një kompani mund të jenë të vlefshme vetëm nga një qendër gjeografikisht qendrore duke përmblledhur disa qendra të ndryshme, ndërkohë që të dhënat për shitjet e produkteve mund të jenë të vlefshme për çdo qendër më vete. Për të vëzhguar dhe analizuar se sa të kënaqshme janë të dhënat, është e nevojshme të përcaktohet një sistem i njësive statistikore. Këto formojnë blloqe sipas të cilave të dhënat mund të mblidhen dhe të klasifikohen në përputhje me NVE

57. Më poshtë janë njësitë që janë përshkruar në Rregulloren e Këshillit mbi njësitë statistikore⁽¹⁾

- Grup ndërmarrje
- Ndërmarrje
- Njësi sipas llojit të aktivitetit (KAU)
- Njësi lokale
- Njësi lokale sipas llojit të aktivitetit (lokal KAU)
- Njësi institucionale
- Njësi e prodhimeve homogjene (UHP)
- Njësi lokale e prodhimeve homogjene (lokal UHP)

	Një ose më shumë vend-ndodhje	Një vend-ndodhje të vetme
Një ose më shumë aktivitete	Ndërmarrje	Njësi lokale
	Njësi institucionale	
Një aktivitet i vetëm	KAU	Lokal KAU
	UHP	Lokal UHP

Diagrama e strukturës së njësive administrative dhe statistikore në Kosovë. Diagrami është i ndarë në dy pjesë kryesore: Njësiti administrative dhe Njësia statistikore.

Njësiti administrative:

- Njësiti administrative përfshin Njësi legale të kontrolluara, Njësia legale dhe Pjesa lokale e njësisë legale.
- Njësi legale të kontrolluara shpërthet në Njësia legale.
- Njësia legale shpërthet në Pjesa lokale e njësisë legale.

Njësia statistikore:

- Njësia statistikore përfshin Grup ndërmarrje, Ndërmarrje, Njësia sipas llojit të aktivitetit, Njësia lokale sipas llojit të aktivitetit, Njësia lokale, Njësia institucionale, Njësia e prodhimeve homogjene dhe Njësia lokale e prodhimeve homogjene.
- Grup ndërmarrje shpërthet në Ndërmarrje.
- Ndërmarrje shpërthet në Njësia sipas llojit të aktivitetit dhe Njësia lokale.
- Njësia sipas llojit të aktivitetit shpërthet në Njësia lokale sipas llojit të aktivitetit.
- Njësia lokale shpërthet në Njësia lokale sipas llojit të aktivitetit.
- Njësia institucionale shpërthet në Njësia e prodhimeve homogjene.
- Njësia e prodhimeve homogjene shpërthet në Njësia lokale e prodhimeve homogjene.

Shënime:

- Njësi sipas llojit të aktivitetit shpërthet në Njësia sipas llojit të aktivitetit.
- Njësia sipas llojit të aktivitetit shpërthet në Njësia sipas llojit të aktivitetit.
- Njësia sipas llojit të aktivitetit shpërthet në Njësia sipas llojit të aktivitetit.

23

Rregullat e klasifikimit për aktivitetet dhe njësitë

kapitull 3

3.1 Rregullat bazë të klasifikimit

58. Çdo njësi të regjistruar në Regjistrin Statistikor⁽¹⁾ të Ndërmarrjeve i është caktuar një kod NVE sipas veprimtarisë ekonomike kryesore. Veprimtaria kryesore është veprimtaria që kontribuon më shumë në vlerën e shtuar të njësisë. Caktimi i kodit NVE është ndihmuar nga: shënimet sqaruese të NVE, vendimet e marra nga komisioni i Nomenklaturave që menaxhon NACE, tabelat korresponduese dhe referencë e sistemeve të klasifikimeve të tjera të tilla si ISIC, CPA, HS, CN, etj.

59. Në rastin më të thjeshtë kur një njësi kryen vetëm një veprimtari ekonomike, klasifikimi i veprimtarisë së kësaj njësie përcaktohet nga kategoria NVE që përshkruan këtë veprimtari. Kur njësi kryen një sërë (më shumë se një) veprimtarish ekonomike (përveç veprimtarive ndihmëse, Seksioni 2.2), veprimtaria kryesore përcaktohet bazuar në vlerën e shtuar që i përket secilës veprimtari në bazë të rregullave të sqaruara më poshtë.

60. Vlera e shtuar është koncepti bazë për përcaktimin e klasifikimit të një njësie bazuar në veprimtarinë ekonomike. Vlera e shtuar bruto është përkufizuar si diferencë ndërmjet prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm. Vlera e shtuar është një masë shtesë e kontributit të çdo njësi ekonomike në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB).

Zëvendësuesit e vlerës së shtuar

61. Për të përcaktuar veprimtarinë kryesore të një njësie duhet të njihen veprimtaritë e njësisë dhe pjesët e vlerës së shtuar. Shpesh nuk është e mundur që të përfitohet informacion mbi vlerën e shtuar të veprimtarive të ndryshme që kryen njësi dhe përcaktimi i klasifikimit të veprimtarisë duhet bërë nëpërmjet përdorimit të kriterëve të tjerë. Kriteret e tilla janë:

- a. Zëvendësues bazuar në prodhim:
 - prodhimi bruto i njësisë i cili përbëhet nga mallra dhe shërbime sipas çdo veprimtarie
 - vlera e shitjeve ose shifra e afarizmit e këtyre grupeve të produkteve që i përkasin secilës veprimtari;
- b. Zëvendësues bazuar në inputet:
 - pagat dhe shpërblimet që i përkasin veprimtarive të ndryshme (apo të ardhurat e të vetëpunësuarve);
 - numri i të punësuarve përfshirë në veprimtari të ekonomike të ndryshme të njësisë.
 - koha e punës së punësuarve në veprimtari ekonomike të ndryshme të njësisë

62. Kriteret e tilla zëvendësuese përdoren si përafrime për të dhënat e vlerës së shtuar të panjohur, për të marrë përafrimin më të mirë të mundshme krahasuar me rezultatet të cilat mund të përfitoheshin mbi bazën të dhënave të vlerës së shtuar. Përdorimi i kriterëve zëvendësues nuk ndryshon metodat e përdorura për të përcaktuar veprimtarinë kryesore, pasi ato janë vetëm operative përafrues të të dhënave të vlerës së shtuar.

63. Megjithatë përdorimi i thjeshtë i kriterëve të mësipërme zëvendësuese ndonjëherë mund të na orientojë gabim. Këto janë rastet kur struktura e kriterëve zëvendësues nuk është në proporcion me vlerën e shtuar të panjohur.

64. Kur shitjet përdoren (shifra afarizmit) si përafrues për vlerën e shtuar, duhet të merret parasysh se në raste të caktuara shifra e afarizmit dhe vlera e shtuar nuk janë proporcionale. Për shembull shifra afarizmit në tregti zakonisht ka një pjesë shumë më të ulët të vlerës së shtuar se shifra afarizmit në prodhim, madje edhe brenda prodhimit lidhje midis shitjes dhe vlerës së shtuar rezulton që mund të ndryshojnë ndërmjet dhe brenda veprimtarive. Për disa veprimtari shifra afarizmit është përcaktuar në një mënyrë të veçantë që e bën krahasimin me veprimtari të tjera të padobishëm, p.sh. veprimtaria ndërmjetësve financiare ose veprimtaria e sigurimit. E njëjta gjë duhet mbajtur në konsideratë kur përdoren të dhënat e prodhimit bruto si kriter zëvendësimi.

65. Shumë njësi ushtrojnë veprimtari tregtare dhe veprimtari të tjera. Në raste të tilla shifra e afarizmit të tregtisë është treguesi më i papërshtatshëm për vlerën e shtuar të panjohur të pjesës së veprimtarisë së tregtisë. Një tregues shumë më i mirë është marzhi bruto (diferenca ndërmjet shifrës së afarizmit në tregti dhe blerjeve të mallrave për rishitje përshtatur me ndryshimet e gjëndjeve). Megjithatë, marzhi i tregtisë mund të ndryshojë brenda një tregti të vetme me shumicë dhe tregtisë me pakicë gjithashtu dhe në mes të veprimtarive tregtare. Përveç kësaj duhet t'i jepet rëndësi rregullave specifike të klasifikimit për tregtinë siç përcaktohet në seksionin 3.4.

66. Masa të ngjashme duhet të merren parasysh edhe kur përdoret kriteri i zëvendësimit bazuar në inpute. Proporcionaliteti midis pagave dhe rrogave apo punësimit nga njëra anë dhe vlera e shtuar nga ana tjetër nuk është i besueshëm në qoftë se intensiteti i punës në veprimtari të ndryshme është i ndryshëm. Intensiteti i punës mund të ndryshojë në mënyrë thelbësore në veprimtari të ndryshme ekonomike gjithashtu edhe në mes të të njëjtës klasë NVE. Shembull: prodhimi i një të mire me dorë dhe prodhimi i një të mire duke përdorur një proces të mekanizuar.

3.2 Veprimtaritë e shumëfishta dhe të integruara

67. Raste mund të lindin kur një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë së një njësie përfshihet në më shumë se një klasë të NVE-s. Këto raste mund të rezultojnë nga integrimi vertikal i veprimtarive (për shembull prerja e pemëve dhe më pas sharrimi, nxjerrja e argjilës e kombinuar me prodhimin e tullave), ose të integritit horizontal të veprimtarive (për shembull, prodhimi i produkteve të bukës kombinuar me prodhimin e ëmbël-sirave me çokollatë), apo ndonjë kombinim të aktiviteteve brenda një njësi statistikore. Në këto situata njësia duhet të klasifikohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë seksion.

68. Nëse një njësi kryen veprimtari që bëjnë pjesë vetëm në dy kategori NVE të ndryshme, do të jetë gjithmonë një veprimtari që do të zërë më shumë se 50% të vlerës së shtuar, përveç rasteve shumë të rralla që të dyja veprimtaritë në kategoritë e ndryshme të kenë ndarje të barabarta prej 50%. Veprimtaria që përfaqëson më shumë se 50% të vlerës së shtuar është veprimtaria kryesore dhe përcakton klasifikimin NVE Rev. 2 të njësisë.

69. Në rastet më të ndërlikuara ku një njësi kryen më shumë se dy veprimtari që u përkasin më shumë se dy kategorive të ndryshme NVE dhe asnjë prej tyre nuk përbën më shumë se 50 % të vlerës së shtuar, klasifikimi i veprimtarisë së kësaj njësie duhet të përcaktohet duke përdorur metodën nga lart-poshtë siç përshkruhet më poshtë.

Metoda nga "lart-poshtë"

70. Metoda nga lart-poshtë ndjek një parim hierarkik. Klasifikimi i një njësie në nivelin më të ulët të klasifikimit duhet të jetë në përputhje me klasifikimin e njësisë në nivelet më të larta të strukturës. Për të plotësuar këtë kusht procesi fillon me identifikimin e nivelit më të lartë përkatës dhe vazhdon poshtë nëpërmjet niveleve të klasifikimit me mënyrën e mëposhtme:

- Identifikimi i seksionit i cili ka pjesën më të madhe të vlerës së shtuar
- Brenda këtij seksioni identifikohet ndarja që ka pjesën më të madhe të vlerës së shtuar
- Brenda kësaj ndarjeje identifikohet grupi që ka pjesën më të lartë të vlerës së shtuar
- Brenda këtij grupi të identifikohet klasa e cila ka pjesën më të madhe të vlerës së shtuar


71. Shembull: një njësi kryen aktivitetet vijuese (ndarja mbi bazën e vlerës së shtuar)

Seksioni	Ndarja	Grupi	Klasa	Përshkrimi	Pjesa që i përket
C	25	25.9	25.91	Prodhimi i fuçive metalike dhe kontenierë të ngjashëm	10%
	28	28.1	28.11	Prodhimi i motorëve dhe turbinave përveç motorave të avionave, automobilave dhe motoçikletave	6%
		28.2	28.24	Prodhimi i makinerive për ushqim, pije dhe përpunimin e duhanit	5%
		28.9	28.93	Prodhimi i veglave për përdorim manual	23%
			28.95	Prodhimin e makinerive për industrinë e letrës dhe kartonit	8%
G	46	46.1	46.14	Ndërmjetësuesit në tregtinë e makinave, paisjeve industriale, anijeve dhe avionëve	7%
		46.6	46.61	Tregtia me shumicë e makinave bujqësore, pjesëve të këmbimit dhe instrumentave	28%
M	71	71.1	71.12	Aktivitetet inxhinierike dhe konsulencë teknike	13%

■ Identifikimi i seksionit kryesor		
Seksioni C - Industria Përpunuese		52%
Seksioni G - Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave		35%
Seksioni M - Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike		13%
■ Identifikimi i Ndarjes kryesore në Seksionin C:		
Ndarja 25 Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuara, përveç makineri dhe pajisje		10%
Ndarja 28 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen		42%
■ Identifikimi i Grupit kryesor në Ndarjen 28:		
Grupi 28.1 Prodhimi i makinerive për përdorim të përgjithshëm		6%
Grupi 28.2 Prodhimi i makinerive të tjera për përdorim të përgjithshëm		5%
Grupi 28.9 Prodhimi i makinerive të tjera për qëllime të veçanta		31%
■ Identifikimi i Klasës kryesore brenda grupit 28.9:		
Klasa 28.93 Prodhimi i makinerive për ushqim, pije dhe përpunimin e duhanit		23%
Klasa 28.95 Prodhimi i makinerive për prodhimin e letrës dhe kartonit		8%

Prandaj Klasa e saktë është 28.93 Prodhimi i makinerive për ushqim, pije dhe përpunimin e duhanit, edhe pse klasa me pjesën më të madhe të vlerës së shtuar është Klasa 46.61 Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe instrumentave.

Skema e mëposhtme paraqet hapat e vendimit të ndjekura në shembull.



72. Për shkak të vështirësive ndërmjet ISIC dhe NVE në nivele grupi dhe klase, aplikimi i metodës nga lartë-poshtë në NVE mund të japë alokime të ndryshme nga ato që do të merren duke aplikuar këtë metodë në ISIC. Nëse është e mundur metoda duhet të ndiqet së pari në lidhje me ISIC, identifikimin e klasës ISIC, dhe më pas në lidhje me NVE. Kjo do të siguronte përputhshmëri me klasifikimet botërore.

73. Kur aplikohet për Seksionin G “Tregtia me shumicë dhe pakicë”, është e nevojshme të bëhet një për-shtatje e veçantë e metodës nga lart-poshtë. Për detaje shiko paragrafët e mëposhtëm 93-99.

Ndryshimet e veprimtarisë kryesore të njësisë

74. Njësitë mund të ndryshojnë veprimtarinë e tyre kryesore njëherësh apo gradualisht gjatë një periudhe kohe, qoftë për shkak të faktorëve sezonalë apo për shkak të një vendimi të menaxhimit që ndryshojnë modelin e prodhimit. Të gjitha këto raste kërkojnë që klasifikimi i njësisë të ndryshohet, por me ndryshimet e shpeshta mund të rezultojnë mospërputhje midis statistikave afatshkurtëra (mujore dhe tremujore) dhe afatgjata, gjë që e bën interpretimin e tyre jashtëzakonisht të vështirë.

75. Kur një njësi kryen dy aktivitete dhe të dy kontribuojnë me rreth 50% të vlerës së shtuar, është theme-luar një rregull stabël në mënyrë që të shmangen ndryshimet e shpeshta që nuk pasqyrojnë ndryshim thelbësor në realitetin ekonomik. Sipas këtij rregulli ndryshimi i veprimtarisë kryesore duhet të bëhet kur veprimtaria aktuale ka zënë më pak se 50% të vlerës së shtuar për të paktën dy vjet.

Trajtimi i aktiviteteve të integruara vertikalisht

76. Integrimi vertikal i aktiviteteve ndodh kur fazat e ndryshme të prodhimit kryhen në zinxhir nga e njëjta njësi dhe ku prodhimi i një procesi shërben si lëndë e parë për procesin pasardhës. Shembuj të integritit vertikal të përbashkët përfshijnë prerjen e pemëve dhe më pas sharrimi, nxjerrja e argjilës e kombinuar me prodhimin e tullave, prodhimi i fijeve sintetike kombinuar me endjen e pëlhurave etj.

77. Kur aplikohet NVE Rev.2, integrimi vertikal duhet të trajtohet si çdo formë tjetër e aktiviteteve të shumfishta, dmth aktiviteti kryesor i njësisë është aktivitet që zë pjesën më të madhe e vlerës së shtuar, siç është përcaktuar në përputhje me metodën nga lartë-poshtë. Ky trajtim ka ndryshuar nga versionet e mëparshme të NVE-së. Për integrimin vertikal të rasteve të veçanta në bujqësi shih paragrafin 92.

78. Nëse vlera e shtuar ose zëvendësuesit nuk mund të përcaktohen për hapa të veçanta në një proces integrimi vertikal duke përdorur llogaritë e hartuara nga vetë njësia mund të bëhen krahasime me njësitë e ngjashme. Nga ana tjetër vlerësimi i produkteve të ndërmjetme ose përfundimtare mund të bazohet në çmimet e tregut.

Trajtimi i aktiviteteve të integruar horizontalisht

79. Integrimi horizontal i aktiviteteve ndodh kur aktivitete kryhen njëkohësisht duke përdorur faktorë të njëjtë prodhimi. Parimi i vlerës së shtuar duhet të zbatohet, duke ndjekur metodën nga lartë-poshtë dhe masa të njëjta të përdorura si zëvendësues të listuara më sipër zbatohen edhe këtu.

3.3 Rregullat për aktivitete specifike

Aktivitete të ndërmarra mbi bazë ndërmjetësimi ose kontrate dhe aktivitete deleguese

80. Në këtë seksion është aplikuar terminologjia e mëposhtme:

- a. Njësia kryesore = njësia që hyn në një marrëdhënie kontraktuale me një njësi tjetër (këtu quhet kontraktori) për të kryer disa pjesë të procesit të prodhimit në tërësi. Ndonjëherë janë përdorur termat “converter” ose “kontraktuesi”.
- b. Kontraktori = njësi që kryen një proces specifik të prodhimit të bazuar në një marrëdhënie kontraktuale me njësinë kryesore. Termi “nënkontraktori” është gjithashtu i përdorur. Në NVE aktivitetet e kryera nga kontraktori janë quajtur “aktivitete ndërmjetësimi”.
- c. Delegimet = marrëveshje kontraktuale sipas të cilës njësia kryesore kërkon që kontraktori të kryejë një proces specifik të prodhimit. Ndonjëherë përdoret termi “nënkontraktim”.

Shembuj të pjesëve të procesit të prodhimit që mund të delegohen janë: aktivitetet prodhuese, shërbime të punësimit, funksionet mbështetëse, etj. Njësia kryesore dhe njësia kontraktuese mund të gjendet në të njëjtin territor ekonomik ose në teritore të ndryshme ekonomike, vendndodhja aktuale nuk ndikon në klasifikimin e asnjërës nga këto njësi.

81. Kontraktorët, dmth njësitë që kryejnë një veprimtari në bazë të një tarife ose kontrate, janë zakonisht të klasifikuara si njësi që prodhojnë mallra ose shërbime për llogari të tyre, përveç tregtisë (shiko paragrafët 93-99 më poshtë dhe shënimet shpjeguese të Seksionit G) dhe ndërtimit (në rastin e delegimeve të aktivitetit të ndërtimit njësia kryesore duhet të klasifikohet në 41.10 dhe kontraktori në 41.20).

82. Në industrinë përpunuese njësia kryesore e siguron kontraktorin me specifikimet teknike për prodhimin e aktivitetit që do të kryhet me materialet hyrëse. Materialet hyrëse (lëndë e parë ose të mira të ndërmjetme) mund të sigurohen (në pronësi) nga njësia kryesore ose jo. Shembuj të aktiviteteve të tilla janë: prodhimi i metaleve (farkëtim, hedhja, prerja, vulosja dhe puna shkrirëse), përpunimi i metaleve (p.sh. krom plating), prodhimi i veshjeve, përfundimi i veshje dhe pjesë elementare të ngjashme të procesit të prodhimit.

83. Një njësi kryesore e cila e delegon plotësisht procesin e transformimit duhet të klasifikohet në prodhim vetëm nëse zotëron lëndën e parë që përdoret si input në procesin e prodhimit (dhe kështu zotëron dhe prodhimin përfundimtar).

Një njësi kryesore që transferon vetëm një pjesë të procesit të transformimit duhet që të klasifikohet në prodhim.

Në të gjitha rastet e tjera njësia kryesore duhet të klasifikohet në përputhje me parimin e vlerës së shtuar: kjo mund të jetë në Seksionin G "Tregtia me shumicë dhe pakicë" (në varësi të veprimtarisë dhe shitjeve të të mirave të veçanta, shiko paragrafët e mëposhtëm 93-99) apo në Seksionet e tjera, p.sh. M "Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike", ose N "Veprimtaritë administrative dhe shërbimet mbështetëse.

84. Në rastin e delegimit të shërbimeve të punësimit duhet të bëhet një dallim, së pari nëse ai është në bazë të përhershme apo në bazë të përkohshme dhe së dyti nëse kontraktuesi i shërben vetëm një njësie kryesore apo më shumë se një njësie kryesore:

- Në qoftë se delegimi është në bazë të përkohshme dhe kontraktori i shërben vetëm një njësie kryesore, si njësia kryesore dhe kontraktuesi do të klasifikohen në bazë të aktivitetit të kryer aktualisht (p.sh. prodhim).
- Në qoftë se delegimi është në bazë të përkohshme dhe kontraktori i shërben më shumë se një njësie kryesore, njësia kryesore do të klasifikohet në bazë të veprimtarisë që kryejnë aktualisht dhe kontraktori duhet të klasifikohet në 78.20 (veprimtaritë e agjencive të punësimit të përkohëshme).
- Në qoftë se delegimi është në bazë të përhershme dhe kontraktori i shërben vetëm një njësie kryesore, si njësia kryesore dhe kontraktuesi do të klasifikohen në bazë të aktivitetit që kryejnë aktualisht.
- Në qoftë se delegimi është në bazë të përhershme dhe kontraktori i shërben më shumë se një njësie kryesore, të cilat kryesisht kryejnë aktivitete të ngjashme, si njësia kryesore dhe kontraktori do të klasifikohen në bazë të aktivitetit të kryer.
- Në qoftë se delegimi është në bazë të përhershme dhe kontraktori i shërben më shumë se një njësie kryesore, të cilat kryesisht kryejnë aktivitete të ndryshme, kontraktori do të klasifikohet në 78.30 (sigurim burimesh njerëzore të tjera).

Trajtimi i veprimtarive prodhuese të deleguara në CPA

85. Në seksionin e mëparshëm, është vërejtur se në përgjithësi klasifikimi i aktiviteteve nuk varet nga kriteri nëse veprimtarinë e kryejnë vetë, me apo nga ndërmjetësuesit. Përderisa aktivitetet nuk përcaktohen në NVE, prodhimi korrespondent është i ndryshëm, në varësi të faktit nëse materialet hyrëse janë në pronësi të njësisë prodhuese apo jo. Në rastin e dytë, prodhimi i aktivitetit është shërbimi i kryer dhe në të përfshihen edhe materialet hyrëse, dhe kjo është ajo për të cilën kontraktuesi është paguar.

86. Prandaj në përgjithësi CPA bën dallimin ndërmjet mallrave të prodhuara për llogari të vet dhe shërbimet e kryera për të mirat nga ndërmjetësuesit. Kategoritë e veçanta dhe nënkategoritë, të koduara zakonisht zx.yy.9 dhe zx.yy.99, kanë titull "operacionet e nënkontraktuar si pjesë e prodhimit të ...".

87. Në CPA-në e vitit 2002 dhe CPC ver. 2, këto rezultate janë quajtur respektivisht "shërbime industriale" dhe "shërbimet e prodhimit".

Instalimi dhe montimi në vend

88. Njësitë e angazhuara kryesisht në instalimin apo montimin e disa artikujve apo pajisjeve në një ndërtesë për funksionimin e saj janë klasifikuar në seksionin e ndërtimit (Ndarja 43).

89. Instalimi i makinerive dhe pajisjeve të tjera përveç atyre të lidhura me funksionimin e ndërtesave (ose punët ndërtimore) klasifikohen në grupin 33.2 “Instalimi i makinerive industriale dhe pajisjeve”.

Riparimi dhe mirëmbajtja

90. Njësitë që merren me riparime ose mirëmbajtje të mirave janë klasifikuar në një nga kategoritë e mëposhtme në varësi të llojeve të mallrave:

- a. Grupi 33.1 “Riparimi i produkteve metalike të fabrikuara, makineri dhe pajisje”
- b. Ndarja 43 “Aktivitete ndërtimi të specializuara”
- c. Grupi 45.2 “Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve”
- d. Ndarja 95 “Riparimi i kompjuterëve dhe të mirave personale dhe shtëpiake”

91. Njësitë që merren me riparimin e avionëve, lokomotiva dhe anijeve janë të klasifikuara në të njëjtën klasë si njësitë që i prodhojnë ato.

3.4 Rregulla dhe përkufizime specifike sipas seksioneve

Ky seksion paraqet rregullat dhe përkufizimet që duhet të merren parasysh për klasifikimin e njësive në seksione të veçanta. Përshkrimet e përgjithshme, përkufizimet dhe karakteristikat e seksioneve janë paraqitur në shënimet shpjeguese përkatëse.

Seksioni A: Bujqësia, pemtaria dhe peshkimi

92. Në bujqësi shpeshherë ndarja e vlerës së shtuar që paraqet vështirësi është kur njësia prodhon rrush dhe prodhon edhe verë nga rrushi i vetëprodhuar, ose kur ajo prodhon ullinj dhe prodhon edhe vaj nga ullinjtë e vetëprodhuar. Në këto raste variabli i përshtatshëm më i përafërt është “numri i orëve të punuara” dhe aplikimi i tyre në këto aktivitete të integruara vertikalisht në përgjithësi do të çojë në klasifikimin e njësive në bujqësi. Në të njëjtin rast për produkte të tjera bujqësore, njësia do të klasifikohet në bujqësi me konventë, në mënyrë që të garantojë trajtim të harmonizuar.


Seksioni G: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe i motorçikletave

93. Në seksionin G, bëhet dallimi ndërmjet tregtisë me shumicë dhe pakicë, përveç tregtisë së automjeteve motorike. Mund të ndodhë që një njësi kryen integrim horizontal në aktivitetet tregtare në mënyra të ndryshme të mundshme: tregti me shumicë dhe pakicë, shitje në dyqane dhe jo në dyqane, ose shet mallra të shumta. Nëse mallrat e shitura nga njësia, të paktën për një klasë, nuk përbëjnë 50% të vlerës së shtuar, atëherë aplikimi i metodës nga lartë-poshtë kërkon një kujdes të veçantë dhe shqyrtim të niveleve të tjera.

94. Nën Ndarjen 46 “Tregtia me shumicë”, së pari duhet të merrët parasysh një veçori shtesë: Grupi 46.1 “Aktivitete të ndërmjetësimit në tregtinë me shumicë” dhe agregimi i grupeve 46.2-46.9. Prandaj vendimi i parë për t’u marrë është caktimi i njësisë në një nga këto dy raste në bazë të parimit të vlerës së shtuar. Nëse zgjedhja 21 bie në nivelin e agreguar 46.2-46.9, atëherë hapi i dytë rezulton të vendoset midis “jo-të specializuara” dhe “të specializuar” (shiko më poshtë). Së fundmi, zgjedhja duhet të bëhet gjithmonë duke aplikuar metodën nga lart-poshtë ndërmjet grupeve dhe klasave.

95. Figura e mëposhtme paraqet pemën e vendimit që do të përdoret për ndarjen e një njësie në një klasë specifike në Ndarjen 46 “Tregtia me shumicë”:


Ndarje të mëtejshme sipas rangut të produkteve



96. Brenda ndarjes 47 “Tregtia me pakicë”, fillimisht duhet të vendoset një nivel shtesë detajimi: agregimi i grupeve 47.1 në “Dyqanet e tregtisë me pakicë”. Prandaj, vendimi i parë për tu marrë është caktimi i njësisë në një nga këto të dyja në bazë të parimit të vlerës së shtuar. Nëse zgjedhja bie në nivelin e agreguar “Dyqanet e tregtisë me pakicë”, më pas hapi i dytë konsiston në vendosjen midis “jo të specializuara” dhe “të specializuara” (shihni më poshtë). Së fundmi duhet të bëhet zgjedhja, duke aplikuar metodën nga lart-poshtë, ndërmjet grupeve dhe klasave.

97. Figura e mëposhtme paraqet pemën e vendimit të përdorur për shpërndarjen e një njësie në një klasë specifike në ndarjen 47 “Tregtia me pakicë”:

Ndarje të mëtejshme sipas rangut të produkteve



98. Si në tregtinë me shumicë ashtu dhe në atë me pakicë, dallimi ndërmjet “të specializuara” dhe “jo të specializuara” është e bazuar në numrin e klasave që përfshijnë mallrat e shitura, ku secila klasë duhet të përbëjë të paktën 5% të vlerës së shtuar (dhe më pak se 50%) në mënyrë që të merret në konsideratë:

a. Nëse produktet e shitura përfshihen deri në katër klasa të secilit prej grupeve 46.2 deri në 46.7 (për tregtinë me shumicë) ose 47.2 deri në 47.7 (për tregtinë me pakicë), njësia duhet të klasifikohet si “tregti e specializuar”. Pra, është e domosdoshme që për të përcaktuar veprimtarinë kryesore të aplikohet metoda nga lart-poshtë bazuar në vlerën e shtuar, së pari zgjidhet grupi kryesor dhe pastaj zgjidhet klasa brenda këtij grupi:

Klasa	Klasa A	Klasa B	Klasa C
47.21	30%	30%	20%
47.25	5%	15%	5%
47.62	45%	40%	35%
47.75	20%	15%	40%
Shpërndarja përfundimtare	Klasa 47.62	Klasa 47.21	Klasa 47.75

b. Nëse produktet e shitura përfshihen në më shumë se pesë klasa të secilit prej grupeve 46.2 deri në 46.7 (për tregtinë me shumicë) ose 47.2 deri në 47.7 (për tregtinë me pakicë), njësia duhet të klasifikohet si jo e specializuar. Në tregtinë me pakicë, është ndarë në grupin 47.1. Nëse ushqimet, pijet dhe duhani përbëjnë të paktën 35% të vlerës së shtuar, do të caktohen në klasën 47.11 të NVE Rev. 2. Në të gjitha rastet e tjera duhet të caktohet në klasën 47.19.

Klasa	Klasa A	Klasa B	Klasa C
47.21	5%	20%	5%
47.22	10%	15%	5%
47.42	15%	10%	45%
47.43	25%	10%	40%
47.54	45%	45%	5%
Shpërndarja përfundimtare	Klasa 47.19	Klasa 47.11	Klasa 47.19

99. Rregullat e shpërndarjes janë të bazuara gjithmonë në veprimtarinë e tregtisë me pakicë të njësisë. Nëse përveç tregtisë me pakicë, një njësi ka një veprimtari dytësore, përcaktimi i njësisë në klasën e duhur përcaktohet vetëm nga përbërja e kushtëzuar e veprimtarisë së saj të tregtisë me pakicë.

Seksionet K: Veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve, dhe

M: Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike

100. Në seksionin K, janë futur dy klasa, të cilat shkojnë përtej qëllimit tradicional të NVE-së në mbulimin e prodhimit ekonomik, përkatësisht klasa 64.20 “Veprimtaritë e kompanive aksionere (holding)” dhe 64.30 “Trustet, fondet dhe njësi të tjera të ngjashme financiare”. Njësitë e klasifikuara në këto dy klasa nuk kanë ndonjë të ardhur nga shitja e produkteve, dhe zakonisht nuk punësojnë staf (përveç një ose dy personave të mundshëm që veprojnë si përfaqësues ligjor). Ndonjëherë këto njësi quhen “plaka bronxi”, “kuti postare”, “kuti boshe”, ose “njësi për qëllime të veçanta- SPE”, sepse ato kanë vetëm emrin dhe adresën. Ato janë të shumta në disa vende për shkak të avantazheve tatimore.

101. Kur klasifikojmë një njësi sipas këtyre dy klasave, duhet t’i kushtohet vëmendje dhe klasave të tjera (dy nga të cilat në seksionin M, ndarja 70, domethënë klasat 70.10 “Veprimtaria e zyrave qendrore” dhe 70.22 “Veprimtaritë e biznesit dhe të konsulencës së menaxhimit”).

102. Më specifikisht:

a. klasa 64.20 “Veprimtaritë e kompanive aksionere (holding)” i referohet veprimtarive të kompanive holding, veprimtaria kryesore e të cilave është të zotërojë grupin, dhe nuk administrojnë apo menaxhojnë grupin;

- b. klasa 64.30 "Trustet, fondet dhe njësi të ngjashme financiare" është shumë e veçantë në NVE sepse ajo nuk i referohet një veprimtarie ekonomike por njësie.
- c. klasa 66.30 "Veprimtaritë e menaxhimit të fondeve" përfshin veprimtaritë e kryera nën një tarifë ose në baza kontrate.
- d. klasa 70.22 "Veprimtaritë e biznesit dhe konsulencë menaxhimi" përfshin veprimtaritë e konsulencës të lidhura me çështje si strategjia e koorporateve dhe planifikimi organizativ, politikat dhe objektivat e marketingut, politikat e burimeve njerëzore, etj.

Veprimtaria kryesore e një njësie që kryen disa veprimtari ndërmjet atyre të përmendura më lart, duhet të identifikohet, si zakonisht, në bazë të parimit të vlerës së shtuar. Duhet të merret parasysh që fitimet kapitale nuk përbëjnë vlerën e shtuar dhe për pasojë nuk duhet të konsiderohen. Prezantimi i klasave të përmendura më lart shënojnë një ndryshim të madh nga NVE 1.1.

Seksioni O: Administrimi dhe mbrojtja publike; Sigurimi shoqëror i detyruar

103. NVE nuk bën ndonjë dallim përse i përket sektoreve institucionale (siç është e përcaktuar në SNA dhe ESA) në të cilin është klasifikuar njësia institucionale. Për më tepër, nuk ka kategori në NVE që përshkruan të gjitha veprimtaritë e kryera nga qeveria. Si pasojë, jo të gjitha organet qeveritare janë të klasifikuara automatikisht në Seksionin O "Administrimi dhe mbrojtja publike; sigurimet shoqërore të detyrueshme". Njësite që kryejnë veprimtari në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal që u atribuohen në mënyrë specifike zonave të tjera të NVE, janë klasifikuar në seksionin e duhur. Për shembull një shkollë e mesme e administruar nga qeveria qendrore apo lokale përfshihet në grupin 85.3 (Seksioni P) ose një spital publik përfshihet në klasën 86.10 (Seksioni Q). Nga ana tjetër, jo vetëm organet qeveritare janë klasifikuar në seksionin O: por edhe njësitë private që kryejnë "veprimtaritë e administrimit publik" janë gjithashtu të klasifikuara këtu.

Seksioni T: Veprimtaritë shtëpiake; Veprimtaritë e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të familjeve për përdorim vetjak.

104. Ndarja 97 përfshin vetëm veprimtaritë e familjeve private si punëdhënës të personelit të brendshëm. Prodhimi i kësaj veprimtarie konsiderohet prodhim në SNA, dhe për këtë qëllim dhe për anketa të caktuara kjo ndarje është përfshirë në NVE Rev 2. Veprimtaritë e personelit të brendshëm nuk janë klasifikuar këtu: për shembull, veprimtaritë e mbajtjes së fëmijëve duhet të klasifikohen në 88.91, larja e tekstileve në 95.01 dhe veprimtaritë e shërbimit në 95.09, etj.

105. Nevoja për të përshkruar veprimtaritë për përdorim vetjak ka shtyrë në mbledhje të dhënash si anketat e forsës së punës dhe të përdorimit të kohës. Ndërsa veprimtaritë e tregut duhet të përshkruhen zakonisht sipas rregullave ekzistuese për të identifikuar kodin NVE, aplikimi i këtyre rregullave për veprimtaritë për përdorim vetjak ka qënë e vështirë sepse ndryshe nga veprimtaritë e tregut, është e vështirë për të nxjerrë sasinë e vlerës së shtuar. Këto veprimtari zakonisht kombinojnë bujqësinë, ndërtimin, prodhimin e tekstileve, riparimet dhe shërbimet e tjera. Ndarja 98 "Mallrat dhe shërbimet e padiferencuara të prodhuara nga veprimtaritë e familjeve private për përdorim vetjak" i korrespondon ndarjeve 96 dhe 97 të NVE Rev. 1, të cilat ishin paraqitur për të mbuluar këto veprimtari. Ndarja 98 nuk është relevante me statistikën e biznesit të EU, por me mbledhjen e të dhënave që mbulojnë familjet dhe veprimtaritë e jetesës.

Ndërlidhja ndërmjet
NVE Rev. 2 dhe
klasifikimeve të tjera

kapitulli **4**

106. Ky kapitull paraqet marrëdhëniet ekzistuese ndërmjet NVE-s dhe klasifikimeve të tjera të lidhura. Referenca kryesore është diagrama në paragrafin 3 të këtij dokumenti. Së pari marrëdhëniet me klasifikimet ndërkombëtare bazuar në sistemin e KB përshkruhen në detaje si NVE dhe shumë klasifikime të KB, në mënyra të ndryshme reflektojnë nomenklaturat botërore korresponduese. Së fundmi jepet lidhja me klasifikime të tjera shumëkombëshe sëbashku me struktura të agreguara të përdorura në kontekstin e llogarive kombëtare.

107. RAMON, serveri online i Eurostat-it për metadatat, jep informacion dhe struktura të detajuara për klasifikimet statistikore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të shumë fushave statistikore: analiza ekonomike, mjedisi, arsimi, punësimi, llogaritë kombëtare, etj. Informacioni mbulon aspekte të ndryshme, përfshirë përshkrime të përgjithshme, strukturën e klasifikimeve (p.sh. kode dhe kapituj), notat shpjeguese, tabelat e korrespondencës të klasifikimeve, dokumenta metodologjike dhe tjetër informacion i përgjithshëm lidhur me klasifikimet.

Informacionet janë në të gjitha gjuhët zyrtare të BE, sipas versionit gjuhësor të disponueshëm. Serveri i RAMON mund të konsultohet në adresën e mëposhtme: <http://www.europa.eu.int/comm/eurostat/ramon/>.

4.1 Lidhjet me klasifikimet ndërkombëtare

Tërësia ndërkombëtare e klasifikimeve ekonomike dhe sociale

108. Tërësia ndërkombëtare e klasifikimeve ekonomike dhe sociale përbëhet nga klasifikimet e regjistruara në Inventarin e Klasifikimeve të Kombeve të Bashkuara, të rishikuara dhe të miratuara si udhëzues nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara ose të tjera borde ndërqeveritare në fusha të tilla si ekonomi, demografi, punë, shëndetësi, arsim, mirëqenia sociale, gjeografi, mjedis, përdorimi i kohës dhe turizmi. Gjithashtu përfshihen klasifikime mbi subjekte të ngjajshëm që janë të regjistruar në inventar dhe janë përfutur ose janë të lidhur me klasifikime ndërkombëtare dhe janë kryesisht, por jo vetëm përdorur për qëllime rajonale ose kombëtare (si NVE dhe CPA).

109. Familja e klasifikimeve ekonomike dhe sociale ndërkombëtare përbëhet nga tre tipe të mëdha klasifikimesh: klasifikimet referencë, klasifikimet e prejardhura dhe klasifikimet e lidhura.

110. Klasifikimet referencë janë klasifikime ekonomike dhe sociale që janë produkt i marrëveshjeve ndërkombëtare miratuar nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara ose një tjetër bord kompetent ndërqeveritar, si ai i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), ose Organizata Botërore e Doganave (WCO) në vartësi të temave që trajtojnë. Këto klasifikime referencë kanë arritur pranim të gjerë dhe marrëveshje zyrtare dhe janë miratuar dhe rekomanduar si udhëzues për përgatitjen e klasifikimeve të prejardhura. Ato mund të përdoren si modele për zhvillimin ose rishikimin e klasifikimeve të tjera, si përsa i përket strukturës edhe natyrës dhe përkufizimit të kategorive. CITI është klasifikimi i referencës përse i përket aktiviteteve ekonomike.

111. Klasifikimet e prejardhura bazohen në klasifikimet referencë. Klasifikimet e prejardhura mund të përgatiten si me përshtatje të strukturës së klasifikimeve të referencës dhe kategorive, dhe më pas duke dhënë hollësira më shumë se ajo e dhënë nga klasifikimet referencë, ose ato mund të përgatiten duke riorganizuar ose agreguar rubrikat e një apo më shumë klasifikimeve referencë. Klasifikimet e prejardhura janë shpesh konceptuar për përdorim në nivel kombëtar ose shumëkombësh. NVE është një klasifikim i prejardhur i klasifikimit ISIC.

112. Klasifikimet e lidhura janë ato që pjesërisht i referohen klasifikimeve referencë, dhe për të cilët tabelat e korrespondencës (ndonjëherë të quajtura tabela konkordance) përdoren për të krahasuar statistikat të bazuara si në njerin apo tjetrin klasifikim. NAICS (shih më poshtë) është një klasifikim i prejardhur i klasifikimit ISIC.

Sistemi i integruar i klasifikimeve të aktiviteteve dhe produkteve të Kombeve të Bashkuara

113. Në 1989 Komisioni Statistikor i KB propozoi një set klasifikimesh që sëbashku formojnë një sistem të integruar për të klasifikuar aktivitetet, mallrat dhe shërbimet dhe që mund të përdoret në lloje të ndryshme të statistikave ekonomike në nivel botëror. ISIC, CPC, SITC, dhe BECs janë komponentët kryesorë të këtij sistemi dhe janë ngushtësisht të ndërlidhur.

- ISIC përfaqëson anën e aktivitetit të sistemit
- CPC është instrument kryesor për klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve,
- SITC është klasifikim i agreguar për mallrat e transportueshëm për statistikën e tregtisë ndërkombëtare dhe që shërben për qëllime krahasuese,
- BECs⁽¹⁾ është klasifikimi i mallrave sipas kategorive të mëdha ekonomike për qëllime të analizave ekonomike.

114. Referuar mallrave, si CPC dhe SITC përdorin kapitujt dhe nënkapitujt e Sistemit të Harmonizuar të përshkrimit dhe kodifikimit të mallrave (HS) si blloqe ndërtimi për kategoritë e tyre, p.sh. çdo kapitull në nivelin më të ulët të CPC korrespondon saktësisht me të paktën një kapitull të HS ose me dy ose më shumë kapituj ose nënkapituj të HS. Ka disa situata veçanërisht në bujqësi, ku një kapitull i HS ndahet në disa poste të CPC.

115. Sistemi Harmonizuar është klasifikimi doganor ndërkombëtar i produkteve i përgatitur nga Organizata Botërore e doganave për tregtinë e jashtme. HS përdoret si për tarifën doganore edhe për statistikën e tregtisë së jashtme. HS është një klasifikim me strukturë hierarkike e cila jep përkufizimet dhe karakteristikat e detajuara për rreth 5,000 mallra. Është e strukturuar në 96 kapituj secili i identifikuar me një kod numerik me dy shifra; kapitujt janë të ndarë në krerë të cilët janë më tej të ndarë në nënkrerë. Krerët janë të identifikuar me një kod numerik me katër shifra dhe nënkrerët me një kod numerik me gjashtë shifra. Megjithatë HS në parim mbulon mallrat, p.sh. produktet të cilët kanë një dimension fizik, ky klasifikim gjithashtu përfshin edhe energjinë elektrike. HS nuk mbulon shërbimet, por përfshin manifestimin fizik të shërbimeve (p.sh. plane arkitekturore, disketa programesh, vepra arti origjinale dhe antike më shumë se 100 vjeç të vjetra, etj). HS gjithashtu përfshin mallra të cilët nuk janë prodhuar si p.sh. pajisjet e përdorura. Rishikimi më i fundit i HS është bërë në 2007.

116. CPC i klasifikon produktet sipas karakteristikave fizike si edhe sipas natyrës të mallrave ose shërbimeve të kryera. Ky kriter përfshin p.sh. llojin e lëndës së parë të përdorur, procesin e prodhimit që kryhet, destinacionin e përdorimit të produktit, etj. Megjithatë ky kriter është shpesh i njëjti si ai që përdoret për klasifikimin e aktiviteteve ekonomike, CPC nuk duhet konsideruar si i varur nga klasifikimi i aktiviteteve ekonomike. Për këtë arsye sistemi i kodifikimit CPC është i pavarur nga ISIC.

117. Megjithatë këtë qasje të veçantë CPC ka marrë gjithashtu në konsideratë kriterin e origjinës ekonomike. Konform këtij kriteri (adaptuar në BE për NVE dhe CPA), një klasifikim i produkteve duhet të kombinojë në një kategori të vetme mallrat ose shërbimet që rezultojnë nga i njëjti aktivitet ekonomik. Për këtë qëllim janë bërë përpjekje për të përkufizuar krerët në nivelin më të ulët të CPC në mënyrë që më shumë produkte të mundëshme në këtë nivel të klasifikohen në një kategori të vetme të ISIC: Publikimi i CPC tregon korrespondencën ndërmjet nën-klasave të CPC dhe klasës korresponduese të ISIC. Megjithatë nuk është gjithmonë e mundur të aplikohet kriteri i origjinës ekonomike, edhe sikur të përdoret niveli më i detajuar i HS.

118. Një version i rishikuar i CPC, CPC versioni 2, është adaptuar nga Komisioni Statistikor i BE në mars 2006.

119. SITC ndjek një rregull tradicional në të cilin lëndët e përdorura, stadi i transformimit dhe përdorimi përfundimtar i produktit janë aspektet kryesore të marra në konsideratë.

120. Klasifikimi BEC është ndërtuar për të shërbyer si mjet për konvertimin e të dhënave të përpunuara në bazë të SITC në agregate të përdorshëm në analiza ekonomike, bazuar në dallimin që bëjnë llogaritë kombëtare ndërmjet të mirave materiale, të mirave ndërmjetëse dhe mallrave të konsumit në të qëndrueshme dhe jo

1

Klasifikimi i mallrave sipas kategorive të mëdha ekonomike: përcaktuar si term i SITC, Rev.3.

të qëndrueshme. Nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet ISIC dhe BEC e cila riorganizon kategoritë e SITC në 19 kategori të BEC. BEC ishte revizionuar në 1986, bazuar në revizionimin e tretë të SITC, dhe përkufizimi i kategorive të BEC në lidhje me nënkapitujt e HS si rrjedhojë është ndryshuar për të reflektuar ndryshimet e bëra në HS në 2002 dhe 2007.

121. NVE është një klasifikim i prejardhur nga ISIC: në të gjitha nivelet e NVE kategoritë janë përcaktuar si për të qenë identike me to ose për të formuar nëngrupe të kategorive të veçanta të ISIC. Niveli i parë dhe niveli i dytë i ISIC Rev.4 (seksione dhe ndarje) janë identike me seksionet dhe ndarjet e NVE Rev.2. Nivelet e treta dhe të katërta (grupe dhe klasa) të ISIC Rev.4 janë nënndarë në NVE Rev.2 sipas kërkesave Europiane. Megjithatë grupet dhe klasat e NVE Rev.2 kanë gjithmonë mundësi të agregohen në grupe dhe klasa të ISIC Rev.4 prej nga ku ato derivojnë. Qëllimi i detajimeve të mëtejshme në NVE Rev.2, krahasuar me ISIC Rev.4 është të kemi një klasifikim më mirë të përshtatur me strukturën ekonomike europiane.

122. Sistemi kodues i përdorur në ISIC dhe NVE janë brenda mundësive të njëjta. Për të bërë lehtësisht dallimin ndërmjet të dy klasifikimeve, NVE përdor pikë midis dy shifrave të parë (nivel ndarje) dhe dy të fundit (grupe dhe klasa). Megjithatë disa grupe dhe klasa në ISIC Rev. 4 janë të ndara në grupe dhe klasa të NVE-s pa krijimin e niveleve hierarkike të tjera, disa kode të ISIC ndryshojnë nga kodet e NVE-s. Një aktivitet në nivel grupi dhe klase mundet të ketë si rrjedhojë një kod numerik në NVE Rev.2, i cili ndryshon nga kodi në ISIC Rev. 4.

Lidhjet e NVE-s me të tjera klasifikime ndërkombëtare

123. Nuk ka klasifikime të tjera të hartuara nga Kombet e Bashkuara, ose të tjera organizma ndërqeveritare, të cilët kanë disa lidhje me ISIC ose përdorin pjesë të këtij klasifikimi në përcaktimin e fushës së tyre të aplikimit ose kategoritë e tyre. Si rrjedhojë, ata janë të lidhur me NVE-n.

124. Këto klasifikime janë hartuar për statistikën e profesioneve, punësimit, shpenzimeve, arsimit, turizmit dhe mjedisit. Klasifikimet më kryesore janë listuar si më poshtë. Informacion i detajuar mund të merret në website të Divizionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara: (http://unstats.un.org/unsd/cr/registry/class_default.asp):

- Klasifikimi i Funksioneve Qeveritare (COFOG);
- Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimit (ISCED)⁽²⁾;
- Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Profesioneve (ISCO)⁽³⁾;
- Llogaritë Satelit të Turizmit(TSA)⁽⁴⁾;
- Klasifikimi i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit(ICT)⁽⁵⁾;
- Përkufizimi i Sektorit të Industrisë së përmbajtjes dhe mediave

4.2 Marrëdhënia me Klasifikimet e BE

Klasifikimi i produkteve sipas aktiviteteve - CPA

125. CPA⁽⁶⁾ është versioni European i CPC, dhe objektivat e tij janë në linjë me ato të CPC. Në BE, klasifikimet për fusha specifike statistikore janë lidhur me CPA, megjithëse CPA përdoret në vetvete si një klasifikim për vërtetime. Megjithëse CPA është varianti European i CPC, ajo ndryshon nga kjo e fundit jo vetëm në atë që është më e detajuar, por edhe përse i përket strukturës së saj. BE ka përshtatur kriterin e origjinës ekonomike për zhvillimin e tij, duke patur NVE si kuadër reference. Për këtë arsye deri në nivelin e katërt (klasa) struktura e CPA korrespondon me NVE.

2 Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (ISCED 1997) (Paris, UNESCO, November 1997).

3 Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve (ISCO-1988) (Geneva, ILO, 1988).

4 Komisioni i BE Organizatë për Kooperimin Ekonomik dhe Zhvillimin, Kombet e Bashkuara dhe Organizata botërore e Turizmit, Llogaritë Satelit të Turizmit: Rekomanduar, Kuadri metodologjik, Dokumenta Statistikore No 80 (United Nations publication, Sales No E.01.XVII.9).

5 www.oecd.org

6 Rregullorja e Keshillit (EEC) No 3696/93 of 29 October 1993 mbi klasifikimin statistikor të produkteve sipas aktiviteteve (CPA) në Bashkimin

Në përgjithësi nënklasat e CPC janë të riorganizuara sipas origjinës së tyre ekonomike. Lidhja midis CPA dhe NVE Rev.2 është e evidente në kodin e CPA: në të gjitha nivelet e CPA kodimi i katër shifrave të para është i njëjtë me atë të përdorur në NVE Rev.2, me shumë pak ndryshim. Si një mjet pune në praktikën e punës së përditëshme statistikore, CPA, si edhe klasifikimet e tjera të produkteve, mund të përdoren në përshkrimin e karakteristikave të produktit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike. Duhet shënuar megjithatë që në disa raste lidhja aktivitet-produkt është një marrëveshje: kjo ndodh kur të njëjtat produkte janë rezultat i proceseve të ndryshëm prodhimi. Sikurse për NVE Rev. 2 ashtu edhe për CPA ekzistojnë versione Kombëtare.

Klasifikimi i Kombinuar - CN

126. CN⁽⁷⁾, Klasifikimi i Kombinuar është klasifikimi i përdorur brenda BE për tarifën doganore statistikore të tregtisë së jashtme dhe është më i detajuar se HS. CN ka hyrë në përdorim në 1988. Krerët në CN identifikohen me një kod numerik tetë shifror, duke i shtuar dy shifra kodit korrespondues HS. CN është rishikuar çdo vit pasi Këshilli Rregullues ka forcë detyruese ndaj vendeve anëtare.

PRODCOM

127. "PRODCOM"⁽⁸⁾ është shkurtimi për sistemin e statistikave të prodhimit për industrinë nxjerrëse dhe prodhuese (përfshirë shërbimet përveç "shërbimet industriale"). Klasifikimi i produkteve (PRODCOM list) në të cilat bazohen statistikave të produkteve përpunohet çdo vit nga komiteti PRODCOM. Krerët e listës PRODCOM derivojnë nga CN, por kodi i tyre është më shumë i detajuar se kodi CPA. Krerët e PRODCOM kodohen duke përdorur një kod numerik tetë shifror, gjashtë shifrat e para të të cilit janë të njëjta me ato të kodit CPA. Lista PRODCOM është pra e lidhur dhe konform me CPA. Lidhja me CPA thekson lidhjen me NVE, duke mundësuar identifikimin e ndërmarrjeve prodhuese të produkteve, ndërsa lidhja me CN mundëson krahasimin ndërmjet statistikave të prodhimit dhe statistikave të tregtisë së jashtme.

Grupimet Kryesore Industriale - MIGs

128. MIGs⁽⁹⁾ është akronim për Grupimet Kryesore Industriale, një klasifikim evropian i cili grupon aktivitetet industriale sipas produkteve të bazuara në kërkesë: mallra kryesore, mallrat e ndërmjetëm, mallra të konsumit të qëndrueshëm, mallra të konsumit jo të qëndrueshëm dhe energji. MIGs përdoren për disa tregues, ndërmjet të cilëve indeksi i prodhimit industrial (shprehur në vlerë të shtuar dhe në parimin bazë KAU) dhe indeksi i çmimeve të prodhimit.

Bilanci i pagesave: Klasifikimi për Statistikat e investimeve të huaja direkte

129. Bilanci i pagesave⁽¹⁰⁾ përdor një agregim të kategorive të NVE-s për raportimin e të dhënave mbi investimet e huaja direkte (FDI): nivelet e detajimit të aktiviteteve përputhen me ndarjet e NVE.

4.3 Ndërlidhja me klasifikime të tjera shumëkombëshe NAICS

NAICS

130. NAICS është Sistemi i klasifikimit të Industrisë në Amerikën e Veriut. NAICS u hartua në mesin e viteve 1990 për të dhënë definicione të përbashkëta për industrinë për Kanadanë, Meksikën dhe Shtetet e Bashkuara, për të lehtësuar analizat ekonomike të ekonomive të tre vendeve të Amerikës së Veriut. NAICS është ndërtuar mbi bazën e kuadri konceptual të orjentuar drejt prodhimit jo drejt aktiviteteve. Për këtë arsye strukturat e ISIC dhe NAICS janë në thelb të ndryshme. Megjithatë të dhënat statistikore të mbledhura sipas NAICS mund të agregohen në ndarje dy shifrore të ISIC Rev.4/NVE Rev.2, duke siguruar kështu krahasueshmërinë e të dhënave. Në shumë raste janë të mundshme lidhje edhe më të detajuara. Një harmoni e detajuar midis NAICS dhe ISICS është publikuar në website të NAICS (USA: <http://www.census.gov/naics>, Canada: <http://www.statcan.ca/>).

7 Nomenklatura e Kombinuar– një detajim i mëtejshëm i Sistemit të Harmonizuar (http://ec.europa.eu/taxation_customs/customs/customs_duties/tariff_aspects/combined_nomenclature/index_en.htm)

8 <http://europa.eu.int-lex/lex/Result....>

9 Rregullore e Këshillit (BE) 86/2001

10 <http://europa.eu.int-lex/lex/Result....>

ANZSIC

131. Klasifikimi standard i aktiviteteve ekonomike i Australisë dhe Zelandës së Re (ANZSIC) është hartuar për tu përdorur nga këto dy vende për prodhimin dhe analizën e statistikave të degëve të ndryshme të aktiviteteve ekonomike. Në hartimin e ANZSIC dhe ISIC është mbajtur parasysh të jenë në një drejtim me standardet ndërkombëtare. ISIC Rev.3 është përdorur si standard ndërkombëtar për qëllim reference. Një përputhje e gjerë midis ANZSIC dhe ISIC mund të gjendet në ABS website: <http://www.statistics.gov.au/>. ANZSIC është më afër me ISIC/NVE se sa NAICS, pasi struktura e saj ndjek më gjerësisht strukturën e ISIC, ku kategoritë në nivel ndarje dhe në nivel edhe më të detajuar mund të agregohen për të korresponduar në kategori dy shifrore të ISIC. Në fakt konvertimi i të dhënave të ANZSIC në SISC/NVE është i mundur në një nivel relativisht të detajuar.

Klasifikime të tjera

132. Përveç Vendeve Anëtare të BE, Norvegjia dhe Zvicra janë angazhuar të përdorin versionin e vendit të tyre të derivuar nga NVE. Për më tepër rreth dhjetë vende të tjera jashtë BE, ose vende candidate si Kroacia dhe Turqia, i referohen NVE-s për klasifikimin e aktiviteteve të tyre ekonomike. Më shumë se 150 vende në botë përdorin klasifikimin e aktiviteteve ekonomike bazuar si në NVE ose në ISIC. Shqipëria i referohet versionit European të NVE në mënyrë identike me akronimin NVE.Rev.2.

4.4 Struktura të agreguara për llogaritë kombëtare

133. Specialistët e Llogarive Kombëtare kanë identifikuar nevojën e përdorimit të dy grupimeve standard të kategorive të ISIC/NVE për të komunikuar të dhënat e llogarive kombëtare të një numri të madh vendesh. I pari, i njohur si “përbashkim i nivelit të lartë” grupon seksionet e ISIC/NVE në 10 ose 11 kategori; i dyti i quajtur “përbashkim i nivelit të mesëm” grupon ndarjet dhe përbëhet nga 38 kategori. Të dy strukturat e agreguara nuk janë pjesë e ISIC/NVE, por janë plotësisht të përfshira në strukturën e tyre hierarkike (përbashkim i nivelit të lartë, seksione, përbashkim i nivelit të mesëm, ndarje, grupe dhe klasa).

134. Tabela në vazhdim paraqet “agregimin në nivel të lartë SNA/ISIC A*10/11”:

	ISIC Rev. 4/ NACE Rev. 2 seksione	Përshkrimi
1	A	Bujqësi, pylltari dhe peshkim
2	B, C, D dhe E	Industri prodhuese, miniera dhe shpime dhe industri të tjera
2a	C	<i>Nga të cilët: prodhimi</i>
3	F	Ndërtim
4	G, H dhe I	Tregtia me shumicë dhe pakicë, transporti dhe magazinimi, Hoteleria dhe aktivitetet e shërbimit ushqimor.
5	J	Informacion dhe komunikim
6	K	Aktivitete financiare dhe të siguracionit
7	L	Aktivitete të Real estate* (Dhënies-Marrjes me qera)
8	M dhe N	Aktivitete profesionale, shkencore, teknike, administrative dhe shërbime mbështetëse.
9	O, P dhe Q	Aktivitete të Administratës Publike, mbrojtjes, arsimit, shëndëtsisë dhe punë sociale
10	R, S, T dhe U	Shërbime të tjera

* që përfshim rentën e imputuar të banesave të zëna nga pronarët e tyre

Tabela më poshtë paraqet “agregimin e ndërmjetëm SNA/ISIC aggregation A*38”:

	Kodi A*38	ISIC Rev. 4/ NACE Rev. 2	Ndarjet
1	A	Bujqësi, pylltari, dhe peshkim	01 to 03
2	B	Miniera dhe shpime	05 to 09
3	CA	Prodhimi i produkteve ushqimore, pije dhe duhan	10 deri 12
4	CB	Prodhimi i tekstileve, industria e veshjeve, industria e lëkurës dhe këpucëve	13 deri 15
5	CC	Prodhimi i produkteve prej druri, letre dhe të shtypshkrimit	16 deri 18
6	CD	Përpunimi i koksit dhe produkteve të naftës së rafinuar	19
7	CE	Industria kimike	20
8	CF	Industria e produkteve farmaceutike, mjeksore kimike dhe botanike	21
9	CG	Prodhimi i produkteve prej kauçuku dhe plastike, dhe produkte të tjera minerale jo metalike	22 +23
10	CH	Prodhimi i produkteve metalike dhe produkteve me bazë metalike përveç makinerive dhe pajisjeve	24 + 25
11	CI	Prodhimi i kompjuterave, dhe produkteve elektronikë dhe optikë	26
12	CJ	Prodhimi i pajisjeve elektrike	27
13	CK	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t	28
14	CL	Prodhimi i pajisjeve të transportit	29+30
15	CM	Të tjera industri prodhuese, riparime dhe instalime të makinerive dhe pajisjeve	31 deri 33
16	D	Prodhimi dhe shpërndarrja e elektricitetit, gazit, avullit dhe ajrit të kondicionuar	35
17	E	Prodhimi dhe furnizimi me ujë, kanalizime dhe menaxhimi e trajtimi i mbetjeve	36 deri 39
18	F	Ndërtimi	41 to 43
19	G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorcikletave	45 deri 47
20	H	Transporti dhe magazinimi	49 deri 53
21	I	Aktivitetet e hotelierisë dhe shërbimit ushqimor	55 + 56
22	JA	Aktivitetet e publikimit, audiovizuale dhe transmetimit	58 to 60
23	JB	Telekomunikimi	61
24	JC	IT dhe të tjera shërbime informacioni	62 +63
25	K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	64 deri 66
26	L	Aktivitetet të Real estate (Dhënies-Marrjes me qera)	*68
27	MA	Aktivitetet juridike, kontabiliteti, drejtimi, arkitekturë, inxhinjeri, kontroll dhe analiza teknike	69 deri 71
28	MB	Kërkim shkencor dhe zhvillim	72
29	MC	Aktivitetet të tjera profesionale, shkencore dhe teknike	73 deri 75
30	N	Aktivitetet administrative dhe shërbime mbështetëse	77 deri 82
31	O	Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyruar social	84
32	P	Arsimi	85
33	QA	Shërbime shëndetësore	86
34	QB	Kujdes mjeko-social me dhe pa hoteleri	87 + 88
35	R	Art, spektakël dhe aktivitete të kohës së lirë	90 deri 93
36	S	Shërbime të tjera	94 deri 96
37	T**	Aktivitetet të familjeve si të punësuar; aktivitete të ndryshme të familjeve si prodhues të të mirave dhe shërbimeve për përdorim familjar	97 + 98*
38	U**	Aktivitetet të organizatave që ushtrojnë aktivitetin e tyre jashtë territorit	99*

Ndryshimet ndërmjet
NVE Rev. 1.1
dhe NVE Rev. 2

kapitulli **5**

135. Ndërsa disa nga rregullat për zbatimin e NVE kanë ndryshuar, dhe kriteret për ndërtimin e klasifikimit si dhe formulimin e shënimeve shpjeguese, janë rishikuar, karakteristikat e përgjithshme të NVE kanë mbetur të pandryshuara.

136. Janë paraqitur koncepte të reja në nivel më të lartë të klasifikimit, dhe është krijuar një detaj i ri për të reflektuar forma të ndryshme të prodhimit si dhe industritë e reja në zhvillim. Në të njëjtën kohë, janë bërë përpjekje për të ruajtur strukturën e klasifikimit në të gjitha fushat që nuk kërkojnë shprehimisht ndryshime të bazuara në koncepte të reja.

137. Detajimi i klasifikimit është rritur ndjeshëm (nga 514 në 615 klasa). Për aktivitetet shërbim-prodhuese, kjo rritje është e dukshme në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe atë më të lartë, ndërsa për aktivitete të tjera, të tilla si bujqësia, rritja në detaje ka prekur nivelin më të ulët të klasifikimit.

5.1 Ndryshimet në strukturë

138. NVE Rev 1.1 ka pasur 17 seksione dhe 62 ndarje; NVE Rev 2 ka 21 seksione dhe 88 ndarje. Në nivelin më të lartë të NVE, disa seksione mund të krahasohen lehtë me versionin e mëparshëm të klasifikimit. Megjithatë, futja e disa koncepteve të reja në nivel seksioni, p.sh. seksioni informues apo grupimi i aktiviteteve të lidhura me mjedisin, e bën të lehtë krahasimin e përgjithshëm ndërmjet NVE Rev 2 dhe me versionin e saj të mëparshëm të pamundur.

139. Tabela e përcaktuar më poshtë paraqet korrespondencën midis seksioneve të NVE Rev 1.1 dhe NVE Rev 2. Ju lutem vini re se kjo tabelë paraqet vetëm korrespondencën një-në-një midis seksioneve: për të krijuar korrespondencë të plotë janë të nevojshme detaje të mëtejshme shtesë.

NVE Rev. 1.1		NVE Rev. 2	
Seksioni	Përshkrimi	Seksioni	Përshkrimi
A	Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura	A	Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim
B	Peshkimi		
C	Industri nxjerrëse	B	Industri nxjerrëse
D	Industri Përpunuese	C	Industri Përpunuese
E	Prodhimi dhe shpërndarja e Energjisë Elektrike, e Gazit e avullit dhe ujit të ngrohtë	D	Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar
		E	Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit
F	Ndërtimi	F	Ndërtimi
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave i motorçikletave i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake.	G	Tregtia me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave e motorçikletave.
H	Hotele dhe Restorante	I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit
I	Transport, Magazinim dhe Komunikacion	H	Transport dhe Magazinim
		J	Informacioni dhe Komunikacioni
J	Ndërmjetësimi Monetar dhe Financiar	K	Aktivitetet Financiare dhe Sigurimit
K	Pasuritë e patundëshme, Dhënia me qira, Informatika, Puna kërkimore shkencore, Të tjera aktivitete profesionale.	L	Pasuritë e patundëshme
		M	Aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe teknike
		N	Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet mbështetëse
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; Sigurimi shoqëror i detyruar	O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; Sigurimi shoqëror i detyruar
M	Arsimi	P	Arsimi
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	Q	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale
O	Aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual	R	Art, Argëtim dhe zbavitje
		S	Aktivitete të tjera shërbimi
P	Shërbime në shtëpi	T	Shërbime në shtëpi
Q	Aktivitete të organizatave ndërkombëtare	U	Aktivitete të organizatave ndërkombëtare

140. Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në terma numerike midis, NVE Rev. 1.1 dhe NVE Rev.

	NVE Rev. 1.1	NVE Rev. 2	Diferencat
Seksionet	17	21	+4
Ndarjet	62	88	+26
Grupet	224	272	+48
Klasat	514	615	+101
Seksioni i përpunimit			
Seksionet	1	1	0
Ndarjet	23	24	+1
Grupet	103	95	-8
Klasat	242	230	-12
Seksione të tjera			
Seksionet	16	20	+4
Ndarjet	39	64	+25
Grupet	121	177	+56
Klasat	272	385	+113

141. Në mënyrë që të kemi një ide të ndikimit të ndryshimeve në statistikat zyrtare për shkak të zbatimit të NVE Rev 2, është e dobishme të dallohen korrespondencat e mëposhtme mes NVE Rev 1.1 dhe NVE Rev 2:

- korrespondenca 1-me-1: 196 klasa në NVE Rev 1.1 korrespondojnë saktësisht me një klasë në NVE Rev2 dhe anasjelltas;
- korrespondenca n-me-1: 86 raste, ku dy ose më shumë klasa në NVE Rev.1.1 korrespondojnë me një klasë në NVE Rev 2;
- korrespondenca 1-tek-m: 18 raste, ku një klasë në NVE Rev 1.1 është e ndarë në dy ose më shumë klasa në NVE Rev 2;
- korrespondenca n-me-m: 214 raste, ku dy ose më shumë klasa në NVE Rev 1.1 korrespondojnë me dy ose më shumë klasa në NVE Rev 2.

Njësitë e klasifikuara në klasat e lidhur me korrespondencë 1-me-1 dhe n-me-1 mund të kodifikohen automatikisht kur te zbatohet NVE Rev 2 në regjistrin e ndërmarrjeve. Kjo deklaratë duhet të përshtatet, për çdo vend, në përputhje me versionin kombëtar të NVE.

142. Ndryshimet thelbësore midis NVE Rev 1.1 dhe NVE Rev 2 janë të shumta për t'u listuar këtu në tërësinë e tyre. Megjithatë, ato më të shquara janë të renditura më poshtë.

143. Te NVE Rev 1.1 seksionet për bujqësinë dhe peshkimin janë kombinuar. Megjithatë, detaje në seksionin e ri A (Bujqësi, pylltari dhe peshkim) janë rritur ndjeshëm. Kjo është në përgjigje të kërkesave të vazhdueshme për më shumë detaje në ISIC, kryesisht për shkak të faktit se bujqësia është një pjesë e rëndësishme e strukturës ekonomike në shumë vende në zhvillim.

144. Ndarjet e reja në prodhim, që përfaqësojnë industrinë e reja të rëndësishme apo industrinë e vjetra që kanë rritur rëndësinë e tyre ekonomike apo sociale, janë krijuar: të tilla si ndarja 21 (Prodhimi i produkteve me bazë farmaceutike dhe preparatet farmaceutike) dhe ndarja 26 (Prodhimi i kompjuterit, produkteve elektronike dhe optike). Qëllimi i këtyre të fundit ndryshon nga ndarja 30 (Prodhimi i makinerive për zyrë dhe kompjuterë) në NVE Rev 1.1, duke e bërë atë një mjet të mirë për statistikat mbi aktivitetet e teknologjisë së lartë. Ndarjet e tjera të reja, të tilla si ndarja 11 (Prodhimi i pijeve) dhe 31 (Prodhimi i mobiljeve) kanë rezultuar nga ndarjet e ndarjeve ekzistuese duke ngritur komponentët e tyre nga niveli i grupit, në nivelin e ndarjes.

145. Shumica e ndarjeve të mbetura në seksionin C (Prodhim) janë të pandryshuara, përveç ndarjeve 22 dhe 37 të NVE Rev 1.1 (printimi dhe riprodhimi i media të regjistruara) dhe (riciklimit), prej të cilave pjesë substanciale janë zhvendosur në seksionin tjetër (shih më poshtë).

146. Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve, i cili ishte klasifikuar më parë sipas prodhimit të llojit përkatës të pajisjeve, tani është identifikuar veçmas në ndarjen 33 (Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve). Të gjitha aktivitetet e specializuara për riparim tani klasifikohen veçmas në NVE, edhe pse një nivel më i lartë agregat për "Riparimet" nuk është krijuar.

147. Një seksion i ri E (furnizimi me ujë, kanalizimit, menaxhimin e mbeturinave dhe aktivitetet e rehabilitimit) është krijuar, i cili përfshin aktivitetet "sanitare" në NVE Rev 1.1 ndarja 90, mbledhjen e ujit dhe aktivitetet e shpërndarjes në NVE Rev 1.1 ndarja 41 dhe aktivitetet e riciklimit, të cilat kryesisht korrespondojnë në NVE Rev.1.1 me ndarjen 37. Ky seksion tani grupon aktivitetet të interesit të përbashkët, por është i bazuar edhe në një organizimin aktual të këtyre aktiviteteve në një numër të madh të shtetesh. Detajimi mbi këto aktivitete është rritur ndjeshëm.

148. Koncepti i "aktiviteteve të specializuara ndërtimore" (e njohur edhe si "tregti speciale") është futur në NVE Rev 2, duke zëvendësuar strukturën e ndarjes së versionit të mëparshëm, i cili është bazuar kryesisht në fazën e procesit të ndërtimit.

149. Riparimi i mallrave shtëpiake është hequr nga seksioni G (tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motorçikletave) të NVE Rev 1.1. Megjithatë, përjashtim për klasifikimin e tregtisë dhe riparimin e automjeteve dhe motorçikletave në ndarjen e 45 NVE Rev 2 (i korrespondon ndarjes 50 në NVE Rev 1.1) është mbajtur për arsye krahasueshmërie dhe vazhdimësie.

150. Detajimi në seksionin I (Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit) është rritur për të reflektuar natyrën e ndryshme dhe specializimin e aktiviteteve të kryera.

151. Një seksion i ri J (informacioni dhe komunikimi) është krijuar, duke kombinuar aktivitetet që përfshijnë prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe produkteve kulturore, sigurimi i mjeteve për të transmetuar ose shpërndarë këto produkte, si dhe të dhëna ose komunikime, aktivitetet e teknologjisë së informacionit dhe përpunimin e të dhënave dhe aktivitetet e tjera të shërbimeve të informacionit. Përbërësit kryesor të këtij seksioni janë aktivitetet botuese, duke përfshirë botimin e software (ndarja 58), kinematografi dhe aktivitetet të inçizimit (ndarja 59), e radio dhe TV që transmetojnë dhe bëjnë programe (ndarja 60), aktivitetet e telekomunikacionit (ndarja 61) dhe aktivitetet e teknologjisë së informacionit (ndarja 62) dhe aktivitetet e tjera të shërbimeve informative (ndarja 63). Këto aktivitete janë të përfshira në NVE Rev 1.1 seksioni D (industria pëpunuese), I (Transporti, Magazinimi dhe Komunikacioni), K (Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore dhe të tjera aktivitete profesionale) dhe O (aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual), prandaj kanë pasur një ndikim të fortë për krahasimin me versionin e mëparshëm të NVE. Megjithatë, ky trajtim i ri i veprimtarisë së informacionit dhe komunikimit ofron më shumë konsistencë se versioni i mëparshëm i NVE Rev 1.1, bazuar në karakterin e aktiviteteve të kryera.

152. Në seksionin K (Financa dhe aktivitetet e sigurimit), dy klasa të reja janë futur që shkojnë përtej qëllimit tradicional të NVE në mbulimin e prodhimit ekonomik, klasa 64.20 (Aktivitete që mbajnë kompanitë) dhe 64.30 (Trusts, fonde dhe subjekte financiare të ngjashme).

153. Seksioni për pasuri të patundshme, dhënie me qira dhe aktivitetet e biznesit në NVE Rev 1.1 është ndarë në tre seksione në NVE Rev 2. Pasuritë e patundshme është e përfaqësuar tani si një seksion i vetëm (seksioni L) për shkak të madhësisë së saj dhe rëndësisë në sistemin e llogarive kombëtare. Aktivitetet e mbetura janë ndarë në seksionin M (aktivitete profesionale shkencore dhe teknike), aktivitetet që mbulojnë dhe që kërkojnë një shkallë të lartë të trajnimit dhe njohurive të specializuara dhe aftësi në dispozicion të përdoruesve dhe seksioni N (administrative dhe aktiviteteve të shërbimeve mbështetëse), që mbulojnë aktivitete që mbështesin operacionet e përgjithshme të biznesit dhe nuk përqëndrohet në bartjen e njohurive të specializuara. Kompjuteri dhe aktivitetet e lidhura me këtë aktivitet (NVE Rev 1.1 Ndarja e 72) nuk janë më pjesë e këtij seksioni. Aktivitetet për riparimin e kompjuterit janë grupuar me riparimin e mallrave shtëpiake në seksionin S, ndërsa software për botim dhe aktivitetet e IT janë grupuar në seksionin e ri J.

154. Qëllimi i (seksionit P) edukimi ka ndryshuar në mënyrë eksplicite për të përfshirë sportet e specializuara, shërbime të tjera kulturore dhe arsimore dhe shërbimet mbështetëse të specializuara.

155. Më shumë detaje janë shtuar nën seksionin Q (aktivitetet shëndetësore dhe aktivitetet e punës sociale), duke krijuar tre ndarje në vend të një, si në versionin e mëparshëm të NVE. Përveç kësaj, fokusi është ngushtuar dhe përfshin vetëm aktivitetet “shëndetësore”, duke siguruar një mjet të mirë për të matur këtë pjesë të rëndësishme të ekonomisë. Si rezultat, aktivitetet veterinarë janë hequr nga ky seksion dhe janë vënë në një ndarje në seksion M (aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike).

156. Komponentet thelbësore të NVE Rev 1.1 seksioni O (komunitete të tjera, aktivitetet sociale dhe personale të shërbimit) janë zhvendosur në NVE Rev 2 në seksionin E (furnizimit me ujë; kanalizimit; menaxhimit të mbeturinave dhe aktivitetet e rregullimit) dhe J (Informim dhe komunikim), siç përshkruhet më sipër. Aktivitetet e mbetura janë rigropuar në dy seksione të reja për Art, argëtim dhe kreativitet (Seksioni R) dhe aktivitete të tjera të shërbimeve (Seksioni S). Si rezultat, aktivitete të tilla si artet kreative, aktivitetet dhe veprimtari të fatit janë ngritur në nivelin e ndarjes. Riparimi i kompjuterave dhe mallrat personale dhe familja është përfshirë tani në këtë seksion të ri S.

5.2 Tabelat e korrespondencës: qëllimi dhe përdorimi

157. Tabelat e korrespondencës janë mjete të rëndësishme për krahasimin e të dhënave të mbledhura dhe paraqitura statistikore duke përdorur klasifikimet e ndryshme. Ato bëhen të nevojshme kur klasifikimet ndryshojnë me kalimin e kohës, ose kur kornizat e ndryshme nuk lejojnë klasifikimet të jenë të lidhura ngushtë. Tabela e korrespondencës ndërmjet versioneve të ndryshme të klasifikimit të njëjtë janë përdorur për të përshkruar ndryshimet e detajuara që kanë ndodhur në procesin e rishikimit.

158. Që në kohën kur NVE është përdorur për mbledhjen dhe paraqitjen e statistikave në shumë fusha ka qenë një nevojë e madhe për tabela korrespondence midis NVE aktuale dhe versionit të saj të mëparshëm. Ko-rrespondenca të hollësishme midis NVE Rev 2 dhe NVE Rev 1.1, dhe anasjelltas, janë të disponueshme elektronikisht, por nuk janë përfshirë në këtë botim.

159. Gjatë hartimit të NVE Rev 2 dhe në të njëjtën kohë të NP 2008, një lidhje e fortë është vendosur mes dy klasifikimeve. Duke përcaktuar mallrat në NP në drejtim të NM kur është e mundur, është krijuar një tabelë e detajuar korrespondence midis CN, CPC, ISIC dhe NACE.

160. Të gjitha tabelat e korrespondencës janë në dispozicion vetëm në formë elektronike ose në RAMON http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/index.cfm?TargetUrl=DSP_PUB_WELC) ose në websitin e Kombeve të Bashkuara, Divizioni Statistikat (<http://unstats.un.org/unsd/class>).

Fjalorth

kapitull 6

Ky fjalor jep një përshkrim të mëtejshëm të disa prej termave të përdorur në përmbajtjen dhe strukturën e NVE REV.2. Çdo përpjekje është bërë për të siguruar që përshkrimet të jenë konsistente me definicionet e termave të përdorur, por këto përshkrime nuk janë menduar që të japin kuptimin definitiv shumë qëllimësh të fjalëve. Qëllimi i dhënies së këtyre definicioneve është të ndihmojë përdoruesit e NVE të interpretojnë korrekt atë.

Sipas –produkteve: E veçanta sipas-produkteve është një produkt teknologjikisht i lidhur me prodhimin e produkteve të tjera në të njëjtin grup, por i cili nuk është prodhuar nga ndonjë grup tjetër (psh melasa është e lidhur me prodhimin e sheqerit). Sipas produkteve janë përdorur vetëm si inpute për përpunimin e produkteve të tjera. Normalja sipas produkteve – (dmth një produkt i cili nuk është ekskluzivitet i një grupi të thjeshtë) është një produkt teknologjikisht i lidhur me prodhimin e produkteve të tjera, por i cili është prodhuar në grupe të veçanta. (psh hidrogjeni i prodhuar gjatë rafinimit të naftës është teknologjikisht i lidhur me atë të prodhuar në përpunimin e produkteve e petrokimisë dhe karbonizimin e qymyrit dhe identik me atë të prodhuar në grup produktet kimike bazë).

Mallrat: Një mall është një produkt i transportueshëm që mund të shkëmbehet. Ato mund të jenë një nga prodhimet e linjës së prodhimit, një artikull unik (Mona Lisa) ose një material i ndërmjetëm për një shërbim (disketat e softwareve). Ky është koncepti i përdorur për klasifikimet e mallrave.

Kjo ndarje përfshin nxjerrjen nga miniera apo karriera, si dhe nxjerrjen e depozitave aluviale, thyerjen e shkëmbit dhe përdorimin e kriporeve. Këto produkte përdoren kryesisht në ndërtim (si rërë, gurë etj), prodhimin e materialeve (si argjile, gips, gëlqere, etj), prodhimin e kimikateve, etj

Kjo ndarje nuk përfshin prodhimin (përveç thyerjes, thërmimit, prerje, pastrimit, tharjes, seleksionimit dhe përzjerjes) e mineraleve të nxjerra.

08.1 Nxjerrja e gurit, rërës dhe argjilës

08.11 Nxjerrja nga karriera e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gipsit, shkumës dhe rrasave

Kjo klasë përfshin:

- nxjerrjen nga karrierat, gdhendjen dhe prerjen e gurëve dekorative dhe të ndërtimit si mermeri, graniti, ranoreve, etj.
- thyerjen dhe thërmimin e gurëve dekorative dhe të ndërtimit;
- nxjerrjen nga karriera, thyerjen dhe thërmimin e gurëve gëlqerore
- nxjerrjen e gipsit dhe anhidriteve
- nxjerrjen e shkumësit dhe dolomiteve të pakalçinuara

Kjo klasë nuk përfshin :

- nxjerrjen e mineraleve kimikateve dhe plehrave kimike, shih 08.91
- prodhimin e dolomiteve të kalçinuara, shih 23.52
- prerjen, dhënien e formës dhe përfundimin e gurit jashtë karrierës, shih 23.70

08.12 Operacionet e nxjerrjes së zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjilës dhe kaolinës;

Kjo klasë përfshin:

- nxjerrjen dhe gërryerjen e rërës industriale, rërës për ndërtim dhe zhavorrit;
- thyerjen dhe copëtimin e zhavorrit;
- nxjerrjen e rërës;
- nxjerrjen e argjilës, argjilës refraktare dhe kaolinës.

Kjo klasë nuk përfshin:

- nxjerrjen e rërës bituminoze, shih 06.10

08.9 Nxjerrja nga minierat dhe karrierat e mineraleve të tjera, p.k.t.

08.91 Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehërave kimike

Kjo klasë përfshin:

- nxjerrjen e fosfateve natyrore dhe kripërave potasike natyrore;
- nxjerrjen e squfurit natyror;
- nxjerrjen dhe përgatitjen e piritit dhe pirotinave, përveç pjekjes;
- nxjerrja e sulfateve dhe karbonateve natyrore të bariomit, borateve, sulfateve dhe magneziumit natyror;
- nxjerrjen e dheut me ngjyrë, fluoritit dhe mineraleve të tjera, vlera e të cilave është si burim për kimikatet

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- nxjerrjen e plehrave natyrore.

Kjo klasë nuk përfshin:

- nxjerrjen e kripës, shih 08.93
- pjekjen e piritit të hekurit, shih 20.13
- prodhimin e plehrave sintetike dhe përzierjeve azotike, shih 20.15

08.92 Nxjerrja e torfave

Kjo klasë përfshin:

- nxjerrjen e torfave;
- përpunimin e torfave me qëllim përmirësimin e cilësisë ose lehtësimin e transportit dhe magazinimit.

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet ndihmëse të veçanta për nxjerrjen e torfave, shih 09.90
- prodhimin e briqueteve të torfave, shih 19.20
- prodhimin e përzierjes me dhe të torfave, dheut, dheut natyror, rërës, argjilës, mineraleve për plehra, shih 20.15.

08.93 Nxjerrja e kripës

Kjo klasë përfshin:

- nxjerrjen e kripës nga nëntoka, duke përfshirë tretjen dhe pompimin;
- prodhimin e kripës nga avullimi i ujit të detit ose i ujrave të tjera të kripura
- thërmimin, pastrimin dhe rafinimin e kripës sipas prodhuesve

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e kripës për kripë gjelle, p.sh. si kripë e jodizuar, shih 10.84
- prodhimin e ujit të pijshëm nga avullimi i ujit të detit, shih 36.00

08.99 Industri të tjera nxjerrëse p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- nxjerrjen nga nëntoka dhe karriera të mineraleve dhe materialeve të ndryshme:
 - lëndë abrazive, asbesti, mielli i fosileve silicike, grafitë natyrore, talku, feldspathi, etj
 - asfalti natyror, shkëmbinjtë asfaltite dhe asfaltet; bitum i ngurtë natyror
 - gurët e çmuar, kuarcet, mikat etj

09 Aktivitete mbështetëse minerare

Kjo ndarje përfshin shërbime mbështetëse të specializuara të nxjerrjes për llogari të të tretëve me ndërmjetësim. Kjo përfshin shërbimet e kërkimit nëpërmjet metodave tradicionale ekzaminuese, të tilla si marrja e mostrave në sipërfaqe dhe kryerja e studimeve gjeologjike si dhe shpimet, shpimet provë apo rishpimet për puse naftë, mineralet metalore ose jo-metalore. Të tjera shërbime tipike mbulojnë ndërtesat fillestare të puseve të naftës, çimentimi i puseve të naftës dhe të gazit, pastrimi, pompimi i puseve të naftës dhe të gazit, vulosja dhe braktisja e puseve të minierave, shërbime lëvizëse të mbingarkesës nga miniera, etj.

09.1 Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror

09.10 Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e shërbimit për nxjerrjen e naftës dhe gazit për llogari të të tretëve:
 - shërbimet e shfrytëzimit në përputhje me nxjerrjen e naftës dhe gazit, dmth metodat tradicionale të shfrytëzimit si kryerja e vrojtimeve gjeologjike për përcaktimin e vendit
 - shpimet direkte dhe rishpime, sipërmarrjen e shpimeve, riparimet dhe zmontimet e skeleteve metalike, cementimi i puseve të naftës dhe gazit, pompimi i puseve, vulosjen dhe braktisjen e puseve etj
 - lëngëzimin dhe rigazifikimin e gazit natyror për qëllime transportimi, të kryera në vendndodhjen e minierës
 - shërbimet e pompimit, për llogari të të tretëve
 - provat e shpimit në përputhje me nxjerrjen e naftës dhe gazit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shërbimet për shuarjen e zjarrit në pellgjet e naftës dhe gazit

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e shërbimit të kryera sipas operatorëve në fushat naftës dhe gazit, shih 06.10, 06.20
- riparimet e specializuara të makinerive të naftës, shih 33.12
- lëngëzimin dhe rigazifikimin e gazit natyror për qëllime transportimi, e kryer në vendndodhjen e minierës, shih 52.21
- vrojtimet gjeofizike, gjeologjike dhe sizmike, shih 71.12

09.9 Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka dhe karrierat

09.90 Aktivitete mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka dhe karrierat

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet mbështetëse për llogari të të tretëve, e kërkuar për aktivitetet e minierave të ndarjeve 05, 07 dhe 08:
 - shërbimet e shfrytëzimit, dmth metoda tradicionale kërkimi, si marrja e një mostre dhe kryerja e vrojtimeve gjeologjike për vendndodhjen e mundëshme.
 - shërbimet e shpimit dhe pompimit, për llogaritë e të tretëve
 - shpimet provë dhe prova shpimi birash.

Kjo klasë nuk përfshin :

- shfrytëzimin e minierave apo karrierave për llogari të të tretëve, shih ndarja 05, 07 dhe 08
- riparimet e specializuara të makinerive të minierave, shih 33.12
- shërbimet e vrojtimeve gjeofizike, për llogari të të tretëve, shih 71.12

SEKSIONI C - PËRPUNIMI

Përpunimi përfshin transformimet fizike dhe kimike të materialeve, substancave apo komponentëve në një produkt të ri, megjithatë kjo nuk mund të përdoret si një kriter i thjeshtë i përgjithshëm për përcaktimin e përpunimit. Materialet, substancat apo komponentët e transformuar janë lëndë të para materiale që janë produkte të bujqësisë, pyjetarisë, peshkimit, nxjerrjes po aq sa edhe nga produktet e aktiviteteve të tjera të përpunimit. Ndryshimet e rëndësishme, rinovimi apo rikonstruksioni i mallrave konsiderohet përgjithësisht si aktivitet përpunimi.

Rezultati i procesit të përpunimit mund të ketë përfunduar në kuptimin që ai është gati për përdorim apo konsum, ose mund të jetë gjysëm i përfunduar në kuptimin që ai do të hyjë përsëri në prodhim për një përpunim të mëtejshëm. Për shembull, prodhimi i aluminit nga rafineria është hyrje për prodhimin primar të aluminit; alumini është hyrje për prodhimin e telave të aluminit.

Përpunimi i komponenteve dhe pjesëve të specializuara, pjesët e këmbimit dhe të bashkëngjiturat me to, makineritë dhe pajisjet, si rregull i përgjithshëm përfshihen në të njëjtën klasë ku përfshihen edhe prodhimi i makinerive dhe pajisjeve.

Përpunimi i pjesëve dhe komponentëve të paspecializuara të makinerive dhe pajisjeve, si motorrat, pistonat, motorrët elektrikë, montimet elektrike, valvolat, ingranazhet e shpërndarjes, kushinetat, klasifikohen në të njëjtën klasë me prodhimin pa përfillur makineritë dhe pajisjet në të cilat këto pjesë mund të përfshihen. Megjithatë bërja e kallëpit me material plastik e komponenteve dhe pjesëve plotësuese të specializuara është përfshirë në grupin 22.2.

Montimi i pjesëve përbërëse të produkteve të përpunuara është konsideruar përpunim. Kjo përfshin montimin e produkteve të përpunuara nga komponentë të vetëprodhuar ose të blerë.

Rikuperimi i mbetjeve, dmth përpunimi i mbetjeve në materiale sekondare është klasifikuar në grupin 38.3 (materiale të rikuperuara). Ndërsa kjo mund të përfshihet në transformime fizike dhe kimike, kjo nuk konsiderohet të jetë pjesë e përpunimit.

Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve konsiderohet të jetë trajtimi ose përpunimi i mbetjeve dhe ato klasifikohen në seksionin E (Furnizimi me ujë; trajtimi i mbetjeve). Megjithatë, përpunimi i produktit të ri përfundimtar klasifikohet në përpunim edhe pse ky proces përdor mbetjet si hyrje. Psh, prodhimi i argjëndit nga mbetjet e filmit konsiderohet proces përpunimi.

Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinerive dhe e pajisjeve industriale, tregtare dhe të ngjashme, në përgjithësi klasifikohet në ndarje 33, (Riparimi, mirëmbajtja dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve). Megjithatë, riparimi i kompjuterave dhe mallrave personale dhe familjare klasifikohen në ndarjen 95 (Riparimi i kompjuterave dhe mallrave personale dhe shtëpiake), ndërsa riparimi i motorrëve e i automjeteve klasifikohet në ndarjen 45 (Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i motorrëve dhe motorçikletave).

Instalimi i makinerive dhe pajisjeve, kur kryhet si aktivitet i specializuar, klasifikohet në 33.20.

Shënim: Kufiri i përpunimit dhe sektorëve të tjerë të sistemit të klasifikimit është përgjithësisht i rregulluar. Si rregull i përgjithshëm, aktivitetet në seksionin e përpunimit përfshijnë transformimin e materialeve në produkt të ri. Rezultati i tyre është një produkt i ri. Megjithatë, përkufizimi se çfarë quhet produkt i ri është diçka subjektive.

Për sqarim, aktivitetet e mëposhtme konsiderohen përpunim në klasifikim:

- përpunimi i peshkut të freskët, nuk përfshihet në peshkim, shih 10.20
- pasterizimi dhe ambalazhimi i qumështit, shih 10.51
- kthimi i lëkurës, shih 15.11
- konservimi i drurit, shih 16.10
- printimi dhe aktivitete të lidhura me to, shih 18.1
- tërheqja e gomave, shih 22.11
- prodhimi i betonit të gatshëm, shih 23.63
- galvanizimi, nikelimi, trajtimi në të ngrohtë i metalit dhe shkëlqimi, shih 25.61
- rimontimi dhe ripërpunimi i makinerive, shih 29.10

Në të kundërtën ka aktivitete që megjithëse disa herë përfshihen në proçese transformimi, klasifikohen në seksione të tjera të klasifikimit (me fjalë të tjera ato nuk klasifikohen në përpunim).

Këtu përfshihen:

- prerja, transportimi i trupave, klasifikohen në Seksionin A (Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi);
- përfshimi i produkteve bujqësore, klasifikohen në seksionin A (Bujqësia, pyjet dhe peshkimi)
- përgatitja e ushqimeve për konsum të shpejtë në vend, klasifikohet tek ndarja 56 (Aktivitete të shërbimit të ushqimit dhe pijeve)
- përfshimi i metaleve dhe mineraleve të tjera, klasifikohen në seksionin B (Nxjerrja)
- ndërtimi i strukturave dhe fabrikimi i veprimeve të kryera në vendin e ndërtimit, klasifikohen në seksionin F (Ndërtimi)
- aktivitetet e thyerjes së masave voluminoze dhe rishpërndarja në copa të vogla, duke përfshirë paketimin, ripaketimin ose produktet e ambalazhuara në shishe, si lëngjet apo kimikatet, seleksionimi i skrapit, bojrat e përziera sipas kërkesave të blerësit; prerja e metalit sipas kërkesave të blerësit, prodhimi i versioneve të modifikuara në të njëjtin produkt klasifikohen në seksionin G (Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i motorëve dhe motorçikletave).

10 Përpunimi i produkteve ushqimore

Kjo ndarje përfshin përpunimet e produkteve të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit në ushqime dhe pije për njerëzit apo kafshët, dhe përfshin prodhimin e produkteve ndërmjetëse të ndryshme që nuk janë direkt produkte ushqimore. Aktiviteti shpesh prodhon produkte të bashkuara në vlerë më të madhe ose më të vogël (psh. lëkura nga prerja ose bërsi për bagëti nga prodhimi i vajit).

Kjo ndarje është organizuar sipas aktiviteteve të ndara në lloje të ndryshme produktesh: si mish, peshk, fruta dhe perime, yndyrna dhe vajra, produkte të drithërave, produkte të furrës dhe pjekjes, produkte të tjera ushqimore dhe ushqime për kafshët. Prodhimi mund të realizohet për llogari të veta, si dhe për llogari të tretëve, apo për treg.

Disa aktivitete konsiderohen përpunim (psh, produktet e furrës, dyqanet e ëmbëlsirave dhe dyqanet e përgatitjes së mishit etj. të cilat shesin prodhimin e tyre) edhe pse këtu është tregëti me pakicë e produkteve në dyqanin e vetë prodhuesit. Megjithatë, kur përpunimi është minimal dhe nuk mund të lejojë një transformim të vërtetë, njësia klasifikohet në Tregëti me Shumicë ose Pakicë (Seksioni G).

Përgatitja e ushqimeve për konsum të shpejtë në vend, klasifikohet tek ndarja 56 (Aktivitete të shërbimit të ushqimit dhe pijeve)

Prodhimi i ushqimeve për kafshë nga mbetjet e therjes ose nën-produkteve klasifikohet në 10.9, ndërsa përpunimi i mbetjeve të ushqimeve dhe pijeve në lëndë materiale dytësore klasifikohet në 38.3 dhe asgjësimi i mbetjeve të ushqimeve dhe pijeve në 38.21.

Kjo ndarje nuk përfshin përgatitjen e ushqimeve për konsum të shpejtë si psh. në restorante.

10.1 Prodhimi dhe përpunimi i mishit dhe produkteve me bazë mishi

10.11 Prodhimi dhe përpunimi i mishit

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e thertores si vrasja, regjia apo paketimi i mishit: si viç, derr, qengj, lepur, dele, gamile, etj.
- prodhimin e mishit të freskët apo të ngrirë, në karkasa
- prodhimin e mishit të freskët apo të ngrirë, në copa

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- therjen dhe përpunimin e balenave në tokë apo në anije të specializuara
- prodhimin e lëkurës origjinale nga thertoret

- nxjerrjen e dhjamt të derrit dhe yndyrna të tjera me origjinë shtazore
- përpunimin e të brendëshmeve
- prodhimi i leshit nga qethja

Kjo klasë nuk përfshin:

- nxjerrjen e yndyrnave nga shpendët, shih 10.12
- paketimin e mishit, shih 82.92

10.12 Prodhimi dhe përpunimi i mishit të shpendëve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e thertoresh si vrasja, regjja apo paketimi i mishit të shpendëve
- prodhimin e mishit të freskët apo të ngrirë në porcione individuale
- nxjerrjen e yndyrnave nga shpendët

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e puplave dhe pushit

Kjo klasë nuk përfshin:

- paketimin e mishit, shiko 82.92

10.13 Prodhimi i produkteve të mishit dhe mishit të shpendëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mishit të tharë, kripur dhe tymosur
- prodhimin e produkteve të mishit:
 - salçiqe, martadel, sallam, hamburger, proshuta etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e pjatave të përgatitura nga mishi dhe shpendët e ngrira, shih 10.85
- përgatitjen e supës që përmban mish, shih 10.89
- tregtinë me shumicë të mishit, shih 46.32
- paketimin e mishit, shih 82.92

10.2 Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve

10.20 Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve

Kjo klasë përfshin:

- përgatitjen dhe konservimin e peshkut, krustaceve dhe molusqeve: ngrirja, mbi-ngrirja, tharja, tymosja, kriposja, futja në conserva, kriposja në shëllirë etj
- prodhimin e produkteve me bazë peshku, krustace dhe molusqe: peshku i gatuar, fileto peshku, haviar, nënprodukte të haviarit etj
- prodhimin e vakteve të ushqimit me peshk për konsum njerëzor apo ushqim për kafshë
- prodhimin e ushqimeve të tretshme nga peshku apo kafshë të tjera ujore për konsum për njerëzit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetin e anijeve fabrikë ku kryhet vetëm përpunimi dhe konservimi i peshkut
- përpunimin e leshterikëve

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin dhe konservimin e peshkut në anijet me peshkim, shih 03.11

- përpunimin e balenave në tokë apo anije të specializuara, shih 10.11
- prodhimin e yndyrnave apo vajit nga prodhimet e detit, shih 10.41
- përpunimin e ushqimeve të përgatitura me peshk të ngrirë, shih 10.85
- përpunimin e supës prej peshku, shih 10.89

10.3 Përpunimi dhe konservimi i frutave dhe perimeve

10.31 Përpunimi dhe konservimi i patates

Kjo klasë përfshin:

- përpunimin dhe konservimin e patates:
 - patate të ngrira të përgatitura
 - pure patatesh të dehidratuara
 - patate të prera
 - patatina
 - mielli i patates

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përpunimin industrial të patates

10.32 Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve

Kjo klasë përfshin:

- përpunimin e lëngut të frutave dhe perimeve

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e koncentreve nga frutat dhe perimet e freskëta

10.39 Proçese të tjera përpunimi dhe konservimi të frutave dhe perimeve

Kjo klasë përfshin:

- përpunimin e ushqimeve që konsistojnë kryesisht tek frutat dhe perimet, përveç ushqimeve të gatshme në formë të ngrirë apo në konserva
- konservimin e frutave, frutave me lëvozhgë dhe perimeve: si ngrirja, tharja, zhytja në vaj apo uthull, vendosja në konserva etj
- përpunimin e produkteve ushqimore nga frutat dhe perimet
- përpunimin e reçelit, marmalatës dhe xhelatinës së tavolinës
- pjekjen e frutave me lëvozhgë
- përpunimin e ushqimeve prej frutave me lëvozhgë dhe pastave

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përpunimin e ushqimeve të përgatitura me fruta apo perime që prishen shpejt si:
 - sallatë
 - perimet e shtypura apo të prera
 - brumin e kokrrave

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e miellit nga perimet leguminoze të thata, shih 10.61
- konservimin e frutave dhe frutave me lëvozhgë në sheqer, shih 10.82
- përpunimin e ushqimeve të përgatitura me perime, shih 10.85
- përpunimin e koncentreve artificiale, shih 10.89

10.4 Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave bimore dhe shtazore

Ky grup përfshin përpunimin e vajrave dhe yndyrnave bruto dhe të rafinuara nga materiale bimore dhe shtazore, përveç rafinimit të dhjemit të derrit dhe yndyrnave të tjera shtazore

10.41 Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e vajrave bimore bruto: vajit të ullirit, të sojës, të palmës, të farave të lulediellit, farave të pambukut, të rrepës, kolcës apo mustardës, farave të linit etj
- prodhimin e miellit të farërave, të arrave ose bajameve bimore
- prodhimin e vajrave bimore të rafinuara: vaj ulliri, vaj soje, etj
- përpunimin e vajrave bimore: shtypja, zierja, dehidratimi, hidrogjenizimi etj

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e vajrave dhe yndyrnave jo nga të brendëshmet shtazore
- nxjerrjen e vajit të peshkut dhe sisoreve të tjerë detare
- prodhimin e bërësive të pambukut, bërsi vaji dhe mbetje të tjera nga prodhimi i vajit

Kjo klasë nuk përfshin:

- rafinimin e dhjemit të derrit dhe yndyrnave të tjera shtazore, shih 10.11
- prodhimin e margarinës, shih 10.42
- bluarjen në të njomë të misrit, shih 10.62
- përpunimin e vajit të misrit, shih 10.62
- prodhimin e vajrave esencialë, shih 20.53
- trajtimin e vajrave dhe yndyrnave nëpërmjet proceseve kimike, shih 20.59

10.42 Prodhimi i margarinës dhe yndyrnave të tjera të ngjashme

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e margarinës
- prodhimin e yndyrnave të përziera e të ngjashme
- prodhimin e yndyrnave për gatim

10.5 Prodhimi i produkteve të qumështit

10.51 Përpunimi i produkteve të qumështit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e qumështit të freskët, të pasterizuar, sterilizuar, homogjenizuar dhe /ose ato që i shtrohen një ngrohje ultra të shkurtër
- prodhimin e qumështit për tu pirë
- prodhimin e kremit nga qumështi i lëngët i freskët, pasterizuar, sterilizuar, homogjenizuar
- prodhimin e qumështit pluhur, ose i qumështit të kondensuar, i ëmbëlsuar ose jo
- prodhimin e qumështit ose kremit në formë të ngurtë
- prodhimin e gjalpfit
- prodhimin e kosit
- prodhimin e djathit dhe gjizës
- prodhimin e hirrës
- prodhimi i kaseinës apo laktozës

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e qumështit të freskët të lopës, shih 01.41
- prodhimin e qumështit nga (dele, dhi, gomarë, kuaj, gamile, shih 01.43, 01.44, 01.45
- prodhimin e qumështit dhe nënprodukteve të djathit jo nga qumështi, shih 10.89

10.52 Prodhimi i akullores

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e akullores dhe produkteve të tjera të ngjashme si akullore me lëng frutash

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e pastërçerive ku konsumohet akullorja, shih 56.10

10.6 Përpunimi i produkteve të drithrave, niseshtes dhe produkteve të niseshtes

Ky grup përfshin bluarjen e miellit ose miellin nga drithërat ose perimet, bluarjen, larjen dhe pastrimin e orizit, si dhe miellin si produkt gjysmë të gatshëm. Gjithashtu përfshihen në këtë grup bluarja e misrit dhe perimeve të njoma dhe prodhimi i niseshtes dhe produkteve të niseshtes.

10.61 Përpunimi i produkteve të drithrave

Kjo klasë përfshin:

- bluarjen e drithërave: prodhimi i miellit, prodhimi i bollgurit të grurit, miellit të tërshërës, thekrës, misrit dhe llojeve të tjera të drithërave;
- bluarjen e orizit: prodhimi i orizit të bardhë, të lëmuar, të ndritshëm, të tharë; prodhimin e miellit të orizit;
- bluarjen e perimeve: prodhimi i miellit nga perimet leguminore të thata, ose rrënjave dhe tuberave, ose frutave me lëvozhgë
- prodhimin e ushqimeve me bazë drithërash për mëngjes
- prodhimin e miellit të përzier dhe përgatitjen e miellit për prodhimin e bukës, kekëve, biskotave ose petullave

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e miellit të patates, shih 10.31
- bluarjen e misrit të njomë, shih 10.62

10.62 Prodhimi i niseshtes dhe produkteve të niseshtes

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e niseshtes nga patate, orizi, misri
- bluarjen e misrit të njomë
- prodhimin e glukozës, shurupit të glukozës, maltozës, insulinës etj
- prodhimin e glutenit
- prodhimin e tapiokës e nënprodukteve të tapiokes përgatitur nga niseshteja
- prodhimin e vajit të misrit

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e miellit të patates, shih 10.31
- prodhimin e sheqerit nga kallami i sheqerit, shih 10.81

10.7 Prodhimi i produkteve të bukës, ëmbëlsirave, makaronave

Kjo përfshin prodhimin e produkteve të furrës, makaronat dhe produkte të ngjashme

10.71 Prodhimi i bukës; prodhimi pastave të freskëta dhe kekëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e produkteve të furrës të freskëta, të ngrira dhe të thata

- prodhimin e bukës së zakonshme dhe të vogla
- prodhimin e pastave të freskëta, kekëve, byrekëve, tartave etj
- prodhimin e tortilave
- prodhimin e produkteve të furrës të ngrira: petullave, vaferave, petave

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e produkteve të bukës së thatë, shih 10.72
- prodhimin e makaronave, shih 10.73
- artikujt e furrave të pjekura për konsum të shpejtë, shih ndarjen 56

10.72 Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e biskotave, galetave dhe produkteve të tjera të thata të furrës
- prodhimin e pastave dhe kekëve të konservuar
- prodhimin e produkteve aperitive (biskota të thata, krekërs, ...) të ëmbla ose të kripura

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e patatinave, shih 10.31

10.73 Prodhimi i makaronave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e të gjithë llojeve të makaronave, të gatuar ose jo apo të mbushura
- prodhimin e kuskus-ve
- prodhimin e produkteve të ngrira prej brumi

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e kuskuseve të gatuar, shih 10.85
- prodhimin e supës me bazë makarona, shih 10.89

10.8 Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore

Ky grup përfshin prodhimin e sheqerit dhe ëmbëlsirave, ushqimeve të përgatitura, kafesë, çajit dhe esencave, si dhe produkteve ushqimore speciale

10.81 Prodhimi i sheqerit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e sheqerit të rafinuar dhe nënprodukteve të sheqerit, të përftuar nga lëngu i kallamit të sheqerit, të panxharit të sheqerit, të panjës dhe palmës
- prodhimin e shurupit të sheqerit
- prodhimin e melasës
- prodhimin e shurupit të panjës dhe sheqerit

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e saharozës, shih 10.62

10.82 Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kakaos, gjalpit të kakaos, yndyrës së kakaos, vajit të kakaos
- prodhimin e çokollatës dhe ëmbëlsirave me çokollatë

- prodhimin e ëmbëlsirave me sheqer: karamеле, çokollatë e bardhë, nuga,
- prodhimin e çëmçakizit
- konservimin në sheqer të frutave, brumit të frutave, dhe pjesëve të tjera të bimëve
- prodhimin e tabletave dhe pilulave të konfeksionuara

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e saharozës, shih 10.81

10.83 Përpunimi i çajit dhe kafes

Kjo klasë përfshin:

- heqjen e kafeinës nga kafeja dhe pjekja e kafesë
- prodhimin e produkteve të kafesë:
 - kafe bluar
 - kafe e tretshme
 - ekstrakti dhe koncentrat i kafesë
- përpunimin e nënprodukteve të kafesë
- përzierjen e çajit dhe beronjës
- përpunimin e koncentreve dhe përgatitjet me bazë çaji të paketave të çajit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përpunimin e infuzeve të bimëve (mente, kamomil etj)

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e inulinës, shih 10.62
- prodhimin e pijeve alkoolike, birrës, verës dhe pijeve të tavolinës, shih ndarja 11
- përgatitjen e produkteve botanike për përdorim farmaceutik, shih 21.20

10.84 Prodhimi i erëzave dhe salcave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e erëzave, salcave dhe përzierjeve pikante jo me bazë mishi:
 - majonezë
 - miell dhe pluhur mustarde
 - mustardë e përgatitur etj
- prodhimin e uthullës

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përpunimin e kripës në kripë ushqimore si psh kripë e jodizuar

Kjo klasë nuk përfshin:

- kultivimin e produkteve të destinuara për përgatitjen e erëzave, shih 01.28

10.85 Prodhimi i ushqimeve të përgatitura

Kjo klasë përfshin prodhimin e gatshëm (i përgatitur, me erëza dhe i gatuar) të gatimeve, të ngrira apo në formë të ngurtë. Këto gjellë të përgatitura zakonisht janë të paketuara dhe të gatshme për rishitje, kjo klasë nuk përfshin përgatitjen e ushqimeve për konsum të menjëhershëm, psh konsumi në restorant.

Kjo klasë përfshin:

- përgatitjen e gatimeve të freskëta apo të ngrira me mish apo mish shpendësh

- përgatitjen e gatimeve me peshk të ngrirë duke përfshirë peshk dhe patate të skuqura
- përpunimin e gatimeve të përgatitura me perime
- përgatitjen e picave të ngrira

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e gatimeve lokale e kombëtare

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e ushqimeve të freskëta ose ushqimet me më pak se dy përbërës, shih klasën korresponduese në ndarjen 10
- prodhimin e sanduiçeve, picave të freskëta, shih 10.89
- shitjen me pakicë të gatimeve në dyqane, shih 47.11, 47.29
- shitjen me shumicë të gatimeve, shih 46.38
- aktivitetet e kontraktorëve të shërbimit të ushqimeve, shih 56.29

10.86 Përgatitja e ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietetike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e ushqimeve për përdorim të veçantë
 - qumështi dhe ushqime të tjera për latantë
 - qumështi dhe ushqime të tjera për fëmijë në fazën e dytë të rritjes
 - ushqime për bebe
- produkte ushqimore me vlerë energjike të ulët ose të reduktuar, të destinuar për të mbajtur në kontroll peshën
- ushqime dietetike të përgatitura për qëllime mjekësore speciale
- ushqime pa sodë duke përfshirë kripëra dietetike me pak ose pa sodë
- ushqime pa gluten
- ushqime të adaptuara për harxhim muskular intensiv, kryesisht për sportistët
- ushqime të destinuara për personat që vuajnë nga një metabolizëm glucidik (diabet)

10.89 Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e suprave
- prodhimin e karamelëve dhe mjaltit artificial
- përgatitjen e ushqimeve që prishen shpejt si:
 - sanduiç
 - pica të freskëta (të pagatuara)

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përgatitjen e majasë
- përgatitjen e ekstrakteve dhe lëngjeve të mishit, peshkut, krustaceve dhe molusqeve
- përgatitjen e nënprodukteve të qumështit dhe të djathit
- prodhimin e produkteve me vezë, vezëve pluhur
- prodhimin e koncentreve artificiale

Kjo klasë nuk përfshin:

- përgatitjen e ushqimeve që prishen shpejt me fruta apo perime, shih 10.39
- përgatitjen e picave të freskëta, shih 10.85
- përgatitjen e pijeve alkoolike, birrës, verës dhe pijeve të tavolinës, shih ndarja 11

10.9 Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshë

10.91 Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës

Kjo klasë përfshin:

- përpunimin e ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës, përfshirë dhe koncentre dhe plotësues ushqimorë
- përgatitjen e ushqimeve jo të përziera për kafshët e fermës

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- trajtimin e mbetjeve nga prodhimi i ushqimeve për kafshët

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e miellit të peshkut për ushqim për kafshët, shih 10.20
- prodhimin e bërësive të vajit të ullirit, shih 10.41
- aktivitetet që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve të yndyrshme si bërës të nga vaji i ullirit (shih 10.41),
- mbetjet nga bluarja e drithërave (shih 10.61) etj

10.92 Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake

Kjo klasë përfshin:

- përpunimin e ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake ku përfshihen qentë, macet, zogjtë, peshqit etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- trajtimin e mbetjeve nga prodhimi i ushqimeve për kafshët

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e miellit të peshkut për ushqim për kafshë, shih 10.20
- prodhimin e bërësive të vajit të ullirit, shih 10.41
- aktivitetet që rezultojnë nga trajtimi i mbetjeve të yndyrshme si bërës të nga vaji i ullirit (shih 10.41),
- mbetjet nga bluarja e drithërave (shih 10.61) etj

11 Prodhimi i pijeve

Kjo ndarje përfshin prodhimin e pijeve, si të pijeve joalkolike dhe ujrave minerale, prodhimin e pijeve alkoolike kryesisht të fermentuara, birra dhe verë, dhe prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara.

Kjo ndarje nuk përfshin :

- prodhimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 10.32
- prodhimin e pijeve me bazë qumështi, shih 10.51
- prodhimin e kafes, çajit dhe produkteve të ngjashme, shih 10.83

11.0 Prodhimi i pijeve**11.01 Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve**

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara, për konsum si: uiski, brendi, xhin, likere, etj
- prodhimin e pijeve të përziera me pije alkoolike të distiluara
- kombinimin (përzierjen) e alkoleve të distiluara
- prodhimin e alkolit të pastër

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pijeve alkoolike jo të distiluara, shih 11.02 - 11.06
- prodhimin e alkolit etilik sintetik, shih 20.14
- prodhimin e alkolit etilik nga materialet e fermentuara, shih 20.14
- ambalazhimin në shishe dhe ngjitjen e etiketës, shih 46.34 (nëse është përcaktuar si pjesë e tregtisë me shumicë) dhe shih 82.92 (nëse është përcaktuar si pjesë ndërmjetësimeve).

11.02 Prodhimi i verës nga rrushi

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e verës
- prodhimin e verës spumante
- prodhimin e verës nga koncentratet e rrushit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përzierjen, pastrimin dhe futjen në shishe të verës
- prodhimin e verës me përqindje të ulët ose pa alkool

Kjo klasë nuk përfshin:

- ambalazhimin në shishe dhe ngjitjen e etiketës, shih 46.34 (nëse është përcaktuar si pjesë e tregtisë me shumicë) dhe shih 82.92 (nëse është përcaktuar si pjesë e ndërmjetësimeve)

11.03 Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e fermentuar por të pa distiluar të pijeve alkoolike: sake, verë molle, verë dardhe dhe verëra nga të tjera fruta.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e pijeve të fermentuara dhe pijeve të përziera që përmbajnë verë frutash.

Kjo klasë nuk përfshin:

- ambalazhimin në shishe dhe ngjitjen e etiketës, shih 46.34 (nëse është përcaktuar si pjesë e tregtisë me shumicë) dhe shih 82.92 (nëse është përcaktuar si pjesë e ndërmjetësimeve)

11.04 Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të pa distiluara

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e vermuthit dhe të tjera të ngjashme

Kjo klasë nuk përfshin:

- ambalazhimin në shishe dhe ngjitjen e etiketës, shih 46.34 (nëse është përcaktuar si pjesë e tregtisë me shumicë) dhe shih 82.92 (nëse është përcaktuar si pjesë e ndërmjetësimeve)

11.05 Prodhimi i birrës

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve të maltës si birrë, birrë e zezë dhe birrë e fortë

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e birrës me përqindje të ulët ose pa alkool

11.06 Prodhimi i maltës

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e maltës

11.07 Prodhimi i pijeve të tavolinës; prodhimi i ujit mineral dhe ujërave të tjerë në shishe

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pijeve joalkoolike, përveç birrës dhe verës joalkoolike
- prodhimin e ujit mineral natyral dhe ujërave të tjerë në shishe
- prodhimin e pijeve të tavolinës:
 - ujëra të ëmbëlsuar joalkoolike: limonadë, aranzatë, koka-kola, pije me fruta, ujë tonik etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e lëngjeve të frutave dhe perimeve, shih 10.32
- prodhimin e pijeve me bazë qumështi, shih 10.51
- prodhimin e kafesë, çajit dhe të ngjashme, shih 10.83
- prodhimin e verës joalkoolike, shih 11.02
- prodhimin e birrës joalkoolike, shih 11.05
- prodhimin e akullit, shih 35.30
- ambalazhimin në shishe dhe ngjitjen e etiketës, shih 46.34 (nëse është përcaktuar si pjesë e tregtisë me shumicë) dhe shih 82.92 (nëse është përcaktuar si pjesë ndërmjetësimeve)

12 Prodhimi i produkteve të duhanit

Kjo ndarje përfshin proceset mbi duhanin, në formën e nënprodukteve deri në konsum përfundimtar.

12.0 Prodhimi i produkteve të duhanit

12.00 Prodhimi i produkteve të duhanit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e produkteve të duhanit dhe nënprodukteve të duhanit si: cigare, duhan për cigare, puro, duhan për pipa, duhan për ta përtypur, duhan për të thithur
- prodhimin e duhanit të "homogjenizuar" dhe "rigjeneruar"

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- ritharjen e duhanit

Kjo klasë nuk përfshin :

- mbjelljen dhe proceset paraprake të duhanit, shih 01.15, 01.63

13 Përpunimi i tekstileve

Kjo ndarje përfshin përgatitjen dhe ëndjen e fibrave tekstile si edhe thurjen e tekstileve, përfundimin dhe prodhimin e veshjeve, prodhimin e artikujve tekstile artificialë (si mbulesa për familje, bataniye, qilim, spango). Mbajllja e fibrave natyrale përfshihet në ndarjen 01, ndërsa përpunimi i fibrave tekstile është një proces kimik i klasifikuar në klasën 20.60. Konfeksionimi i veshjeve përfshihet në ndarjen 14.

13.1 Përgatitja e fibrave tekstile dhe filatura

13.10 Përgatitja e fibrave tekstile dhe filatura

Kjo klasë përfshin veprimet përgatitore tek fibrat e tekstileve dhe tjerren apo endjen e fibrave tekstile. Kjo mund të kryhet nga lëndë të para materiale të ndryshme si: mëndafsh, lesh, fibra me origjinë shtazore ose bimore, fibra artificiale ose sintetike, letër ose qelq, etj.

Kjo klasë përfshin:

- proceset përgatitore për trajtimin e fibrave tekstile:
 - larja e mëndafshit
 - çyndyrëzimi dhe karbonizimi i leshit dhe ngjyrimi i leshit të qethur
 - krehja dhe ndërthurja e të gjitha llojeve të fibrave shtazore, bimore dhe artificiale
- tjerren dhe përpunimin e fijeve dhe fillit për endje dhe qepje, për treg dhe për procese të mëtejshme
 - zhveshja e fijeve të lirit
 - endja, thurja, mbështjellja, kabllimi, dhe kredhjen e filamenteve të fijeve artificiale dhe sintetike

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përpunimin e fijeve të letrës

Kjo klasë nuk përfshin:

- operacionet përgatitore të kryera në kombinim me bujqësinë, shih ndarjen 01
- njomjen e bimëve që prodhojnë fibra tekstile bimore (jut, liri, etj.), shih 01.16
- zhveshjen e farave nga pambuku, shih 01.63
- përpunimin e fibrave dhe shtëllungave sintetike dhe artificiale, përpunimi i fijeve të thjeshta (duke përfshirë fije të forta në kapje dhe fijet për tapete) të fibrave sintetike apo artificialë, shih 20.60
- përpunimin e fibrave të qelqit, shih 23.14

13.2 Endja e tekstileve

13.20 Endja e tekstileve

Kjo klasë përfshin përfundimin e tekstileve. Kjo mund të kryhet nga lëndë të para materiale të ndryshme si : mëndafsh, lesh, fibra me origjinë shtazore ose bimore, fibra artificiale ose sintetike, letër ose qelq, etj.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pëlhurave prej pambuku, leshi, mëndafshi, duke përfshirë fijet e përziera ose artificiale ose sintetike (polipropilen, etj.)
- prodhimin e pëlhurave të tjera duke përdorur fin, hither, kërp, jut, fibra të lehtë dhe fije të tjera speciale

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e turrave ose përlhura të lehta si garza, peshqirë mëndafshi etj.
- prodhimin e pëlhurave të endura me fibra qelqi
- prodhimin e filleve të endura me karbon dhe aramid
- prodhimin e gëzofit imitacion për veshje

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pëlhurave të endura dhe thurura, shih 13.91
- prodhimin e tekstileve për mbulimin e dyshemesë, shih 13.93
- prodhimin e pëlhurave të paendura, shih 13.95
- prodhimin e pëlhura si rripa të ngushtë, shih 13.96
- prodhimin e filtrave, shih 13.99

13.3 Proçeset përfundimtare të përpunimit të tekstileve

13.30 Proçeset përfundimtare të përpunimit të tekstileve

Kjo klasë përfshin proçeset përfundimtare të tekstileve dhe veshjeve si zbardhjen, ngjyrosjen, stampimin dhe aktivitete të ngjashme.

Kjo klasë përfshin:

- zbardhjen dhe ngjyrosjen e fibrave tekstile, fijeve, pëlhurave dhe artikujve tekstile, duke përfshirë veshjet
- veshjen, tharjen, avullimin (vaporizimin), kontraktimin, fiksimin, lustrimin e tekstileve dhe artikujve tekstilë, duke përfshirë dhe veshjet

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- zbardhjen e xhinseve
- palosjen dhe punë të ngjashme mbi tekstilet
- mbrojtjen nga uji, shtresat, plastifikimin, ose ngopjen e artikujve të veshmbathjes të blera
- stampimin mbi tekstile dhe veshje

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e pëlhurave tekstile të ngopura, shtresëzuara, mbuluara ose të laminuara me kauçuk, ku kauçuku është përbërësi kryesor, shih 22.19

13.9 Prodhimi i tekstileve të tjera

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve nga tekstilet, përveç veshjet, si artikuj tekstile artificiale, tapete dhe qilima, shtresa, pëlhura të endura ngushtë, zbukurime etj.

13.91 Prodhimi i tekstileve të tjera, pëlhurave të endura dhe thurura

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin dhe prodhimin e pëlhurave të endura dhe thurura:
 - pëlhura me push dhe mëndafshi
 - pëlhura të tipeve që përdoren për fileto, perde dhe vitrina të endura në makina të tipit Raschel ose të ngjashme
 - pëlhura të tjera të endura apo të thurura

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e gëzofëve imitacion me thurje

Kjo klasë nuk përfshin:

- pëlhura të tipeve që përdoren për fileto, perde dhe vitrina të endura si dantellë në makina të tipit Raschel ose të ngjashme, shih 13.99
- prodhimin e pëlhurave të endura apo të thurura, shih 14.39

13.92 Prodhimi i artikujve tekstile të konfeksionuar, përveç veshjeve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikujve të konfeksionuar të çdo materiali tekstil, të endura apo të thurura:
 - batanije, duke përfshirë dhe mbulesat e udhëtimit
 - të linjtat e krevatit, tavolinës, tualetit ose kuzhinës
 - mbulesa këmbësh, pufka, jorgan, jorgan me pupla, jastëk, çanta fjetjeje etj
- prodhimin e artikujve të konfeksionuar për mobilime:
 - perde, velenca, mbulesa krevati, kuvertë, mbulesë mobilje apo makine etj
 - mushama, tenda, artikuj për kamping, vela, grila dielli, mbulesa të lirshme për veturat, makinat apo mobiljet etj
 - flamurë, banderola, flamur sinjalizimi etj.
 - leckë për të fshirë pluhurat, leckë për larje enët dhe artikuj të ngjashëm, jelekë shpëtimi, parashuta etj

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e pjesëve tekstile të mbulesave ngrohëse elektrike
- prodhimin e tapicerive të thurura me dorë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e artikujve tekstilë për përdorim teknik, shih 13.96

13.93 Prodhimi i tapeteve dhe qilimave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mbulesave të dyshemesë prej tekstili:
 - tapet, qilim dhe rrogoz, katrorë

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e mbulesave në tezgjah me gjilpërë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e hasrave dhe rrogozëve të vegjël prej materiali që thuret gërshet, shih 16.29
- prodhimin e mbulesave të dyshemesë prej xunkthi, shih 16.29
- prodhimin e mbulesave të dyshemesë elastike si: vinili, linoleum, shih 22.23

13.94 Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e litarëve, spangove, kablove dhe litarëve të hollë prej fibrave tekstile, të ngjyrosura, të mbuluara ose të vendosura në këllëf prej kaucuku ose materiale plastike
- prodhimin e rrjetave me thyesa të lidhura duke pasur si bazë spango dhe litarë
- prodhimin e artikujve me litar apo spango: rrjeta peshkimi, të mbrojtjes së anijes, jastëk ngarkimi, shkarkimi, litarë ku janë vendosur unaza metalike etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rrjetave të flokëve, shih 14.19
- prodhimin e telave litar, shih 25.93
- prodhimin e rrjetave për peshkimin sportiv, shih 32.30

13.95 Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve

Kjo klasë përfshin të gjitha aktivitetet të lidhura me tekstilet apo produktet prej tekstili, të paklasifikuara në ndarjet 13 ose 14, duke përfshirë një numër të madh të proceseve dhe një varietet të madh të produkteve të prodhuara.

13.96 Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pëlhurave të thurura të ngushta, duke përfshirë pëlhurat pa fibra ose fije të vendosura paralelisht dhe të lidhura
- prodhimin e etiketave etj.
- prodhimin e artikujve dekorativë, kordone, xhufkave etj.
- prodhimin e pëlhurave të ngopura, shtresëzuara, mbuluara ose laminuara me material plastik
- prodhimin e fijeve të metalizuara ose fijeve të përdredhura të metalizuara, fill dhe spango kauçuku, me material tekstil, fill tekstili ose rrip i mbuluar, ngopur, shtresëzuar dhe mbuluar me kauçuk ose plastik

- prodhimin e pëlhurave për goma të përfutur nga fije sintetike apo artificiale me fortësi në tërheqje
- prodhimin e artikujve tekstil të ndryshëm: fitila, mbulesa inkandeshente, etj
- prodhimin e pëlhurave mbështjellëse, tuba për pompa, rripa transmesioni ose konvejeri, (të veshura ose jo me materiale metalikë apo materiale metalikë ose materiale të tjera), veshja e shisheve, veshje filtri
- prodhimin e zbulimeve të automjeteve
- prodhimin e artikujve prej kanavaçe

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rripave të transmetimit ose konvejerëve prej pëlhure tekstili, fije ose kordon i shtresëzuar, ngopur, mbuluar ose laminuar me kauçuk, ku përbërësi kryesor është kauçuku, shih 22.19
- prodhimin e pllakave ose fletëve të kombinuara plastik ose kauçuk me tekstile vetëm për qëllime rivendosje, shih 22.19, 22.21
- prodhimin e veshjeve të telave metalikë, shih 25.93

13.99 Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e etiketave etj.
- prodhimin e tyleve dhe pëlhurave të tjera rrjetë, dantella, qëndistari, në copa, në shirit, në motive
- prodhimin e shiritave adezivë për veshjet
- prodhimin e lidhëseve për këpucë, prej tekstili
- prodhimin e pufka pudre dhe dorashka sportive

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e mbulesave në tezgjah me gjilpërë, shih 13.93
- prodhimin e vatave prej tekstili dhe artikujt prej vate: si peceta higjenike, tamponet etj, shih 17.22

14 Konfeksionimi i veshjeve

Kjo ndarje përfshin të gjitha qepjet (gati për t'u veshur ose gati për t'u matur), në të gjitha llojet e materialeve (lëkurë, pëlhurë, pëlhurë e ëndur apo e thurur), të gjithë artikujt e veshjes (veshje të jashtme, të brendëshme për burra, gra dhe fëmijë; veshje pune, argetimi etj) dhe aksesoret. Këtu nuk ka asnjë dallim veshje për të rritur dhe veshje për fëmijë, ndërmjet veshjes moderne dhe asaj tradicionale. Ndarja 14 përfshin gjithashtu industrinë e gëzofëve (lëkurë gëzofi dhe veshje prej gëzofi).

14.1 Konfeksionimi i veshjeve, përveç veshjeve prej gëzofi

Ky grup përfshin konfeksionimin e veshjeve. Materiali i përdorur mund të jetë prej çdo lloji dhe mund të jetë i shtresëzuar, i ngopur ose kauçukëzuar.

14.11 Konfeksionimi i veshjeve prej lëkure

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve me lëkurë ose përbërje prej lëkure duke përfshirë ndihmëset e punës prej lëkure si përparëse mbrojtëse pune.

Kjo klasë nuk përfshin:

- konfeksionimin e artikujve me lëkurë gëzofi, shih 14.20
- konfeksionimin e dorezave prej lëkure dhe kasketave sportive, shih 32.30
- konfeksionimin e veshjeve mbrojtëse dhe kundra zjarrit, shih 32.99

14.12 Konfeksionimi i veshjeve të punës

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve të punës

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e këpucëve, shih 15.20
- konfeksionimin e veshjeve mbrojtëse dhe kundra zjarrit, shih 32.99
- riparimin e veshjeve, shih 95.29

14.13 Konfeksionimi i veshjeve të tjera të jashtme

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve të tjera të jashtme të endura, thurura, jo të thurura etj. për burra, gra dhe fëmijë:
 - pallto, pardesy, kostume, xhaketa, fustane, funde etj

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- konfeksionimin e kostumeve në rrobaqepsi
- konfeksionimin e pjesëve të produkteve të listuara

Kjo klasë nuk përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve me lëkurë gëzofi (përveç kasketave), shih 14.20
- konfeksionimin e veshjeve prej kauçuku apo plastike jo kostume të qepura por thjesht me ngjitje, shih 22.19, 22.29
- konfeksionimin e veshjeve mbrojtëse dhe kundrazjarrit, shih 32.99
- riparimin e veshjeve, shih 95.29

14.14 Konfeksionimi i veshjeve të brendshme

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve të brendshme dhe veshjet e natës të trikotuara, të endura apo të thurura, dantella, për burra, gra dhe fëmijë:
 - bluza, T-shirt, pizhama, të mbathura, këmbishë nate, bluza, petk dhome, korse, etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- riparimin e veshjeve, shih 95.29

14.19 Konfeksionimi i veshjeve të tjera dhe aksesore

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve për foshnjat, tuta, kostume për ski, veshje për not etj;
- konfeksionimin e kapeleve dhe kapuçëve
- konfeksionimin e aksesorëve të tjerë për veshje: dorashka, rripa, shall, kollare, kravatë, rrjet flokësh etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- konfeksionimin e kasketave me lëkurë gëzofi
- konfeksionimin e këpucëve me material tekstili pa vendosjen e shollës
- konfeksionimin e pjesëve të produkteve të listuara

Kjo klasë nuk përfshin:

- konfeksionimin e kapeleve sportive, shih 32.30
- konfeksionimin e kasketave mbrojtëse (përveç kasketave sportive), shih 32.99
- konfeksionimin e veshjeve mbrojtëse dhe kundrazjarrit, shih 32.99
- riparimin e veshjeve, shih 95.29

14.2 Konfeksionimi i artikujve prej gëzofi

14.20 Konfeksionimi i artikujve prej gëzofi

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e artikujve me lëkurë gëzofi:
 - veshjet dhe aksesoret prej gëzofi
 - bashkime të copave prej lëkurë gëzofi, katrorë, shirita etj
 - artikuj të ndryshme prej lëkurë gëzofi si: qilima, pufka jo me garniturë, lëkurë për të ilustruar për industrinë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e gëzofit bruto, shih 01.4, 01.70
- prodhimin e lëkurës bruto, shih 10.11
- konfeksionimin e gëzofit imitacion(stofra me flokë të gjatë që përftohen nga endja ose gjatë trikotimit), shih 13.20, 13.9
- konfeksionimin e kapeleve prej gëzofi, shih 14.19
- konfeksionimin e veshjeve me garniturë gëzofi, shih 14.19
- veshjeve dhe ngjyrosje të gëzofit, shih 15.11
- konfeksionimin e pjesëve me gëzof të çizmeve dhe këpucëve, shih 15.20

14.3 Konfeksionimi i veshjeve me thyesa

14.31 Konfeksionimi i trikotazheve me thyesa

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e trikotazheve, duke përfshirë çorape, çorape të shkurtra dhe geta

14.39 Konfeksionimin e veshjeve të tjera me thyesa

Kjo klasë përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve me thyesa dhe artikuj të tjerë trikotazhi si pulovra, jelekë me mëngë, xhilet dhe artikuj të ngjashëm tëthurur

Kjo klasë nuk përfshin:

- konfeksionimin e tekstileve tëthurura, shih 13.91
- konfeksionimin e çorapeve, shih 14.31

15 Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure

Kjo ndarje përfshin regjien dhe tharjen e lëkurës dhe transformimin e lëkurës në lëkurë të tanuar apo regjur dhe fabrikimin e produkteve prej lëkurës për përdorim përfundimtar.

Kjo gjithashtu përfshin produkte të ngjashme nga materiale të tjera (imitacione të lëkurëve apo nënprodukte lëkure), si këpucë kauçuku, valixhe tekstili etj. Produktet e prodhuara nga nënprodukte lëkure përfshihen këtu, pasi ato janë prodhuar me rrugë të ngjashme në të cilat janë prodhuar produktet e lëkurës (si valixhe) dhe shpesh janë të prodhuara në të njëjtën njësi.

15.1 Tanini dhe regjja e lëkurës, prodhimi i valixheve, çantave të dorës, pajimeve të kuajve, veshja dhe ngjyrosja e gëzofëve

Ky grup përfshin përpunimin e lëkurës dhe gëzofit dhe produktet prej tyre

15.11 Tanini dhe regjja e lëkurës dhe ngjyrosja e gëzofit

Kjo klasë përfshin:

- taninin, tharjen dhe regjjen e lëkurës
- përpunimin e kamoshit të regjur, pergamenë e regjur, lëkurë e shkëlqyer apo metalizuar
- përpunimin e përbërësve të lëkurës
- pastrimin, kruarjen, taninin, zbardhjen, qethjen dhe rrjepjen e lëkurës me qime

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e lëkurës si pjesë e fermës, shih 01.4
- përpunimin e lëkurës si pjesë e thertoresh, shih 10.11
- konfeksionimin e veshjeve prej lëkure, shih 14.11
- përpunimin e lëkurës imitacion jo të bazuar në lëkurë natyrale, shih 22.19, 22.29

15.12 Prodhimi i valixheve, çantave të dorës dhe të ngjashme, pajimeve të kuajve dhe të tjerë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e valixheve, çantave të dorës dhe të ngjashme, përbërës lëkure dhe prej çdo materiali tjetër, si fletë plastike, materiale tekstili, fibra të vullkanizuara ose kartoni, ku teknologjia e përdorur është e njëjtë si për lëkurën
- prodhimin e pajimeve të kuajve
- prodhimin e fashove jometalike të orëve (si pëlhurë, lëkurë, plastik)
- prodhimin e artikujve të ndryshëm të lëkurës ose përbërës të lëkurës: rripi i makinës, paketimi etj
- prodhimin e lidhëseve të këpucëve prej lëkure
- prodhimin e rripave të kuajve

Kjo klasë nuk përfshin:

- konfeksionimin e veshjeve prej lëkure, shih 14.11
- prodhimin e kasketave dhe kapeleve prej lëkure, shih 14.19
- prodhimin e këpucëve, shih 15.20
- prodhimin e ndenjësve për biçiklet, shih 30.92
- prodhimin e fashove të orëve me metal të çmuar, shih 32.12
- prodhimin e fashove të orëve me metal jo të çmuar, shih 32.13
- prodhimin e rripave mbrojtës të fillrojtësve dhe rripave të tjerë për përdorim profesional, shih 32.99

15.2 Prodhimi i këpucëve

15.20 Prodhimi i këpucëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e materialeve të ndërtimit, me substanca vegjetale (lesh druri, kashtë, kallama) të aglomeruara me çimento, allçi dhe minerale të tjera lidhëse
- prodhimin e artikujve prej çimento asbesti ose çimento fibra celuloze, të tilla si:
 - pllaka të valëzuara, pllaka të tjera, panele, tjegulla, tuba, shtylla, rezervuar, govatë, mobilje, skelete dritare, këllëf etj.

23.69 Prodhimi i artikujve të tjerë prej betoni, allçie dhe çimento

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e artikujve të tjerë prej betoni, çimento, allçie ose guri artificial:
 - statuja, mobilje, basorelieve, qypa, vazo lulesh etj.

23.7 Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni

23.70 Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni

Kjo klasë përfshin:

- thyerjen, dhënien e formës dhe finicionin e gurit për qëllime ndërtimi ndërtesash, në monumente funerale, në rrugë, si veshje në trotuare etj
- prodhimin e mobiljeve prej guri

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetin e gurorëve, psh prodhimi i gurit bruto, shih 08.11
- prodhimin e gurit të mullirit, gurit abraziv dhe produkte të ngjashme, shih 23.9

23.9 Prodhimi i produkteve abrazive dhe mineraleve jo metalike p.k.t

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve të tjera minerale jo metalike.

23.91 Prodhimi i produkteve abrazive

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e gurit të mullirit, i gurëve për mpreshe ose për lëmim, dhe produkteve abrazive natyrale dhe artificiale duke përfshirë produktet abrazive mbi një mbajtëse me bazë të butë (si letra zmerile)

23.99 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike të p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e materialeve të friksionit dhe pjesëve të pamontuara, me përmbajtje të substancave minerale ose prej celuloze:
 - lesh skorje, lesh shkëmbi dhe lesh i mineraleve të ngjashme; argjilës së shfrytëzueshme dhe lëndëve minerale të ngjashme për izolim termik, izolim sonor, materiale për absorbimin e tingujve
- prodhimin e artikujve prej substancave minerali të ndryshme:
 - mika e punuar ose artikujt prej mike, të shtresave të varfra të mineralit, grafiti, (për përdorim të ndryshëm nga ajo elektrik) etj
- prodhimin e artikujve prej asfalti apo materiale të ngjashme, si adezive bazë-asfalti, katran qymyri etj.
- prodhimin e fibrave dhe produkteve prej karboni dhe grafiti (përveç elektrodave dhe aplikacioneve elektrike)

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e leshit të qelqit dhe produkteve prej lesh qelqi të paendur, shih 23.14
- prodhimin e elektrodave grafiti, shih 27.90
- prodhimin e rondelave prej grafiti dhe karboni, shih 28.29

24 Metalurgjia

Kjo ndarje përfshin aktivitete të shkrirjes dhe/ose rafinimit të hekurit dhe metaleve jo-ferroze nga minierat, metale të derdhura ose kallëpe metali, duke përdorur teknikën elektrometalurgjike dhe procese të tjera metalurgjike. Kjo ndarje gjithashtu përfshin prodhimin e aliazheve të metaleve dhe super-aliazheve duke përdorur elementë të tjerë kimikë tek metali i pastër. Rezultati i shkrirjes apo rafinimit, zakonisht në formë lingote përdoret në operacione petëzimi, tërheqje dhe nxjerrje për të prodhuar fletë, rripa, shufër, kallam ose tela, dhe në formë të shkrirë për të realizuar derdhje apo produkte të tjera metalike.

24.1 Siderurgjia, prodhimi i hekurit, çelikut dhe ferroaliazheve

Ky grup përfshin aktivitete të tilla si reduktimi i mineralit të hekurit, prodhimi i kallëpeve prej hekuri në shkrirje apo formë solide; konvertimin e kallëpeve të hekurit në çelik; prodhimi i ferroaliazheve.

24.10 Siderurgjia, prodhimi i hekurit, çelikut dhe ferroaliazheve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin e furrave plasëse, këmbimin e çelikut, petëzimin dhe përfundimin
- prodhimin e kallëpeve prej hekuri dhe gize, blloqe apo forma të tjera primare
- prodhimin e ferroaliazheve
- prodhimin e produkteve ferrike nga reduktimi direkt i hekurit dhe produkteve të tjera ferrike poroze;
- prodhimin e hekurit veçanërisht i pastër nga elektroliza dhe procese të tjera kimike;
- shkrirjen e lingotave skrap prej hekuri dhe çeliku;
- prodhimin e hekurit të granular dhe pluhurit të hekurit;
- prodhimin e çelikut në lingota ose në forma të tjera primare;
- prodhimin e produkteve prej çeliku;
- prodhimin e produkteve të çelikut të derdhura në të ngrohtë, në të ftohtë në forma të ndryshme (shina treni, shufra, etj);

Kjo klasë nuk përfshin:

- tërheqjen në të ftohtë të shufrave, shih 24.31

24.2 Prodhi i tubave, tubacioneve, profilet e lugëta dhe pjesë të tjera prej çeliku**24.20 Prodhi i tubave, tubacioneve, profilet e lugëta dhe pjesë të tjera prej çeliku**

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tubave dhe tubacione me seksione jo rrethore kryq, ose me boshllëqe në seksionin me kryqe rrethore, për përpunim të mëtejshëm, me laminim dhe tërheqjen në të nxehtë ose nga procese të tjera në të nxehtë duke përdorur një produkt të ndërmjetëm i cili mund të jetë kallëp ose shufër e marrë nga farkëtimi i nxehtë ose derdhja e vazhdueshme
- prodhimin e tubave dhe tubacioneve të pa salduar me saktësi dhe ose jo, të laminuar në të nxehtë apo nxjerrje e nxehtë për përpunim të mëtejshëm, nga tërheqja (rulëzimi) në të ftohtë i tubave dhe tubacioneve me seksione kryq rrethor dhe nxjerrja në të ftohtë vetëm për tubat dhe tubacionet me seksione kryq jo rrethore dhe profilet e lugëta
- prodhimin e tubave të ngjitur dhe tubacioneve me një diametër të jashtëm që kalon 406,4 mm, artikujve të sheshtë, atyre gjatësorë dhe spiralë të ngjitur të cilët janë të rulëzuar dhe i është dhënë forma në të ftohtë
- prodhimin e tubave të ngjitur dhe tubacionet me një diametër të jashtëm 406,4 mm ose më pak, e artikujve të sheshtë, atyre gjatësorë dhe spiralë të ngjitur me seksion kryq rrethor ose me seksione jo rrethore kryq, të cilat iu është dhënë forma në të nxehtë ose në të ftohtë, farkëtimi i tyre në të ftohtë ose në të nxehtë
- prodhimin e tubave të ngjitur me saktësi dhe tubacionet me një diametër të jashtëm 406,4 mm ose më pak, e artikujve që i jepet formë në të nxehtë ose në të ftohtë ose rulëzimi i tyre dhe nga të nxehtë apo të ftohtë, atyre gjatësorë të salduar të cilët nuk i nënshtrohen proceseve të tjera pasi saldohen ose ato që përpunohen më tej; me tërheqje, rulëzim ose dhënie formës në të ftohtë për farkëtimin e tubave dhe tubacioneve të çelikut me seksion kryq jo rrethor
- prodhimin e shufrave të sheshta dhe shufrave të farkëtuara me anë të farkëtimin të tyre në të nxehtë nëpërmjet artikujve të çelikut
- prodhimin e pajisjeve me saldim, të tilla si bërryla dhe reduktime si dhe tuba çeliku me farkëtim në të nxehtë
- prodhimin e tubave ose tubacioneve të çelikut të ndërprera ose të tjera.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e tubave dhe tubacioneve pa tegel (ngjitje) të çelikut me sistemin centrifugal, shih 24.52.

24.3 Prodhi i produkteve të tjera pas transformimit fillestar të çelikut

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve të tjera prej çeliku të përpunuar në të ftohtë

24.31 Tërheqja në të ftohtë e shufrave

Kjo klasë përfshin:

- tërheqjen e shufrave dhe seksioneve të ngurta të çelikut nga tërheqja në të ftohtë, mprehjen ose vidhosjen

Kjo klasë nuk përfshin:

- tërheqjen në të ftohtë të telit, shih 24.34

24.32 Petëzimi në të ftohtë i rripave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e produkteve të petëzuara të sheshta prej çeliku, të riveshura apo të paveshura, të rulëzuara ose jo, me një gjatësi që nuk e kalon 600 mm, të përfutur sipas ripetëzimit në të ftohtë.

24.33 Profilizimi në të ftohtë me anë të përkuljes

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e profileve të hapura me deformim progresiv mbi makina me gurë ose mbi presa të fletëve të mbështjella të produkteve prej çeliku
- prodhimin e profiluar në të ftohtë ose përkulur në të ftohtë, fletëve të sipërme ose paneleve shumështrësash

24.34 Trafilimi në të ftohtë i telave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e telave prej çeliku, të trafeluar në të ftohtë ose tërheqjen e gypave prej çeliku

Kjo klasë nuk përfshin:

- trafilimin e shufrave dhe seksionet e forta të çelikut, shih 24.31
- përpunim e produkteve të telit të derivuara, shih 25.93

24.4 Prodhimi i metaleve të çmuar dhe metaleve jo-ferrike**24.41 Prodhimi i metaleve të çmuara**

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e metaleve të çmuar:
 - prodhimin dhe rafinimin e metaleve të çmuar bruto: ar, argjend, platin, etj, nga minerali dhe skrapi
- prodhimin e aliazheve prej metaleve të çmuar
- prodhimin e gjysmë produkteve prej metali të çmuar
- prodhimin e pllakave dubël prej argjendi mbi metal të zakonshëm
- prodhimin e pllakave dubël prej ari mbi bazë metali të zakonshëm ose argjendi
- prodhimin e pllakave dubël prej platini apo grupi metaleve të platinut mbi ar, argjend ose metale të zakonshme

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e telave prej trafilit të katër metaleve
- prodhimin e fletëve të metaleve të çmuara të petëzuara

Kjo klasë nuk përfshin:

- derdhjen e metaleve joferrike, shih 24.53, 24.54
- përpunimin e bizhuterive prej metali të çmuar, shih 32.12

24.42 Prodhimi i aluminit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e aluminit nga alumina
- prodhimin e aluminit nga rafineria elektrolitike e mbetjeve të aluminit ose skrapit
- prodhimin e aliazheve të aluminit
- prodhimin e gjysmëprodukteve prej alumini

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e telave prej këtyre metaleve me tërheqje
- prodhimin e oksidit të aluminit (alumina)
- prodhimin e letrës mbështjellëse prej alumini
- prodhimin e laminateve mbështjellëse të aluminit (kallaj) të bëra nga mbështjellëse alumini (kallaj) si komponent primar.

Kjo klasë nuk përfshin:

- derdhjen e metaleve joferrike, shih 24.53, 24.54

24.43 Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e plumbit, zinkut dhe kallajit nga mineralet
- prodhimin e plumbit, zinkut dhe kallajit nga rafinimi elektrolitik i mbetjeve apo mbeturinave të plumbit, zinkut dhe kallajit
- prodhimin e aliazheve të plumbit, zinkut dhe kallajit
- prodhimin e gjysmë produkteve të plumbit, zinkut dhe kallajit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e telave prej këtyre metaleve me tërheqje
- prodhimin e fletëve të kallajit

Kjo klasë nuk përfshin:

- derdhjen e metaleve joferrike, shih 24.53, 24.54

24.44 Prodhimi i bakrit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e bakrit nga minerali
- prodhimin e bakrit nga rafinimi elektrolitik i mbetjeve të bakrit ose skrapit
- prodhimin e aliazheve prej bakri
- prodhimin e fillit ose rripave prej bakri e gjysmë-produkte prej bakri

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e telave prej petëzimit të këtyre metaleve

Kjo klasë nuk përfshin:

- derdhjen e metaleve joferrike, shih 24.53, 24.54

24.45 Prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kromit, magnezit, nikelit, etj nga mineralet ose oksidet
- prodhimin e kromit, magnezit, nikelit, etj, nga rafinimi elektrolitik ose aluminotermik i mbetjeve apo skrapit të kromit, magnezit, nikelit etj
- prodhimin e aliazheve të kromit, magnezit, nikelit etj
- prodhimin e gjysmë-produkteve të kromit, magnezit, nikelit etj
- prodhimin e matës prej nikeli

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e telave të petëzuar prej këtyre metaleve

Kjo klasë nuk përfshin:

- derdhjen e metaleve joferrike, shih 24.53, 24.54

24.46 Përpunimi i metaleve nukleare

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e metalit të uraniumit nga përzjerja e katranit ose mineraleve të tjera
- bashkëshkrirjen dhe rafinimin e uraniumit

24.5 Derdhja e metaleve

Ky grup përfshin:

- prodhimin e produkteve gjysmë të përfunduara dhe derdhje të ndryshme nga procesi i derdhjes.

Ky grup nuk përfshin:

- prodhimin e produkteve të derdhura e të përfunduara si:
 - bolierët dhe radiatorët, shih 25.21
 - artikuj shtëpiakë të derdhur, shih 25.99

24.51 Derdhja (fonderia) e gizës

Kjo klasë përfshin aktivitete të fonderisë së gizës.

Kjo klasë përfshin:

- derdhjen (fonderinë) e gjysmë-produkteve prej gize
- derdhjen (fonderinë) e detalit gizës gri të derdhur
- derdhjen (fonderinë) e gizës grafite sferoidale të derdhur
- derdhjen (fonderinë) e produkteve prej gize të derdhur të farkëtueshme
- prodhimin e tubave dhe pajisjeve prej gize të derdhur

24.52 Derdhja (fonderia) e çelikut

Kjo klasë përfshin aktivitete të fonderisë së çelikut.

Kjo klasë përfshin:

- derdhjen (fonderinë) e gjysmë produkteve prej çeliku
- derdhjen e metaleve të derdhur të çelikut
- prodhimin e tubave pa saldime dhe tubave të çelikut nga derdhja centrifugale
- prodhimin e pjesëve për tuba ose gypa nga çeliku i derdhur

24.53 Derdhja (fonderia) e metaleve të lehtë

Kjo klasë përfshin:

- derdhjen (fonderinë) e produkteve gjysmë të përfunduara prej alumini, magnezi, titanium, zink, etj
- derdhjen (fonderinë) e metaleve të lehtë të derdhur

24.54 Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera jo-ferrike

Kjo klasë përfshin:

- derdhjen (fonderinë) e metaleve të rënda të derdhura
- derdhjen (fonderinë) e metaleve të çmuara të derdhura
- derdhjen-stampë të metaleve joferrike të derdhura

25 Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve

Kjo ndarje përfshin përpunimin e “pastër” të produkteve metalike (si pjesët, kontenierët dhe strukturat metalike) zakonisht me një funksion statik, të qëndrueshëm, të kundërt me ndarjet 26-30 që vijojnë, të cilët mbulojnë përpunimin e kombinacioneve ose montimeve të disa produkteve metalike (disa herë me materiale të tjera) në njësi shumë më komplekse që, përveç rasteve kur ato janë elektrike të pastër, elektronik ose optik, punojnë me pjesë të lëvizshme.

Në këtë ndarje përfshihet gjithashtu prodhimi i armëve dhe municioneve.

Kjo ndarje nuk përfshin:

- aktivitetin e mirëmbajtjes dhe riparimeve të specializuara, shih grupi 33.1
- instalimin e specializuar të makinerive dhe mallrave të tjerë të përpunuar në ndërtesa siç janë bolierët e ngrohjes qendrore, shih 33.20

25.1 Prodhimi i produkteve metalike strukturore

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve metalike strukturore (si skeletet metalike dhe pjesët e tyre për ndërtim).

25.11 Prodhimi i strukturave metalike dhe pjesët e strukturave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e konstruksioneve metalike ose skeleteve për ndërtim dhe pjesë prej tyre (kulla, urat etj.)
- prodhimin e konstruksioneve industriale në metale (skeletet e furnaltave, ashensorët, pajisje të manovrimit, etj)
- prodhimin e konstruksioneve parafabrikat të ndërtesave kryesisht prej metali:
 - kantiere, elementet e lëvizshme të ekspozitave etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pjesëve për flotat detare dhe bolierët, shih 25.30
- prodhimin e oredivave të fiksuara të montuara në vagonët e hekurudhave, shih 25.99
- prodhimin e seksioneve të anijeve, shih 30.11

25.12 Prodhimi i dyerve dhe dritareve metalike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e dyerve metalike, dritareve dhe skeletet e tyre, qepenëve dhe kangjellave
- ndarjen e dhomave metalike për shtojcat e apartamenteve

25.2 Prodhimi i çisternave, rezervuareve dhe mbajtësve prej metali

Ky grup përfshin prodhimin e çisternave, radiatorëve të ngrohjes qendrore dhe bolierëve.

25.21 Prodhimi i radiatorëve dhe bolierëve për ngrohje qendrore

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e furrave elektrike dhe ngrohësve të ujit

25.29 Prodhimi i çisternave të tjera, rezervuarëve dhe mbajtësve prej metali

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e rezervuarëve, çisternave dhe mbajtësve të ngjashëm prej metali, të tipeve normale të instaluar si pajisje fikse për magazinim ose për tu përdorur në përpunim të mëtejshëm.
- përpunimin e mbajtësve metalike për gaze të kompresuar ose të lëngëzuar

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e fuçive metalike, të cilindrave, bidonave, kovave, kutive etj të një lloji të përdorur për transportim dhe paketimin e mallrave, në një kapacitet i cili nuk tejkalon 300 litra, shih 25.91, 25.92
- prodhimin e kontenierëve për transport, shih 29.20
- prodhimin e çisternave (mjete ushtarake të blinduara), shih 30.40

25.3 Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç bolierëve me ujë të ngrohtë për ngrohje qendrore

Ky grup përfshin prodhimin e gjeneratorëve të avullit.

25.30 Prodhimi i gjeneratorëve të avullit, përveç bolierëve me ujë të ngrohtë për ngrohje qendrore

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e gjeneratorëve të avullit ose të tipeve të tjerë të gjeneratorëve
- prodhimin e aparateve të tjerë ndihmës për përdorim me gjeneratorë avulli:
 - kondensatorët, ekonomizatorët, mbigrohësat, kolektorët e avullit dhe akumulatorët
- prodhimin e reaktorëve nuklearë, përveç ndarjeve izotope
- prodhimin e pjesëve për fuqinë elektrike të bolierëve të flotave detare

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve që përmbledh një trajtim suplementar të tubave në mënyrë që të realizojnë kryesisht kanalizimin ose rrjetin nën presion, si dhe punimet plotësuese të konceptimit dhe të montimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e bolierëve dhe radiatorëve me ujë të ngrohtë për ngrohje qendrore, shih 25.21
- prodhimin e kompletit të turbinave të bolierëve, shih 28.11
- prodhimin e ndarësve të izotopeve, shih 28.99

25.4 Prodhimi i armëve dhe municioneve**25.40 Prodhimi i armëve dhe municioneve**

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e armëve të rënda (artilери, pushkë të lëvizshme, mekanizëm i lëshimit të raketave, tubat e silurëve, makineritë e armëve të rënda)
- prodhimin e armëve të vogla (revolver, pushkë gjahu, makineritë e armëve të lehta)
- prodhimin e armëve me gaz ose me ajër dhe pistoletave
- prodhimin e municioneve të luftës

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e armëve të zjarrit për gjueti, sportive ose ruajtëse dhe municioneve
- prodhimin e derivateve të eksplozivëve si bomba, mina dhe silura

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e kapsollave goditëse, detonatore ose sinjalizuese, shih 20.51
- prodhimin e thikave, shpatave dhe bajonetave etj, shih 25.71
- prodhimin e mjeteve të blinduara për transportimin e bankënotave ose sendeve të çmuara, shih 29.10
- prodhimin e mjeteve të hapësirës, shih 30.30
- prodhimin e tankeve dhe mjete të tjera luftuese, shih 30.40

25.5 Farkëtimi, kovaçana, stampimi dhe trafilizimi i metaleve, pluhuri metalurgjik

Ky grup përfshin aktivitete të përgjithshme për trajtimin e metaleve, siç janë farkëtimi dhe presimi, të cilët në mënyrë tipike kryhen me ndërmjetësime.

25.50 Farkëtimi, kovaçana, stampimi dhe petëzimi, pluhuri metalurgjik

Kjo klasë përfshin:

- farkëtimin, presimin, stampimin dhe trafilizimin e metaleve
- pluhuri metalurgjik: prodhimin e objekteve metalike direkt nga pluhuri metalik sipas trajtimit në të nxehtë (skorje) ose nën presion

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pluhurit të metaleve, shih 24.1, 24.4

25.6 Makineritë; trajtimi dhe veshja e metaleve

Ky grup përfshin aktivitete të përgjithshme për trajtimin e metaleve, si shtresë mbulimi, veshja, gdhendje, shpimi, shkëlqimi, saldimi etj, të cilët në mënyrë tipike kryhen me ndërmjetësime.

25.61 Trajtimi dhe veshja e metaleve

Kjo klasë përfshin:

- veshjen metalike, trajtimi anodik etj, i metaleve
- trajtimin në të nxehtë i metaleve
- axhustimin, pastrimin nga rëra, thyerjen dhe pastrimin e metaleve
- ngjyrosjen, gravura e metaleve
- veshjen jo-metalike të metaleve:
 - plastifikimi, emalimi, llakimi etj.
- forcimin, goditjen e metaleve

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e kovaçanës, shih 01.62
- shpimet mes metaleve, shih 18.12
- veshjen e metaleve me plastik, shih 22.29
- bashkimin e metaleve të çmuar të petëzuar mbi metale bazë ose metale të tjera, shih 24.41, 24.42, 24.43, 24.44
- shërbimet e graviturës “nderkohë që pret”, shih 95.29

25.62 Instrumentat

Kjo klasë përfshin:

- shpimin, kthimin, thyerjen, vënien në funksionim, planizimin, drejtimin, sharimin, derdhjen, mprehjen, saldimin etj, e pjesëve metalpunuese
- prerjen e metaleve dhe shkrimin mbi metale nga mjete me lazer

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e kovaçanës, shih 01.62

25.7 Prodhimi i thikave për makina, veglave dhe pajisje të përgjithshme metalikë

Ky grup përfshin takëmet, veglat metalike të dorës dhe pajisje metalike të përgjithshme.

25.71 Prodhimi i thikave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e takëme shtëpiake si thika, pirunj, lugë, etj
- prodhimin e artikujve të tjerë të enëve shtëpiake:
 - hanxhar dhe satëre
 - brisqe dhe brisqe rroje
 - gërshtë dhe gërshtë për flokë
- prodhimin e thikave, shpatave, bajonetave etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e artikujve (tenxhere, çajnik, etj), servis darke (supiera, pjata, etj) ose servis filxhanesh (tabaka, filxhane, komplet filxhane, etj), shih 25.99
- prodhimin e thikave prej metali të çmuar, shih 32.12

25.72 Prodhimi i kyçeve dhe menteshave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kyçeve, çelësave, menteshave, shulave e të tjera të tilla, për ndërtesa, mobilje, mjete transporti, etj

25.73 Prodhimi i veglave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e thikave dhe tehë prerës për makineri ose paisje mekanike
- prodhimin e veglave të dorës si pinca, darë, turjela, etj.
- prodhimin e veglave të dorës për bujqësinë pa përdorur fuqinë
- prodhimin e sharrës dhe teheve të sharrës, duke përfshirë tehet e sharrës rrethore dhe sharra zinxhir
- prodhimin e pjesëve të zëvendësueshme për pajisjet që funksionojnë me dorë, mekanike ose jo, makinat mjete: pistoleta shpuese, stampuese
- prodhimin e veglave të presave
- prodhimin e mjeteve të farkëtuesit: forzhe, kudhër, etj
- prodhimin e kutive të modeluara dhe modeleve (përveç moduleve të lingotave)
- prodhimin e presave, morsetave

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e veglave të dorës me përdorim fuqie, shih 28.24
- prodhimin e moduleve të lingotave, shih 28.91

25.9 Prodhimi i produkteve të tjera metalike të fabrikuara

Ky grup përfshin prodhimin e produkteve metalikë të ndryshme, si kova, gozhdë; sita dhe kullesa; artikuj shtëpiakë prej metali; orendi metalike; helikat dhe ankorat e anijeve; pajisje të montuara në shinat hekurudhore etj për përdorime të ndryshme industriale dhe shtëpiake.

25.91 Prodhimi i kovave me çikrik prej çeliku dhe mbajtës të tjerë të ngjashëm

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kovave, kutive, kovë eskavatori, etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e çisternave dhe rezervuarëve, shih 25.2

25.92 Prodhimi i ambalazheve prej metali të lehtë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kanaçeve dhe kutive për konserva për produkte ushqimore, tuba dhe kuti të palosshme.
- prodhimin e kyçeve metalik

25.93 Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe sustë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kablove metalike, manshetave metalike dhe artikuj të ngjashëm
- prodhimin e kablove metalike të painstaluara ose kablo të instaluara të paaftë për tu përdorur si konduktore elektrik
- prodhimin e gozhdëve dhe thumbave
- prodhimin e artikujve prej teli: tel kabllor, tel përthurje, grila, rrjeta, pëlhura etj
- prodhimin e sustave, (përveç sustave të orëve):
 - susta metalike, sustë helikoidale, susta të përdredhura
 - pllaka për susta
- prodhimin e zinxhirëve, përveç zinxhirëve të transmetimit të fuqisë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e sustave për orë dhe orë muri, shih 26.52
- prodhimin e telave dhe kablove për transmetimin e energjisë elektrike, shih 27.32
- prodhimin e zinxhirëve për transmetimin e fuqisë (energjisë), shih 28.15

25.94 Prodhimi i dadove dhe bullonave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e vidave, rondeleve dhe produkte të ngjashëm të pa ndërprera
- prodhimin e dadove për makina
- prodhimin e bulonave, dadove, dhe produkte të ngjashme të ndërprera

25.99 Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e takëmeve metalikë:
 - pjata të sheshta: pllaka, pjata filxhani etj.
 - takëme: tenxhere, ibrikë, etj.
 - takëme darke: supiere, pjatë e madhe, etj.

- tigan i thellë, tavë dhe të tjera enë kuzhine për përdorim në tavolinë apo në kuzhinë
- pajisje dhe pajisje ndihmëse të vogla kuzhine
- shparcë metalike për të fërkuar enët
- prodhimin e mjeteve me përbërës zinku:
 - prodhimin e vaskave, lavamanëve, lavapjatëve dhe artikuj të ngjashëm
- përpunimin e metaleve për përdorim zyrtar pa përfshirë mobiljet
- prodhimin e kasafortave, kutiave të forta, dyer të blinduara etj
- prodhimin e artikujve metalikë të ndryshëm:
 - helikë anije dhe thikat për këtë
 - ankorat
 - kambanat
 - paisje fikse të montuara për hekurudha
 - çengel, kapëse, kanxhë
- çanta prej letër varaku
- prodhimin e magnetëve metalikë për permanent
- prodhimin e shisheve dhe brokeve me vakum metalikë
- prodhimin e shenjave dalluese metalike dhe distinktiveve ushtarake metalike
- prodhimin e bigutinave metalike për flokë, skeleti dhe bishti metalik i çadrës, krehër

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e shpatave, bajonetave, shih 25.71
- prodhimin e kartave të dyqaneve, shih 30.99
- prodhimin e mobiljeve metalike, shih 31.01, 31.02, 31.09
- prodhimin e pajisjeve sportive, shih 32.30
- prodhimin e lodrave dhe lojrave, shih 32.40

26 Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë

Kjo ndarje përfshin prodhimin e kompjuterave, periferinë e kompjuterave, pajisjet e komunikimit dhe produkte elektronike të ngjashme, si dhe prodhimin e përbërësve për këto produkte. Proceset e prodhimit të kësaj ndarje janë karakterizuar nga skicimi dhe përdorimi i qarqeve të integruara dhe përdorimi i teknologjisë së lartë të minimizuar të specializuar. Kjo ndarje gjithashtu përmban prodhimin e elektronikës përdoruese, matëse, testuese, pajisjet naviguese dhe të kontrollit, pajisjet ndriçuese, elektromjekësore dhe elektroterapike, pajisjet dhe instrumentet optike dhe prodhimin e medias magnetike dhe optike.

26.1 Prodhimi i përbërësve elektronik

26.11 Prodhimi i bazamentëve elektronikë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kapacitoreve, elektronike
- prodhimin e rezistencave, elektronike
- prodhimin e mikroproçesoreve
- prodhimin e tubave elektrike
- prodhimin e lidhsave elektrike
- prodhimin e mbajtësve të qarkut printues
- prodhimin e qarqeve të përbërë (analoge, dixhitale ose hibride)
- prodhimin e diodave, transistoreve, pajisjet diskrete të lidhura
- prodhimin e induktorëve (psh chokes, coils, transformatore), përbërësit elektronik të këtyre tipave
- prodhimin e kristaleve elektronike dhe bashkimeve kristalore
- prodhimin e solonoideve, mbyllësve dhe kaluesve të aplikimeve elektronike
- prodhimin e gjysmëpërçuesit, të përfunduar ose gjysmë të përfunduar
- prodhimin e komponenteve të ekraneve (plazma, polimere dhe LCD)
- prodhimin e diodave për tejçimin e dritës (LED)

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e kablllove të printerave, kablllove të monitoreve, kablllove të USB, lidhsave etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- printimin e kartave smart, shih 18.12
- prodhimin e ekraneve të kompjuterave ose televizoreve, shih 26.20, 26.40
- prodhimin e modemave (pajisjet mbajtëse), shih 26.30
- prodhimin e tubave me rreze X dhe pajisje të ngjashme irradiante, shih 26.60
- prodhimin e pajisjeve dhe instrumentave optike, shih 26.70
- prodhimin e lidhjeve të ngjashme për aplikime elektrike, shih ndarjen 27
- prodhimin e balestrave fluorishente, 27.11
- prodhimin e lidhjeve elektrike, shih 27.12
- prodhimin e kaluesve elektrike, shih 27.33
- prodhimin e pajisjeve komplete, duke u bazuar në klasifikimin komplet të këtyre pajisjeve

26.12 Prodhimi i mbajtësve elektronike të ngarkuar

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mbajtësve të qarqeve të ngarkuara të printuara
- ngarkimin e përbërësve nëpërmjet mbajtësve të qarkut të printuar
- prodhimin e kartave sipërfaqësore (psh zanore, video, kontrollor, rrjeti, modem)

Kjo klasë nuk përfshin:

- printimin e kartave smart, shih 18.2
- prodhimin e mbajtësve të qarkut rrethor, shih 26.11

26.2 Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike

26.20 Prodhimi i kompjuterave dhe pjesëve periferike

Kjo klasë përfshin prodhimin dhe/ose montimin e kompjuterave elektronikë, si skeleti kryesor, kompjuterat desktop, laptopët dhe serverat e kompjuterave dhe pajisjet periferike të tyre si aparatet e magazinimit dhe aparatet e hyrje-daljeve (printera, monitorët, tastierat). Kompjuterat mund të jenë analogë, dixhital ose hibrid. Kompjuterat dixhital, tipi më shumë i përhapur, janë pajisje që bëjnë të gjitha veprimet e mëposhtme:

(1) magazinimin e programit ose programeve të përpunuara dhe nevojën e domosdoshme për të dhëna për tu ekzekutuar një program; (2) mund të jenë programuar në varësi me kërkesat e përdoruesve; (3) kryen veprime matematike të specifikuara sipas përdoruesve; dhe (4) kryen pa ndërhyrjen njerëzore një program përpunimi që i kërkoet kompjuterit të modifikojë ekzekutimin e tij sipas vendimit llogjik gjatë kryerjes së përpunimit. Kompjuterat analogë janë kabllorë për të stimuluar modelet matematikore dhe përfshihen në listën e kontrolleve analoge dhe elementët e programimit.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kompjuterave desktop
- prodhimin e kompjuterave laptop
- prodhimin e skemës kryesore të kompjuterave
- prodhimin e kompjuterave të dorës (si PDA)
- prodhimin e transmetimit të diskut manjetik, transmetimi i shpejtë dhe aparatura të tjera magazinimi
- prodhimin e transmetimit të diskut optik (si CD-RW, CD-ROM, DVD-ROM, DVD-RW)
- prodhimin e printerave
- prodhimin e monitorëve
- prodhimin e tastierave
- prodhimin e të gjitha tipeve të mausit, dorezat dhe pajisje të tjera trackball
- prodhimin e terminaleve të përshtatshme për kompjuter
- prodhimin e serverit të kompjuterit

- prodhimin e skanerit, duke përfshirë skanerat e koduar
- prodhimin e lexuesve të kartave smart
- prodhimin e mbrojtëseve të realitetit virtual
- prodhimin e projektorëve të kompjuterave (video beamers)

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e terminaleve të kompjuterave, terminale si makinat treguese automatike, (ATM's), pikat e shitjes (POS), që nuk veprojnë mekanikisht

Kjo klasë nuk përfshin:

- riprodhimin e medias së regjistruar (kompjuter, zëri, video etj.), shih 18.20
- prodhimin e komponentëve elektronikë dhe montimet elektronike përdorur në kompjuterat dhe periferitë, shih 26.12
- prodhimin e modem të kompjuterave të brendshëm dhe të jashtëm, shih 26.12
- prodhimin e kartave interface, modulet dhe montimet, shih 26.12
- prodhimin e modem, pajisjet transportuese, shih 26.30
- prodhimin e switch komunikimeve dixhitale, pajisje të komunikimit të të dhënave (si urat, rrugë, porta), shih 26.30
- prodhimin e aparateve elektronikë dhe përdorues, si lojrat CD dhe lojrat DVD, shih 26.40
- prodhimin e monitorëve dhe ekraneve, shih 26.40
- prodhimin e paneleve të komandimit të lojrave video, shih 26.40
- prodhimin e xhamit të zi dhe media manjetike për tu përdorur me kompjuterat dhe pajisje të tjera, shih 26.80

26.3 Prodhimi i pajisjeve të komunikimit

26.30 Prodhimi i pajisjeve të komunikimit

Kjo klasë përfshin prodhimin e telefonave dhe pajisjet e komunikimit të të dhënave që përdoren për të lëvizur sinjalet elektronike nëpërmjet telit ose nëpërmjet ajrit si transmetimet e radios dhe televizionit dhe pajisjet e komunikimit pa tel.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pajisjeve switch qendrore
- prodhimin e telefonave pa fije
- prodhimin e pajisjeve të ndërrimit të krahut (PBX)
- prodhimin e pajisjeve të telefonave dhe faksimileve, duke përfshirë makineritë telefonat autopërgjegjes
- prodhimin e pajisjeve të komunikimit të të dhënave, si urat, rrugët dhe portat
- prodhimin e antenave transmetuese dhe marrëse
- prodhimin e pajisjeve të televizioneve kabllore
- prodhimin e sinjaleve (biper)
- prodhimin e telefonave celular
- prodhimin e pajisjeve të komunikimit me celular
- prodhimin e pajisjeve të transmetimit dhe studios së radio dhe televizionit, duke përfshirë kamerat televizive
- prodhimin e modem, pajisjet transportuese të sinjalit
- prodhimin e modem të kompjuterit hyrje/dalje
- prodhimin e sistemeve të alarmit kundra zjarrit dhe vjedhjes, që dërgojnë sinjale tek stacioni i kontrollit
- prodhimin e studiove të radios dhe televizionit dhe pajisjet broadcast përfshirë edhe kamerat televizive
- prodhimin e transmetuesve të radios dhe televizionit
- prodhimin e aparaturave infra të kuqe (si kontrollet e largësisë)

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e komponentëve elektronik dhe të nënsinjaleve të përdorura në pajisjet e komunikimit, përfshirë modem të kompjuterit të brendshëm apo të jashtëm, shih 26.1

- prodhimin e mbajtësve elektronike të loduar, shih 26.12
- prodhimin e pajisjeve periferike të kompjuterit dhe kompjuterave, shih 26.20
- prodhimin e pajisjeve audio dhe video për konsumatorët, shih 26.40
- prodhimin e pajisjeve GPS, shih 26.51
- prodhimin e scoreboards, shih 27.90
- prodhimin e ndriçuesëve të trafikut, shih 27.90

26.4 Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët

26.40 Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët

Kjo klasë përfshin prodhimin e pajisjeve elektronike audio dhe video për dëfrime familjare, automjete, sistemet e adresave publike dhe amplifikimin e instrumentave muzikorë.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e regjistruësve video kasetë dhe pajisjet e dublikimit
- prodhimin e televizioneve
- prodhimin e ekraneve dhe monitorëve të televizionit
- prodhimin e sistemeve audioregjistruese dhe dublikimeve
- prodhimin e pajisjeve të riprodhimeve stereofonike
- prodhimin e radio marrësve
- prodhimin e sistemeve folëse
- prodhimin e video kamerave të tipit familjar
- prodhimin e gramafonëve me monedhë
- prodhimin e amplifikatorëve për instrumenta muzikore dhe sistemet e adresave publike
- prodhimin e mikrofoneve
- prodhimin e aparateve për CD dhe DVD (players)
- prodhimin e makinave karaoke
- prodhimin e radio, stereo, kompjuter që përdoren në kompjuter
- prodhimin e panelëve të komandimit të lojrave

Kjo klasë nuk përfshin:

- riprodhimin e medias së regjistruar (media kompjuter, zëri, video, etj.), shih 18.2
- prodhimin e pajisjeve periferike të kompjuterit dhe monitorët e kompjuterit, shih 26.20
- prodhimin e telefonave autopërgjegjës, shih 26.30
- prodhimin e pajisjeve sinjalizuese (biper), shih 26.30
- prodhimin e pajisjeve kontrolluese (radio dhe infra të kuqe), shih 26.30
- prodhimin e pajisjeve të studiove transmetuese si pajisje të riprodhimit dhe antenat e transmetimit dhe marrëse, kamerat video tregtare, shih 26.30
- prodhimin e antenave, shih 26.30
- prodhimin e kamerave dixhitale, shih 26.70
- prodhimin e lojrave elektronike me software të fiksuar (pa i zënë vendin), shih 32.40

26.5 Prodhimi i pajisjeve të matjes, testimit, verifikimit dhe kontrollit të orëve dhe orëve të murit

Ky grup përfshin aparatet matëse, testuese, verifikuese dhe kontrolluese për qëllime të ndryshme industriale apo joindustriale, duke përfshirë pajisjet matëse bazë të kohës si orët dhe orët e murit dhe pajisjet e lidhura me to.

26.51 Prodhimi i instrumentave dhe aparateve për matje, verifikim, kontrolle

Kjo klasë përfshin prodhimin e sistemeve dhe instrumenteve të kërkimit, zbulimit, verifikimit, drejtim, aeronautikës dhe nautikës, kontrollet automatike dhe rregullatorët automatik për aplikim, si ngrohëse, ajër-kondicioner, ftohës dhe pajisje, instrumentet dhe aparatet për matje, ekspozime, treguese, regjistruese, transmetuese dhe matjen e temperaturës, lagështirës, presionit, vakumit, oksidimit, shpejtësisë, nivelit, viskozitetit, densitetit, aciditetit, koncentrimin dhe rotacionin, aparate të regjistrimit të basteve, (si regjistrim), sahatët e matjes dhe aparatet llogaritës, instrumentet për matjen dhe testimin e karaktersitikave të energjisë elektrike dhe sinjaleve

elektrike, instrumentet dhe sistemet instrumentuese për analizat laboratorike të kompozimeve ose koncentrimave fizike dhe kimike të modeleve të ngurta, lëngëta, gazta dhe materiale të përziera, instrumenta matëse dhe testuese dhe pjesë të tyre. Prodhimi i pajisjeve matëse, testuese dhe verifikuese jo elektrike (përveç veglave mekanike të thjeshta) përfshihet këtu.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e instrumentave të motorit të avionëve
- prodhimin e pajisjeve testuese të emetimeve vetëlëvizëse
- prodhimin e instrumentave meteorologjike
- prodhimin e pajisjeve të testimit dhe inspektimit të vetive fizike
- prodhimin e makinerive poligrafike
- prodhimin e instrumentave monitoruese dhe zbuluese të rezatimit
- prodhimin e instrumentave të vrojtimit
- prodhimin e termometrave të tipeve me lëng në gotë dhe bimetalik (përveç mjekësorit)
- prodhimin e lagështimatësve
- prodhimin e kontolleve limite hidro ujore
- prodhimin e aparateve të kontrollit të zjarrit
- prodhimin e spektometrave
- prodhimin e kalibrave pneumatik
- prodhimin e sahatëve të konsumit (si ujë, gaz etj)
- prodhimin e sahatëve të shpejtësisë dhe aparatet e numërimit
- prodhimin e numëruesve të biletave
- prodhimin e detektorëve të minave, gjeneratorët sinjalizuese, detektorët metalikë
- prodhimin e pajisjeve të kërkimit, verifikimit, aeronautikës dhe nautikës
- prodhimin e pajisjeve të radarëve
- prodhimin e pajisjeve GPS
- prodhimin e kontroleve të ambjentit dhe kontroleve automatike për pajisjet
- prodhimin e pajisjeve matëse dhe regjistruese (si regjistrueset e fluturimeve)
- prodhimin e detektorëve vepruese
- prodhimin e radarëve
- prodhimin e instrumentave analitike të laboratorëve (si pajisjet e analizave të gjakut)
- prodhimin e shkallës laboratorike, peshore, inkubator dhe aparate të ndryshme laboratorike për matje, testim, etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e telefonave auto përgjegjës, shih 26.30
- prodhimin e pajisjeve të rrezatimeve dhe testimeve mjekësore, shih 26.60
- prodhimin e pajisjeve optike të pozicionuara, shih 26.70
- prodhimin e makinave diktuese, shih 28.23
- prodhimin e aparateve peshuese (me përjashtim të peshoreve laboratorikë), të matjes së niveleve, etj., shih 28.29
- prodhimin e termometrave mjekësore, shih 32.50
- instalimi i pajisjeve të kontrollit të procesit industrial, shih 33.20
- prodhimin e veglave matëse mekanike të thjeshta (si shiritat matës, kalibrat), shih prodhimin e klasave në varësi të materialit kryesor të përdorur

26.52 Prodhimi i orëve dhe orëve të murit

Kjo klasë përfshin prodhimin e orëve, orëve të murit, mekanizmat dhe pjesët e tyre.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e orëve dhe orëve të murit të të gjitha llojeve, duke përfshirë instrumentet e paneleve të orëve
- prodhimin e kutive të orëve dhe orëve të murit, duke përfshirë kutitë e metaleve të çmuara
- prodhimin e pajisjeve regjistruese të kohës dhe pajisjeve për matje, të regjistrimit dhe intervaleve të kohës me orë ose orë muri lëvizëse ose me motor sinkronik si:

- sahatët e parkingëve
 - orët e kohës
 - stampat kohë/datë
 - matësit e proçeseve
- prodhimin e suiçeve të kohës dhe të tjera që lidhen me një orë, një orë muri ose motorr sinkronik:
 - time locks
 - prodhimin e komponentëve për orët e murit dhe orët:
 - pjesët lëvizëse të të gjitha llojeve për orët dhe orët e murit:
 - zemrekë, susta, gurë, fusha, gjilpëra, byzylykë të orëve metalike, ura dhe pjesë të tjera
 - kutitë dhe karkasat e orëve dhe orët e murit të të gjitha materialeve

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e bazamenteve të orëve jo metalike (tekstile, lëkurë, plastik), shih 15.12
- prodhimin e bazamentit të orëve prej metali të çmuar, shih 32.12
- prodhimin e bazamentit të orëve prej metali jo të çmuar, shih 32.13

26.6 Prodhimi i pajisjeve rrezatuese, elektromjekësore dhe elektroterapiste

26.60 Prodhimi i pajisjeve rrezatuese, elektromjekësore dhe elektroterapiste

Kjo klasë përfshin prodhimin e aparateve elektromjekësore dhe elektroterapiste si pajisjet e imazhit të rezonancës manjetike, pajisjet ultrazonore mjekësore, stimuluesit kardiak, aparatet e ndihmës së dëgjimit, elektrokardiogramet dhe pajisjet endoskopike elektromjekësore dhe prodhimin e aparateve rrezatuese dhe tub për zbatim si diagnozat mjekësore, terapitë mjekësore, industriale, kërkimore dhe evolucioni shkencore. Rrezatimet mund të merren në formën e rrezeve-Beta, rreze-gama, rreze-X ose rrezatime të tjera jonizuese.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e aparateve dhe tubeve të rrezatimeve (si industriale, diagnozat mjekësore, terapitë mjekësore, kërkimore, shkencore)
- prodhimin e pajisjeve të rrezeve X
- prodhimin e skanerit CT
- prodhimin e skanerit PET
- prodhimin e pajisjeve MRI
- prodhimin e pajisjeve mjekësore me ultratinguj
- prodhimin e pajisjeve mjekësore elektrokardiograf
- prodhimin e pajisjeve mjekësore endoskopike
- prodhimin e pajisjeve mjekësore lazer
- prodhimin e pajisjeve mjekësore stimulator kardiak
- prodhimin e pajisjeve mjekësore për dëgjim

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e aparateve të rrezatimit të ushqimeve dhe qumështit

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e bankave solare, shih 28.99

26.7 Prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve optike

26.70 Prodhimi i instrumentave dhe pajisjeve optike

Kjo klasë përfshin prodhimin e instrumentave dhe lenteve optike, si binokularët, mikroskopikët, (përveç elektron, proton), teleskopët, prizma dhe lentet (përveç të syrit); mbulimin dhe shkëlqimin (përveç të syrit) vendosja e lenteve (përveç të syrit) dhe prodhimin e pajisjeve fotografike si kamerat dhe aparatet fotografikë.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pasqyrave optike
- prodhimin e pajisjeve optike të shikimit të pushkës
- prodhimin e pajisjeve optike pozicionuese
- prodhimin e instrumentave optike zmadhues
- prodhimin e veglave optike të precizionit të makinistëve
- prodhimin e komparatoreve optike
- prodhimin e kamerave (optike dhe dixhitale)
- prodhimin e pikturave lëvizëse dhe projektorët
- prodhimin e projektorëve diapozitiv të varur
- prodhimin e aparateve dhe instrumentave optike të matjes dhe kontrollit (si pajisjet e kontrollit të zjarrit, aparatet e lehtë fotografik)
- prodhimin e lenteve, mikroskopët optikë, binokularët dhe teleskopët
- prodhimin e aparateve lazer

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e projektorëve të kompjuterave, shih 26.20
- prodhimin e video kamera dhe TV tregtare, shih 26.30
- prodhimin e video kamera të përdorimit familjar, shih 26.40
- prodhimin e pajisjeve komplet duke përdorur përbërësit lazer, shih klasën e prodhimi sipas tipit të makinerive (si pajisje lazer mjekësore, shih 26.60)
- prodhimin e makinerive fotokopje, shih 28.23
- prodhimin e artikujve të shikimit, shih 32.50

26.8 Prodhimi i mjeteve të komunikimit optike dhe manjetike

26.80 Prodhimi i mjeteve të komunikimit optike dhe manjetike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mjeteve të regjistrimit optik dhe manjetik, si kasetat dhe manjetofonët, disketat e zeza, disqet e zi optik dhe hard drive media.

Kjo klasë nuk përfshin:

- riprodhimin e rekordeve të regjistruara (regjistrimi kompjuterik, zërit, figurës etj), shih 18.2

27 Prodhimi i paisjeve elektrike

Kjo ndarje përfshin prodhimin e produkteve që gjenerojnë, shpërndajnë dhe përdorin fuqinë elektrike. Gjithashtu, këtu përfshihet ndriçimi elektrik, paisjet e sinjalizimit, dhe paisjet shtëpiake elektrike.

Kjo ndarje nuk përfshin prodhimin e produkteve elektronikë (shih ndarja 26).

27.1 Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve, transformatorëve dhe shpërndarësve të energjisë elektrike dhe aparaturave të kontrollit

Ky grup përmban prodhimin e fuqisë, shpërndarjen dhe transformatorët specialë; motorrët elektrikë, gjeneratorët dhe kompletet e motorit të gjeneratorit.

27.11 Prodhimi i motorëve elektrikë, gjeneratorëve dhe transformatorëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e motorëve elektrik
- prodhimin e transformatorëve elektrikë të shpërndarjes
- prodhimin e balestrave fluoreshente (si transformator)
- prodhimin e transformatorëve të nënstacioneve për shpërndarjen e energjisë elektrike
- prodhimin e rregullatorëve të tensionit për transmetimin dhe shpërndarjen

- prodhimin e gjeneratorëve të fuqisë (përveç gjeneratorëve me rrymë të alternuar për motorët me djegje të brendshme)
- prodhimin e paisjeve për motor gjeneratorët (përveç njërive të paisjes së turbinave të gjeneratorit)
- ribobinazhim i rotorit në linjë industriale

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e transformatorëve dhe ndryshuesave me përbërës të tipit elektronik, shih 26.12
- prodhimin e paisjeve me ngjitje dhe saldime elektrike, shih 27.90
- prodhimin e këmbyesve statik të fortë, ndreqës dhe konvertues, shih 27.90
- prodhimin e turbinave të gjeneratorëve, shih 28.11
- prodhimin e motorëve dhe gjeneratorëve për përdorim me djegje të brendshme, shih 29.31

27.12 Prodhimi i aparaturave të shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e aparaturave për këputjen
- prodhimin e paneleve të kontrollit për shpërndarjen e energjisë elektrike
- prodhimin e releve elektrike
- prodhimin e aparateve të tabelave elektrike
- prodhimin e siguresave elektrike
- prodhimin e paisjeve të ndryshimit të energjisë
- prodhimin e ndryshuesave të energjisë elektrike (përveç butonëve automatik, hapësat, solenoid, tambur)
- prodhimin e gjeneratorëve të lëvizjes primare

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e instrumentave të kontrollit të proceseve industriale dhe kontrollet rrethuese, shih 26.51
- prodhimin e ndryshuesave për qarkun elektrik si butonët automatik dhe ndryshesat snap, shih 27.33

27.2 Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve

27.20 Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve

Kjo klasë përfshin prodhimin e baterive jo-riimbushëse dhe riimbushëse.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pilave primare dhe baterive të pilave
 - pila përmban dioksid magnez, dioksid mercuri, oksid argjendi, etj
- prodhimin e akumulatorëve elektrikë, duke përfshirë dhe pjesë prej tyre:
 - separatorët, mbajtësit, mbështjellëset
- prodhimin e baterive me acid plumbi
- prodhimin e baterive prej NiCad
- prodhimin e baterive NiMH
- prodhimin e baterive me litium
- prodhimin e baterive me pilë të thatë
- prodhimin e baterive me pilë të njomë

27.3 Prodhimi i telave dhe kablllove të izoluar

Ky grup përfshin prodhimin e kablllove të transmetimit të rrymës elektrike dhe jo të transmetimit të rrymës elektrike për qarkullimin e energjisë elektrike prej çfarodo materiali. Ky grup gjithashtu përfshin instalimin e metaleve dhe prodhimin e kablllove të fibrave optike.

27.31 Prodhimi i kablllove të fibrave optikë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e kablllove të fibrave optikë për transmetimin e të dhënave ose transmetimin direkt të imazheve

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e fibrave të xhamit ose flokut, shih 23.14
- prodhimin e kablllove optikë ku janë vendosur ose montuar konektor apo bashkues të tjerë, shih në varësi të zbatimit, si 26.11

27.32 Prodhimi i telave dhe kablllove të tjerë elektrike dhe elektronikë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e telave dhe kablllove izolues prej çeliku, bakri, alumini

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e telave, shih 24.34, 24.41, 24.42, 24.43, 24.44, 24.45
- prodhimin e kablllove të kompjuterave, kablllove të printerave, kabllot USB dhe kablllo të vendosur ose të montuar të ngjashëm, shih 26.11
- prodhimin e kordave elektrike me tela dhe bashkues izolues, shih 27.90
- prodhimin e kablllove, tela mbrojtës dhe kablllo të ngjashëm të vendosur apo montuar në përdorimin e automjeteve, shih 29.31

27.33 Prodhimi i telave transmetues

Kjo klasë përfshin prodhimin e telave prej çfardo materiali që transmetojnë rrymë ose që nuk transmetojnë rrymë të cilat realizojnë qarkullimin e rrymës elektrike.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e përpunimit e shufrave bus, përcjellësve elektrikë (përveç tipit të mekanizmit të ndryshimit)
- prodhimin e GFCI (ndërprerësit e defekteve të qarkut tokësor)
- prodhimin e portollambës
- prodhimin e qarqeve dhe bobinave
- prodhimin e ndryshuesave të energjisë me tela elektrikë (si me shtypje, automatike, tambur etj)
- prodhimin e prizave dhe çelsave elektrikë
- prodhimin e kutive për shpërndarjen e telave (si bashkim, priza, kutitë e switch)
- prodhimin e tubave dhe paisjeve elektrike
- prodhimin e shtyllave të transmetimit dhe linjave të rënda
- prodhimin e transmetuesve të rrymës jo elektrike dhe duke përfshirë kutitë e shpërndarjes plastike, pllakat dhe të ngjashme, tubat plastikë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e izolatorëve qeramikë, shih 23.43
- prodhimin e konektorëve të tipit-përbërës elektronik, shih 26.11

27.4 Prodhimi i paisjeve elektrike të ndriçimit**27.40 Prodhimi i paisjeve elektrike të ndriçimit**

Kjo klasë përfshin prodhimin e paisjeve elektrike të ndriçimit si llampa dhe tuba, dhe pjesët dhe përbërësit, (përveç hapësirës së qelqit për llampat ndriçuese elektrike); instalimet elektrike të ndriçuesve (përveç atyre të automjeteve); paisjet joelektrike të ndriçimit dhe përbërësit e instalimeve të ndriçuesve (përveç mekanizmit të telave që transmetojnë rrymë).

Në këtë klasë përfshihet gjithashtu dhe prodhimi i paisjeve joelektrike të ndriçimit.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e llampave dhe tubave elektrikë, inkadeshent, fluoreshentë, ultra-violet, infra-të kuqe, etj
- prodhimin e tubave të ndriçimit në lartësi
- prodhimin e llampadarëve
- prodhimin e llampave të tabelave (si tubat ndriçues)
- prodhimin e llampushkave të pemës së krishtlindjeve
- prodhimin e ndriçuesave të vatrave elektrike
- prodhimin e llampave sinjalizuese
- prodhimin e llampave elektrike në formë insekti
- prodhimin e fanarëve (me karabit, elektrike, gaz, naftë, vajguri)
- prodhimin e prozhektorëve (përveç të automjeteve)
- prodhimin e tubave të ndriçimit të rrugëve (përveç sinjaleve të trafikut)
- prodhimin e paisjeve të ndriçimit për transportimin e paisjeve (si për automjete, avionë)

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e paisjeve të ndriçimit jo elektrikë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e qelqeve dhe pjesëve të qelqit për tubat e ndriçimit, shih 23.19
- prodhimin e paisjeve të transmetimit të rrymave elektrike për tubat e ndriçimit, shih 27.33
- prodhimin e plafonierëve ventilatorë ose të ventilatorëve të banjove me ndriçim të integruar, shih 27.51
- prodhimin e paisjeve sinjalizuese elektrike si ndriçuesit e trafikut dhe paisjet e ndriçimit të këmbësorëve, shih 27.90
- prodhimin e shenjave elektrike, shih 27.90

27.5 Prodhi i aparateve shtëpiakë

Ky grup përfshin prodhimin e paisjeve të vogla elektrike dhe elektro-shtëpiake, ventilatorët e tipit shtëpiak, fshesë korenti e tipit shtëpiak, fshesat e korentit për larje dyshemeje e tipit shtëpiak, paisje gatimi shtëpiake, makina larëse shtëpiake, frigorifer, ngrirës minibar, dhe paisje të tjera elektrike dhe joelektrike shtëpiake si larësë enësh, ngrohëse uji, dhe njesitë e mbajtjes së mbeturinave. Ky grup përfshin dhe prodhimin e paisjeve me energji elektrike, gaz dhe burime të tjera djegëse.

27.51 Prodhi i aparateve shtëpiakë elektrike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e paisjeve shtëpiake elektrike:
 - frigoriferit
 - ngrirësit
 - larësen e enëve
 - makina larëse dhe tharëse e rrobave
 - fshesa me korent
 - fshesa për larjen e dyshemesë
 - pastruesja e mbeturinave
 - grirëse, grirëse frutash
 - hapëse konservash
 - makinë rroje elektrike, furçe dhëmbësh elektrike dhe paisje të tjera personale elektrike
 - mprehës thikash
 - kapakët e ventilimit ose riqarkullimit
- prodhimin e paisjeve elektrotermike shtëpiake:
 - ngrohësit elektrik të ujit
 - batanije elektrike
 - tharëse, krehër, furçe, bigutina elektrike
 - hekur elektrik

- ngrohës hapësire e tipit-shtëpiake, e lëvizshme (portable)
- furra elektrike,
- mikrovalë
- pllaka gatimi
- tostiera
- bërëse kafe ose çaji
- thekëse buke, grila,
- rezistencat elektrike për ngrohje etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e frigoriferëve dhe frigoriferëve industrial dhe tregtar, ajër-kondicionerët e dhomave, ngrohës hapësire të përhershme, dhe ventilator tregtar, paisje gatimi e tipit tregtar, paisje larëse e tipit tregtar, makina larëse, tharëse me shtypje e tipit tregtar, fshesa me korent industriale, tregtare dhe institucionale, shih ndarjen 28
- prodhimin e makinerive qepëse shtëpiake, shih 28.94
- instalimin e sistemeve qendrore të pastrimit me vakum (fryrje apo tërheqje), 43.29

27.52 Prodhimi i paisjeve shtëpiake jo-elektrike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e paisjeve të gatimit dhe ngrohëse shtëpiake jo-elektrike:
 - ngrohësit joelektrik të hapësirës, sobat e gatimit, grirëset, sobat, ngrohëset e ujit, paisjet e gatimit, pllakat ngrohëse

27.9 Prodhimi i paisjeve të tjera elektrike

27.90 Prodhimi i paisjeve të tjera elektrike

Kjo klasë përfshin prodhimin e paisjeve të tjera elektrike të përziera si motorët, gjeneratorët dhe transformatorët, bateritë dhe akumulatorët, telat dhe kabllo, paisjet e ndriçimit ose aparatet shtëpiake.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mbushësve të baterive, solid-state
- prodhimin e paisjeve të hapjes dhe mbylljes së dyerve, elektrike
- prodhimin e zileve elektrike
- prodhimin e kordonëve elektrikë të bëra nga tela izolues të blerë
- prodhimin e makinave të pastrimi ultrasonike (përveç atyre të laboratorëve dhe dentistëve)
- prodhimin e invertërave të qëndrueshëm, aparataturat korigjuese, regullues ose të fuqisë së energjisë
- prodhimin e paisjeve të mosndërprerjes së energjisë (UPS)
- prodhimin e shtypësve të valëve
- prodhimin e kordave lidhëse, zgjatjen e tyre dhe lidhëse të tjera elektrikë
- prodhimin e elektrodave karboni dhe grafiti, kontaktorëve, dhe produkte të tjera grafiti dhe karboni
- prodhimin e përshpejtuesve të thërmijave
- prodhimin e kondensatorëve, rezistorëve, kondensuesve dhe përshpejtuesve të ngjashëm
- prodhimin e elektromanjeteve
- prodhimin e sirenave
- prodhimin e tabelave të shenjimit elektronike
- prodhimin e shenjave elektrike
- prodhimin e paisjeve të sinjalizimeve elektrike si ndriçuesit e trafikut për automjete dhe këmbësorë (semaforet)
- prodhimin e izolatorëve elektrike (përveç prej qelqi dhe porcelain), tubat dhe gypat me bazë metal
- prodhimin e paisjeve elektrike dhe përbërësve të motorëve me djegje të brendëshme
- prodhimin e paisjeve ngjitëse dhe salduese elektrike, duke përfshirë hekurat saldues të dorës

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e izolatorëve elektrikë prej porçelani, shih 23.43
- prodhimin e fibrave dhe produkteve prej karboni dhe gafiti (përveç elektrodave dhe paisjeve elektrike), shih 23.99
- prodhimin e rafinuesve të tipit përbërës elektronik, qarku integruar i rregullimit të tensionit, qarku i integruar i kthimit të fuqisë, kondensatorët elektronik, rezistencat elektronike, dhe paisje të ngjashme, shih 26.11
- prodhimin e transformatorëve, motorëve, gjeneratorëve, dhe kontrollorëve elektrik, shih 27.1
- prodhimin e baterive, shih 27.20
- prodhimin e telave të komunikimit dhe energjisë elektrike, telat e transmetimit të rrymës elektrike dhe jo elektrike, shih 27.3
- prodhimin e paisjeve të ndriçimit, shih 27.40
- prodhimin e paisjeve të tipit-shtëpiak, shih 27.5
- prodhimin e paisjeve ngjitëse dhe salduese jo-elektrike, shih 28.29
- prodhimin e paisjeve elektrike të automjeteve, si gjenerator, transformator, sistemet e kondensimit të dyerve dhe dritareve, rregullatorët e tensionit, shih 29.31

28 Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t

Kjo ndarje përfshin prodhimin e makinerive dhe paisjeve që veprojnë në mënyrë të pavarur mbi materialet në mënyrë mekanike ose termike ose plotësojnë operacione mbi materialet (si lëvizjet, spërkatje, peshim, ose paketim), duke përfshirë përbërësit mekanik që prodhojnë dhe ushtrojnë forcë dhe çdo përpunim i pjesëve primare speciale. Kjo ndarje përfshin paisjet e fiksuara ose lëvizëse të dorës, pavarësisht nëse ato janë të përcaktuar për t'u përdorur në industri, ndërtesa dhe punime inxhinierike, bujqësi ose përdorim shtëpiak. Gjithashtu, brenda kësaj ndarje, brenda kufijve të lejuar, përfshihet dhe prodhimi i pjesëve speciale të automjeteve për transportin e mallrave dhe pasagjerëve.

Kjo ndarje përcaktohet ndërmjet prodhimit të makinerive me qëllim special, si makineri që përdoren në një industri të veçantë të klasifikimit ose grumbull industri të klasifikimit, dhe makineri me përdorim të përgjithshëm, dmth makineri që përdoren në një diapazon më të gjerë të industrive të klasifikimit.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin makineritë me qëllim special, të pambuluara në klasifikim tjetër, ose të pa përdorura në ndonjë proces tjetër përpunimi apo prodhimi, etj.

Këtu nuk është përfshirë, prodhimi i produkteve metalike për përdorim të përgjithshëm (ndarja 25), aparatet e kontrollit të shoqëruara, paisjet kompjuterike, paisjet e kontrollit dhe testimit, aparaturat e kontrollit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike (ndarja 26 dhe 27) dhe automjetet me qëllim të përgjithshëm (ndarje 29 dhe 30).

28.1 Prodhimi i makinerive me qëllim të përgjithshëm

28.11 Prodhimi i motorëve dhe turbinave, përveç motorëve të avionëve, automjeteve dhe motorçikletave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e motorëve me djegje të brendëshme, përveç motorëve për avionë, automjete dhe motoçikleta:
 - motorë për flotë detare
 - motorët për mjete të transportit hekurudhor
- prodhimin e pistonave, unazës së pistonit, karburatorëve dhe të tjera për të gjitha llojet e motorëve me djegje të brendëshme, motorët diesel etj.
- prodhimin e valvolave të hyrjes dhe daljes të motorëve me djegje të brendëshme
- prodhimin e turbinave dhe pjesët e tyre:
 - turbinat me avull dhe tipe të tjera turbina me avull
 - turbinat hidraulike, rrota hidraulike dhe rregullatorët e tyre
 - turbinat e erës
 - turbinat me gaz, përveç motorëve turboreaktivë ose me helikë për ti dhënë shtytjen avionëve

- prodhimin e turbinave me ujë të ngrohtë
- prodhimin e komplet turbinave gjenerator
- prodhimin e motorëve për zbatime industriale

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e gjeneratorëve elektrikë (përveç turbinave gjenerator), shih 27.11
- prodhimin e gjeneratorëve me forcë lëvizëse primare (përveç gjeneratorëve të turbinave), shih 27.11
- prodhimin e paisjeve elektrike dhe përbërësve të motorëve me djegje të brendëshme, shih 29.31
- prodhimin e motorëve për vënie në lëvizje të mjeteve të transportit automobilistik, avionëve dhe motoçikletave, shih 29.10, 30.30, 30.91
- prodhimin e turboreaktorëve dhe turbinave me helikë, shih 30.30

28.12 Prodhimi i paisjeve hidraulike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e komponentëve hidraulikë dhe pneumatikë (duke përfshirë pompat hidraulike, motorët hidraulikë, cilindrat hidraulikë dhe pneumatikë, valvolat hidraulike dhe pneumatike, tubat dhe gypat hidraulikë dhe pneumatike)
- prodhimin e paisjeve për përgatitjen e ajrit për t'u përdorur në sistemet pneumatike
- prodhimin e sistemeve me fuqi lëngjet ose gazet
- prodhimin e paisjeve të transmisionit hidraulike
- prodhimin e paisjeve të transmisionit hidrostatikë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e kompresorëve, shih 28.13
- prodhimin e pompave për përdorime jo-hidraulike, shih 28.13
- prodhimin e valvolave për përdorime hidraulike dhe pneumatike, shih 28.14
- prodhimin e paisjeve të transmisionit mekanike, shih 28.15

28.13 Prodhimi i pompave dhe kompresorëve të tjerë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pompave me ajër dhe vakum, kompresorët me avull ose gaze të tjerë
- prodhimin e pompave për lëngje, me apo pa dispozitiv matës,
- prodhimin e pompave të përcaktuar për motorët me djegje të brendëshme: pompa me naftë, ujë dhe lëndë djegëse për automjetet etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e pompave të dorës

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e paisjeve hidraulike dhe pneumatike, shih 28.12

28.14 Prodhimi i tapave dhe valvolave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tapave dhe valvolave industriale, duke përfshirë valvolat rregullatore dhe tapat në hyrje
- prodhimin e tapave dhe valvolave sanitare
- prodhimin e tapave dhe valvolave ngrohëse

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e valvolave prej kauçuku të vullkanizuar të pakalitura, qelqi apo prej materiali qeramike, shih 22.19, 23.19 ose 23.44

- prodhimin e valvolave hyrëse dhe të daljes të motorëve me djegje të brendëshme, shih 28.11
- prodhimin e valvolave pneumatike dhe hidraulike dhe paisjet për përgatitjen e ajrit për tu përdorur në sistemet pneumatike, shih 28.12

28.15 Prodhimi i kuzhinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementëve të drejtimit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e zarave dhe rulave të kuzhinetave dhe pjesë prej tyre
- prodhimin e paisjeve të transmisionit me fuqi mekanike:
 - boshtet dhe manivelat e transmisionit: shufra me gunga, bosht me gunga, manivela etj.
 - shasitë e kuzhinetave dhe kushinetat me bosht të rrafshët
- prodhimin e ingranazheve, grupit të ingranazheve dhe kutitë e ingranazheve dhe shasitë e marsheve të tjera
- prodhimin e paisjeve të kapjes dhe boshtet e dublimit
- prodhimin e volanteve dhe pulexhove
- prodhimin e zinxhirëve me unaza të artikuluara
- prodhimin e zinxhirëve të transmisionit

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e zinxhirëve të tjerë, shih 25.93
- prodhimin e paisjeve të transmisionit hidraulike, shih 28.12
- prodhimin e paisjeve të transmisionit hidrostatikë, shih 28.12
- prodhimin e friksioneve elektromanjetike, shih 29.31
- prodhimin e sub-assemblies të paisjeve të transmisionit të fuqisë e identifikueshme si pjesë e automjeteve ose avionëve, shih ndarja 29 dhe 30

28.2 Prodhimi i makinerive të tjera për qëllime të përgjithëshme

28.21 Prodhimi i furrave, furnaltave dhe aparaturave për djegje

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e furrave dhe furnaltave elektrike dhe furrave të tjera laboratorike dhe industriale, duke përfshirë aparaturat e djegjes së plehrave
- prodhimin e aparaturave për djegje
- prodhimin e bazamenteve të qëndrueshëm të ngrohësve elektrik të hapësirës, ngrohëset elektrike të pishinave të notit
- prodhimin e bazamenteve të qëndrueshëm të ngrohësve familjare jo-elektrike, si ngrohje solare, ngrohje me avull, ngrohje me naftë dhe furra të ngjashme dhe paisje ngrohëse
- prodhimin e furrave elektrike të tipit familjar (furrat elektrike me forcën e ajrit, pompat ngrohëse ,etj), furrat jo-elektrike familjare me forcën e ajrit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e furrave mekanike, të mjeteve për largimin e plehrave etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e furrave familjare, shih 27.51
- prodhimin e makinave tharëse bujqësore, shih 28.93
- prodhimin e furrave të pjekjes, shih 28.93
- prodhimin e makinave tharëse të drurit, brumit të letrës, letrës ose kartonit, shih 28.99
- prodhimin e sterilizatorëve mjekësorë, kirurgjikalë ose laboratorik , shih 32.50
- prodhimin e furrave laboratorike (dentare), shih 32.50

28.22 Prodhimi i paisjeve të ngritjes dhe zhvendosjes

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive ngritëse, zhvendosëse, ngarkuese dhe shkarkuese, me veprim me dorë ose me motor:
 - çikrik, vinç, vinç i lëvizshëm, kova ngritëse dhe krika
 - kullat e shpimit, vinç me krahë, skeleti lëvizës i ashensorit, transportuesit me krahë, etj.
 - kamionë, me apo pa vendosjen e paisjes ngritëse apo zhvendosëse, me apo pa vetëlëvizje, të tipave që përdoren në uzina (duke përfshirë karrocet e dorës me dy rrota dhe karrocet e dorës)
 - manipulorët mekanikë dhe robotët industrialë të dizenuar specifikisht për ashensorë, paisjet zhvendosëse, ngarkuese ose shkarkuese
- prodhimin e konvejerëve dhe teleferikëve etj.
- prodhimin e ashensorëve, eskalatorëve dhe shkallëve lëvizëse
- prodhimin e pjesëve të specializuara për ashensorë dhe pajisje zhvendosëse

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e robotëve industrialë për përdorime të shumfishta, shih 28.99
- prodhimin e elevatorëve me veprim të vazhdueshëm dhe konvejerëve për përdorime nën tokësore, shih 28.92
- prodhimin e lopatave mekanike, eskavatorëve dhe ngarkuesve me lopatë, shih 28.92
- prodhimin e urave, vinçave hekurudhorë, autovinçave, shih 30.11, 30.20
- instalimin e ashensorëve dhe elevatorëve, shih 43.29

28.23 Prodhimi i makinerive dhe paisjeve të zyrave, përveç kompjuterave dhe paisjeve periferike

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinave llogaritëse
- prodhimin e makinave mbledhëse, regjistrimi i parave
- prodhimin e kalkulatorëve, elektronik ose jo
- prodhimin e kutive postare, makinat e postimit me dorë (mbushja e zarfave, dyllosja dhe makinat e adresimit, hapja, sistemimi, kontrolli)
- prodhimin e makinave të shkrimit
- prodhimin e makinave stenografike
- prodhimin e paisjeve lidhëse të tipit zyrtar (si lidhje me plastik ose lidhëse)
- prodhimin e makinerive të shkrimit të çeqeve
- prodhimin e makinave të llogaritjes së monedhave dhe mbështjelljes së monedhave)
- prodhimin e mprehësave të lapsave
- prodhimin e makinave vendosjes së kapëseve dhe heqjes
- prodhimin e makinave të votimit
- prodhimin e aparateve me shirit
- prodhimin e makinave të hapjes së vrimave
- prodhimin e regjistrimit të parave, operacione mekanike
- prodhimin e makinave fotokopje
- prodhimin e tonerave rezervë
- prodhimin e dërrasës së zezë, stendë e bardhë dhe stendat shënjuese
- prodhimin e makinave diktuese

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e kompjuterave dhe paisje periferike, shih 26.20

28.24 Prodhimi i veglave portative me motor të inkorporuar

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e veglave portative, me motor elektrik ose jo-elektrik ose drejtues pneumatik si:
 - sharra qarkulluese dhe me lëvizje vajtje-ardhje
 - trapan dhe çekiç trapani
 - zdrukth me fuqinë e dorës
 - gozhda pneumatike
 - amortizator
 - bela
 - mprehëse
 - makinë për ngulje kapëse
 - shpimi i përçinave pneumatike
 - zdukth
 - gërshërë të mëdha dhe të vogla
 - përdredhëse
 - vendosja e barutit

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e veglave të këmbyeshme për vegla dore, shih 25.73
- prodhimin e aparaturave elektrike të dorës për saldim dhe ngjitje, shih 27.90

28.25 Prodhimi i paisjeve ftohëse dhe ventiluese jo shtëpiake

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e paisjeve industriale ftohëse dhe frigoriferike, duke përfshirë montimet e pjesëve kryesore
- prodhimin e makinave të ajër-kondicionerëve duke përfshirë ato për automjete
- prodhimin e ventilatorëve jo-shtëpiake
- prodhimin e shkëmbyesve të nxehtësisë
- prodhimin e makinerive për lëngëzimin e ajrit ose të gazit
- prodhimin e ventilatorëve për ventilimin e papafingos (ventilator për çati me majë, ventilatorë çatie, etj.)

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e paisjeve ftohëse dhe frigoriferëve shtëpiake, shih 27.51
- prodhimin e ventilatorëve shtëpiake, shih 27.51

28.29 Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm të p.kt.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive peshore (të tjera përveç peshoreve të ndjeshme të laboratorëve):
 - peshore familjare dhe dyqani, platformë peshore, peshore për peshim në vazhdimësi, peshore urë, peshoret etj.
- prodhimin e makinerive dhe aparaturave për filtrim dhe pastrim për lëngje
- prodhimin e paisjeve për projektim, shpërndarje ose spërkatje të lëngjeve ose pluhurave:
 - armët spërkatëse, shuarëse zjarri, makina fryrëse rëre, makinë pastrim avulli, etj.
- prodhimin e makinerive për ambalazhim dhe paketim:
 - mbushja, mbyllja, dyllosja, makina kapëse ose etiketimi etj.
- prodhimin e makinerive për pastrimin dhe tharjen e shisheve dhe për ajrimin e pijeve
- prodhimin e impjantit për rektifikimin ose distilimin për rafineritë e naftës, industritë kimike, industritë e pijeve etj.

- prodhimin e gjeneratorëve të gazit
- prodhimin e makinave kalendra dhe rrokullitës dhe cilindrat e tyre (përveç për metal dhe qelq)
- prodhimin e centrifugave (përveç ndarësve të kremit dhe tharësve të rrobave)
- prodhimin e rondeleve dhe të ngjashme të bëra për një kombinim të materialeve ose faqesjes prej të njejtë material
- prodhimin e makinave të shitjes së mallrave automatike
- prodhimin e pjesëve të makinave me përdorim të përgjithshëm
- prodhimin e niveleve, matës shirit dhe vegla dore të ngjashme, vegla të precizionit të makinistit (përve optike)
- prodhimin e paisjeve jo-elektrike për ngjitje dhe saldim

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e peshoreve të ndjeshme (tipi aboratorik), shih 26.51
- prodhimin e paisjeve ftohëse dhe frigoriferëve shtëpiak, shih 27.51
- prodhimin e ventilatorëve shtëpiakë, shih 27.51
- prodhimin e paisjeve ngjitëse dhe salduese elektrike, shih 27.90
- prodhimin e makinerive të sprucimit për bujqësinë, shih 28.30
- prodhimin e makinerive për kthimin e qelqeve dhe metaleve dhe cilindrat e tyre, shih 28.91, 28.99
- prodhimin e tharësve për bujqësinë, makinerive për filtrimin dhe pastrimin e ushqimeve, shih 28.93
- prodhimin e makinerive filtrimin dhe pastrimin e ushqimeve, shih 28.93
- prodhimin e ndarësve të kremit, shih 28.93
- prodhimin e tharësve të veshjeve tregtare, shih 28.94
- prodhimin e makinerive të shtypjes së tëkstileve, shih 28.94

28.3 Prodhimin e makinerive bujqësore dhe pyjore

28.30 Prodhimin e makinerive bujqësore dhe pyjore

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e traktorëve të përdorur në bujqësi dhe pyje
- prodhimin e traktorëve me këmbë (kontroll me këmbë)
- prodhimin e kositësve, duke përfshirë makinën kositëse të barit
- prodhimin e rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove me vet-ngarkim dhe vet-shkarkim
- prodhimin e makinerive për përgatitjen e tokës, mbjelljen dhe plehërimin:
 - plug, spërkatës, hedhëse farash, lesë, etj
- prodhimin e makinerive korrëse dhe shirëse:
 - korrëse, shirëse, seleksionuese etj.
- prodhimin e makinave të qumështit
- prodhimin e makinave për spërkatje për përdorim bujqësor
- prodhimin e makinerive të ndryshme për bujqësinë:
 - makineri për rritjen e shpendëve, makineri për rritjen e bletëve, paisje për përgatitjen e foragjereve etj.
 - makina për pastrimin, seleksionimin dhe shkallëzimin e vezëve, frutave etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e veglave të dorës për përdorim në bujqësi, shih 25.73
- prodhimin e konvejerëve për përdorim në ferma, shih 28.22
- prodhimin e veglave me përdorim fuqie, shih 28.24
- prodhimin e ndarësve të kremit, shih 28.93
- prodhimin e makinerive për pastrimin, seleksionimin dhe shkallëzim të farave, drithrave ose perimeve leguminoze të thata, shih 28.93
- prodhimin e traktorëve rrugorë me gjysmë rimorkio, shih 29.10
- prodhimin e traktorëve rrugorë dhe gjysmë rimorkiove, shih 29.20

28.4 Prodhimi i makinerive dhe instrumentave për punimin e metaleve

Ky grup përfshin makineritë dhe instrumentat për punimin e metaleve si prodhimin e instrumentave, punimin e metaleve dhe materialeve të tjera (dru, kockë, gurrë, plastik e fortë, kauçuk i fortë, qelq i ftohtë, etj) duke përfshirë këtu edhe makineritë që punojnë me rreze lazer, valë ultrasonike, me hark plazme, pulsime manjetik etj.

28.41 Prodhimi i instrumentave për punimin e metaleve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e instrumentave për punimin e metaleve, duke përfshirë ato me përdorim rreze lazer, valë ultrasonike, me hark plazme, pulsime manjetik etj.
- prodhimin e instrumentave për kthimin, shpimin, thyerjen, gdhëndjen, planifikimin, mprehjen etj.
- prodhimin e instrumentave stampuese ose presuese
- prodhimin e presave shpuese, presave hidraulike, çekiçëve pikues, makinave të kovaçanës, etj.
- prodhimin e bankave për tërheqje, hollim dhe makina për punimin e telave
- prodhimin e makinerive elektrogalvanizuese

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve për instrumentat që shërbejnë për punimin e metaleve

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e veglave të këmbyeshme me veglat e dorës, shih 25.73
- prodhimin e aparaturave elektrike të dorës për saldime dhe ngjitje, shih 27.90

28.49 Prodhimi i instrumentave të tjerë p.k.t.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e instrumentave për punimin e drurit, kockës, gurit, kauçukut të fortë, plastikës së fortë, qelqit të ftohtë etj., duke përfshirë këtu përdorimin e rrezeve lazer, valëve ultrasonike, ngjitje me hark, pulset manjetike etj.
- prodhimin e bankove të punës për instrumenta
- prodhimin e kokave ndarëse dhe pjesë të tjera speciale që i bashkangjiten për instrumentat
- prodhimin e makinerive stacionare për gozhdimin, nguljen, ngjitjen ose të tjera për punimin e drurit, zunkthit, kockës, kauçukut ose plastikës së fortë etj.
- prodhimin e trapanove fikse me rotullim, limatriçe, prerës metalit etj.
- prodhimin e presave për prodhimin e mbajtëseve të veçanta dhe të tjera si këto
- prodhimin e makinerive për trajtimin elektrolitik

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e pjesëve dhe aksesorëve për instrumenta: si koka ndarëse, dhe pjesë të vecanta që i bashkangjiten për instrumentat

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e veglave të këmbyeshme me instrumenta (trapan, shpuese, stampë, filetuese, prerëse bluarëse, torno, brisqe, thika etj), shih 25.73
- prodhimin e hekurave saldues elektrik dhe dyllosje elektrike, shih 27.90
- prodhimin e veglave me përdorimin e fuqisë, shih 28.24
- prodhimin e makinerive që përdoren në uzinat ose fonderitë e metaleve, shih 28.91
- prodhimin e makinave për nxjerrje, shih 28.92

28.9 Prodhimi i makinerive të tjera për qëllime speciale

Ky grup përfshin prodhimin e makinerive për qëllime speciale, si makineri për përdorim ekskluzive në një industri ose një grup të vogël të industrive. Ndërsa mjaft prej tyre janë përdorur në procese të tjera përpunimi, përpunimi i ushqimeve dhe përpunimi i tekstileve, ky grup gjithashtu përfshin prodhimin e makinerive specifike për të tjera (industri jo-përpunuese) si ingranazhet e lëshimit të avionëve ose paisjet e parkut të argëtimit.

28.91 Prodhimi i makinerive për metalurgjinë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinave dhe paisjeve për trajtimin në të nxehtë të metaleve:
 - kthimet, kallëpet e lingotave, kupave, makina të derdhjes
- prodhimin e presave për metalet-petëzuese dhe ruloni për disa presa

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e bankove të skicuara, shih 28.41
- prodhimin e kutive të kallëpeve dhe kallëpet (përveç kallëpet e lingotave), shih 25.73
- prodhimin e makinave për formimin e kallëpeve të fonderisë, shih 28.99

28.92 Prodhimi i makinerive për industrinë nxjerrëse dhe ndërtim

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e elevatorëve dhe konvejerëve me veprim të vazhdueshëm për përdorim në nëntokë.
- prodhimin e makinerive për shpim, thyerje, shpim në gjatesi dhe hapje tuneli (për përdorim nëntokësor ose jo)
- prodhimin e makinerive për trajtimin e mi neraleve për shoshitje, selektim, ndarje, larje, shkatërrim etj.
- prodhimin e përzierseve të betonit dhe llaçit
- prodhimin e makinerive të lëvizjes së dheut:
 - buldozer, angle-dozer, skrapper, niveluese, lopata mekanike, mbushëset e lopatave etj.
- prodhimin e makinerive për nguljen dhe shkulje e shtyllave, shpërndarës llaçi, shpërndarëse bitumi, makineri për hedhjen e betonit në sipërfaqe etj.
- prodhimin e traktorëve binar mbajtës dhe traktorët të përdorur në ndërtim apo nxjerrje
- prodhimin e thikave të buldozerëve dhe angle-dozereve
- prodhimin e kamionëve të punimit në rrugë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e ashensorëve dhe paisjet e ngritjes, shih 28.22
- prodhimin e traktorëve të tjerë, shih 28.39, 29.10
- prodhimin e veglave të makinave për punimin e gurit duke përfshirë makinat për ndarjen dhe pastrimin e gurit, shih 28.49
- prodhimin e betonierëve për punimin e betonit, shih 29.10

28.93 Prodhimi i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tharëseve për produkte ushqimore
- prodhimin e makinerive për industrinë e qumështit:
 - skremuese
 - makineri të përpunimit të qumështit (si homogjenizator)
 - makineri të konvertimit të qumështit (si përzierje gjalpi, punuese gjalpi dhe makina për nxjerrjen e gjalpës)
 - makina të prodhimit të djathit: (si homogjenizator, makina të prodhimit të djathit, presimin) etj.

- prodhimin e makinerive për përpunimin e drithrave
 - makineri për pastrim, seleksionim, madhësive të farave, drithrave ose perimeve leguminoze të thata (shoshitja, sitja, ndarës, makinat e mbledhjes së drithrave, etj)
 - makineritë për produkte miell gruri, miell misri, etj. (mullinjt e blojës, përzierës, shoshitës, pastrues, përzierës, qërues orizi, ndarës i kokrave të bizeles)
- prodhimin e presave, shtypësive etj përdorur për të bërë verë, sidër, lëng frutash etj.
- prodhimin e makinerive për industrinë e pjekjes në furra ose për bërjen e makaronave, spaghetti dhe produkte të ngjashme si:
 - furrat e bukës, përzierës, ndarës, prerës në feta, makineri të përgatitjes së kekut, etj.
- prodhimin e makinave dhe paisjeve për ushqime të ndryshme:
 - makineri për të bërë reçel, kakao dhe çokollatë; për përpunimin e sheqerit, punishte për prodhimin e birrës, makineri për mishin ose shpendët për të përgatitur fruta, arra ose perime; për të përgatitur peshk, guaskat ose produkte të tjera deti
 - makineri për filtrim dhe pastrim
 - te tjera makineri për përgatitjen dhe përpunimin e ushqimeve dhe pijeve
- prodhimin e makinerive për nxjerrjen e përgatitjen e vajit dhe yndyrnave bimore ose shtazore
- prodhimin e makinerive për përgatitjen e duhanit dhe për bërjen e cigareve dhe cigarillove, ose berjen per pipa, ose përtypjen e duhanit, ose nuhatjen
- prodhimin e makinerive për përgatitjen e ushqimeve në hotele dhe restorante

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e paisjeve ndriçuese për frutat dhe qumështin, për rrezatim, shih 26.60
- prodhimin e makinerive për paketim, ambalazhim dhe peshim, shih 28.29
- prodhimin e makinave për pastrim, seleksionim ose ndarjen e vezëve, frutave dhe produkte të tjera bujqësore (përveç fara, drithra dhe perime leguminoze të thata), shih 28.39

28.94 Prodhimi i makinerive për prodhimin e tekstileve, veshjeve dhe lëkurëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për tekstile:
 - makina për përgatitjen, prodhimin, filaturimin, tërheqjen, tektsturimin ose prerjen e fibrave tekstile, sintetike dhe artificiale, materialeve ose fijeve;
 - makineri për përgatitjen e fibrave tekstile: zhveshjen e pambukut, rrahës të pambukut, niveluese, filaturuese e tipit garnet, makina për karbinizimin e leshit, krehëse, tjerëse, vegël për fitilë etj
 - makineri tjerëse
 - makineri për përgatitjen e fijeve tekstile: bobinat, përdredhëset dhe makina të lidhura me to
 - makinat për endje konfeskione (tezgjah), duke përfshirë tezgjahet me dorë
 - makinat prerëse
 - makinat për bërjen e rrjetave, tantella, fileto, fjongo etj
- prodhimin e makinave ose paisjeve ndihmëse për makineritë tekstile:
 - pjesë mekanike Jakuart, mekanizmat e ndërrimit të navetave, (folesë së fillit) për kalimin e gjilpërës, etj
- prodhimin e makinerive për shtypjen e tekstileve
- prodhimin e makinerive për përpunimin e pëlhurave:
 - makineri për larjen, zbardhimin, ngjyrosjen, stampimin, përfundimin, mbulimin, shtresëzimin e pëlhurave tekstile
 - prodhimin e makinerive për rrotullimin, çrrotullimin, çpalosjen, prerjen, ose zbukurimin e pëlhurave tekstile

- prodhimin e makinerive të lavanderisë:
 - makinat për hekurosje, duke përfshirë këtu dhe presimin
 - larjet tregtare dhe makinat e tharjes
 - makinat e pastrimit kimik
- prodhimin e makinave të qepjes, kokat e makinave qepëse dhe gjilpërat e makinave qepëse (për doren ose jo për përdorim familjar)
- prodhimin e makinave për prodhimin e ose përfundimin e shajakut ose të pa thurur
- prodhimin e makinave për prodhimin e lëkurës:
 - makineri për përgatitjen, tanimin ose punimin e lëkurëve, lëkurëve bruto ose lëkurë gëzofit
 - makineri për bërjen dhe riparimin e këpucëve ose artikujve të tjerë prej lëkure, ose lëkure gëzofi

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e makinerive të letrës ose kartonit për përdorim të makinave Jakuart, shih 17.29
- prodhimin e makinave larëse dhe tharëse shtëpiake, shih 27.51
- prodhimin e makinave kalendruese, shih 28.29
- prodhimin e makinave që përdoren në libërlidhje, shih 28.99

28.95 Prodhimi i makinerive për prodhimin e letrës dhe kartonit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për bërjen e brumit të letrës
- prodhimin e makinerive për bërjen e letrës dhe kartonit
- prodhimin e makinerive për prodhimin e artikujve prej letre dhe kartoni

28.96 Prodhimi i makinerive të plastikës dhe kauçukut

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për prodhimin e kauçukut ose plastikës së butë, ose për prodhimin e produkteve prej këtyre materialeve:
 - nxjerrje modeli, kallëpe, makina për bërjen ose tërheqjen e gomave dhe makineri të tjera për bërjen e produkteve specifike prej kauçuku ose plastike

28.99 Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm p.k.t

Kjo klasë përfshin prodhimin e makinerive me qëllim special të pa klasifikuara në vend tjetër.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e makinerive për tharjen e drurit, brumit të letrës, letrës dhe kartonit dhe materiale të tjera (përveç produkteve bujqësore e tekstile)
- prodhimin e makinerive për shtypjen dhe libërlidhjen dhe makina për aktivitete ndihmëse në shtypje prej materialeve të ndryshme
- prodhimin e makinerive për prodhimin e tullave, tjegullave, të brumit qeramik të formuar, tubave, elektrodave prej grafiti, shkumësit për dërrasë të zezë, modelet e fonderive etj.
- prodhimin e makinerive për përpunimin e gjysëmpërçuesëve
- prodhimin e robotëve industrial i përdorur vetëm për qëllime speciale
- prodhimin e makinerive dhe paisjeve të ndryshme:
 - makina për montimin e llampave elektrike ose elektronike, tubave, valvolave,
 - makina për prodhimin në të nxehtë të qelqit ose produkteve prej qelqi, fibrave ose fijeve të qelqit
 - makineri ose aparate për ndarjen e izotopeve
- prodhimin e paisjeve për bashkimin dhe balancimin e gomave, paisje balancuese, (përveç balancimit të rrotullueseve)
- prodhimin e kuzhinetave për avionë, mbajtëse e katapultave të avionëve dhe paisjeve të lidhura me to
- prodhimin e vaskave të taninit

- prodhimin e paisjeve për zbulurime automatike (si gjilpërat argjendare)
- prodhimin e argëtuesëve për panaire, hedhëse, galeri qitje etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e paisjeve shtëpiake, shih 27.5
- prodhimin e makinave fotokopje etj., shih 28.23
- prodhimin e makinave dhe pasijeve për përpunimin e kauçikut të rëndë, plastikës së rëndë ose qelqit të ftohtë, shih 28.49
- prodhimin e kallëpeve të lingotave, shih 28.91

29 Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove

Kjo ndarje përfshin prodhimin e mjeteve të transportit për pasagjerë ose mallra. Këtu përfshihet gjithashtu dhe prodhimi i pjesëve të këmbimit të pjesëve të ndryshme si dhe prodhimi i rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove. Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve të prodhuara në këtë ndarje klasifikohen në klasën 45.20.

29.1 Prodhimi i mjeteve të transportit

29.10 Prodhimi i mjeteve të transportit

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e veturave të pasagjerëve
- prodhimin e mjeteve të transportit tregtarë:
 - kamionë, kamionçina, traktorë rrugorë me gjysmë rimoriko etj.
- prodhimin e autobuzëve, troli-buzëve dhe mikrobuzëve
- prodhimin e motorëve për mjetet e transportit
- prodhimin e shasive për mjetet e transportit
- prodhimin e mjeteve të tjera të transportit:
 - makina bore, makina për fusha golfi, makina amfibe
 - zjarrfikëse, makina për pastrimin e rrugëve, bibliotekave shëtitëse, makina të blinduara etj.
 - betoniera
- prodhimin e makinave për të gjitha terenet, ATVs, mini vetura dhe të ngjashme duke përfshirë makinat e garave

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- riparimin kapital i motorëve të mjeteve të transportit

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e motorëve elektrikë (përveç motorëve fillestarë), shih 27.11
- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit për mjetet e transportit, shih 27.40
- prodhimin e pistonave, unazave të pistonave dhe karburatorëve, shih 28.11
- prodhimin e traktorëve bujqësorë, shih 28.30
- prodhimin e traktorëve të përdorur në ndërtim dhe minierë, shih 28.92
- prodhimin e kamionëve të shkarkimit, shih 28.92
- prodhimin e karrocive për mjetet e transportit, shih 29.20
- prodhimin e pjesëve elektrike për mjetet e transportit, shih 29.31
- prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve për mjetet e transportit, shih 29.32
- prodhimin e tankeve dhe mjeteve të tjera luftarake, shih 30.40
- mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të transportit, shih 45.20

29.2 Prodhimi i karrocive për mjetet e transportit: prodhimi i rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove

29.20 Prodhimi i karrocereve për mjetet e transportit: prodhimi i rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e karrocereve duke përfshirë kabinat për mjetet e transportit
- prodhimin e të gjitha tipeve të mjeteve të transportit të rimorkueshme dhe të gjysmë rimorkueshme
- prodhimin e rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove:
 - për transport mallra: çisterna, rimorkio lëvizëse etj.
 - për transport pasagjerësh: furgon etj.
- prodhimin e mbajtësve speciale të pajisur që i bashkëngjiten mjeteve të transportit për një ose disa mënyra transporti

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove të përcaktuar kryesisht për përdorim në bujqësi, shih 28.30
- prodhimin e pjesëve dhe pjesëve të këmbimit të trupave të mjeteve të transportit, shih 29.32
- prodhimin e automjeteve të përcaktuar për kafshët, shih 30.99

29.3 Prodhimi i pjesëve të mjeteve të transportit dhe motorët e tyre**29.31 Prodhimi i pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet e transportit dhe motorët e tyre**

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pjesëve elektrike për motorë si gjenerator, të tilla si gjeneratorë, alternatorë, pjesët elektrike ndezëse, sistemet e hapjes së dyerve dhe dritareve, rregullatorët e tensionit, etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e baterive për mjetet e transportit, shih 27.20
- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit për mjetet e transportit, shih 27.40
- prodhimin e pompave për mjetet e transportit dhe motorët e tyre, shih 28.13

29.32 Prodhimi i pjesëve dhe aksesoreve të tjerë për mjetet e transportit dhe motorët e tyre

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve për mjetet e transportit:
 - frenat, kutia e shpejtësisë, akset, rrotat, boshtet, ingranazhet, amortizatorët e lëkundjeve, radiatorët, tubat e shpëtimit, volante, kolona dhe kutitë e drejtimit, biella, pistonave, segmente etj
- prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve të karrocereve për mjetet e transportit:
 - rripi i sigurimit, jastëk ajri, dyer, parakolpi, prapakolpi
- prodhimin e ndenjësve të veturave

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e gomave pneumatike, shih 22.11
- prodhimin e tubave dhe ripave të sigurimit prej kauçuku dhe pajisje të ngjashme prej kauçuku, shih 22.19
- prodhimin e pistonave, unaza pistonave dhe karburatorët, shih 28.11
- mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të transportit, shih 45.20

30 Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit

Kjo ndarje përfshin prodhimin e mjeteve transportuese si prodhimi i anijeve tregtare dhe barkave, prodhimi i vagonëve dhe lokomotivave të trenit, avionëve dhe pjesët e tyre.

30.1 Ndërtimi i anijeve dhe barkave

Ky grup përfshin ndërtimin e anijeve, barkave dhe struktura të tjera lundruese për transportim dhe qëllime tregtare, si dhe për sport apo qëllime argëtimi.

30.11 Ndërtimi i anijeve dhe strukturave lundruese

Kjo klasë përfshin ndërtimin e anijeve, përveç anijeve për sport dhe qëllime argëtimi dhe ndërtimin e strukturave lundruese:

- ndërtimin e anijeve tregtare:
 - anije pasagjerësh, mallrash, anije ngarkimi, anije çisternë, rimorkiator etj.
- ndërtimin e anijeve të luftës
- ndërtimin e anijeve të peshkimit dhe anijet fabrikë që përpunojnë peshkun

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- ndërtimin e anijeve me jastëk ajri - motoskaf (përveç motoskafëve të tipit të argëtimit)
- ndërtimin e platformave të shpimit ujor, lundrues dhe nënujor
- ndërtimin e strukturave lundruese:
 - lundra, arka lëvizëse, çisterna lundruese, lundër, lundër e sheshtë, tragete jo argëtimi etj.
- prodhimin e seksioneve për anije dhe struktura lundruese

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pjesëve të anijeve, të tjera nga montimi i trupit kryesor të anijes si:
 - vela, shih 13.42
 - helikat e anijes, shih 25.99
 - ankorat prej hekuri dhe çeliku, shih 25.99
 - motorat e marinës, shih 28.11
- prodhimin e instrumentave të drejtimit të anijes, shih 26.51
- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit për anije, shih 27.40
- prodhimin e automjeteve amfibë, shih 29.10
- prodhimin e tragetëve për argëtim, shih 30.12
- riparimin e specializuar dhe mirëmbajtjen e anijeve dhe strukturave lundruese, shih 33.15
- prodhimin e anijeve thyrrëse, shih 38.31
- instalimin e brendshëm i barkave, shih 43.3

30.12 Ndërtimi i barkave të argëtimit dhe sportive

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e barkave dhe trageteve të gjera
- ndërtimin e anijeve me vela me ose pa motor ndihmës
- ndërtimin e anijeve me motor
- ndërtimin e trageteve të tipit të argëtimit
- prodhimin e trageteve personal
- prodhimin e barkave të tjera sportive ose të argëtimit:
 - kanoe, kaike, barka kanotazhi, ski

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pjesëve të barkave sportive dhe të kënaqësisë:
 - velat, shih 13.42
 - ankorat prej hekuri apo çeliku, shih 25.99
 - motorrat e flotës, shih 28.11

- prodhimin e bazamentit të anijes me vela dhe bazamentit të sërfit, shih 32.30
- mirëmbajtjen dhe riparimin e barkave të argëtimit, shih 33.15

30.2 Prodhimi i lokomotivave dhe mjetet mbështetëse të transportit hekurudhor

30.20 Prodhimi i lokomotivave dhe mjetet mbështetëse të transportit hekurudhor

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e lokomotivave elektrike, me naftë, avull dhe të tjera hekurudhore
- prodhimin e mjeteve hekurudhorë dhe të tramvajeve me vet-shtytje, vagonat, mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre
- prodhimin e mjeteve hekurudhore ose tramvajeve jo me vet-shtytje si:
 - vagona pasagjerësh, vagona mallrash, vagona çisternë, vagona për shkarkim automatik, vagona pune, vagona vinç, vagona për lëndë djegëse etj.
- prodhimin e pjesëve të specializuara të lokomotivave hekurudhore, tramvajeve apo mjeteve mbështetëse si:
 - boshte, rrota, frena dhe pjesë të tyre, çengela, dhe sisteme të vendosjes, amortizatorë, shasi e vagonave dhe lokomotivave, trupi, korridoret e komunikimit etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e sinjaleve mekanike dhe elektromekanike, pajisjet e kontrollit të trafikut dhe sigurimit për trena, tramvaje, lundruet në ujrat e brendshme, rrugë, parkim, fusha aeroporti etj.
- prodhimin e lokomotivave dhe makinave tren të minierave
- prodhimin e ndenjseve për trena

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e hekurave të pamontuara, shih 24.10
- prodhimin e kamionëve të fiksuar të hekurudhave të montuara, shih 25.99
- prodhimin e motorëve elektrik, shih 27.11
- prodhimin e sinjaleve elektrike, pajisjeve të kontrollit dhe sigurimit, pajisjeve të sinjalizimit, shih 27.90
- prodhimin e motorëve dhe turbinave, shih 28.11

30.3 Prodhimi i avionëve dhe pjesëve që lidhen me to

30.30 Prodhimi i avionëve dhe pjesëve që lidhen me to

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e aeroplanëve për transport mallrash dhe pasagjerësh, për përdorim të forcave mbrojtëse, sport ose qëllime të tjera
- prodhimin e helikopterëve
- prodhimin e avionëve pa motor dhe deltaplaneve
- prodhimin e dirizhabëlave (aerostat i drejtuar) dhe balonave me ajër të nxehtë
- prodhimi e montimi i pjesëve dhe aksesoreve të aeroplanëve si:
 - trupi i avionit, krahëve, dyerve, sipërfaqes kontrollit, kuzhinetat tokësore, rezervuarët me lëndë djegëse, kabina e ekuipazhit, etj
 - helikat ajrore, rotorët e helikopterëve dhe thikat e rotorit të helikës
 - motorët dhe rotorët e çdo lloji të ndodhur në hapësirë
 - pjesë të motorëve turboreaktivë dhe turbohelikat për mjetet që përdoren në hapësirë
- prodhimin e trajnerëve drejtues nga toka
- prodhimin e mjeteve të hapësirës, satelitët, sondat planetare, stacionet orbitale, anijet kozmike
- prodhimin e raketave balistike ndërkontinentale

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- riparimin kapital dhe shndërrimi i mjeteve të transportit ajror dhe motorëve të mjeteve të transportit ajror
- prodhimin e ndenjësve të mjeteve të transportit ajror

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e parashutave, shih 13.92
- prodhimin e artilerisë ushake dhe municionet, shih 25.40
- prodhimin e pajisjeve të telekomunikacionit për satelitët, shih 26.30
- prodhimin e instrumenteve të avionëve dhe instrumenteve të aeronautikës, shih 26.51
- prodhimin e sistemeve të drejtimit në hapësirë, shih 26.51
- prodhimin e pajisjeve të ndriçimit për avionët, shih 27.40
- prodhimin e pjesëve ndezëse dhe pjesëve të tjera elektrike për motorët me djegje të brendshme, shih 27.90
- prodhimin e pistonave, unazave të pistonave dhe karburatorëve, shih 28.11
- prodhimin e kuzhinetave të lëshimit të avionëve, katapultat mbajtëse të avionëve dhe pajisje që lidhen me to, shih 28.99

30.4 Prodhimi i mjeteve luftarake të ushtrisë

30.40 Prodhimi i mjeteve luftarake të ushtrisë

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e tankeve
- prodhimin e mjeteve ushtarake amfibe të blinduara
- prodhimin e mjeteve të tjera luftarake të ushtrisë

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e armëve dhe municioneve, shih 25.40

30.9 Prodhimi i pasijeve të tjera të transportit p.k.t

Ky grup përfshin të tjera pajisje të transportit si automobilistike, hekurudhore, ujore, ajrore ose të hapësirës dhe mjete luftarake.

30.91 Prodhimi i motorçikletave

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e motorçikletave, biçikletave me motor dhe çikletave të pajisura me motor ndihmës
- prodhimin e motorëve të motorçikletave
- prodhimin e koshave
- prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve për motorçikleta

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e biçikletave, shih 30.92
- prodhimin e karrocave të invalidëve, shih 30.92

30.92 Prodhimi i biçikletave dhe karrocave të invalidëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e biçikletave të pamotorizuara dhe biçikletave të tjera, duke përfshirë triçikël, biçikleta dhe triçikla për fëmijë
- prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve të biçikletave

- prodhimin e karrocave të invalidëve me ose pa motorr
- prodhimin e pjesëve dhe aksesoreve të karrocave të invalidëve
- prodhimin e karrocave për bebe

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e biçikletave me motor ndihmës, shih 30.91
- prodhimin e lodrave me rrota, duke përfshirë biçikletat dhe triçiklat plastikë, shih 32.40

30.99 Prodhimi i paisjeve të tjera të transportit p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mjeteve që lëvizin me dorë: mbajtëset e bagazheve, karroca dore, rrëshqitëse, karroca dyqani etj
- prodhimin e mjeteve të tërhequra nga kafshët: pajtonët, karroca me avull, makinë varrimi, etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e kamionëve të punës, të pajisur apo jo me ashensor apo pajisje ngritëse, me apo jo vetlëvizje, e tipit të përdorur në uzina, (duke përfshirë makinat e dorës dhe karrocat me rrota), shih 28.22
- prodhimin e karrocave për dekorime të restoranteve, si karrocat e ëmbëlsirave, vagonat e ushqimit, shih 31.01

31 Prodhimi i mobiljeve

Kjo ndarje përfshin prodhimin e mobiljeve dhe produktet që lidhen me to prej çdo materiali, përveç gurit, betonit dhe qeramikës. Proçeset e prodhimit të mobiljeve janë metodat standarte të formimit të materialeve apo pjesëve të montuara, duke përfshirë prerjen, formimin dhe laminimin. Skicimi i artikujve, për estetikë dhe funksionale, është një aspekt i rëndësishëm i proçesit të prodhimit.

Disa prej proçeseve të përdorura në prodhimin e mobiljeve janë të ngjashme me proçeset që janë përdorur në segmente të tjera të prodhimit. Për shembull, prerja dhe montimi ndodh në prodhimin e veglave të drurit që janë klasifikuar në ndarjen 16 (Përpunimi drurit dhe produkte prej druri). Megjithatë, proçeset e përsëritura përcaktojnë prodhimin e mobiljeve prej druri nga prodhimi i produkteve prej druri.

Ngjashmërisht, prodhimi mobiljeve prej metali përdor teknika që gjithashtu janë përdorur në proçeset e formimit dhe petëzimit të metaleve klasifikuar në ndarjen 25 (Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuara). Proçesi i derdhjes së mobiljeve prej plastike është i ngjashëm me derdhjen e produkteve prej plastike. Megjithatë, prodhimi i mobiljeve plastike tenton të jetë një aktivitet i specializuar.

31.0 Prodhimi i mobiljeve

31.01 Prodhimi i mobiljeve të zyrave dhe dyqaneve

Kjo klasë përfshin prodhimin e mobiljeve prej çdo lloji, prej çdo materiali (përveç gurë, beton ose qeramikë) për çdo vend dhe për çdo qëllim.

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e karrigeve dhe ndenjësive të zyrave, dhoma pune, hotele, restorante, lokale shtetërore dhe private
- prodhimin e karrikeve dhe ndenjësive për teatro, kinema dhe të tjera si këto
- prodhimin e mobiljeve speciale për dyqane si banakë, kuti për ekspozitë, rafte etj
- prodhimin e mobiljeve të zyrave
- prodhimin e stolave të laboratorëve, stola dhe ndenjësive të tjera për laboratorë, mobilje për laboratorë (si kabinete dhe tabela)
- prodhimin e mobiljeve për kisha, shkolla, restorante

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e karrocave dekorative për restorante, si karroca për ëmbëlsira, për ushqimet

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e dërrasës së zezë, shih 28.23
- prodhimin e ndenjësive të autoveturave, shih 29.32
- prodhimin e ndenjësive të mjeteve hekurudhore, shih 30.20
- prodhimin e ndenjësive të avionëve, shih 30.30
- prodhimin e mobiljeve të mjekësisë, kirurgjive, stomatologjisë ose veterinare, shih 32.50
- instalimin dhe bashkimin e modeleve të mobiljeve, instalimin pjesor, instalimin e mobiljeve të paisjeve të laboratorëve, shih 43.32

31.02 Prodhimi i mobiljeve të kuzhinës

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e mobiljeve të kuzhinës

31.03 Prodhimi i dyshekëve

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e dyshekëve:
 - dyshekë të pajisur me sustë ose materiale dhe susta të brendëshme me material ndihmës
 - dyshekë plastik ose kauçuku të pambuluar me celula
- prodhimin e mbështetësive të dyshekëve

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e dyshekëve të fryrë, shih 22.19
- prodhimin e dyshekëve prej kauçuku të mbushura me ujë, shih 22.19

31.09 Prodhimi i mobiljeve të tjera

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e divanëve, krevateve divan dhe kolltukëve
- prodhimin e karrikeve dhe ndenjësive të kopshteve
- prodhimin e mobiljeve për dhoma gjumi, dhoma ndenje, kopshte etj.
- prodhimin e dollapëve për makina qepse, televizorë etj

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- përfundimin si vendosjen e tapicerisë së karrikeve dhe ndenjësive
- finiturën e mobiljeve si sprucimi, lysterja, shkëlqimi, etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e pupave, pufëve, jastëkëve, jorganëve dhe jorganëve me pupla, shih 13.92
- prodhimin e mobiljeve prej qeramike, betoni dhe guri, shih 23.42, 23.69, 23.70
- prodhimin e llampave apo paisjeve të ndriçimit, shih 27.40
- prodhimin e ndenjësive të automjeteve, shih 29.32
- prodhimin e ndenjësive të mjeteve hekurudhore, shih 30.20
- prodhimin e ndenjësive të avionëve, shih 30.30
- restaurimin e mobiljeve, shih 95.24

32 Industri të tjera p.k.t.

Kjo ndarje përfshin prodhimin e mallrave të ndryshme të pambuluara në pjesë të tjera të klasifikimit. Meqënëse kjo është një ndarje për mbetjet, prodhimin në proces, materialet që hyjnë në proces dhe produktet e prodhuara mund të ndryshojnë gjerësisht dhe kriteri i përdorur zakonisht për rigrupimin e klasave në ndarje nuk zbatohet këtu.

32.1 Prodhimi i stolive të çmuara, bizhuterive dhe artikuj të ngjashëm me to

Ky grup përfshin prodhimin e stolive të çmuara dhe imitacione të artikujve të çmuar.

32.11 Prerja e monedhave

Kjo klasë përfshin:

- prerjen e monedhave, duke përfshirë monedhat për përdorim legal, me apo jo metale të çmuara

32.12 Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikuj të lidhur me to

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e perlave të punuara
- prodhimin e gurëve të çmuar dhe gjysmë të çmuar, të punuara, duke përfshirë punimin e gurëve cilësorë industrialë dhe sintetikë apo gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar të rikonstruktuar
- punimin e diamanteve
- prodhimin e stolive me metal të çmuar ose metale bazë të veshur me metale të çmuar, ose gurë të çmuar apo gjysmë të çmuar, ose e kombinimeve të metaleve të çmuar me gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar ose materiale të tjera
- prodhimin e artikujve të arpunuesve apo argjendarëve me metale të çmuar ose prej metaleve bazë të veshur me metale të çmuar:
 - takëme ngrënie, pllaka, kupa, artikuj tualeti, artikuj zyre apo tavoline, artikuj për përdorim fetar etj
- prodhimin e artikujve teknik dhe laboratorik prej metali të çmuar (përveç instrumentave dhe pjesëve të tyre): poçe për shkrirje, shpatulla, anoda galvanizuese etj.
- prodhimin me metal të çmuar të rripave të orëve, byzylykëve, kutitë e cigareve.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- prodhimin e gravurave me metal të çmuar ose gjysmë të çmuar

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e rripave të orëve jometalike (pëlhurë, lëkurë, plastik, etj), shih 15.12
Kjo ndarje përfshin instalimin e të gjitha lehtësirave që e bëjnë ndërtimin funksional. Këto punime kryhen zakonisht në vendin e ndërtimit, megjithëse pjesë të punës mund të jenë kryer jashtë në një repart të specializuar. Përfshihen punime të tilla si punime hidraulike, instalimi i sistemit të ngrohjes dhe ajrimit, sistemet e alarmit dhe

punime elektrike, sistemi i shuarjes automatike të zjarrit, ashensorëve dhe eskalatorëve, etj. Gjithashtu janë përfshirë punime të izolimit (ujë, nxehtësi, tingull), punime me fletë metali, punime ftohëse qendrore, instalimi i sistemeve të ndriçimit dhe sinjalistikës për rrugët, hekurudhat, aeroportet, portet, etj. Gjithashtu përfshihet riparimi i punimeve të mësipërme.

Punime përfundimtare të ndërtesave përmbledhin edhe punime që kontribuojnë në përfundimin e ndërtimit si veshja me xham, suvatimi, lyerja, shtrimi i dyshemeve ose mureve me pllaka ose me material tjetër si parket, moket, letër muri, etj. mbushja me rërë e dyshemesë, punime karpentjeri, punime akustike, pastrimi i fasadës, etj. Gjithashtu përfshihet riparimi i punimeve të mësipërme.

Marrja me qira e makinerive me operator klasifikohet me punimin e ndërtimit për të cilin kryhet.

43.1 Prishja dhe përgatitja e kantierit të ndërtimit

Ky grup përfshin:

- punimet për përgatitjen e kantierit të ndërtimit, përfshirë zhvendosjen e strukturave ekzistuese më parë.

43.11 Punime për prishje

Kjo klasë përfshin:

- prishjen ose shembjen e ndërtesave dhe strukturave të tjera.

43.12 Përgatitja e kantierit të ndërtimit

Kjo klasë përfshin:

- pastrimin e vendit të ndërtimit
- heqjen e dherave, gërmimin, mbushjen e tokës, nivelimin dhe shkallëzimin e terrenit (njolla) të ndërtimit, gërmimi në thellësi, heqja e mbeturinave shkëmbore, plasjet me eksploziv, etj.
- përgatitjen e terrenit për gërmime të thella (miniera): heqje masive e dherave dhe punime të tjera për sistemimin e fushave minerare, përveç atyre të naftës e gazit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- drenimin e terrenit të ndërtimit
- drenimin e tokave bujqësore dhe pyjeve

Kjo klasë nuk përfshin:

- shpimin e puseve për nxjerrjen e naftës dhe gazit, shih 06.10, 06.20
- dezinfektimin e tokës, shih 39.00
- shpime për nxjerrjen e ujit, shih 42.21
- shpime të puseve, shih 43.99

43.13 Shpime

Kjo klasë përfshin:

- shpimet provë dhe zgjedhjen e tokës për qëllime ndërtimi, gjeofizike, gjeologjike ose të ngjashme.

Kjo klasë nuk përfshin:

- shpime për prodhimin e naftës, gazit, shih 06.10, 06.20
- shërbime të mirëmbajtjes të shpimeve provë që lidhen me aktivitetin e minierave, shih 09.90
- shpime për nxjerrjen e ujit, shih 42.21
- shpime të puseve, shih 43.99
- eksplorimin e tokës për naftë dhe gaz, studimi gjeofizik, gjeologjik dhe sizmik, shih 71.12

43.2 Punime elektrike, hidraulike dhe të tjera punime instalimi

Ky grup përfshin punimet e instalimit të lehtësirave që shërbejnë për funksionimin e një godine si të tillë, përfshirë instalimin e sistemeve elektrike, hidraulike (ujë, gaz, dhe tubave të shkarkimit), sisteme të ngrohjes dhe të kondicionimit të ajrit, ashensorëve etj.

43.21 Instalime elektrike

Kjo klasë përfshin:

- instalimin e sistemeve elektrike në të gjitha llojet e ndërtesave dhe të strukturave inxhinierike.
 - kabllimi dhe pajisjet elektrike
 - kabllim për telekomunikacion
 - kabllim i rrjetit kompjuterik dhe tekeviziv, përfshirë fibrat optike
 - satelitë
 - sisteme ndriçimi
 - alarm zjarri
 - mbrojtje elektronike kundër vjedhjeve
 - ndriçimi i rrugëve dhe sinjale elektrike
 - ndriçimi i rrugëve të aeroporteve

Kjo klasë gjithashtu përfshin

- lidhjen e pajisjeve elektroshtëpiake dhe pajisjeve shtëpiake, përfshirë dhe ngrohjen e dyshemesë

Kjo klasë nuk përfshin

- ndërtimin e linjave të transmetimit të komunikimit dhe energjisë, shih 42.22
- sistemet elektronike të survejimit normal e në distancë dhe sigurimit sikurse alarmi antivjedhje dhe kundra zjarrit përfshirë instalimin dhe mirëmbajtjen e tyre, shih 80.20

43.22 Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit

Kjo klasë përfshin punime të tilla si punime hidraulike, instalimin e sistemeve të ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar përfshirë shtesa, ndryshime, mirëmbajtje dhe riparime.

Kjo klasë përfshin:

- instalimin në ndërtesa ose vepra të tjera ndërtimi të:
 - sistemeve të ngrohjes (elektrike, gaz dhe naftë)
 - furnaltave dhe kullave të ftohjes
 - kolektorëve të energjisë diellore jo elektrike
 - pajisjeve hidraulike dhe sanitare
 - pajisjeve dhe rrugëve të ventimit, ftohjes ose kondicionimit të ajrit
 - pajisje të gazit
 - tubacioneve të avullit
 - sistemeve të sprucimit kundra zjarrit
 - sistemeve të ujitjes automatike të barit
 - instalime të tubacioneve

Kjo klasë nuk përfshin:

- instalimin e ngrohjes elektrike të dyshemesë, shih 43.21

43.29 Instalime të tjera elektrike

Kjo klasë përfshin instalimin e pajisjeve përveç atyre elektrike, hidraulike, të sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit ose të makinerive industriale në ndërtesa dhe vepra të punimeve inxhinierike.

Kjo klasë përfshin:

- instalimin në ndërtesa ose vepra të tjera ndërtimi të:
 - ashensorëve, eskalatorëve përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre
 - dyerve automatike dhe të rrutullueshme
 - përcjellësve ndriçimi
 - sistemeve pastrimi në vakum
 - izolimit termik, të zhurmave ose vibracioneve

Kjo klasë nuk përfshin:

- instalimin e makinerive industriale, shih 33.20

43.3 Punime përfundimtare të ndërtesave dhe punime të finicionit

43.31 Punime suvatimi

Kjo klasë përfshin:

- aplikimin në ndërtesa ose në të tjera vepra ndërtimi në mjedise të jashtme ose të brendshëm të suvatimit ose stukimit, përfshirë edhe me materiale të tjera.

43.32 Punime montimi

Kjo klasë përfshin:

- vendosjen e dyerve (përveç dyerve automatike e rotulluese), dritareve, kasave të dyerve dhe dritareve, prej druri ose materiale të tjera
- kuzhina të inkastruara, kasat e sirtareve të inkastruara, shkallët, montime raftesh për dyqane dhe të ngjajshme
- kompletimi i punimeve të brendëshme si tavanet, pjesë të tjera të lëvizëshme, etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- vendosjen e dyerve automatike e rotulluese, shih 43.29

43.33 Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve

Kjo klasë përfshin:

- vendosjen në ndërtesë ose në vepra të tjera ndërtimi të elementëve të mëposhtëm:
 - veshja e mureve e dyshemesë me pllaka qeramike, betoni, ose guri të prerë, pllaka qeramike të kaldajave
 - shtrimi me parket dhe të tjera veshjeve druri të dyshemeve, veshja e murit me elementë druri
 - veshje të dyshemesë me mokete dhe linoleum, përfshirë gomën ose plastikën
 - veshje dyshemeje ose muri me terakotë, mermer, granit ose gurë
 - veshje me letër muri

43.34 Lyerja dhe vendosja e xhamave

Kjo klasë përfshin:

- lyerjen e mjediseve të brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesave
- lyerjen e strukturave të punimeve inxhinierike
- instalimin e xhameve, pasqyrave, etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- vendosjen e dritareve, shih 43.32

43.39 Punime të tjera përfundimtare dhe finicioni të ndërtesave

Kjo klasë përfshin:

- pastrimin e ndërtesave të reja pas ndërtimit
- punime të tjera përfundimtare dhe të finicionit të ndërtesave të pa klasifikuara në vend tjetër.

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitete të arkitektëve të interierëve, shih 74.10
- pastrime të vazhdueshme të ndërtesave dhe strukturave të tjera, shih 81.21
- aktivitete të posaçme të pastrimit të specializuara të mjediseve të brendëshme e të jashtme të godinës, shih 81.22

43.9 Punime të tjera të specializuara ndërtimi**43.91 Punime të çatisë**

Kjo klasë përfshin:

- ngritjen e çatisë
- mbulimin e çatisë

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënien me qira të makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit pa operator, shih 77.32

43.99 Të tjera punime të specializuara ndërtimi p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- punime ndërtimi të specializuara për një lloj punimi të njejtë për struktura të ndryshme që kërkojnë njohuri apo pajisje të posaçme:
 - ndërtimi i themeleve, përfshirë vendosjen e pilotave
 - punime për të provuar lagështirën dhe prova për ujën
 - tharja e ndërtesave
 - shpime
 - montimi i strukturave metalike
 - veshje çeliku
 - shtrimi i tullave dhe vendosja e gurëve
 - skeleri dhe platforma pune për ngrohje dhe çmontim skelash duke përjashtuar dhënien me qira të skelave dhe platformave të punës
 - ngritja e oxhakëve dhe furrave industriale
 - punime sipas kërkesës së specialistit që kërkojnë ngjitje dhe përdorimin e pajisjeve të duhura, p.sh. punime në lartësi ose struktura të lartë
- punime nënsipërfaqësore
- ndërtimin e pishinave të zbuluara
- pastrimin me avull, grryerja me rërë dhe punime të ngjajshme për fasadat e ndërtesave
- marrjen me qira të vinçave me operator

Kjo klasë nuk përfshin:

- marrjen me qira të makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit pa operator, shih 77.32

SEKSIONI G - TREGTIA ME SHUMICË DHE ME PAKICË; RIPARIMI I AUTOMJETEVE DHE MOTORÇIKLETAVE

Ky seksion përfshin shitjen me shumicë dhe pakicë (shitje pa transformim) të të gjitha llojeve të mallrave, dhe kryerjen e të gjitha shërbimeve në lidhje me shitjen e mallrave. Shitja me shumicë dhe pakicë janë fazat përfundimtare të shpërndarjes së mallrave. Gjithashtu në këtë seksion janë përfshirë edhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave.

Shitja pa transformim përfshin fazat e zakonshme të punës (ose manovrimet) që lidhen me tregtinë, për shembull, klasifikimin, rigrupimin dhe grumbullimin e mallrave, përzjerjen e mallrave (për shembull rërë), mbushjen në shishe (me ose pa pastrimin e shisheve) paketimin, thyerjen dhe ripaketimin për shpërndarje në pako më të vogla, ruajtja (të ngrira, të freskta ose jo), pastrimi dhe tharja e prodhimeve bujqësore, prerja e fibrave prej druri ose e fletëve metalike si aktivitete të dyta.

Ndarja 45 përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen me shitjen dhe riparimin e automjeteve dhe motorçikletave, ndërsa ndarja 46 dhe 47 përfshin të gjitha aktivitetet e tjera të shitjeve. Dallimi midis ndarjes 46 (Tregtia me shumicë) dhe ndarjes 47 (Tregtia me pakicë) mbështetet në llojin kryesor të klientit. Tregtia me shumicë është rishitja (shitje pa transformim) e mallrave të reja ose të përdorura ndaj shitësve me pakicë, ndaj përdoruesve industrialë, tregtarë, institucionalë, ose profesionalë, ose ndaj shitësve të tjerë me shumicë, ose ndërmjetësimi në blerjen dhe shitjen e mallit ose shitjen e mallit personave apo ndërmarrjeve.

Llojet kryesore të ndërmarrjeve të përfshira janë tregtarët me shumicë p.sh tregtarë ekskluzive të mallrave që ata shesin, distributorë industrialë, eksportues, importues, degë shitje dhe zyra shitje (por jo dyqane të shitjes me pakicë) që mbahen nga njësitë e prodhimit ose njësitë e minierave veçmas nga uzinat e tyre ose minierat për qëllime të marketingut të produkteve të tyre dhe që nuk marin thjesht urdhëra për të furnizuar direkt nga uzinat ose minierat.

Gjithashtu përfshirë janë edhe ndërmjetësit për shitjen e mallrave dhe produkteve, agjentët dhe grumbulluesit, blerësit dhe shoqatat e kooperativave që meren me marketingun e produkteve të fermave.

Tregtarët me shumicë shpesh fizikisht i mbledhin, paketojnë dhe klasifikojnë mallrat në sasi të mëdha, e copetojnë mallin e ripaketojnë dhe e rishpërndajnë në sasi më të vogla, p.sh farmaceutike; depozitojnë, ngrijnë, shpërndajnë, dhe vendosin mallrat, merren me promovimin e shitjeve për klientët e tyre dhe për dizejnimin e firmës.

Shitja me pakicë është rishitja (shitje pa transformim) të mallrave të reja dhe të përdorura kryesisht nga klientët për konsum ose përdorim familjar, nga dyqanet, magazinat e mëdha, shtëpitë e porositë me postë, tregtarëve shëtitës, shitësve me pakicë, kooperativave konsumatore, shitjeve me ankand etj. Shumica e tregtarëve me pakicë e marrin emrin nga malli që ata shesin, por disa veprojnë si agjentë për një shitës kryesor dhe shesin ose në formën e dorëzimit në dorë të mallit ose me bazë komisioni.

45 Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave

Kjo ndarje përfshin të gjitha aktivitetet (përveç prodhimit dhe dhënies me qira) të lidhura me automjetet dhe motorçikletat, përfshirë kamionët dhe maunet si edhe tregtia me shumicë dhe pakicë e mjeteve të reja dhe të përdorura, riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i pjesëve dhe aksesorëve për automjete dhe motorçikleta. Gjithashtu këtu përfshihen edhe aktivitetet e agjentëve e komisionerëve të përfshirë në shitjen me shumicë ose pakicë të automjeteve.

Kjo ndarje përfshin edhe veprime të tilla si larje, pastrim të automjeteve etj.

Kjo ndarje nuk përfshin shitjen me pakicë të karburantit të automjeteve dhe produkteve lubrifikantë ose ftohës ose dhënien me qira të automjeteve dhe motorçikletave.

45.1 Tregtia e automjeteve**45.11 Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël**

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të veturave dhe automjeteve të reja dhe të përdorura:
 - automjete pasagjerësh, përfshirë automjete të specializuar për pasagjerë si ambulancë dhe minibuset etj. (më pak se 3.5 ton)

Kjo klasë gjithashtu përfshin :

- shitjen me shumicë dhe pakicë të automjeteve të rënda si jeeps (më pak se 3.5 ton)

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të pjesëve dhe aksesoreve të automjeteve, shih 45.3
- dhënien me qira të automjeteve me shofer, shih 49.39
- dhënien me qira të automjeteve pa shofer, shih 77.11

45.19 Tregtia e automjeteve të tjerë

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të mjeteve të reja dhe të përdorura:
 - kamionë, rimorkio dhe gjysmë rimorkio
 - mjete kampingu si rulota-shtëpi dhe mjete-shtëpi

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të automjeteve off-road (më shumë se 3.5 ton)

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të pjesëve dhe aksesoreve për automjete, shih 45.3
- dhënien me qira të kamionëve me shofer, shih 49.41
- dhënien me qira të kamionëve pa shofer, shih 77.12

45.2 Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve**45.20 Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve**

Kjo klasë përfshin :

- mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve:
 - riparime mekanike
 - riparime elektrike
 - riparimet e sistemeve elektronike
 - servis i zakonshëm
 - riparimi i karrocërës
 - riparimi i pjesëve të motorrit
 - larje, pastrim etj.
 - lyerje dhe shkëlqim
 - riparimi i ndarësve dhe dritareve
 - riparimi i ndenjësve të automjetit
- riparimin e gomave dhe kamardareve, montimi ose zëvendësimi
- trajtimin kundër ndryshkut
- instalimin e pjesëve dhe aksesoreve jo si pjesë e procesit të prodhimit.

Kjo klasë nuk përfshin :

- rishitjen dhe riformimin e gomave, shih 22.11

45.3 Tregtia e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve

45.31 Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të të gjitha pjesëve, komponentëve, pajisjeve, veglave dhe aksesorëve për automjete si :
 - gomat dhe dhe kamardaret për gomat
 - kandelet, bateri, pajisje ndriçimi dhe pjesë elektrike

45.32 Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të të gjitha pjesëve, komponentëve, pajisjeve, veglave dhe aksesorëve për automjete si:
 - gomat dhe dhe kamardaret për gomat
 - kandelet, bateri, pajisje ndriçimi dhe pjesë elektrike

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të karburantit të automjeteve, shih 47.30

45.4 Shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i motorçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre

45.40 Shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i motorçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë dhe pakicë të motorçikletave përfshirë biçikletat me motor
- shitjen me shumicë dhe pakicë të pjesëve dhe aksesorëve të motorçikletave (përfshirë agjentët me komision dhe shtëpive për porosi me postë)
- mirëmbajtjen e motorçikletave

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të biçikletave dhe pjesëve dhe aksesorëve të tyre, shih 46.49
- shitjen me pakicë të biçikletave dhe pjesëve dhe aksesorëve të tyre, shih 47.64
- dhënien me qira të motorçikletave, shih 77.39
- riparimin dhe mirëmbajtjen e biçikletave, shih 95.29

46 Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motorçikletave

Kjo ndarje përfshin shitjen me shumicë për llogari të vet ose me pagesë në bazë kontrate (komisione tregtare) lidhur me shitjen me shumicë të brendëshme si edhe shitjen me shumicë ndërkombëtare (import/export).

Kjo ndarje nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të mjeteve motorike, furgonëve dhe motorçikletave, shih 45.1, 45.4
- shitjen me shumicë të aksesorëve të mjeteve motorike, shih 45.31, 45.40
- dhënien dhe marrjen me qira të mallrave, shih ndarjen 77
- paketimin e mallrave të ngurtë dhe ambalazhimi në shishe i produkteve të lëngshëm ose të gaztë përfshirë përzierjen ose filtrimin për të tretë, shih 82.92

46.1 Aktivitete të ndërmjetësimit në shitjen me shumicë

Ky grup përfshin:

- aktivitetin e ndërmjetësimit dhe tregtimit me shumicë në emër dhe për llogari të të tjerëve.
- aktivitetin e ndërmjetësve të përfshirë në takimet e blerësve dhe shitësve për të ndërmarrë transaksione tregtarë në emër të aktivitetit kryesor, përfshirë internetin.

Ky grup gjithashtu përfshin:

- aktivitetin e shtëpive të shitjes me shumicë me ankand, përfshirë internetin

46.11 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e lëndëve të para bujqësore si dhe kafshëve të gjalla, lëndëve të para tekstile si dhe mallrave gjysmë të gatshme

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e lëndës së parë bujqësore, kafshëve të gjalla, lëndës së parë tekstile dhe mallrave gjysmë të gatshme

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri 46.9
- shitjen me pakicë jo në dyqan, shih 47.99

46.12 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale përfshirë plehurat kimike

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 to 46.9
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99

46.13 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e lëndës drusore dhe materialeve të ndërtimit

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e lëndës drusore dhe materialeve të ndërtimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 to 46.9
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99

46.14 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e makinerive, pajisjeve industriale, anijeve dhe avionëve

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e makinerive, përfshirë makineri dhe kompjutera zyre, pajisje industriale, anije dhe avionë

Kjo klasë nuk përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e mjeteve motorike, shih 45.1
- aktivitetin e ankandëve për mjete motorike, shih 45.1

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.5, 46.6
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99

46.15 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e mobiljeve mallrave shtëpiakë, artikuj elektronikë dhe hekurishte

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e mobiljeve mallrave shtëpiakë, artikuj elektronikë dhe hekurishte

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri 46.9
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99

46.16 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, peliçeve, këpucëve, dhe artikujve prej lëkure

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e tekstileve, veshjeve, peliçeve, këpucëve dhe artikujve prej lëkure

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri 46.9
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99

46.17 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e mallrave ushqimorë, pijeve dhe duhanit

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin për shitjen e ushqime, pije, duhan

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri 46.9
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99

46.18 Aktivitete të ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçantë ose grupe produktesh p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- ndërmjetësimin e specializuar për shitjen e grupeve të veçantë produktesh të paklasifikuar në vend tjetër

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri 46.9
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99
- aktivitetin e agjentëve të sigurimit, shih 66.22
- aktivitetin e agjentëve të pasurive të patundëshme, shih 68.20

46.19 Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e një varieteti mallrash

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë në emër të vet, shih 46.2 deri 46.9
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan, shih 47.99

46.2 Tregtia me shumicë e lëndëve të para bujqësore dhe kafshëve të gjalla

46.21 Tregtia me shumicë e drithrave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të drithrave dhe farave
- shitjen me shumicë të frutave vajore
- shitjen me shumicë të duhanit të papërpunuar
- shitjen me shumicë të ushqimit për kafshët, mbeturinave dhe mbetjet dhe nën–produktet e përdorura për ushqimin e kafshëve

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë e fibrave tekstile, shih 46.76

46.22 Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të luleve dhe bimëve

46.23 Tregtia me shumicë e kafshëve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të kafshëve

46.24 Tregtia me shumicë e gëzofit e lëkurës

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të gëzofit e lëkurës

46.3 Tregtia me shumicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit

46.31 Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të freskëta
- shitjen me shumicë të frutave dhe perimeve të konservuara

46.32 Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mishit dhe produkteve të mishit

46.33 Tregtia me shumicë e produkteve bulmetore, vezëve, dhe vajit të gatimit e yndyrnave

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të produkteve bulmetore
- shitjen me shumicë të vezëve
- shitjen me shumicë të vajit dhe yndyrnave të ngrënëshme me origjinë bimore ose shtazore

46.34 Tregtia me shumicë e pijeve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të pijeve alkoolike
- shitjen me shumicë të pijeve jo alkoolike

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- blerjen e verës në sasi të madhe dhe ambalazhimi në botë ose shishe pa transformim

Kjo klasë nuk përfshin:

- përzjerjen e verës ose alkoolit të distiluar, shih 11.01, 11.02

46.35 Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë e produkteve të duhanit

46.36 Tregtia me shumicë e sheqerit, çokollatës dhe ëmbëlsirave

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të sheqerit, çokollatës dhe ëmbëlsirave
- shitjen me shumicë të produkteve të furrave pjekëse (bukë, biskota etj)

46.37 Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të kafes, çajit, kakaos dhe erëzave

46.38 Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë të specializuar ushqimorë, përfshirë peshkun, krustacet dhe molusqet

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të peshkut, krustacet dhe molusqet (të freskëta, të ngrira, të konservuara, të thara) si dhe produktet e tyre
- shitjen me shumicë të produkte të tjera ushqimore si: produktet dietetike, kripë, uthull, makarona, miell, mjaltë, maja, etj

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të ushqimit për kafshë shtëpiake

46.39 Tregtia me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë, pije dhe duhan

46.4 Tregtia me shumicë e artikujve shtëpiake

Ky grup përfshin:

- shitjen me shumicë të artikujve shtëpiake, përfshirë tekstilet

46.41 Tregtia me shumicë e tekstileve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të fillit
- shitjen me shumicë të metrazheve
- shitjen me shumicë të pëlhurave shtëpiake si perde, mbulesa, peshqira etj.
- shitjen me shumicë të kinkalerive për tekstile: gjilpëra, shtiza, fije etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të fibrave tekstile, shih 46.76

46.42 Tregtia me shumicë e veshjeve dhe këpucëve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të veshjeve, përfshirë veshje sportive
- shitjen me shumicë të aksesorëve si doreza, kravata dhe rripa
- shitjen me shumicë të këpucëve
- shitjen me shumicë të artikujve prej gezofi
- shitjen me shumicë të çadrave

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të bizhuterive, shih 46.48
- shitjen me shumicë të artikujve prej lëkure, shih 46.49
- shitjen me shumicë të artikujve sportive si çizme për ski etj, shih 46.49

46.43 Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake dhe radio e televizorë

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të pajisjeve elektroshtëpiake
- shitjen me shumicë të radiove dhe televizorëve
- shitjen me shumicë të artikujve fotografike dhe optike
- shitjen me shumicë të paisjeve elektrike për ngrohje
- shitjen me shumicë të shiritave audio dhe video të regjistruar, CD, DVD

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të shiritave audio dhe video të paregjistruar, CD, DVD, shih 46.52
- shitjen me shumicë të makinave qepëse

46.44 Tregtia me shumicë e porcelaneve, qelqurina dhe lëndëve të pastrimit të tyre

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të porcelaneve dhe qelqurina
- shitjen me shumicë të lëndëve të pastrimit

46.45 Tregtia me shumicë e artikujve të parfumerisë dhe kozmetikës

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të artikujve të parfumerisë, kozmetikës dhe sapunëve

46.46 Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutike

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të artikujve farmaceutike, mjeksore, ortopedike, dentare

46.47 Tregtia me shumicë e mobiljeve, qilimave dhe pajisjeve të ndriçimit

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mobiljeve për shtëpi
- shitjen me shumicë të qilimave
- shitjen me shumicë të pajisjeve të ndriçimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të mobiljeve të zyrave, shih 46.65

46.48 Tregtia me shumicë e orëve dhe bizhuterive

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të orëve dhe bizhuterive

46.49 Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë shtëpiakë

Kjo klasë përfshin :

- shitjen me shumicë të artikujve të drurit, shporterisë, dru tape, etj
- shitjen me shumicë të biçikletave dhe pjesëve të aksesorëve të tyre
- shitjen me shumicë të kinkalerive, librave, revistave dhe gazetave
- shitjen me shumicë të artikujve prej lëkure dhe aksesorëve për udhëtim
- shitjen me shumicë të instrumentave muzikorë, lojrave, lodrave dhe artikujve
- shitjen me shumicë të artikujve sportive, përfshirë veshjet speciale sportive si psh. çizme për ski etj.

46.5 Tregtia me shumicë e pajisjeve të informacionit dhe teknologjisë së komunikimit (ICT)

Ky grup përfshin shitjen me shumicë të pajisjeve të informacionit dhe teknologjisë së komunikimit (ICT), p.sh. kompjutera, pajisje të telekomunikacionit dhe pjesëve të tyre.

46.51 Tregtia me shumicë e kompjuterave, pajisjeve periferike të kompjuterave dhe programeve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të kompjuterave dhe pajisjeve periferike të kompjuterave
- shitjen me shumicë të programeve

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të pjesëve elektronike, shih 46.52
- shitjen me shumicë të pajisjeve dhe makinerive të zyrave, (përveç kompjuterave dhe pajisjeve periferike të kompjuterave), shih 46.66

46.52 Tregtia me shumicë e pajisjeve elektronike dhe të telekomunikacionit dhe pjesëve të tyre

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të valvolave dhe tubave elektronikë
- shitjen me shumicë të pajisjeve gjysmëpërçuese
- shitjen me shumicë të mikroçipeve dhe qarqeve të integruar
- shitjen me shumicë të qarqeve të stampuar
- shitjen me shumicë të shiritave audio dhe video të paregjistruar dhe të disketave, disqeve manjetikë dhe optike(CD, DVD)
- shitjen me shumicë të pajisjeve telefonike dhe të komunikimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të shiritave audio dhe video të regjistruar, CD, DVD, shih 46.43
- shitjen me shumicë të kompjuterave dhe pajisjeve periferike të kompjuterave, shih 46.51

46.6 Tregtia me shumicë e makinerive, pajisjeve e pjesëve të tjera

Ky grup përfshin shitjen me shumicë të makinerive të specializuara, pajisjeve dhe pjesëve për të gjitha llojet e industrive dhe makinerive me përdorim të përgjithshëm.

46.61 Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive bujqësore dhe pajisjeve:
 - plugje, shpërndarësve të plehut organik, makinave mbjellëse
 - makinat korrëse
 - makinat shirësë
 - makinat mjelëse
 - makinat e mbajtjes së pulave dhe makinave mbajtësë të bletëve
 - traktorë për t'u përdorur në bujqësi dhe pyje

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të makinave kositëse të barit

46.62 Tregtia me shumicë e veglave të makinerive

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të veglave të makinerive të çdo lloji dhe për çdo lloj materiali

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të veglave të makinerive të komanduara nga kompjuteri

46.63 Tregtia me shumicë e makinerive të minierave, ndërtimit, dhe përpunime inxhinierike

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive të minierave, ndërtimit dhe përpunime inxhinierike

46.64 Tregtia me shumicë makinerive të industrisë tekstile dhe të makinerive qepëse e thurëse

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive për industrinë tekstile dhe të makinerive qepëse e thurëse

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive të komanduara me kompjuter për industrinë tekstile, qepëse e thurëse.

46.65 Tregtia me shumicë e mobiljeve të zyrave

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mobiljeve të zyrave

46.66 Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera të zyrave

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të makinerive dhe pajisjeve të zyrave përveç kompjuterave dhe pajisjeve periferike të kompjuterave

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të kompjuterave dhe pajisjeve periferike të kompjuterave, shih 46.51
- shitjen me shumicë të pjesëve elektronike dhe telefonike pajisjeve të komunikimit, shih 46.52

46.69 Tregtia me shumicë e makinerive, pajisjeve dhe pjesëve p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të pajisjeve të transportit përveç mjeteve motorike, motorçikletave dhe biçikletave
- shitjen me shumicë të linjave të prodhimit të robotëve
- shitjen me shumicë të përcjellësve, çelsave dhe të tjerave pajisje instalimi për përdorim industrial
- shitjen me shumicë të materialeve të tjera elektrike si motorë elektrikë, transformatorë
- shitjen me shumicë të makinerive të tjera të pa klasifikuara në vend tjetër për përdorim në industri (përveç në miniera, ndërtim punime inxhinierike dhe industrinë tekstile), tregti dhe lundrim e shërbime të tjera.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të instrumentave dhe pajisjeve matëse

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të mjeteve motorike, kamionëve dhe furgonëve, shih 45.1
- shitjen me shumicë të pjesëve të mjeteve motorike, shih 45.31
- shitjen me shumicë të motorçikletave, shih 45.40
- shitjen me shumicë të biçikletave, shih 46.49

46.7 Tregti të tjera me shumicë të specializuara

Ky grup përfshin tjetër tregti me shumicë të specializuara të paklasifikuar në grupe ose ndarje të tjera. Ky grup përfshin shitjen me shumicë të produkteve ndërmjetës, përveç atyre bujqësore, veçanërisht jo për përdorim shtëpiak.

46.71 Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhura me to

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me shumicë të karburantit të automjeteve, grasos, lubrifikantëve, vajrave si:
 - qymyr druri, qymyr, koks, dru zjarri, vajguri, naftë e papërpunuar, naftë, benzinë, vajguri, gaze të lëngshëm të naftës, gazit propan butan, vajra lubrifikant, produkte të naftës të rafinuar etj të kësaj natyre.

46.72 Tregtia me shumicë e metaleve dhe mineraleve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mineraleve ferore dhe jo-ferore
- shitjen me shumicë të metaleve ferore dhe jo-ferore në forma fillestare
- shitjen me shumicë të produkteve metalike ferore dhe jo-ferore të paklasifikuar në vend tjetër
- shitjen me shumicë të arit dhe metaleve të tjerë të çmuar

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të skrapit të metalit, shih 46.77

46.73 Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të drurit të papërpunuar
- shitjen me shumicë të produkteve nga përpunimi fillestar i drurit
- shitjen me shumicë të bojrave dhe vernikëve
- shitjen me shumicë të materialeve të ndërtimit:
 - rërë, zhavorr, suva, tulla, çimento etj
- shitjen me shumicë të letrës murale dhe mbulesave të dyshemesë (linoleume, mokete)
- shitjen me shumicë të fletëve të xhamit
- shitjen me shumicë të pajisjeve hidrosanitare:
 - banja, vaska, tualete dhe të tjera pajisje sanitare prej porcelani
- shitjen me shumicë të parafabrikeve për banesë

46.74 Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes dhe pjesëve të tyre

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të pjesëve elektronike dhe bravave
- shitjen me shumicë të armaturave dhe orendive të fiksuara
- shitjen me shumicë të ngrohësve të ujit
- shitjen me shumicë të pajisjeve për instalimin e pajisjeve hidrosanitare:
 - tuba, qyngje, armature, rubineta, T-pjesë, bashkuesve, tuba plastikë (gome) etj.
- shitjen me shumicë të veglave si çekiq, sharra, kaçavida, dhe të tjera vegla dore

46.75 Tregtia me shumicë e produkteve kimikë

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të kimikateve industriale:
 - anilinenë, bojë shtypi, vajra esenciale, gaze industriale, ngjitës kimikë, lëndë ngjyrosëse, rrëshirë sintetike, metanol, parafin, dekorues dhe aromatizues, sodë industriale, kripë industriale, acide dhe sulfure, etj.
- shitjen me shumicë të plehrave kimikë dhe produkte të tjera kimike për bujqësinë

46.76 Tregtia me shumicë e produkteve të tjerë ndërmjetës

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të materialeve plastikë në forma fillestare
- shitjen me shumicë të gomës, kauçukut
- shitjen me shumicë të fibrave tekstile etj.
- shitjen me shumicë të letrës në sasi të madhe
- shitjen me shumicë të gurëve të çmuar

46.77 Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe skrapit

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të mbeturinave metalike dhe jo-metalike, skrapit dhe materialeve për riciklim, përfshirë mbledhjen, nxjerrjen, ndarjen, prerjen e gjërave të përdorura si veturat për të përfutur pjesë të ripërdorëshme, paketimi dhe ripaketimi, grumbullimi dhe shpërndarja, por pa një proces të vërtetë transformimi. Si rezultat mbeturina e shitur dhe e blerë ka një vlerë.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- çmontimin e automjeteve, kompjuterave, televizionëve dhe pajisjeve të tjera për të përfutur dhe shitur pjesë të ripërdorshme.

Kjo klasë nuk përfshin:

- mbledhjen e mbeturinave shtëpiake dhe industriale, shih 38.1
- trajtimin e mbetjeve, jo për një përdorim të mëtejshëm në një proces prodhimi, por me qëllim hedhjen, shih 38.2
- përpunimin e mbeturinave, skrapit dhe artikujve të tjerë në lëndë të para sekondare kur kërkohet një proces i vërtetë transformimi (lënda e parë sekondare është për përdorim të drejtpërdrejtë në një proces prodhimi industrial, por nuk është një produkt përfundimtar), shih 38.3.
- çmontimin e automjeteve, kompjuterave, televizionëve dhe pajisjeve të tjera për material për përpunim, shih 38.31
- çmontimin e anijeve, shih 38.31
- çoptimin e veturave me mjete mekanike, shih 38.32
- shitjen me pakicë të mallrave të përdorur, shih 47.79

46.9 Tregtia me shumicë jo e specializuar

46.90 Tregtia me shumicë jo e specializuar

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me shumicë të njëllojshmërie mallrash pa specializim të posaçëm

47 Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve dhe motorçikletave

Kjo ndarje përfshin rishitjen (shitje pa transformim) e mallrave të reja ose të përdorura kryesisht ndaj publikut të gjerë për konsum ose përdorim personal ose shtëpiak, nga dyqanet, magazinat tregtare, shtëpitë e shitjes me porosi me internet, shitës ambulantë dhe kooperativa të konsumatorëve etj.

Tregtia me pakicë klasifikohet së pari sipas tipit të dyqanit të shitjeve (shitje me pakicë në dyqane: grupet 47.1 deri 47.7; shitje me pakicë jo në dyqane: grupet 47.8 dhe 47.9). Shitja me pakicë përfshin shitjen me pakicë të mallrave të përdorur (klasa 47.79). Për shitje me pakicë në dyqane ka një tjetër dallim midis dyqaneve të specializuar për shitje me pakicë (grupet 47.2 deri 47.7) dhe atyre jo të specializuar të shitjeve me pakicë (grupet 47.1). Grupet e mësipërme janë ndarë më tej sipas llojit të produktit të shitur. Shitjet jo nëpërmjet dyqaneve ndahen sipas formës së tregtisë, si tregti me pakicë në stenda dhe tregje (grupi 47.8) dhe të tjera shitje jo në dyqane, p.sh. me porosi me internet, derë më derë, nëpërmjet makinave ku shitet etj. (grupet 47.9)

Mallrat që shiten në këtë ndarje janë për arsye normale të kufizuara ndaj kërkesave të konsumatorit dhe prandaj në shitjen me pakicë nuk bëjnë pjesë drithërat, mineralet, makineritë dhe pajisjet industriale etj. Kjo ndarje gjithashtu përfshin njësi që merren me shitjen ndaj publikut të gjerë, nga mallrat e ekspozuara, produkte të tilla si makina shkrimi, artikuj shkrimi, bojë ose orendi druri, megjithëse këto shitje mund të mos jenë mallra të konsumit personal ose shtëpiakë. Mund të përfshihen këtu edhe disa përpunime të mallrave por që nuk janë karakteristike për shitjen.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin shitjen me pakicë me agentë me komision dhe shitjet me pakicë me ankand.

Kjo ndarje nuk përfshin:

- shitjen e prodhimeve të fermerëve nga fermerët, shih ndarjen 01
- prodhimin dhe shitjen e mallrave të cilat zakonisht klasifikohen si prodhim në ndarjet 10-32
- shitjen e automjeteve dhe motorçikletave dhe pjesëve të tyre, shih ndarjen 45
- shitjen e drithrave, mineraleve të naftës bruto, kimikateve industriale, hekurit dhe celikut dhe pajisjeve dhe makinerive industriale, shih ndarjen 46
- shitjen e artikujve ushqimorë dhe pijeve për konsum në kushtet e blerjes dhe marrjes me vete të ushqimit të blerë, shih ndarjen 56
- dhënie me qiratë e sendeve personale dhe atyre shtëpiakë ndaj publikut të gjerë, shih grupin 77.2

47.1 Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të një shumëllojshmërie produktesh në të njëjtën njësi, (dyqane jo të specializuar), si supermarketet apo magazinat të mëdha.

47.11 Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar me mbizotërim ushqimor, pije dhe duhan

Kjo klasë përfshin njësi tregtimi që merren me:

- shitjen me pakicë të një shumëllojshmërie produktesh ku mbizotërojnë produktet ushqimore, pijet dhe duhani:
- aktivitetin e dyqaneve të përgjithshëm ku përveç shitjes së tyre kryesore që janë ushqime, pije ose duhan, ofrojnë edhe lloje të tjera produktesh si veshje, mobilje, elektroshtëpiake, pjesë elektronike, kozmetike etj.

47.19 Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqane që merren me:

- shitjen me pakicë të një shumëllojshmërie produktesh ku produktet ushqimore, pijet dhe duhani nuk janë mbizotëruese
- trajtimin në përgjithësi të një linje malli, përfshirë veshjet, mobiljet, elektroshtëpiaket, pjesë elektronike, kozmetike, bizhuteri, lodra, mallra sportive etj.

47.2 Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pije dhe duhan në dyqane të specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë në dyqane të specializuara të produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit.

47.21 Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të frutave dhe perimeve të freskëta
- shitjen me pakicë të frutave dhe perimeve të konservuara

47.22 Tregtia me pakicë e mishit dhe prodhimeve të mishit në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuar në shitjen e:

- mishit dhe prodhimeve të mishit (përfshirë shpendët)

47.23 Tregtia me pakicë të peshkut, krustaceve dhe molusqeve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për :

- shitjen me pakicë të peshkut dhe të tjera produkte të detit dhe nënprodukteve të tyre

47.24 Shitja me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri në dyqane të specializuara**47.25 Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara**

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të pijeve (jo për konsum në lokal):
 - pijeve alkolike
 - pijeve jo-alkolike

47.26 Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuar

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të duhanit
- shitjen me pakicë të produkteve të duhanit

47.29 Tregtia me pakicë e produkteve të tjera ushqimorë në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të produkteve të bulmetrave dhe vezëve
- shitjen me pakicë të produkteve të tjera ushqimore

47.3 Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar**47.30 Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar**

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të karburantit për automjete dhe motorçikleta

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me pakicë të produkteve lubrifikante dhe atyre ftohës për automjete

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me shumicë të karburantit, shih 46.71
- shitjen me pakicë të gazit të lëngët për gatim ose ngrohje, shih 47.78

47.4 Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike e komunikimit në dyqane të specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të pajisjeve të informacionit dhe komunikimit, si kompjutera, pajisje periferike dhe pajisje elektronike të konsumit në dyqane të specializuara.

47.41 Tregtia me pakicë e kompjuterave, njësive periferike dhe softweare në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të kompjuterave
- shitjen me pakicë të pajisjeve periferike të kompjuterave
- shitjen me pakicë të tastierave të lojrave elektronike
- shitjen me pakicë të software jo me porosi, përfshirë video-games

47.42 Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuar

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të pajisjeve të telekomunikacionit

47.43 Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuar

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të pajisjeve të radios dhe televizionit
- shitjen me pakicë të pajisjeve stereo
- shitjen me pakicë të CD dhe DVD players dhe recorders

47.5 Tregtia me pakicë e pajisjeve shtëpiake në dyqane të specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të pajisjeve shtëpiake, si tekstile, pjesë elektronike, qilima, elektroshtëpiake ose mobilje në dyqane të specializuara.

47.51 Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të pëlhurave
- shitjen me pakicë të tekstileve methurje
- shitjen me pakicë të materialeve bazë për bërjen e sixhadeve, tapiceri dhe për qëndistari
- shitjen me pakicë të tekstileve
- shitjen me pakicë të kinkalerive, gjilpërave, fillit për qepje etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të veshjeve, shih 47.71

47.52 Tregtia me pakicë e pjesëve elektronike, bojrave dhe xhamit në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të pjesëve elektronike
- shitjen me pakicë të bojrave, vernikëve dhe llakeve
- shitjen me pakicë të xhamit fletë
- shitjen me pakicë të materialeve të tjera ndërtimi si tulla, dru dhe pajisje hidrosanitare
- shitjen me pakicë të materialeve dhe pajisjeve që përgatiten vetë

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen me pakicë e makinave kositësë të barit sido që të operojnë
- shitjen me pakicë të vaskave për sauna

47.53 Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të qilimave dhe sixhadeve
- shitjen me pakicë të perdeve
- shitjen me pakicë të veshjeve të mureve dhe të dyshemeve

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të pllakave prej tape për veshjen e dyshemesë, shih 47.52

47.54 Tregtia me pakicë e pajisjeve elektroshtëpiake në dyqane të specializuara

Kjo klasë nuk përfshin shitjen me pakicë të pajisjeve audio e video, shih 47.43

47.59 Tregtia me pakicë e mobiljeve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të mobiljeve të shtëpive
- shitjen me pakicë të artikujve për ndriçim
- shitjen me pakicë të enëve të kuzhinës dhe takëmeve si lugë, pirunj, thika, fajanca, qelqe, porcelane dhe qeramike
- shitjen me pakicë të artikujve prej tape, prej druri dhe artikuj shporterie
- shitjen me pakicë të pajisjeve shtëpiake jo-elektrike

- shitjen me pakicë të instrumentave muzikorë
- shitjen me pakicë të sistemeve të sigurimit, si pajisje kyçëse, siguresa, etj, pa instalim ose shërbime mirëmbajtje
- shitjen me pakicë të artikujve dhe pajisjeve shtëpiake jo të klasifikuara në vend tjetër

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të artikujve antike, shih 47.79

47.6 Tregtia me pakicë e mallrave kulturorë dhe të argëtimit në dyqane të specializuara

Ky grup përfshin shitjen me pakicë në dyqane të specializuar të mallrave kulturorë dhe të argëtimit si libra gazeta, rregjistruar muzike dhe video, pajisje sportive, lojra dhe lodra.

47.61 Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të librave të të gjitha llojeve

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të librave të përdorur ose antikë, shih 47.79

47.62 Tregtia me pakicë e gazetave dhe artikuj shkrimorë në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të gazetave

Kjo klasë gjithashtu përfshin :

- shitjen me pakicë të artikujve të zyrave si stilograf e stilolapse, lapsa, letër etj

47.63 Tregtia me pakicë e regjistruar muzikorë dhe video në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të regjistruar muzikorë, shiritave zanorë, kompakt disqeve dhe kasetave
- shitjen me pakicë të shiritave video dhe DVD

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitje me pakicë të shiritave dhe disqeve të paregjistruara

47.64 Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të mallrave sportivë, pajisjeve të peshkimit, mallrave të kampingut, varkave dhe biçikletave

47.65 Tregtia me pakicë e lojrave dhe lodrave në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të lojrave dhe lodrave të bëra me materiale të ndryshme

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të tastierave të lojrave video, shih 47.41
- shitjen me pakicë të programeve jo me porosi përfshirë edhe lojrat video, shih 47.41

47.7 Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara

Ky grup përfshin shitjen në dyqane të specializuara që trajtojnë një linjë të caktuar produktesh të pa përfshira në klasa të tjera të klasifikimit, si veshje, këpucë dhe artikuj lëkure, mallra farmaceutike dhe mjeksore, orë, dhurata, materiale pastrimi, armë, lule, kafshë shtëpie dhe të tjerë. Gjithashtu përfshihet shitja me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane të specializuara.

47.71 Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të veshjeve
- shitjen me pakicë të artikujve prej gëzofi
- shitjen me pakicë të aksesorëve të veshjeve si doreza, kravata, rripave etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të tekstileve, shih 47.51

47.72 Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të këpucëve
- shitjen me pakicë të artikujve të lëkurës
- shitjen me pakicë të aksesorëve të udhëtimit prej lëkure dhe imitacion lëkure

Kjo klasë nuk përfshin:

- paisje speciale sportive si kepucë skish, shih 47.64

47.73 Shitja e përgatitja e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të artikujve farmaceutikë

47.74 Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të artikujve ortopedikë dhe mjeksorë

47.75 Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të artikujve të parfumerisë, kozmetikës dhe tualetit

47.76 Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre

47.77 Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të orëve, sahatëve dhe bizhuterive

47.78 Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara

Kjo klasë përfshin dyqanet e specializuara për:

- shitjen me pakicë të pajisjeve fotografike, optike dhe të precizionit
- aktivitetin e dyqaneve optikë
- shitjen me pakicë të dhuratave, të artikujve të artizanatit dhe fetarë
- aktivitetin e galerive të artit komerciale
- shitjen me pakicë të naftës për përdorim shtëpiak, gazit të ambalazhuar, qymyrit dhe drurit të zjarrit
- shitjen me pakicë të armëve dhe municioneve
- shitjen me pakicë të pullave dhe monedhave
- shërbimet me pakicë të galerive të artit komercial
- shitjen me pakicë të produkteve jo ushqimore të paklasifikuara në vend tjetër

47.79 Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të librave të përdorur
- shitjen me pakicë të mallrave të tjerë të përdorur
- shitjen me pakicë të antikitetëve
- aktivitetin e shtëpive të ankandit (me pakicë)

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen me pakicë të automjeteve të përdorur, shih 45.1
- aktivitetin e ankandit me internet dhe të tjerë ankande jo në dyqane (me pakicë), shih 47.91, 47.99
- aktivitetin e dyqaneve të lënies peng, shih 64.92

47.8 Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje

Ky grup përfshin shitjen me pakicë të çdo lloji të produkteve të reja ose të përdorura në një stendë të lëvizëshme ose përgjatë një rruge publike ose në një vendtregtimi fiks.

47.81 Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit

Kjo klasë nuk përfshin :

- shitjen me pakicë të ushqimit të përgatitur për konsum të çastit (shitës ambulantë të ushqimeve), shih 56.10

47.82 Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të tekstileve, veshjeve dhe këpucëve

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë në tenda dhe tregje të tekstileve, veshjeve dhe këpucëve

47.89 Tregtia me pakicë në tenda dhe tregje të mallrave të tjera

Kjo klasë përfshin:

- shitje me pakicë të mallrave të tjerë në tenda dhe tregje si:
 - qilima dhe sixhade
 - libra
 - lojra dhe lodra
 - pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike të konsumit
 - regjistruar muzike dhe video

47.9 Tregtia me pakicë jo në dyqane, tenda ose tregje

Ky grup përfshin shitjen me pakicë me porosi me mail, nëpërmjet internetit, shitje derë më derë, makinave që shesin etj.

47.91 Tregtia me pakicë me porosi me mail ose nëpërmjet internetit

Kjo klasë përfshin shitjen me pakicë ku blerësi bën zgjedhjen e tij mbi bazën e publicitetit, katalogjeve, informacionit të ofruar nëpërmjet website, modeleve ose ndonjë mjeti tjetër publiciteti. Klienti e bën porosinë e tij me postë, telefon ose nëpërmjet internetit (zakonisht nëpërmjet mjeteve të websites). Produktet e blera mund të jenë ose direkt të shkarkuara nga interneti ose fizikisht të dërguara klientit.

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të çdo lloj produkti nëpërmjet porosisë me postë
- shitjen me pakicë të çdo lloji produkti nëpërmjet internetit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shitjen direkt nëpërmjet televizionit, radios dhe telefonit, ankandit me internet me pakicë

47.99 Tregtia me pakicë të artikujve të tjerë jo në dyqane, tenda ose tregje

Kjo klasë përfshin:

- shitjen me pakicë të çdo lloj produkti në ndonjë mënyrë tjetër që nuk është përfshirë në klasat e mësipërme:
 - nëpërmjet shitjeve direkte me shitës derë më derë
 - nëpërmjet makinave që shesin etj.
- shitjen direkte të lëndëve djegëse (naftë për ngrohje, dru zjarri, etj), dorëzuar në banesën e klientit
- aktivitetin e ankandëve jo në dyqan (me pakicë)
- shitjen me pakicë nga agjentët e shitjes jo në dyqan

SEKSIONI H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI

Ky seksion përfshin kryerjen e transportit të rregullt ose jo, të pasagjerëve apo të mallrave me hekurudhë, me tubacion, rrugor, ujor, ose ajror dhe aktivitete të lidhura të tilla si lehtësira terminali dhe parkimi, dorëzim ngarkese, magazinim etj. Në këtë seksion përfshihet edhe dhënia me qira e mjeteve të transportit me shofer ose operator. Gjithashtu përfshihen aktivitetet e postës ose shërbimet me korier.

Ky seksion nuk përfshin:

- riparimin e përgjithshëm ose modifikimin e mjeteve të transportit, përveç motorçikletave, shih grupin 33.1
- ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve, hekurudhave, porteve, fushave të aviacionit, shih ndarjen 42
- mirëmbajtjen dhe riparimin e motorçikletave, shih 45.20
- dhënien me qira të mjeteve të transportit pa shofer ose operator, shih 77.1, 77.3

49 Transporti tokësor dhe me tubacione

Kjo ndarje përfshin transportin e pasagjerëve dhe mallrave me rrugë tokësore, transportin hekurudhor si edhe transportin e mallrave me tubacione.

49.1 Transporti hekurudhor interurban i pasagjerëve

49.10 Transporti hekurudhor interurban i pasagjerëve

Kjo klasë përfshin:

- transportin hekurudhor interurban të pasagjerëve në rrjetet e linjave kryesore hekurudhore, të shtrirë në një sipërfaqe gjeografike të madhe;
- transportin e pasagjerëve me hekurudhë që operon me distanca të vogla në një linjë lokale hekurudhore;
- aktivitetin e vagonëve me fjetje dhe me ngrënie si pjesë e integruar e punës së kompanive hekurudhore.

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin e pasagjerëve në sistemin tranzit brenda dhe jashtë qytetit, shih 49.31
- aktivitetin e terminalit të pasagjerëve, shih 52.21
- aktivitetet e lidhura me infrastrukturën e hekurudhave, si hapje dhe mbyllje, shih 52.21
- aktivitetin e vagonëve me fjetje dhe me ngrënie kur operohet nga njësi të vecanta, shih 55.90, 56.10

49.2 Transporti hekurudhor i mallrave

49.20 Transporti hekurudhor i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- transportin hekurudhor të mallrave duke përdorur rrjetin e linjave kryesore hekurudhore, të shpërndara në sipërfaqe gjeografike të madhe, apo në linjat dytësore.

Kjo klasë nuk përfshin:

- magazinimin dhe ruajtjen, shih 52.10
- aktivitetet e terminaleve të mallrave, shih 52.21
- aktivitetet e lidhura me infrastrukturën e hekurudhave, si hapje dhe mbyllje, shih 52.21
- dorëzimin e ngarkesës, shih 52.24

49.3 Transporte të tjerë rrugor të pasagjerëve

Ky grup përfshin të gjitha aktivitetet e transportit rrugor të pasagjerëve përveç atij hekurudhor.

49.31 Transporti rrugor i pasagjerëve me sistemin urban

Kjo klasë përfshin:

- transportin rrugor të pasagjerëve nëpërmjet sistemit të transportit urban.

Kjo përfshin mënyra të ndryshme të transportit rrugor si me autobus, tramvaj, trolejbus, metro, dhe hekurudha të ngritura etj. Transporti kryhet në rrugë të përcaktuara normalisht duke ndjekur një orar të përcaktuar, duke respektuar hipjen dhe zbritjen e pasagjerëve në stacione të fiksuara të ndalimit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- linjat qytet - aeroport ose qytet - stacioni i linjave
- aktivitetin e hekurudhave të kapura, rrugëve ajrore me kablo (teleferik) etj. nëse janë pjesë e sistemeve të transportit urban.

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin e pasagjerëve me hekurudhë ndër-qytetëse, shih 49.10

49.32 Aktiviteti i taksive

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin e taksive

49.39 Transporte të tjerë rrugor të pasagjerëve

Kjo klasë përfshin :

- transporte të tjerë rrugor të pasagjerëve:
 - shërbim i transportit të rregullt të pasagjerëve me autobus në distancë të gjatë
 - shërbime charter, ekskursione dhe transporte të tjerë të rastit me autobus
 - shërbimi me autobus në aeroport
- aktivitetin e teleferikëve, transportit me kabëll, ashensorëve me kablo dhe skive nëse nuk janë pjesë e sistemeve urbane

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- tipet e tjera të dhënies me qira të veturave private me shofer
- autobuset e shkollave dhe të transportit të të punësuarve
- transportin e pasagjerëve dhe mjeteve të drejtuara nga njeriu ose kafsha

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin me ambulancë, shih 86.90

49.4 Transporti rrugor i mallrave

Ky grup përfshin të gjitha llojet e transporteve rrugore të mallrave përveç atij hekurudhor.

49.41 Transporti rrugor i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- të gjitha llojet e transportit rrugor të mallrave:
 - transporti i trupave të drurit
 - transporti me kamion
 - kamion frigorifer
 - kamion i tonazhit të rëndë
 - transporte në sasi të madhe, përfshirë atë në tankera, përfshirë grumbullimin e qumështit në ferma
 - transporti i automjeteve
 - transporti i plehrave ose mbeturinave pa kolektor ose hedhje

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qera të kamionëve me shofer
- transportin e mallrave dhe i mjeteve të drejtuara nga njeriu ose kafsha

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin e trungjeve brenda pyllit, si pjesë e shfrytëzimit të pyllit, shih 02.40
- shpërndarjen e ujit me kamiona, shih 36.00
- lehtësirat e terminaleve për dorëzimin e mallrave, shih 52.21
- shërbimet e paketimit dhe mbylljes në kuti për transportim, shih 52.29
- aktivitetin e postave dhe korjerëve, shih 53.10, 53.20
- transportin e plehrave si pjesë e integruar e mbledhjes së plehrave, shih 38.11, 38.12

49.42 Shërbime të lëvizëshme

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet e lëvizëshme ndaj bizneseve dhe familjeve me transport rrugor

49.5 Transporti me tubacion**49.50 Transporti me tubacion**

Kjo klasë përfshin:

- transportin e gazit, lëngjeve, ujit, gëlqeres dhe produkteve të tjera nëpërmjet tubacioneve

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- stacionet e pompimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- shpërndarjen e gazit natyror ose të prodhuar, ujit ose avullit (përfshirë shpërndarjen e ujit me kamion), shih 35.22, 35.30, 36.00
- transportin e lëngjeve, etj. me kamion, shih 49.41

50 Transporti uhor

Kjo ndarje përfshin transportin uhor të rregullt ose jo, të pasagjerëve apo të mallrave. Gjithashtu përfshihen edhe rimorkimi i anijeve, anijet për eskursion, turistike, taksi uji etj. Megjithëse vendndodhja është një tregues për ndarjen midis transportit detar dhe uhor, faktori vendimtar në këtë rast është lloji i mjetit të përdorur. Transporti detar me anije klasifikohet në grupet 50.1 dhe 50.2, ndërsa transporti duke përdorur anije të tjera klasifikohet në grupet 50.3 dhe 50.4.

Kjo ndarje nuk përfshin aktivitetin e restoranteve dhe bar-eve në bordin e anijes (shih klasat 56.10, 56.30), nëse kryhet nga njësi të veçanta.

50.1 Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve

Ky grup përfshin transportin detar dhe bregdetar të pasagjerëve me anije të përshtatëshme. Përfshihet gjithashtu transporti i pasagjerëve në liqene të mëdhenj etj. kur përdoren lloje të ngjajshme anijesh.

50.10 Transporti detar dhe bregdetar i pasagjerëve

Kjo klasë përfshin:

- transportin detar dhe bregdetar, të rregullt ose jo, të pasagjerëve
 - anije për eskursione, turistike
 - taksi turistike ujore, etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënie me qera të anijeve turistike me ekuipazh për transport detar dhe bregdetar (p.sh. për turizëm peshkimi)

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetin e restoranteve dhe bar-eve në bordin e anijes të kryera nga njësi të veçanta, shih 56.10, 56.30
- aktivitetin e kazinove, shih 92.00

50.2 Transporti detar dhe bregdetar i mallrave

Ky grup përfshin transportin e mallrave me anije të përshtatshme për të lundruar në ujëra detare dhe bregdetare.

Përfshihet gjithashtu transporti i mallrave në liqene të mëdhenj etj. kur përdoren tipe të ngjajshme anijesh.

50.20 Transporti detar dhe bregdetar i mallrave

Kjo klasë përfshin:

- transportin në ujëra detare dhe bregdetare, të rregullt ose jo, të mallrave
- transportin me lundër me shtyrje ose tërheqje me litarë etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- ruajtjen e mallit, shih 52.10
- aktivitetin e porteve dhe aktivitete të tjera ndihmëse si futja e anijes në dok, drejtimi, ndriçimi, shpëtimi i anijeve, shih 52.22
- dorëzimin e ngarkesës, shih 52.24

50.3 Transporti ujor në ujra të brendshme

Ky grup përfshin transportin e pasagjerëve në ujra të brendshme, me anije që nuk janë të përshtatëshme për transport detar.

50.30 Transporti ujor i pasagjerëve në ujra të brendshme

Kjo klasë përfshin:

- transportin e pasagjerëve në lumenj, kanale, liqene dhe në rrugë ujore të brendshme, përfshirë limane dhe porte të brendshëm

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënie me qera të anijeve turistike me ekuipazh për transport ujor të brendshëm

50.4 Transporti ujqor i mallrave në ujra të brendshme

Ky grup përfshin transportin e mallrave në ujra të brendshme, me anije që nuk janë të përshtatshme për transport detar

50.40 Transporti ujqor i mallrave në ujra të brendshme

Kjo klasë përfshin:

- transportin e mallrave në lumenj, kanale, liqene dhe në rrugë ujore të brendshme, përfshirë limane dhe porte të brendshëm

51 Transporti ajror

Kjo ndarje përfshin transportin e pasagjerëve apo të mallrave me avion ose në rrugë ajrore.

Kjo ndarje nuk përfshin:

- spërkatjen e bimëve nga lart, shih 01.61
- kontrollin e avionëve dhe motorëve të avionëve, shih 33.16
- aktivitetin e aeroporteve, shih 52.23
- publicitetin ajror, shih 73.11
- fotografitë ajrore, shih 74.20

51.1 Transporti ajror i pasagjerëve**51.10 Transporti ajror i pasagjerëve**

Kjo klasë përfshin:

- transportin e pasagjerëve me rrugë ajrore, në rrugë të rregullta dhe me orare të rregullta
- udhëtimet me charter të pasagjerëve
- fluturimet turistike e skenike

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënien me qira të pajisjeve të transportit ajror me operator për transport të pasagjerëve
- aktivitetet e përgjithëshme të aviacionit si:
 - transporti i pasagjerëve me aeroklub për instruksion ose argëtim

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënien me qira të pajisjeve të transportit ajror pa operator për transport të pasagjerëve, shih 77.35

51.2 Transporti ajror i mallrave dhe transporti hapësinor**51.21 Transporti ajror i mallrave**

Kjo klasë përfshin:

- transportin e mallrave me rrugë të rregullta ajrore dhe orare të rregullta;
- transportin e mallrave në rrugë ajrore jo të rregullta.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënia me qira e pajisjeve të transportit ajror me operator me qëllim transportin e mallrave

51.22 Transporti hapësinor

Kjo klasë përfshin:

- hedhjen e satelitëve dhe mjeteve hapësinorë;
- transportin hapësinor të mallrave dhe pasagjerëve

52 Magaznimi dhe aktivitete mbështetëse për transportin

Kjo ndarje përfshin magazinimin dhe aktivitetet mbështetëse për transport, si operimin e infrastrukturës së transportit (p.sh. aeroportet, skelat, portet, tunelet, urat, etj.), aktivitetet e agjencive të transportit dhe të dorëzimit të mallrave.

52.1 Magaznimi dhe ruajtja**52.10 Magaznimi dhe ruajtja**

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin e strukturave për magazinimin dhe ruajtjen e të gjitha llojeve të mallrave:
 - sillose të grurit, magazina të përgjithshme të mallrave, magazina frigorifer, tanke të ruajtjes së mallit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- ruajtjen e mallrave në zona të jashtme (të huaja) tregtimi

Kjo klasë nuk përfshin:

- parkimin për automjetet, shih 52.21
- vetë ruajtjen e mallit, shih 68.20
- dhënien me qera të hapësirave bosh, shih 68.20

52.2 Aktivitete mbështetëse për transportin

Kjo ndarje përfshin aktivitetet mbështetëse të transportit të pasagjerëve dhe mallrave, si pjesë e infrastrukturës së transportit ose aktiviteteve që lidhen me dorëzimin e mallit menjëherë, para ose pas transportit ose midis segmenteve të transportit. Ketu përfshihet edhe aktiviteti dhe mirëmbajtja e strukturave të transportit.

52.21 Shërbime të ndryshme ndaj transportit tokësor

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet lidhur me transportin tokësor të pasagjerëve, të kafshëve apo të mallrave :
 - aktiviteti i lehtësirave të terminaleve si stacione hekurudhorë, stacione autobusi, stacione për dorëzimin e mallrave
 - aktivitete të infrastrukturës së hekurudhave
 - aktivitete të rrugëve, urave, tuneleve, parkimit dhe garazheve të veturave, parkime bicikletash, ruajtje gjatë stinës së dimrit e furgonëve (caravan)
- aktivitetet e infrastrukturës së hekurudhave
- shërbimin e rimorkimit dhe asistencës në rrugë

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- lëngëzimin e gazit për qellime transporti

Kjo klasë nuk përfshin :

- dorëzimin e ngarkesës, shih 52.24

52.22 Shërbime të ndryshme ndaj transportit ujor

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet lidhur me transportin ujor të pasagjerëve, të kafshëve apo të mallrave :
 - lehtësirat e terminaleve të porteve dhe skelave
 - veprimet e portave të kanaleve të ujit etj.
 - navigacion, pilotim dhe veprime të ankorimit
 - aktivitete të ndricimit dhe shpëtimit
 - fanarin e detit

Kjo klasë nuk përfshin:

- dorëzimin e ngarkesës, shih 52.24
- aktivitetin e flotës detare, shih 93.23

52.23 Shërbime të lidhura me transportin ajror

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet që lidhen me transportin ajror të pasagjerëve, të kafshëve apo të mallrave:
 - lehtësirat e terminaleve si p.sh terminaleve të aeroporteve etj.
 - aktivitete të kontrollit të trafikut ajror
 - aktivitete të shërbimeve tokësore në aeroporte etj.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shërbimet e shuarjes së zjarrit dhe parandalimit të tij në aeroporte

Kjo klasë nuk përfshin:

- dorëzimin e ngarkesës, shih 52.24
- aktivitetin e shkollave të fluturimit, shih 85.53

52.24 Dorëzimi i ngarkesës

Kjo klasë përfshin:

- ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave ose bagazheve të pasagjerëve, pavarësisht nga mjeti i përdorur i transportit
- punëtor të ngarkim shkarkimit
- ngarkimin dhe shkarkimin e vagonëve të mallrave

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetin e lehtësirave të terminaleve, shih 52.21, 52.22 dhe 52.23

52.29 Aktivitete të tjera mbështetëse të transportit

Kjo klasë përfshin:

- dërgimin e mallrave
- organizimin e transporteve rrugorë, hekurudhorë, ujor ose ajrorë
- organizimin e dorëzimit në grup ose individual (përfshirë marrjen dhe shpërndarjen e dërgesës dhe grupimin e tyre)
- nxjerrjen dhe prokurimin e dokumentave të transportit dhe të faturave shoqëruese të mallit
- aktivitetin e agjentëve të klientëve
- aktivitetin e dërguesve të ngarkesave me transport detar dhe të agjentëve të ngarkesave të transportuara në rrugë ajrore

- komisionerët e hapësirave për anijet dhe avionët
- aktivitetin e dorëzimit të mallrave, p.sh. paketimeve të përkohshëm për të vetmin qëllim të mbrojtjes së mallrave gjatë tranzitit, shpaktimit, zgjedhjes, peshimit të tyre.

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetin e korrierëve, shih 53.20
- pajisjen me siguracion për motorat, mjetet e lundrimit, aviacionin, dhe transportin, shih 65.12
- aktivitetin e agjencive të udhëtimit, shih 79.11
- aktivitetin e operatorëve turistikë, shih 79.12
- aktivitetin e asistencës turistike, shih 79.20

53 Aktivitete të postës dhe korrierës

Kjo ndarje përfshin aktivitetet postare dhe të korrierës, si marrja, transporti dhe shpërndarja e letrave dhe pakove nën organizime të ndryshme. Përfshihen gjithashtu dorëzimi lokal dhe shërbime të lajmërimit.

53.1 Aktivitete të postave me detyrimin e shërbimit të përgjithshëm

53.10 Aktivitete të postave me detyrimin e shërbimit të përgjithshëm

Kjo klasë përfshin aktivitetin e shërbimeve të postave që operojnë sipas detyrimit të shërbimit të përgjithshëm, me një ose më tepër ofrues të shërbimit të përgjithshëm. Këto aktivitete përfshijnë përdorimin e infrastrukturës të shërbimit të përgjithshëm, përfshirë vendndodhjet e shitjes me pakicë, lehtësira të nxjerrjes dhe përpunimit, dhe rrugët për të marrë dhe shpërndarë postën. Kjo shpërndarje mund të përfshijë letrat postare, kartolinat, shtypshkrimet (gazeta, periodikë, material publiciteti, etj.), paketa të vogla, mallra ose dokumenta. Gjithashtu përfshihen shërbime të tjera të nevojshme për mbështetjen e detyrimeve të shërbimit të përgjithshëm.

Kjo klasë përfshin:

- marrjen, nxjerrjen, transportin dhe shpërndarjen, e brendëshme ose ndërkombëtare, të postimit të letrave dhe pakove (mail-type) dhe dengjeve me shërbim postar që veprojnë sipas detyrimit të shërbimit të përgjithshëm. Ky aktivitet mund të kryhet në një ose disa mënyra transporti me mjete të veta (private) ose me transport publik.
- mbledhjen e letrave të postuara dhe e pakove nga kutitë postare ose nga zyrtat postare

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetin e arkave të kursimeve postare, porosi dërgesash parash me postë e aktivitete me karakter financiar, shih 64.19

53.2 Aktivitete të tjera postare dhe të korrierës

53.20 Aktivitete të tjera postare dhe të korrierës

Kjo klasë përfshin:

- marrjen, nxjerrjen, transportin dhe shpërndarjen, të brendëshme ose ndërkombëtare, e letrave, dhe pakove postare ose dengjeve postare, nga firma që operojnë jashtë detyrimit të përgjithshëm të detyruar. Mund të përdoren një ose më shumë mënyra transporti dhe aktiviteti mund të kryhet ose me transport të vet ose me transport publik.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shërbimin e dorëzimit të postës në shtëpi

Kjo klasë nuk përfshin:

- transportin e mallrave, shih (sipas mënyrës së transportit) 49.20, 49.41, 50.20, 50.40, 51.21, 51.22

SEKSIONI I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR

Ky seksion përfshin kushte akomodimi për qëndrime të shkurtra për vizitore dhe udhetarë të tjerë, dhe ushqim të plotë e pije për konsum të menjëhershëm Llojet dhe sasia e shërbimeve shtesë të ofruara brenda këtij sektori mund të variojnë shumë.

Ky seksion nuk përfshin akomodimin me kohë të gjatë si vend qëndrimi kryesor, i cili është klasifikuar në aktivitetet e Real estate (seksioni L). gjithashtu është përjashtuar përgatitja e ushqimeve dhe pijeve që nuk janë për konsum të menjëhershëm ose që janë shitur nëpërmjet kanaleve shpërndarës të pavarur, p.sh. nëpërmjet tregtisë me shumicë ose pakicë. Përgatitja e këtyre ushqimeve klasifikohet në Përpunim (seksioni C).

55 Akomodimi

Kjo ndarje përfshin kushte akomodimi për qëndrime të shkurtëra për vizitorë dhe udhëtarë të tjerë. Gjithashtu, përfshin akomodim të gjatë për studentët, punëtorët dhe individë të ngjashëm. Disa njësi mund të ofrojnë vetëm akomodim, ndërsa të tjerë një kombinim të akomodimit me vaktet dhe/ose lehtësira argëtuese. Kjo ndarje nuk përfshin aktivitetet në lidhje me akomodimin afatgjatë si rezidence primare në lehtësira si apartamente me qira me bazë mujore ose vjetore, klasifikuar në Real Estate (seksioni L)

55.1 Hotele dhe struktura të ngjashme

55.10 Hotele dhe struktura të ngjashme

Kjo klasë përfshin kushte akomodimi kryesisht për qëndrime të shkurtra, ditore ose javore për vizitorët. Kjo përfshin ofrimin e mobilimit të dhomave dhe suitave. Shërbimet përfshijnë pastrimin ditor dhe rregullimin e shtretërve. Shërbime shtesë mund të ofrohen të tilla si: shërbime ushqimi, pije, parking, lavanteri, pishina, palestra, gjimnastikë lehtësirat argetuese dhe lehtësirat për konferenca dhe kongrese

Kjo klasë përfshin akomodimin e dhënë nga:

- hotele
- resort hotelier (kompleks turistik)
- suite / apartament hotel
- motele

Kjo klasë nuk përfshin:

- shtëpi dhe apartamente të mobiluar ose jo, ose apartamente për qëndrime më të gjata, të përhershme, zakonisht me bazë mujore ose vjetore, shih ndarjen 68

55.2 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive

55.20 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive

Kjo klasë përfshin kushte akomodimi për qëndrime të shkurtra ditore ose javore për vizitorët, të organizuara në dhoma të mobilura ose hapësira fjetjeje dhe ngrënie me lehtësira gatimi dhe kuzhina plotësisht të pajisura. Kjo mund të ketë formën e apartamenteve në godina të vogla të vecanta ose në godina me shumë kate, grumbull godinash, ose shtëpi njëkatëshe të veçanta, ose vila, ose kabina. Në këton rast ka shumë pak, ose nuk ka asnjë shërbim plotësues.

Kjo klasë përfshin akomodimin e dhënë nga:

- shtëpi pushimi për fëmijë dhe të tjerë.
- apartamente dhe shtëpi njëkatëshe për vizitorë
- shtëpi pushimi familjare pa shërbim në dhome.
- bujtina të rinjsh dhe streha malore

Kjo klasë nuk përfshin:

- akomodime të shkurtra me mobilim me pastrim ditor, shtrim shtrati, shërbim ushqimi dhe pije, shih 55.10
- shtëpi dhe apartamente të mobiluar ose jo, ose apartamente për qëndrime më të gjata, të përhershme, zakonisht me bazë mujore ose vjetore, shih ndarjen 68

55.3 Parqe automjesh, kamionësh dhe kampingje për argëtim

55.30 Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi

Kjo klasë përfshin ofrimin e hapësirave dhe të lehtësirave për akomodimin në kampingje e parqe, për çadra, automjete ose rulota argëtimi, kampe peshkimi dhe gjuetie për vizitorët me qëndrim të shkurtër.

Kjo klasë nuk përfshin akomodimin e dhënë nga:

- strehat malore, shih klasën 55.20

55.9 Akomodime të tjera

55.90 Akomodime të tjera

Kjo klasë përfshin ofrimin e kushteve për akomodimin afatgjatë dhe të përkohshëm në dhoma të veçanta dhe të përbashkta, fjetore për studentë, migrantë, puntorë dhe individë të tjerë.

Kjo klasë përfshin:

- konvikte për studentë
- fjetore shkollash
- bujtina puntorësh
- dhoma dhe shtëpi me qira
- vagona treni me fjetje

56 Shërbime ushqimi dhe pije

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e shërbimeve të ushqimit dhe pijeve duke ofruar vaktet e plota për konsum të menjëhershëm, si në restorantet tradicionale, vet-shërbimi ose restorante me shërbim katering (ushqim i paketuar), qoftë në vende të përhershme apo të përkohshme, me ose pa mbulesë. I rëndësishëm është fakti që ofrohen vaktet për konsum të menjëhershëm dhe jo mënyra se si ofrohen ato.

Nuk përfshihen në këtë klasë prodhimi i vakteve për konsum jo të përnjëhershëm ose të planifikuara të jenë konsum jo i përnjëhershëm apo përgatitja e ushqimit i cili nuk konsiderohet të jetë një vakt (Shiko ndarjen 10: fabrikimin e produkteve të ushqimit dhe 11; fabrikimin e pijeve)

Gjithashtu, përjashtohet shitja e ushqimeve të vetë fabrikuar të cilat nuk konsiderohen të jenë një vakt ose vakte të cilat nuk janë për konsum të menjëhershëm (shiko seksionin G tregëtia e shitjes me shumicë dhe pakicë).

56.1 Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm

56.10 Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm

Kjo klasë përfshin ofrimin e shërbimit të ushqimit për konsumatorët, qoftë nëse u shërbehet ulur apo vetëshërbim, edhe nëse ata e konsumojnë ushqimin në lokal ose e marrin me vete apo e porosisin. Kjo përfshin përgatitjen e vakteve për konsum të menjëhershëm dhe shërbimin me mjete motorike ose me karro jo motorike

Kjo klasë përfshin:

- restorante
- kafeteri
- vende ngrënie ku ushqimet merren me vete

- karroca shitës ambulantë të akullores
- karro të lëvizëshme ku shiten ushqime
- përgatitje ushqimi në tregje dhe markete

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetin e restoranteve dhe bar që lidhen me transportin kur ai kryhet nga njësi të veçanta

Kjo klasë nuk përfshin:

- kryerjen e lehtësirave të ushqimit me konçesion, shih 56.29

56.2 Katering me porosi për raste dhe shërbime të tjera ushqimore

Ky grup përfshin aktivitetin katering (furnizim me ushqim të paketuar) për ngjarje të veçanta për një periudhë të caktuar kohë dhe operimin e ushqimit me konçesion, të tillë si; në sportet dhe lehtësira të ngjashme

56.21 Katering me porosi për raste

Kjo klasë përfshin kushtet shërbimit të ushqimit bazuar në marrëveshje kontraktuale me konsumatorët në vendet e specifikuar nga klienti për një rast të veçantë.

Kjo klasë përfshin:

- furnizuesit e ushqimeve për raste me porosi

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e artikujve ushqimorë që prishen, për rishitje, shih 10.89
- shitjen me pakicë të artikujve ushqimorë që prishen, shih ndarja 47

56.29 Aktivitetet e shërbimeve ushqimore të tjera

Kjo klasë përfshin Katering (furnizim me ushqime të paketuara) industrial psh: ofrimin e shërbimit ushqimor bazuar në marrëveshje kontraktuale me konsumatorët për një periudhë kohe të caktuar. Gjithashtu, përfshin operimin me konçesione të ushqimit si lehtësirat për sportet dhe të ngjashme. Ushqimi zakonisht është përgatitur në njësi qendrore.

Kjo klasë përfshin:

- kontraktorët e shërbimeve të përgatitjes së ushqimit për kompanitë e transportit
- aktivitetin e përgatitjes së ushqimeve për sportet dhe lehtësira të ngjashme
- aktivitetin e rrjetit të kafeterive (p.sh. për fabrika, zyra, spitale ose shkolla) me një bazë koncesioni

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e artikujve ushqimorë që prishen për rishitje, shih 10.89
- shitjen me pakicë e artikujve ushqimorë që prishen, shih ndarja 47

56.3 Aktivitete të shërbimit të pijeve

56.30 Aktivitete të shërbimit të pijeve

Kjo klasë përfshin aktivitetin e përgatitjes dhe servirjes së pijeve për konsum të menjëhershëm në lokal.

Kjo klasë përfshin:

- bare
- taverna
- pritje koktail

- diskoteka (me mbizotërim servirje pijesh)
- sallon birre
- lokal kafeje
- bar me lëng frutash
- shitës pijesh lëvizës

Kjo klasë nuk përfshin:

- rishitjen e paketuar / pije të përgatitura, shih 47
- diskotekat dhe sallone vallzimi pa shërbim pije, shih 93.22

SEKSIONI J - INFORMACIONI DHE KOMUNIKACIONI

Ky seksion përfshin prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe produkteve kulturore, vënien në dispozicion të mjeteve që lejojnë transmetimin ose shpërndarjen e këtyre produkteve, si edhe aktivitete të lidhura me teknologjinë informatike ose të informacionit dhe komunikacionit, shërbime të trajtimit të të dhënave dhe shërbime të tjera të informacionit.

Komponentët kryesorë të këtij seksioni janë aktivitete të publikimit (ndarja 58) përfshirë programe publikimi, fotografi me lëvizje dhe aktivitete të regjistrimit të zërit (ndarja 59), rrjete radio dhe televizioni dhe aktivitete programimi (ndarja 60), aktivitete të telekomunikacionit (ndarja 61), teknologji informacioni (ndarja 62) dhe shërbime të tjera informacioni (ndarja 63).

Publikimi përfshin blerjen e të drejtës së përmbajtjes (produkte informacioni) dhe vendosja e kësaj përmbajtjeje për publikun në përgjithësi duke organizuar riprodhimin dhe shpërndarjen e kësaj përmbajtjeje në forma të ndryshme.

Gjithashtu në këtë seksion përfshihen të gjitha format e mundshme të publikimit (në shtyp, në formën elektronike ose audio, në internet, si produkt multimedial në formën e CD-ROOM, në libra reference etj.), aktivitete lidhur me prodhimin dhe shpërndarjen e programimit të hapësirave Tv, grupet 59, 60, 61, duke reflektuar statet e ndryshme në këtë proces.

Në këtë seksion përfshihen edhe komponentë individuale, si filma, serialë televizivë, etj. që janë prodhuar nga aktivitetet e grupit 59, krijimi i një programi të plotë të një kanali, nga komponentë të prodhuar në grupin 59 ose të tjerë komponentë (si programimi live) që përfshihen në grupin 60. Grupi 60 gjithashtu përfshin transmetimin e këtij programi nga prodhuesi. Shpërndarja e programit të plotë televiziv nga të tretë, p.sh pa ndonjë ndryshim të përmbajtjes, përfshihet në grupin 61. Kjo shpërndarje në grupin 61 mund të bëhet me transmetim, me sistem satelitor ose kabllor.

58 Aktivitete të botimtarisë

Kjo ndarje përfshin botimin e librave, broshurave, fletëpalosjeve, fjalorëve, enciklopedive, atlaseve, hartave dhe grafikëve, publikimin e gazetave, periodikëve, revistave; listat e adresave postare dhe publikime të tjera si edhe software-ve.

Botimi përfshin blerjen e të drejtës së përmbajtjes (produkte informimi) dhe vendosjen e kësaj përmbajtjeje të mundshme ndaj publikut në përgjithësi, duke u marrë me riprodhimin dhe shpërndarjen e kësaj përmbajtjeje në forma të ndryshme. Të gjitha format e mundshme të botimit (në shtyp, në formën elektronike ose audio, në internet, si produkt i multimedias në formën e CD-ROOM, në libra reference etj.) gjithashtu përfshihen në këtë seksion, me përjashtim të edicioneve të filmave.

Kjo ndarje nuk përfshin publikimin e filmave, shiritave video dhe filmave në DVD ose forma të ngjashme (grupi 59) dhe prodhimin e kopjeve kryesore për regjistrimin e materialit audio (seksioni 59). Gjithashtu nuk përfshihet shtypshkrimi (shih 18.11, 18.12) dhe riprodhimi masiv i mediave të regjistruara (shih 18.20).

58.1 Botimi i librave, periodikëve dhe aktivitete të tjera publikimi

Ky grup përfshin aktivitetin e botimit të librave, gazetave, revistave, dhe periodikëve të tjerë, listave të adresave postare dhe produkte të tjera si fotografi, filma, gravura, kartolina, tabela oraresh, formularë, postera dhe riprodhimi i punimeve të artit. Këto produkte karakterizohen nga kërkesa për krijimtari intelektuale në zhvillimin e tyre dhe zakonisht janë të mbrojtura me të drejtë autori (copyright)

58.11 Botimi i librave

Kjo klasë përfshin aktivitetet e botimit të librave në formë të shtypshkrimit, elektronike (CD, dispozitivë elektronike etj.), forma audio ose në internet.

Kjo klasë përfshin:

- botimin e librave, broshurave, fletëpalosjeve dhe botime të ngjashme, përfshirë fjalorët dhe enciklopeditë.

- botimin e atlaseve, hartave dhe skicave
- botimin e librave audio
 - botimi i enciklopedive etj. në CD-ROOM

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e globeve, shih 32.99
- botimin e materialit të publicitetit, shih 58.19
- botimin e fletëve të muzikës dhe librave, shih 59.20
- aktivitetin e autorëve të pavarur, shih 74.90, 90.03

58.12 Botimi i listave të adresave postare

Kjo klasë përfshin botimin e listave të informacionit ose fakteve që janë të mbrojtur në formën e tyre, por jo në përmbajtjen e tyre. Këto lista mund të botohen në formë shtypshkrimi ose elektronike.

Kjo klasë përfshin:

- botimin e listave të adresave postare
- botimin e librave telefonik
- botimin

58.13 Botimi i gazetave

Kjo klasë përfshin aktivitetet e botimit të gazetave, përfshirë gazeta publiciteti. Ky informacion mund të botohet në shtyp ose formë elektronike, përfshirë internetin.

58.14 Botimi i revistave dhe periodikëve

Kjo klasë përfshin aktivitetet e botimit të periodikëve dhe revistave të tjera. Ky informacion mund të botohet në shtyp ose formë elektronike, përfshirë internetin.

Këtu përfshihet edhe botimi i programeve radio televizive.

58.19 Aktivitete të tjera botimi

Kjo klasë përfshin:

- botimin e:
 - katalogëve
 - fotografive, gravurave dhe kartëpostaleve
 - kartolinave të urimit
 - formularëve
 - posterave, riprodhimeve të punimeve artistike
 - materialeve publiciteti
 - shtypshkrimeve të tjera

Kjo klasë nuk përfshin:

- botimin e gazetave publicitare, shih 58.13

58.2 Publikimi i programeve

58.21 Publikimi i lojrave kompjuterike

Kjo klasë përfshin:

- publikimi i lojrave kompjuterike për të gjitha programet

58.29 Publikimi i programeve të tjera

Kjo klasë përfshin:

- publikimin e programeve të gatshëm (jo me porosi):
 - sisteme operative
 - aplikime biznesi dhe të tjera

Kjo klasë nuk përfshin:

- riprodhimin e programeve, shih 18.20
- tregtinë me pakicë të programeve jo me porosi, shih 47.41
- prodhimin e programeve të pashoqëruar me publikim, shih 62.01

59 Filma, video dhe prodhimi i programeve televizivë, regjistrimi i zërit dhe aktivitete publikimi të muzikës

Kjo ndarje përfshin prodhimin e filmave teatralë ose jo teatralë si në formë filmi, shirit video ose disqe për projektim të drejtpërdrejtë në teatro ose për transmetim në television, aktivitete mbështetëse si nxjerrja e filmave, prerja, dublimi, etj.; shpërndarja e filmave dhe prodhimeve të tjera filmike në degë të tjera të ekonomisë, si edhe filma ose projekte të tjera të prodhimeve filmike. Gjithashtu përfshihet blerja dhe shitja e filmave ose të drejta të prodhimeve filmike të tjera.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin aktivitetet e regjistrimit zanor p.sh. prodhimin regjistrimeve zanore origjinale, përhapjen e tyre, promovimin dhe shpërndarjen e tyre, publikimi i muzikës si edhe aktivitete shërbimi të regjistrimeve zanore në një studio ose vend tjetër.

59.1 Filma, video dhe aktivitete të programeve televizivë

Ky grup përfshin prodhimin e filmave teatralë ose jo teatralë si në formë filmi, shirit video DVD ose media të tjera, përfshirë shpërndarjen digitale, për projektim direkt në teatro ose për transmetim në television, aktivitete mbështetëse si p.sh. nxjerrja e filmit, prerja, dublimi etj. Shpërndarja e filmave ose prodhimeve të tjera filmike (shirita video, DVD, etj.) në degë të tjera të ekonomisë, si edhe projektimi i tyre. Gjithashtu përfshihet edhe blerja dhe shitja e të drejtave të shpërndarjes së filmave dhe e çdo lloj tjetër produkti të ngjashëm.

59.11 Filma, video dhe aktivitete të prodhimit të programeve televizivë.

Kjo klasë përfshin prodhimin e filmave, videove, programeve televizivë, ose reklamave tregtarë televizive

Kjo klasë përfshin gjithashtu prodhimin e programeve televizivë dhe reklamave tregtare televizive të bëra jo nëpërmjet lehtësirave transmetuese dhe aktivitetet e librarive të stokimit të metrazhit filmik etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- dublikimin e filmit (përveç riprodhimit të filmave për shpërndarjen teatrale), si edhe riprodhimin nga master kopje e CD dhe DVD, shih 18.20
- tregtinë me shumicë e shiritave video të regjistruar, CD, DVD, shih 46.43
- tregtinë me shumicë e shiritave të paregjistruar, CD, shih 46.52
- tregtinë me pakicë e shiritave video, CD, DVD, shih 47.63
- aktivitetet e pas prodhimit, shih 59.12
- regjistrimin e zërit dhe regjistrimi i librave në shirit, shih 59.20
- transmetimet televizive, shih 60.2
- prodhimin e një programi komplet televizivë, shih 60.2
- zhvillimin e filmave të destinuar jo për industrinë e prodhimit të filmave, shih 74.20
- aktivitetet e agjentëve ose agjensive personale teatrale, shih 74.90
- dhënie me qira e shiritave video, DVD publikut në përgjithësi, shih 77.22
- shërbimin e titrave në kohë reale (p.sh. simultane) të televizionit në aktivitetet live ose mbledhje e konferenca, shih 82.99
- aktivitetet e aktorëve për llogari të vet, karikaturistëve, drejtorëve, skenaristëve dhe specialistëve teknikë, shih 90.0

59.12 Post-produksioni i filmave kinematografikë, të videove dhe programeve televizivë

Kjo klasë përfshin aktivitete si post-produksionit si nxjerrja, film/shirit transmetim, titrimi, nëntitrimi, kreditë, diçitura, grafikë të prodhuar nga kompjuteri, efekte animacioni dhe speciale, zhvillimi dhe përpunimi i prodhimit të filmave, aktivitete të laboratorëve të filmave, aktivitete të laboratorëve të posaçëm për filma me animacion.

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e kinematikës

Kjo klasë nuk përfshin:

- dublikimin e filmave, (përveç riprodhimit të filmave për shpërndarje teatrale) si edhe të shiritave video dhe audio, riprodhim CD ose DVD nga master kopjet, shih 18.20
- shitjen me shumicë të shiritave video të regjistruar, CD, DVD, shih 46.43
- shitjen me shumicë të shiritave të paregjistruar, CD, shih 46.52
- shitjen me pakicë të shiritave video, CD, DVD, shih 47.63
- zhvillimin e filmave të destinuar jo për industrinë e prodhimit të filmave, shih 74.20
- dhënie me qira të shiritave video, DVD publikut në përgjithësi, shih 77.22
- aktivitetet e aktorëve për llogari të vet, karikaturistëve, drejtorëve, skenaristëve dhe specialistëve teknikë, shih 90.0

59.13 Aktivitete të shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizivë

Kjo klasë përfshin shpërndarjen e filmave, shiritave video, DVD dhe prodhime të ngjashme të filmave, teatrove, rrjeteve dhe stacioneve televizive dhe ekspozuesve. Gjithashtu përfshihet blerja e shiritave video dhe DVD dhe e drejta e shpërndarjes.

Kjo klasë nuk përfshin:

- dublikimin e filmave si audio dhe video, riprodhimi i CD dhe DVD nga master kopjet, shih 18.20

59.14 Aktivitete të projektimit të filmave

Kjo klasë përfshin aktivitetin e projektimit të filmave dhe të videove në kinema, jashtë ose në struktura të tjera projektioni.

Kjo klasë gjithashtu përfshin aktivitetet e kino-klubeve.

59.2 Rregjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës**59.20 Rregjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës**

Kjo klasë përfshin aktivitetet e prodhimit të master regjistrimeve origjinale të zërit, si shirita, CD, publikimin, promovimin dhe shpërndarjen e regjistrimeve të zërit ndaj tregtarëve me shumicë, tregtarëve me pakicë ose drejtpërdrejt publikut. Këto aktivitete mund të integrohen ose jo me prodhimin e master regjistrimeve në të njëjtën njësi. Nëse jo, njësia ekzistuese duhet të sigurojë të drejtën e riprodhimit dhe shpërndarjen të master regjistrimeve. Kjo klasë përfshin gjithashtu shërbime të regjistrimit të zërit në një studio ose gjetkë, përfshirë dhe prodhimin e programimit radio (jo të drejtpërdrejtë).

Kjo klasë përfshin gjithashtu aktivitetet e publikimit të muzikës, p.sh. blerjen dhe regjistrimin e të drejtave të autorit për kompozimet muzikore, promovimin, autorizimin dhe përdorimin e këtyre kompozimeve në regjistrime, radio, television, filma, shfaqje të drejtpërdrejta, shtypshkrimi dhe media të tjera.

Këtu përfshihet edhe publikimi i librave të muzikës e partiturat

60 Aktivitete të programimit dhe shpërndarjes

Kjo ndarje përfshin aktivitetet që konsistojnë në krijimin e përmbajtjes ose blerjes të së drejtës për shpërndarjen e programit dhe transmetimin e tij, si radio, television dhe programet e të dhënave, lajme, biseda, programe argëtuese dhe të ngjashëm. Gjithashtu përfshihet transmetimi i të dhënave të integruara me transmetimin radio ose TV. Transmetimi mund të kryhet duke përdorur teknologji të ndryshme, ajrore, satelitore, rrjeti kabllor ose internet. Kjo ndarje përfshin gjithashtu prodhimin e programeve që janë të kufizuara në natyrë (format i kufizuar, si lajmet, sportet, programe arsimore, programe rinie) në bazë pagese ose jo, ndaj të tretëve, për transmetimin në publik.

Kjo ndarje nuk përfshin shpërndarjen e kablove dhe programime të tjera të abonuara (shih ndarjen 61).

60.1 Transmetimi i programeve radiofonike

60.10 Transmetimi i programeve radiofonike

Kjo klasë përfshin aktivitetin e transmetimit të sinjaleve audio nëpërmjet studiove të transmetimit radiofonik dhe lehtësirave për transmetimin e programeve të dëgjimit në publik, ndaj anëtarëve ose abonentëve. Këtu gjithashtu përfshihen aktivitetet e rrjetit radiofonik, p.sh mbledhja dhe transmetimi i programeve të dëgjimit ndaj abonentëve me rrjete ajrore, kabëll ose satelit.

Kjo klasë gjithashtu përfshin transmetimin e aktiviteteve të radios me internet (internet radio stacione), transmetimi i të dhënave integruar me transmetimin radiofonik.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e programeve radiofonike në shirita, shih klasën 59.20

60.2 Aktivitete të programacionit dhe transmetimit televiziv

60.20 Aktivitete të programacionit dhe transmetimit televiziv

Kjo klasë përfshin krijimin e një programi të plotë televiziv me programe të blera (p.sh. filma, dokumentarë etj.), programe të prodhuara vetë (p.sh. lajme lokale, njoftime, live) ose një kombinim i tyre.

Ky program i plotë televiziv mundet të transmetohet nga njësi prodhuese ose të prodhohet për transmetim nga një shpërndarës i tretë, si kompani kabllore ose televizionë satelitorë.

Programet mund të jenë të një natyre të përgjithshme ose të specializuar (format i kufizuar, si lajmet, sportet, arsimore, programe rinie).

Kjo klasë përfshin programet e realizuara për tu shpërndarë pa pagesë përdoruesve si dhe programet që janë të vlefshme me pagesë për abonentët apo kanaleve televizivë.

Gjithashtu përfshihet transmetimi i integruar me transmetimin televiziv.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e elementëve të programeve televizivë (filma, dokumentarë biseda televizive, etj) jo të lidhura me transmetimin, shih klasën 59.11
- tërësinë e një pakete kanalesh dhe shpërndarja e saj, pa programacion, shih ndarjen 61

61 Telekomunikacioni

Kjo ndarje përfshin shërbimet e telekomunikacionit dhe të lidhura me to si transmetimi i zërit, të dhënave, teksti, tingullit dhe video. Lehtësirat e transmetimit që kryejnë këto aktivitete mund të bazohen në një teknologji të vetme ose teknologji të kombinuar. Njëllojshmëria e aktiviteteve klasifikuar në këtë ndarje është transmetimi i përmbajtjes, pa përfshirë në të krijimin. Detajimi i kësaj ndarje bazohet në llojin e infrastrukturës që vepron. Në rastin e transmetimit të sinjaleve televizive kjo mund të përfshijë ndërtimin e kanaleve të plotë televizivë (prodhuar në ndarjen 60) në programimin e paketës për shpërndarje.

61.1 Aktivitete të telekomunikacioneve (wired)

61.10 Aktivitete të telekomunikacioneve (wired)

Kjo klasë përfshin aktivitetet e veprimit, mirëmbajtjes, ose dhënies akses të lehtësirave për transmetimin e zërit, të dhënave, tekstit, tingullit dhe video duke përdorur një infrastrukturë telekomunikacioni me tel. Lehtësirat e transmetimit që kryejnë këto aktivitete, mundet të bazohen në një teknologji të vetme ose në një teknologji të kombinuar. Në mënyrë më specifike këto aktivitete përfshijnë: 1) ofrimin dhe mirëmbajtjen e lehtësirave hapje dhe transmetimi për të siguruar pikë më pikë komunikimin tokësor, mikrovalë, ose kombinimin e lidhjeve tokësore dhe satelitore, 2) sistemet e shpërndarjes kabllore dhe 3) kryerja e komunikacionit telegrafik dhe jo-zanor duke përdorur lehtësirat e veta. Gjithashtu përfshihet edhe blerja e kapacitetit të rrjetit nga pronarët dhe operatorët e rrjetit dhe sigurimi i shërbimeve të telekomunikacionit me tel duke përdorur këtë kapacitet ndaj ndërmarrjeve dhe familjeve.

Kjo klasë përfshin gjithashtu furnizimin me internet akses nga operatori i një infrastrukture me tel.

Kjo klasë nuk përfshin:

- rishitësit e telekomunikacioneve, shih 61.90

61.2 Aktivitete të telekomunikacionit pa tel (wireless)**61.20 Aktivitete të telekomunikacionit pa tel (wireless)**

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e veprimit, mirëmbajtjes, ose dhënies akses të lehtësirave për transmetimin e zërit, të dhënave, tekstit, tingullit dhe video duke përdorur një infrastrukturë telekomunikacioni pa tel.
- shërbimet e telefonisë celulare dhe rrjete të tjera të komunikacionit pa tel

Këto lehtësira sigurojnë transmetim të gjithanshëm në rrugë ajrore dhe mund të bazohet në një teknologji ose në një kombinim teknologjik.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- blerjen e aksesit në kapacitetin e rrjetit nga pronarët dhe operatorët e rrjetit dhe sigurimi i shërbimeve të telekomunikacionit pa tel (përveç satelitit) duke përdorur këtë kapacitet ndaj ndërmarrjeve dhe familjeve.
- furnizimin me internet, akses nga operatori i një infrastrukture pa tel

Kjo klasë nuk përfshin:

- rishitësit e telekomunikacioneve, shih 61.90

61.3 Telekomunikacioni me satelit**61.30 Telekomunikacioni me satelit**

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e veprimit, mirëmbajtjes, ose dhënies akses të lehtësirave për transmetimin e zërit, të dhënave, tekstit, tingullit dhe video duke përdorur një infrastrukturë telekomunikacioni satelitor.
- shpërndarjen e programeve vizuale, zanore ose të shkruara, të programeve të marrë nga rrjetet kabllore, stacionet televizive lokale, rrjetet radio për konsumatorët nëpërmjet sistemeve satelitore drejtpërdrejt në shtëpi. Njësitë e klasifikuara këtu zakonisht nuk krijojnë programe.

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- aktivitetet e aksesit në internet nga operatori i infrastrukturës satelitore.

Kjo klasë nuk përfshin:

- rishitësit e telekomunikacioneve, shih 61.90

61.9 Aktivitete të tjera të telekomunikacionit**61.90 Aktivitete të tjera të telekomunikacionit**

Kjo klasë përfshin:

- sigurimin e aplikimeve të specializuara të telekomunikacionit, si gjurmuesit satelitor, komunikacione telemetrike dhe operatorët e stacioneve radar;
- aktivitetin e terminaleve të stacioneve satelitorë dhe instalime lidhëse që lidhen me një ose më shumë sisteme komunikimi tokësorë dhe të aftë të sigurojnë telekomunikacionin me sistemet satelitore.
- sigurimin e aksesit në internet midis klientit dhe ISP nga ndërmjetës jo pronar, ose të kontrolluara nga ISP, si p.sh. dial-up internet access etj.
- sigurimin e aksesit në internet dhe telefonisë për publikun e gjerë;
- sigurimin e shërbimeve të telekomunikacionit me lidhjet ekzistuese të telekomunikacionit:
 - siguri VOIP (Voice Over Internet Protocol)
- rishitës telekomunikacioni (p.sh. blerja dhe rishitja e kapacitetit të rrjetit pa siguruar shërbime shtesë).

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetin e internet access nga operatorët e infrastrukturës së telekomunikacionit, shih 61.10, 61.20, 61.30

62 Shërbime të teknologjisë së informacionit

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e mëposhtme për sigurimin e ekspertizës në fushën e teknologjive të informacionit: programme për shkrim, modifikim, testim dhe mbështetës të sistemeve të planifikimit të hartimit që integrojnë hardware kompiuterike, teknologji të programeve dhe të komunikacionit on-site organizim dhe punën e klientëve të sistemeve kompiuterike dhe /ose lehtësira të përpunimit të të dhënave dhe aktivitete të tjera të lidhura profesionalisht dhe teknikisht me kompjuterat.

62.0 Programacioni, këshillime dhe aktivitete të tjera informatike**62.01 Aktivitete të programimit informatik**

Kjo klasë përfshin programet e shkrimit, modifikimit, testimit dhe atyre mbështetëse për të plotësuar kërkesat e çdo klienti.

Kjo klasë përfshin:

- strukturat e konceptimit të përmbajtjes dhe/ose shkrimi i kodeve informatike të nevojshme për të krijuar e zbatuar:
 - software e sistemit (përfshirë zbatimin dhe korigjimin)
 - aplikacionet e software (përfshirë zbatimin dhe korigjimin)
 - bazat e të dhënave
 - faqet web
- adaptimin e software, psh modifikimi dhe konfigurimi i një aplikacioni ekzistues për tu bërë funksional në mjedisin informatik të klientit

Kjo klasë nuk përfshin:

- publikimin e paketë software, shih 58.29
- përkthimin ose përshtatjen e software të padoptuar për një treg të veçantë për llogari të vet, shih 58.29
- planifikimin dhe konceptimin e sistemeve kompjuterikë që integrojnë hardware të kompjuterave, software dhe teknologji komunikacioni, megjithëse siguri i programeve mund të jetë pjesë e integruar, shih 62.02

62.02 Aktivitete të këshillimeve informatike

Kjo klasë përfshin planifikimin dhe konceptimi e sistemeve kompjuterike që integrojnë hardware kompjuteri, software dhe teknologji komunikimi. Këto shërbime mund të përfshijnë trajnime për përdoruesit.

Kjo klasë nuk përfshin:

- shitjen e hardware ose software, shih 46.51, 47.41
- instalimin e sistemeve të mëdha dhe ordinatorëve të ngjashëm, shih 33.20
- instalimin (konfigurimi) e kompjuterave personale, shih 62.09
- instalimin e software, rikuperim i problemeve informatike, shih 62.09

62.03 Aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike

Kjo klasë përfshin shërbimin e sigurimit të menaxhimit të sistemeve informatike dhe /ose trajtimi i të dhënave të klientëve, si edhe shërbime të asistencës të lidhura me to

62.09 Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit

Kjo klasë përfshin aktivitete në fushën informatike dhe të teknologjisë së informacionit të pa klasifikuar në vend tjetër, të tilla si:

- rikuperimin e problemeve informatike
- instalimin (konfigurimi) e kompjuterave personale
- instalimin e software

Kjo klasë nuk përfshin:

- instalimi i sistemeve të mëdha dhe ordinatorëve të ngjashëm, shih 33.20
- programimet informatike, shih 62.01
- këshillimet kompjuterike, shih 62.02
- shërbimet e instalimeve informatike, shih 62.03
- trajtimi dhe mbajtja (hosting) e të dhënave, shih 63.11

63 Aktivitete të shërbimit të informacionit

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e portave të kërkimit në web, përpunimi i të dhënave dhe aktivitete të mbajtjes (hosting), si edhe aktivitete të tjera me objekt kryesor furnizimi me informacion.

63.1 Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse (hosting) të informacionit dhe aktivitete të lidhura me to, portat web

Ky grup përfshin aktivitetet e sigurimit të infrastrukturës së mbajtjes (hosting) së informacionit, shërbime të përpunimit të të dhënave dhe aktivitete të lidhura, si edhe sigurimi i lehtësirave të kërkimit dhe portave të tjera për internet.

63.11 Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse (hosting) të informacionit dhe aktivitete të lidhura me to

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e sigurimit të infrastrukturës për mbajtjen (hosting) e informacionit, shërbime të përpunimit të të dhënave dhe aktivitete të lidhura me to
- aktivitetet e specializuara të mbajtjes (hosting) së informacionit si
 - web (hosting)
 - shërbime në vazhdimësi
 - aplikime për mbajtje (hosting)
- aplikime për furnizim me shërbime
- shërbimi i ndarjes së kohës së ordinatorëve të mëdhenj për klientët
- përpunimi i të dhënave:

- përpunimi i plotë e të dhënave të klientëve
- përgatitja e raporteve të posaçme nisur nga të dhënat e klientëve.

- sigurimin e shërbimeve të hedhjes së të dhënave

63.12 Portat web

Kjo klasë përfshin:

- funksionin e web sites që përdorin një motor kërkimi për të gjeneruar dhe mirëmbajtur bazat e të dhënave të adresave në internet si dhe përmbajtjen në një format të lehtë për kërkim.
- funksionin e web siteve të tjerë të cilët veprojnë si porta për internetin, si site të mediave, që japin përmbajtje të përditësuar periodike.

Kjo klasë nuk përfshin:

- publikimin e librave, gazetave, revistave etj. nëpërmjet internetit, shih ndarjen 58
- shpërndarjen e filmave nëpërmjet internetit, shih ndarjen 60.

63.9 Shërbime të tjera të informacionit

Ky grup përfshin aktivitetin e agjensive të lajmeve dhe të gjitha aktivitetet e tjera të lidhura me shërbimet e informacionit të pa klasifikuara në vend tjetër.

Ky grup nuk përfshin:

- aktivitetin e bibliotekave dhe arshivave, shih 91.01

63.91 Aktivitete të agjencive të lajmeve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e agjencive të lajmeve, dmth komunikimi për median të lajmeve, fotografive, dhe elementë të tjerë të ndryshëm.

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e gazetarëve fotografë të pavarur, shih 74.20
- aktivitetet e gazetarëve të pavarur, shih 90.03

63.99 Shërbime të tjera informacioni p.k.t

Kjo klasë përfshin aktivitete shërbimi të tjera të pa klasifikuara në vend tjetër si:

- shërbimet informatike të informacionit me telefon
- shërbimet e kërkimeve të informacionit për llogari të të tretëve
- shërbimet e lajmeve të shpejta etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e qendrave telefonike, shih 82.20

SEKSIONI K - AKTIVITETE TË SHËRBIMEVE FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT

Ky seksion përfshin aktivitetet e shërbimeve financiare, përfshirë sigurimet, risigurimin dhe aktivitetet e fondeve të pensioneve dhe aktivitetet për mbështetjen e shërbimeve financiare

Ky seksion gjithashtu përfshin aktivitetin e aseteve të holdingut, si aktivitetet e kompanive holding, aktivitetet e trustit, fondit dhe të mjeteve të tjera financiare.

64 Aktivitete të shërbimeve financiare, përveç sigurimeve dhe financimit të pensioneve

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e sigurimit dhe rishpërndarjes së fondeve, përveç atyre për qëllime të sigurimeve shoqërore të detyrueshme ose sigurimit ose financimit të pensioneve.

Shënim: dispozitat kombëtare institucionale luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e klasifikimit brenda kësaj ndarje

64.1 Ndërmjetësim Monetar

Ky grup përfshin:

- sigurimin e fondeve në formën e depozitave të transferueshme, p.sh. fonde që janë fiksuar në terma monetare dhe siguruar me bazë ditore, veçmas bankës qendrore, të siguruara nga burime jo financiare

64.11 Aktiviteti i bankës qendrore

Kjo klasë përfshin:

- emëtimin dhe manaxhimin e monedhës kombëtare
- monitorimin dhe kontrollin e ofertës monetare
- marrjen e depozitave që janë përdorur për kompesim ndërmjet institucioneve financiare
- mbikëqyrjen e operacioneve bankare
- mbajtjen e rezervës ndërkombëtare të vendit
- veprimin si bankier i qeverisë

Aktivitetet e bankës qendrore mund të ndryshojnë për arsye të ndryshme institucionale.

64.19 Ndërmjetësime të tjera financiare

Kjo klasë përfshin marrjen e depozitave dhe /ose mbylljen e zëvendësimin e depozitave dhe zgjatjen e kredive ose huadhënien e fondeve. Garantimi i kredisë mund të marrë formë të ndryshme si hua, hipotekë, karta krediti etj. Këto aktivitete, në përgjithësi janë zbatuar nga institucione monetare përveç bankave qendrore, si:

- bankat
- banka të kursimeve
- unionet financiare të kreditit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- transfertat financiare postare dhe aktivitetin e bankave të kursimit postar
- garantim kredie për blerjen e shtëpive nga institucione depozitare të specializuara
- aktivitete mandatpaguese

Kjo klasë nuk përfshin:

- garantim kredie për blerjen e shtëpive nga institucione jo depozitare të specializuara, shih 64.92
- trajtimin e transaksioneve me karta krediti dhe aktivitetet e shlyerjes, shih 66.19

64.2 Aktivitete të kompanive holding

64.20 Aktivitete të kompanive holding

Kjo klasë përfshin aktivitetet e kompanive holding, p.sh. njësi që kanë në zotërim asetet (zotërimin, kontrollin e nivelit të paanshmërisë) të një grupi të korporatave vartëse dhe që aktiviteti kryesor i të cilave është zotërimi i grupit. Kompanitë holding në këtë klasë nuk kryejnë ndonjë shërbim tjetër ndaj bizneseve nga të cilët është krijuar kapitali, (psh: ata nuk administrojnë ose manaxhojnë njësi të tjera).

Kjo klasë nuk përfshin:

- manaxhimin aktiv të kompanive dhe ndërmarrjeve, planin strategjik dhe vendimarrjen e kompanisë, shih 70.10

64.3 Truste, fonde dhe njësi të ngjashme financiare

64.30 Truste, fonde dhe njësi të ngjashme financiare

Kjo klasë përfshin njësitë legale të organizuara për mbledhjen e sigurimeve ose aseteve të tjera financiare, pa menaxhim, në emër të aksionerëve ose përfituesve. Aksionet janë përshtatur për të arritur karakteristikat specifike të investimeve, si zgjerim të investimeve, risku, normën e kthimit, dhe paqëndrueshmërinë e çmimeve.

Këto njësi fitojnë interesin, dividendët, dhe të tjera të ardhura të pronës, por kanë pak ose nuk kanë të punësuar dhe nuk kanë të ardhura nga shitja e shërbimeve.

Kjo klasë përfshin:

- fondet e përbashkëta fikse të investimeve
- fondet e përbashkëta të ndryshueshme të investimeve
- fondet e njërive të investimit
- truste, zyra ose agjensi të llogarive të pronave, të administruara në interes të përfituesve në bazë të kushteve të një marrëveshje besimi, dëshire, ose kontrate.

Kjo klasë nuk përfshin:

- fonde dhe truste që fitojnë të ardhura nga shitja e mallrave ose shërbimeve, shih klasën NACE sipas aktivitetit të tyre kryesor
- aktivitetet e kompanive holding, shih 64.20
- financimin e pensioneve, shih 65.30
- menaxhimin e fondeve, shih 66.30

64.9 Ndërmjetësime të tjera financiare

Ky grup përfshin ndërmjetësimin financiar veçmas atyre të kryera nga institucione monetare.

Ky grup nuk përfshin:

- sigurimin dhe financimin e pensioneve shih ndarjen 65

64.91 Leasing (Qiramarrja financiare)

Kjo klasë përfshin:

- leasing (qiramarrjen financiare) ku afatet përafërsisht mbulojnë jetëgjatësinë e pritëshme të aseteve dhe qiramarrësi kryesisht siguron të gjithë përfitimet e përdorimit dhe merr përsipër riskun që lidh të drejtën e tij të pronësisë. Pronësia e asetit mundet ose nuk mundet të transferohet. Këto qera mbulojnë të gjitha ose përafërsisht të gjitha kostot përfshirë interesin.

Kjo klasë nuk përfshin:

- qeramarrjen operacionale, shih ndarjen 77, sipas tipit të mallit të dhënë me qera.

64.92 Aktivitete të tjera të garantimit të kredisë

Kjo klasë përfshin:

Kjo klasë përfshin shërbime të tjera financiare të interesuara kryesisht me marrjen e huasë nga institucione jo të përfshirë në ndërmjetësime monetare, ku garantimi i kredisë mund të bëhet në forma të ndryshme si hua, hipotekë, karta krediti etj, duke siguruar llojet e mëposhtme të shërbimeve:

- garantimi i kredive konsumatore.
- financimi i tregtisë ndërkombëtare
- sigurimi i financimit afat-gjatë ndaj industrisë prej bankave industriale
- hua-dhënia e parave jashtë sistemit bankar
- garatimi i kredive për blerje shtëpie nga institucione të specializuara jo depozituese
- dyqan pengjesh dhe pengmbajtës

Kjo klasë nuk përfshin:

- garantimin e kredive për blerje shtëpie nga institucionet e specializuara që gjithashtu marrin depozita, shih 64.19
- qiramarrje, shih ndarjen 77, sipas llojit të mallrave të dhëna me qira

64.99 Ndërmjetësime të tjera financiare, përveç sigurimit dhe fondeve të pensionit, p.k.t

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e shërbimit financiar që lidhen kryesisht me shpërndarjen e fondeve se sa me sigurimin e huave:
 - aktivitetet e faktoringut
 - shkëmbime, mundësi dhe marrveshje të tjera mbrojtëse
- aktivitetet e investimit për llogari të vet si psh. kompani të sipërmarrjes, shoqëri të investimit etj

Kjo klasë nuk përfshin:

- leasing (qeramarrje financiare), shih 64.91
- sigurimin në emër të tjerëve, shih 66.12
- tregtinë, qeradhënie dhe huamarrjen, qeramarrjen e pronave të paluajtëshme, shih ndarjen 68
- mbledhjen e faturave pa blerjen e borxhit, shih 82.91
- dhënie të granteve nga organizata anëtarësimi, shih 94.99

65 Sigurimi, risigurimi dhe financimi i fondeve të pensioneve, përjashtuar sigurimin shoqëror të detyrueshëm

Kjo klasë përfshin nënshkrimin e pensioneve vjetore, policave të sigurimit dhe shpenzimin e primeve për të ngritur një koleksion të aseteve financiare për t'u përdorur ndaj pretendimeve të ardhshme. Janë përfshirë parashikimet e sigurimit të drejtëpërdrejtë dhe risigurimit.

65.1 Sigurimi

Ky grup përfshin sigurimin e jetës me ose pa elemente të dukshme kursimi dhe sigurime të tjera jetësore.

65.11 Sigurimi i jetës

Kjo klasë përfshin:

- nënshkrimin e pensioneve vjetore
- politikat e sigurimit të jetës
- politikat e sigurimit të të ardhurave të paaftësisë
- vdekjen aksidentale dhe prishjen e politikave të sigurimit (me ose pa elementë të dukshëm kursimi)

65.12 Sigurime jo jetësore

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet e sigurimit përveç sigurimit të jetës:
 - sigurimi ndaj aksidenteve dhe zjarrit
 - sigurimi shëndetësor
 - sigurimi në udhëtim
 - sigurimi i pronës
 - sigurimi i mjeteve motorike, flotës, aviacionit dhe sigurimi i mjeteve të transportit
 - sigurimi për humbjen e parave dhe borxheve

65.2 Risigurimi**65.20 Risigurimi**

Kjo klasë përfshin aktivitetet e marrjes së të gjithë ose të një pjesë të riskut e shoqëruar me politikat ekzistuese të sigurimit, të nënshkruara fillimisht nga agjensi të tjera sigurimi

65.3 Financimi i Pensioneve**65.30 Financimi i Pensioneve**

Kjo klasë përfshin entitetet ligjore (p.sh. fonde, plane, dhe /ose programme) të organizuara për të siguruar tërheqjen e përfitimeve të pensionit veçanërisht për të punësuarit ose për anëtarët. Kjo përfshin planifikimin e pensioneve me fitime të përcaktuara, si edhe planifikime individuale ku fitimet janë përcaktuar thjesht nëpërmjet kontributit të anëtarëve.

Kjo klasë përfshin:

- planifikimin e përfitimit të punonjësve
- fondin e pensioneve dhe planifikimi
- planin e daljes në pension

Kjo klasë nuk përfshin:

- manaxhimin e fondeve të pensioneve, shih 66.30
- skemat e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, shih 84.30

66 Aktivitete të tjera financiare

Kjo ndarje përfshin sigurimin e shërbimeve të përfshira në ose ngushtësisht të lidhura me aktivitetin e shërbimeve financiare, por jo të ndërmarrin shërbime financiare. Detajimi i parë i kësaj ndarje është sipas llojit të transaksionit financiar ose financimit të bërë.

66.1 Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar, përveç sigurimit dhe financimit të pensioneve

Ky grup përmban furnizimin fizik ose elektronik të tregjeve me qëllim lehtësimin e blerjes dhe shitjes së fondeve, opsioneve të fondeve, letrave me vlerë, ose kontratat e të mirave.

66.11 Administimi i tregjeve financiare

Kjo klasë përfshin funksionimin dhe mbikqyrjen e tregjeve financiare përveç atyre të kryera nga autoritetet publike, si:

- kontratat e shkëmbimit të të mirave
- kontratat e shkëmbimit të të mirave të ardhshme
- shkëmbimin e sigurimeve
- shkëmbimin e fondeve
- opsionet e shkëmbimit të të mirave ose fondeve

66.12 Aktivitete të ndërmjetësimit të kontratave të sigurimit dhe mallrave

Kjo klasë përfshin:

- veprimi në tregje financiare në emer të të tjerëve (p.sh. agjentët e bursave) dhe aktivitete të lidhura me to
- ndërmjetës sigurimi
- ndërmjetës të kontratave të mallrave
- aktivitete të zyrave të këmbimit etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- të vepruarit në tregje për llogari të vet, shih 64.99
- menaxhim i portofolit, në bazë të kuotave ose kontratave, shih 66.30

66.19 Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar përveç sigurimit dhe financimit të pensioneve p.k.t

Kjo klasë përfshin aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar të paklasifikuara në asnjë kategori tjetër si:

- trajtimin e transaksione financiare dhe shlyerje të aktivitetit përfshirë transaksionet e kartave të kreditit
- shërbimet e konsultimit lidhur me investimet
- aktivitetet e këshilltarëve të hipotekimit dhe komisionerëve

Kjo klasë përfshin gjithashtu:

- administrimin, shërbime mirëbesimi dhe kujdestarie me pagesë ose me kontratë

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e agjentëve të sigurimit dhe të komisionerëve, shih 66.22
- menaxhimin e fondeve, shih 66.30

66.2 Aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe financimit të pensioneve

Ky grup përfshin veprimin si agjent (p.sh.komisioner) në shitjet vjetore të policave të sigurimit ose siguron përfitime të tjera të të punësuarve dhe sigurimin e fondit të pensioneve, të sigurimit siç janë pagesat e dëmeve ose administrimin si i tretë.

66.21 Vlerësimi i riskut dhe dëmit

Kjo klasë përfshin dhënien e shërbimeve administrative të sigurimeve si vlerësimi dhe zgjidhja e dëmeve të sigurimit.

Kjo përfshin:

- vlerësimin e pretendimeve të sigurimit
 - zgjidhja e pretendimeve
 - vlerësimi i riskut
 - vlerësimi i riskut dhe dëmit
 - përmirësimi i humbjeve
- zgjidhjen e konflikteve që rrjedhin nga sigurimi

Kjo klasë nuk përfshin:

- vlerësimin e pasurive të paluajtshme, shih 68.3
- vlerësimin për qëllime të tjera, shih 74.90
- aktivitetet e hetimit, shih 80.30

66.22 Aktivitete të agjentëve të sigurimit dhe komisionerëve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin e agjentëve dhe komisionerëve (ndërmjetës sigurimi) në shitjen, negocimin ose mbledhjen e kërkesave, të pensioneve vjetore të sigurimit dhe politikave të risigurimit.

66.29 Të tjera aktivitete ndihmëse të sigurimeve dhe financimit të pensioneve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e përfshirë ose ngushtësisht të lidhura me sigurimet dhe financimin e pensioneve (përveç ndërmjetësimit financiar, zgjidhjes së konflikteve dhe aktivitetin e agjentëve të sigurimit):
 - administrim i aktiviteteve të kompensimit
 - shërbime aktuariale të sigurimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e shpëtimit detar, shih 52.22

66.3 Manaxhimi i fondeve**66.30 Manaxhimi i fondeve**

Kjo klasë përfshin aktivitete të manaxhimit të fondeve dhe portofoleve me pagesë ose me kontratë, për persona fizik, biznese (persona juridik) ose të tjerë si:

- menaxhimin e fondeve të përbashkëta
- menaxhimin e fondeve të tjera të investimit
- menaxhimin e fondeve të pensioneve

SEKSIONI L - AKTIVITETE TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME (REAL ESTATE)

Ky seksion përfshin ushtrimin e aktivitetit si qiradhënës, agjentë dhe /ose komisionerë në një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme: Shitja, qiradhënia e pasurive të paluajtshme, kryerja e shërbimeve të tjera të pasurive të paluajtshme ose të vepruarit si agjentë dorëzënës të pasurive të paluajtshme.

Aktivitetet e këtij seksioni mund të kryhen në pronë të vet ose të marrë hua dhe mund të bëhet me pagesë ose kontratë. Gjithashtu përfshihen ndërtimi i strukturave të kombinuara me mirëmbajtjen e pronësisë ose qiradhënien e këtyre strukturave.

Ky seksion përfshin menaxherët e mirëfilltë të pasurive të paluajtshme.

68 Aktivitete të pasurive të paluajtshme

68.1 Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme

68.10 Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet

Kjo klasë përfshin:

- blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të vet ose dhënien e tyre me qira:
 - ndërtesa rezidenciale dhe shtëpi banimi
 - ndërtesa jo rezidenciale, përfshirë salla ekspozitash, qendra tregtare dhe dyqane, etj
 - tokë dhe troje

Kjo klasë gjithashtu përfshin

- ndarjen e pasurive të paluajtshme në pjesë, pa përmirësimin e gjëndjes

Kjo klasë nuk përfshin:

- zhvillimin e projektit të objektit për shitje, shih 41.10
- ndarjen e pasurive të paluajtshme në pjesë, me përmirësimin e gjëndjes, shih 42.99

68.2 Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira

68.20 Dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme të veta ose të marra me qira

Kjo klasë përfshin:

- qiradhënien dhe funksionimin e pasurive të paluajtshme të veta ose të huajtura:
 - ndërtesa rezidenciale dhe shtëpi banimi
 - ndërtesa jo rezidenciale, përfshirë salla ekspozitash, qendra tregtare dhe dyqane, etj
 - tokë dhe troje
- sigurimin e shtëpive dhe apartamenteve të mobiluar ose jo për përdorim të gjatë, zakonisht me bazë mujore ose vjetore

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- funksionimin e vendbanimeve rezidenciale të lëvizshme

Kjo klasë nuk përfshin:

- funksionimin e hoteleve, shtëpive lëvizëse, kampingjeve, kampeve me furgona dhe të tjera vend banimi me qëndrim të shkurtër jo-rezidencial, shih ndarjen 55
- funksionimin e suite hoteleve dhe akomodime të ngjashme, shih 55.10

68.3 Aktivitete të pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë**68.31 Agjencitë e pasurive të paluajtshme**

Kjo klasë përfshin aktivitete të pasurive të paluajtshme nga agjencitë e pasurive të paluajtshme:

- agjentët dhe komosionerët e pasurive të paluajtshme
- agjentët dhe dorëzanës të pasurive të paluajtshme

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet ligjore, shih 69.10

68.32 Menaxhimi i pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë

Kjo klasë përfshin aktivitetin pasurive të paluajtshme me pagesë ose kontratë përfshirë shërbimet e lidhura me pasuritë e paluajtshme:

- ndërmjetësim në blerje, shitje dhe dhënie me qira të pasurive të paluajtshme me pagesë ose me kontratë
- menaxhimin e pasurive të paluajtshme me pagesë ose me kontratë
- shërbimet e vlerësimit të pasurive të paluajtshme

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet ligjore, shih 69.10
- shërbimet mbështetëse, shih 81.10
- menaxhimin e hapësirave të tilla: baza ushtarake, burgje, e të tjera (përveç shërbimeve informatike), shih 81.10

SEKSIONI M - AKTIVITETE PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE

Ky seksion përfshin aktivitete të specializuara profesionale, shkencore dhe teknike. Këto aktivitete kërkojnë shkallë të lartë trajnimi, dhe sigurojnë për përdoruesit njohuri dhe aftësi të specializuara.

69 Aktivitete ligjore dhe të kontabilitetit

Kjo ndarje përmban përfaqësimin ligjor të interesave të njëres palë kundrejt palës tjetër, përpara ose jo gjykatës ose trupit tjetër gjykues, ose nën mbikëqyrjen e personave që janë anëtarë të avokatisë, si këshillim dhe përfaqësim në çështjet civile, këshillim dhe përfaqësim në aktet kriminale, këshillim dhe përfaqësim në lidhje me debatet në punë. Kjo ndarje gjithashtu përfshin përgatitjen e dokumentave ligjore si statute, marrëveshje të bashkëpunimit ose dokumente të ngjashme të nevojshme për krijimin e shoqërisë, patentat dhe e drejta e autorit, aktivitete të noterisë publike, noterive të ligjit civil, përmbarues, arbitrave, kontrollorëve dhe gjyqtarëve. Gjithashtu përfshihet mbajtja e llogarive dhe shërbimet e kontabilitetëve si auditimi dhe mbajtja e llogarive, sisteme të hartimit të llogarive, përgatitja e gjendjes financiare.

69.1 Aktivitete ligjore

69.10 Aktivitete ligjore

Kjo klasë përfshin:

- përfaqësimin ligjor të interesave të njëres palë kundrejt palës tjetër, përpara ose jo gjykatës ose trupit tjetër gjykues, ose nën mbikëqyrjen e personave që janë anëtarë të avokatisë:
 - këshillimin dhe përfaqësimin në çështjet civile
 - këshillimin dhe përfaqësimin në aktet kriminale
 - këshillimin dhe përfaqësimin në lidhje me debatet në punë
- këshillimin dhe informacionin e përgjithshëm, përgatitjen e dokumentave ligjore:
 - statute, marrëveshje të bashkëpunimit ose dokumente të ngjashme të nevojshme për krijimin e shoqërisë
 - patenta dhe e drejta e autorit
- aktivitete të tjera të noterisë publike, noterive të ligjit civil, përmbaruesve, arbitrave, kontrollorëve dhe gjyqtarëve

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e trupit gjykues, shih 84.23

69.2 Aktivitete të llogarive, mbajtjes së llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat

69.20 Aktivitete të llogarive, mbajtjes së llogarive dhe aktivitete auditimi; konsulencë për taksat

Kjo klasë përfshin:

- regjistrimin e transaksioneve tregtare nga bizneset ose të tjerëve
- përgatitjen e auditimeve, llogarive financiare
- kontrollin e llogarive dhe vërtetimi i saktësisë së tyre
- përgatitjen e pagesës së detyrimeve tatimore për individë e ndërmarrje
- aktivitetet këshillimore dhe përfaqësim (përveç përfaqësimit juridik ligjor) në emër të klientëve përpara autoriteteve tatimore

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e të dhënave dhe aktivitete tabulimi, shih 63.11

- konsultat e menaxhimit si hartimi i sistemeve të llogarive, programeve të llogaritjes së kostos, procedura të kontrollit buxhetor, shih 70.22
- mbledhjen e faturave, shih 82.91

70 Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve dhe aktivitete të konsultimit

Kjo ndarje përfshin dhënien e këshillave dhe asistencës ndaj ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera mbi menaxhimin, planifikimin strategjik dhe organizues; planifikimin financiar dhe i buxhetit; objektiva dhe politika marketingu; politika të burimeve njerëzore, praktika dhe planifikim; programimi i prodhimit, dhe planifikimi i kontrolleve. Kjo ndarje gjithashtu përfshin mbikëqyrjen dhe menaxhimin e njësive të tjera të të njëjtës kompani ose ndërmarrje, p.sh. aktivitetet e drejtuesve të tyre.

70.1 Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve

70.10 Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve

Kjo ndarje përfshin:

- dhënien e këshillave dhe asistencës ndaj ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera mbi menaxhimin, planifikimin strategjik dhe organizues
- planifikimin financiar dhe atë të buxhetit
- objektivat dhe politikat e marketingut
- politikat e burimeve njerëzore, praktikën dhe planifikimin
- programimin e prodhimit, dhe planifikimin e kontrolleve

Kjo ndarje gjithashtu përfshin:

- mbikëqyrjen dhe menaxhimin e njësive të tjera të të njëjtës kompani ose ndërmarrje, p.sh. aktivitetet e drejtuesve të tyre

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e kompanive holding, jo pjesëmarrëse në menaxhim, shih 64.20

70.2 Aktivitete të konsulencës menaxheriale

70.21 Aktivitete të marrëdhënieve publike dhe të komunikimit

Kjo klasë përfshin dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe asistencën operative ndaj ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera mbi marrëdhëniet publike dhe komunikimit.

Kjo klasë nuk përfshin:

- agjencitë e publicitetit dhe shërbime të përfaqësimit të mediave, shih 73.1
- kërkime tregu dhe opinioni publik mbi votimet, shih 73.20

70.22 Aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin

Kjo klasë përfshin:

- dhënien e këshillave, udhëzimeve dhe asistencën operative ndaj bizneseve dhe organizatave të tjera mbi marrëdhëniet publike, si planifikimi strategjik dhe organizimi
- marrjen e vendimeve të natyrës financiare, objektiva marketingu dhe politika
- politikat e burimeve njerëzore, praktikën dhe planifikimin
- programimin e prodhimit dhe planifikimin e kontrollit.

Këto shërbime përfshijnë këshillimin, asistencë operacionale dhe udhëzime ndaj ndërmarrjeve dhe shërbimeve publike në lidhje me:

- hartimin e metodave të llogarisë ose procedurave, programeve të llogaritjes së kostos, procedurave të kontrollit buxhetor.

- këshillimin dhe ndihmën ndaj ndërmarrjeve dhe shërbime publike në planifikim, organizim, efikasitet dhe kontroll informacion manaxhimi etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- ndërtimin e programeve kompjuterikë për sistemet e llogarive, shih 62.01
- këshillim juridik dhe përfaqësim, shih 69.10
- aktivitete të llogarive, mbajtjes së llogarive, dhe aktiviteteve të audutimit, konsulencë për taksat, shih 69.20
- aktivitete këshilluese arkitekturore, inxhinierike, shih 71.11, 71.12,
- aktivitete këshilluese për mjedisin, agronominë, sigurinë e të tjera të ngjashme, shih 74.90
- shërbimet e konsulencës të kërkimeve, shih 78.10
- aktivitete konsulence arsimimi, shih 85.60

71 Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike; aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike

Kjo ndarje përfshin dhënien e shërbimeve arkitekturore, inxhinierike, shërbime projektsh, shërbime të inspektimit të godinave dhe survejimi dhe hartimi i hartave. Gjithashtu përfshihet kryerja e shërbimeve të testeve fizike, kimike, dhe analitike.

71.1 Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike dhe konsulencia teknike të lidhura me to

Ky grup përfshin dhënien e shërbimeve arkitekturore, shërbimeve inxhinierike, shërbimeve projektimi, shërbime të inspektimit të ndërtesave dhe shërbime të vrojtimit dhe hartimit të hartave.

71.11 Aktivitete arkitekturore

Kjo klasë përfshin:

- aktivitete konsultimi arkitekturor:
 - konceptimi dhe hartimi i projekteve të ndërtimit
 - hartimi i planit urbanistik, dhe i arkitekturës së hapësirave urbane

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitete të konsulencës kompjuterike, shih 62.02, 62.09
- dekoracioni i brendshëm, shih 74.10

71.12 Aktivitete inxhinierike dhe konsulencia teknike të lidhura me to

Kjo klasë përfshin:

- projekte inxhinierike dhe aktivitete konsultimi për:
 - makineri, procese dhe impiante industriale
 - projekte për punime inxhinierike, hidraulike, transporti
 - projekte për menaxhimin e ujrave
 - projekte dhe realizimi i projekteve elektrike dhe elektronike të inxhinierisë së minierave, kimike, mekanike, inxhinierisë industriale dhe të sistemeve, inxhinierisë së sigurimit
- përpunimin e projekteve që përdorin ajër të kondicionuar, frigorifer, kontroll inxhinierik sanitar dhe i mjedisit dhe inxhinieri akustike etj.
- vrojtimit gjeofizike, gjeologjike dhe sizmike
- aktivitete vrojtimi gjeodet:
 - aktivitete të vrojtimit të tokës dhe kufirit
 - aktivitete të vrojtimit hidrologjik
 - aktivitete të vrojtimit nënsipërfaqësor
 - aktivitete kartografike dhe të informacionit hapësinor

Kjo klasë nuk përfshin:

- shpimet test lidhur me veprimtarinë e minierave, shih 09.10, 09.90
- zhvillimin ose publikimin e programeve shoqëruese, shih 58.29, 62.01
- aktivitetet e konsulentëve të kompjuterave, shih 62.02, 62.09
- kontroll teknik, shih 71.20
- aktivitete kërkimi dhe zhvillimi dhe të tjera lidhur me inxhinierinë, shih 72.1
- fotografi ajrore, shih 74.20

71.2 Kontrollet dhe analizat teknike

71.20 Kontrollet dhe analizat teknike

Kjo klasë përfshin:

- kryerjen e testeve analitike fizike, kimike dhe të tjera të llojeve të ndryshme të materialeve dhe produkteve, përfshirë:
 - kontrolli akustik dhe i vibrimit
 - kontrolli i përbërjes dhe pastërtisë së mineraleve etj.
 - kontrolli në fushën e higjienës së ushqimeve, përfshirë testimet veterinare dhe kontrollet në lidhje me prodhimet ushqimore.
 - kontrolli e karakteristikave fizike dhe paraqitjen e materialeve si fortësia, trashësia, jetëgjatësia, radioaktiviteti etj.
 - kontrolli i cilësisë dhe besimit
 - kontrolli i efektshmërisë të të gjitha makinerive, motorë, automjete, pajisje elektronike etj.
 - kontroll adiografik i saldimeve dhe bashkimeve
 - analizat e dëmtimit
 - kontrolli dhe matja e treguesve të mjedisit: ndotja e ajrit dhe ujit etj.
- çertifikimin e produkteve, përfshirë mallrat e konsumit, automjetet, avionët, kontenerëve të presuar, uzinave bërthamore etj.
- kontrolli periodik i sigurisë në rrugë të automjeteve
- kontrolli me përdorimin e modeleve ose maketeve (p.sh. të avionëve, anijeve, moleve etj)
- funksionimin e laboratorëve të policisë

Kjo klasë nuk përfshin:

- kontrolli e mostrave të kafshëve , shih 75.00
- diagnostikimin me pamje, kontroll dhe analiza e mostrave mjeksore dhe dentare, shih 86

72 Kërkim dhe zhvillim shkencor

Kjo ndarje përfshin aktivitetin e tre lloj kërkimeve dhe zhvillimeve: 1) kërkim themelor: punë teorike dhe eksperimentale e ndërmarë kryesisht për të fituar njohuri të reja mbi themelin e fenomenit dhe fakteve të observuara, pa aplikacion të veçantë ose kqyrje, 2) kërkim i aplikuar: ndërmarrja e vrojtimit të posacëm për të përfutur njohuri të reja, të drejtuara fillimisht ndaj një qëllimi ose objektivë specifike dhe 3) zhvillimi eksperimental: punë sistematike njohuri e nxjerrë ose ekzistuese fituar nga kërkimi dhe /ose eksperiencia praktike, për të prodhuar materiale të reja, produkte dhe pajisje, për instalimin e proceseve të reja, sistemeve dhe shërbimeve dhe për të përmirësuar thellësisht ato tanimë të prodhuar ose të instaluar

Aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit eksperimental në këtë ndarje janë nënndarë në dy kategori: shkenca natyrore dhe inxhinieri; shkenca shoqërore dhe humane

Kjo ndarje nuk përfshin:

- kërkimet e tregut, shih 73.20

72.1 Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinjeri

Ky grup përmbledh kërkimin themelor, kërkimin e aplikuar zhvillimin eksperimental në shkencat natyrore dhe inxhinjeri

72.11 Kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në bioteknologji

Kjo klasë përfshin kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në bioteknologji:

- kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në ADN (kodimi):
 - genoma, farmako–gjenetike, geneprobës, DNA sequencing/synthesis/amplification, inxhinjeri gjenetike
- kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në proteina dhe molekula (blloqet funksionale):
 - protein/peptide sequencing/synthesis, lipid/protein/glyco engineering, proteomics, hormones dhe faktorët e rritjes, receptorët e qelizave/signalling/pheromones
- kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në qeliza dhe në kultura indi dhe inxhinjeri:
 - qelizë/ /kulturë indi, inxhinjeria e indeve, hybridization, cellular fusion, vaccine/immune stimulants, embryo manipulation
- kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në procesin e bioteknologjive:
 - bioreactors, fermentation, bioprocessing, bioleaching, biodesulphurization, biopulping, biofiltration, bioremediation
- kërkimin dhe zhvillimin eksperimental në organizmat nën-qelizorë:
 - gene therapy, viral vectors

72.19 Kërkime të tjera dhe zhvillime eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinjeri

Kjo klasë përfshin:

- kërkimet dhe zhvillimet eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinjeri përveç kërkimeve bioteknologjike dhe zhvillimit eksperimental
 - kërkimin dhe zhvillimin në shkencat natyrore
 - kërkimin dhe zhvillimin në inxhinjeri dhe teknologji
 - kërkimin dhe zhvillimin në shkencat mjeksore
 - kërkimin dhe zhvillimin në shkencat bujqësore
 - kërkime dhe zhvillime të përgjithshme, me mbizotërim të shkencave natyrore dhe inxhinjerisë

72.2 Kërkime dhe zhvillime eksperimentale në shkencat shoqërore dhe humane**72.20 Kërkime dhe zhvillime eksperimentale në shkencat shoqërore dhe humane**

Kjo klasë përfshin:

- kërkimin dhe zhvillimin në shkencat sociale
- kërkimin dhe zhvillimin në shkencat humane
- kërkime dhe zhvillime të përgjithshme, me mbizotërim të shkencave sociale dhe humane

Kjo klasë nuk përfshin:

- kërkimet e tregut, shih 73.20

73 Publiciteti dhe kërkimet e tregut

Kjo ndarje përfshin krijimin e fushatave publicitare dhe vendosjen e publiciteteve të tilla në gazeta, periodikë, radio dhe televizion, ose të tjera media si edhe dizajni i strukturave të paraqitjes dhe vendosjes.

73.1 Publicitet

73.11 Agjenci publiciteti

Kjo klasë përfshin kryerjen e një game të plotë shërbime publiciteti (p.sh. nëpërmjet kapaciteteve të brëndëshme ose nën kontraktimeve), përfshirë këshillim, shërbime krijimi, prodhimin e materialit publicitar dhe blerjen. Kjo përfshin:

- krijimin dhe realizimin e fushatave publicitare:
 - krijimin dhe vendosjen e reklamave në gazeta, periodikë, radio, televizion, internet dhe të tjera media.
 - krijimi dhe vendosja e reklamave të jashtme, p.sh. stendë afishimi, panele, buletin dhe korniza, veshje dritaresh, pamje të ekspozitave, vetura dhe autobuzë etj.
 - reklamat ajrore
 - shpërndarja dhe përhapja e materialit të reklamave
 - krijimi i stendave dhe i strukturave të tjera dhe vendeve për vendosjen e reklamave
- bërjen e fushatave publicitare dhe të tjera shërbime reklamuese me qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e klientëve
 - promovimi i prodhimeve
 - marketingu i pikave të shitjes
 - reklama me postë të drejtpërdrejtë
 - konsulencë marketingu

Kjo klasë nuk përfshin:

- material stampimi të reklamave, shih 58.19
- prodhimin e mesazheve komerciale për radio, televizion dhe film, shih 59.11
- kërkim tregu, shih 73.20
- fotografi reklamuese, shih 74.20
- organizatorët e kongreseve dhe ekspozitave tregtare, shih 82.30
- aktivitete të drejtpërdrejta postare, shih 82.99

73.12 Shërbime të përfaqësimit të mediave

Kjo klasë përfshin:

- përfaqësimin e mediave, p.sh. shitjen ose rishitjen e kohës dhe hapësirës për reklamat në media të ndryshme

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e marrëdhënieve publike, shih 70.21

73.2 Studimi i tregut dhe sondazhet

73.20 Studimi i tregut dhe sondazhet

Kjo klasë përfshin:

- studimin e potencialit të tregut, pëlqimin dhe familjaritetin për blerjen e produkteve, pëlqyeshmeria e klientëve me qëllim promovimin e zbritjeve dhe zhvillimin e produkteve të reja, përfshirë analizat statistikore të rezultateve
- sondazhet në opinionin publik kolektiv rreth çështjeve politike, ekonomike dhe atyre sociale dhe analiza statistikore e tyre

74 Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike

Kjo ndarje përfshin sigurimin e shërbimeve profesionale, shkencore dhe teknike (përveç aktiviteteve juridike dhe të kontabilitetit; aktiviteteve të arkitekturës dhe inxhinjerisë, testimeve teknike dhe analizave; menaxhimit dhe aktivitete të konsulencës të manaxhimit; kërkim dhe zhvillim dhe aktivitete të reklamave)

74.1 Aktivitete të specializuara skicimi**74.10 Aktivitete të specializuara skicimi**

Kjo klasë përfshin:

- skicimin e modeleve të tekstileve, veshjeve, këpucëve, bizhuterive, mobiljeve dhe të tjera dekoracione të brëndëshme dhe të tjera artikuj të modës si edhe të tjera orendi personale dhe shtëpie
- shërbimet e skicuesve grafikë
- aktivitetet e dekoratorëve për mjedise të brëndëshme

Kjo klasë nuk përfshin:

- skicimin arkitekturor dhe inxhinjerik, shih 71.11, 71.12
- programimin e faqeve të web, shih 62.01
- projektet inxhinjerie që lidhen me skicimin e makinerive, materialeve, instrumentave, etj. shih 71.12

74.2 Aktivitete fotografike**74.20 Aktivitete fotografike**

Kjo klasë përfshin:

- prodhimin e fotografive komerciale dhe të klientëve:
 - fotografi portret për pasaporta, shkolla, martesë etj.
 - fotografi për tregtarë, publikues, modele, pasuri të patundëshme, ose për qëllime turizmi
 - fotografi ajrore
 - xhirime video të ngjarjeve: dasma, mbledhje etj.
- përpunimin e filmave:
 - zhvillimi, shtypshkrimi dhe zmadhimi i negativave të mara nga klienti ose filmat kinematografië
 - laboratore të zhvillimit të filmave dhe të stampimit të tyre
 - dyqane fotografie një orëshe (jo pjesë e dyqaneve të aparateve fotografikë)
 - montimi i negativave
 - kopja dhe restaurimi ose ritushimi transparent lidhur më fotografitë
- aktivitetet e fotogazetarëve

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- mikrofilmimin e dokumentave

Kjo klasë nuk përfshin:

- përpunimin e filmave për filmat kinematografikë dhe të industrisë televizive, shih 59.11
- aktivitete kartografike dhe të informacionit hapsinor, shih 71.12

74.3 Aktivitete përkthimi dhe interpretimi**74.30 Aktivitete përkthimi dhe interpretimi**

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit

74.9 Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t

74.90 Të tjera aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t

Kjo klasë përfshin një varietet të gjerë të shërbimeve në përgjithësi realizuar ndaj klientëve komercialë. Kjo përfshin ato aktivitete për të cilët kërkohen nivele të përparuara profesionale, shkencore dhe teknike por nuk përfshin funksionet rutinë në vazhdim të bizneseve që zakonisht janë afat shkurtër

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin e komisionerëve të biznesit, p.sh. përgatitja për blerjen dhe shitjen e bizneseve të vogla dhe të mesme, përfshirë praktikat profesionale, por duke mos përfshirë komisionerët e pasurive të paluajtëshme.
- aktivitetin e komisionerëve të patentave (përgatitja për blerjen dhe shitjen e patentave)
- aktivitetet e vlerësimit përveç pronës së paluajtëshme dhe sigurimeve (për antikitetë, bizhuteri etj).
- auditimin e faturave dhe informacion për tarifat e transportit
- aktivitetet e parashikimit të motit
- konsulencë sigurimi
- konsulencë agnomie
- konsulencë mjedisi
- konsulencia të tjera teknike
- aktivitetet e konsulentëve përveç atyre të arkitekturës, inxhinjerisë dhe menaxhimit

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e kryera nga agjentë dhe agjenci në emër të individëve që zakonisht janë të interesuar nëpërmjet botuesve dhe producentëve etj. në përfshirjen në një film, prodhim teatral, ose të ngjashme ose në aktivitete sportive dhe gjetjen e punës në librari, pjesë teatrale, punime artistike, fotografë etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- tregtinë me shumicë me ankand të automjeteve të përdorur, shih 45.1
- aktivitetet e ankandit on-line (me pakicë), shih 47.91
- aktivitetet e ankandit të shtëpive (me pakicë), shih 47.99
- aktivitetin e komisionerëve të pasurive të paluajtëshme, shih 68.3
- aktivitetet e mbajtjes së llogarive, shih 69.20
- aktivitetet e konsulentëve të manaxhimit, shih 70.22
- aktivitetet e konsulencës të arkitekturës dhe inxhinjerisë, shih 71.1
- projektimin industrial dhe të makinerive, shih 71.1
- ekspozimin e lajmërimeve dhe të tjera forma publiciteti, shih 73.11
- krijimin e stendave dhe të tjera struktura ekspozimi dhe vende ekspozimi, shih 73.11
- aktivitetet e organizuesve të kongreseve e konferencave dhe ekspozitave tregtare, shih 82.30
- aktivitetet e drejtuesve të pavarur të ankandeve, shih 82.99
- administrimin e programeve të besimit, shih 82.99
- konsultimin për kredi dhe hua të klientit, shih 88.90

75 Aktivitete Veterinare

Kjo ndarje përfshin sigurimin e kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe aktivitetin e kontrollit të fermave të kafshëve ose të kafshëve shoqëruese. Këto aktivitete kryhen nga veterinerë të kualifikuar në spitale veterinare si edhe kur vizitojnë ferma, stalla ose shtëpi, në kabinetin e vet të konsultimit ose gjetkë. Gjithashtu përfshihet aktiviteti i ambulancave të kafshëve.

75.0 Aktivitete veterinare**75.00 Aktivitete veterinare**

Kjo klasë përfshin:

- kujdesjen e shëndetit të kafshëve dhe aktiviteti i kontrollit të fermave të kafshëve
- kujdesin e shëndetit të kafshëve dhe aktiviteti i kontrollit të kafshëve shoqëruese

Këto aktivitete kryhen nga veterinerë të kualifikuar që punojnë ose në spitale veterinare si edhe në vizitat në ferma, stalla ose shtëpi, në kabinetet e tyre mjekësore ose gjatë.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e asistentëve veterinerë ose personelit tjetër ndihmës veterinar
- aktivitetet kliniko-patologjike dhe të tjera aktivitete diagnostikuese që lidhen me kafshët
- aktivitetet e ambulancave të kafshëve

Kjo klasë nuk përfshin :

- aktivitetet e strehimit të kafshëve pa kujdesin shëndetsor, shih 01.62
- qethjen e dhenve, shih 01.62
- shërbimin e testimit të kopeve, shërbime të tufave, tredhja e kafshëve, shih 01.62
- aktivitetet e lidhura me inseminimin artificial, shih 01.62
- aktivitetet e strehimit të kafshëve të shoqërimit pa përkujdesje shëndetësore, shih 96.09

SEKSIONI N - SHËRBIME ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Ky seksion përfshin një llojshmëri aktivitetesh që mbështesin funksionimin e përgjithshëm të bizneseve. Këto aktivitete ndryshojnë nga ato në seksionin M, meqënëse qëllimi i tyre kryesor nuk është transferimi i njohurive të specializuara.

77 Aktivitete të marrjes e dhënies me qira

Kjo ndarje përfshin qeramarrjen dhe qeradhënien ndaj konsumatorëve e të mirave jo financiare, duke përfshirë grup të gjerë të mirash të trupëzuara e të patrupëzuara si automjete, kompjutera, mallra konsumi dhe makineri e pajisje industriale, në këmbim të një pagesë qeraje ose rente periodike. Kjo është e ndarë në: 1) qeradhënia e mjeteve motorike, 2) qeradhënia e pajisjeve sportive argëtuese, sendeve personale dhe orendive shtëpiake, 3) qeradhënia e makinerive dhe pajisjeve të tjera që përdoren më shumë në aktivitete biznesi, përfshirë pajisjet e transportit dhe 4) qeradhënia të mirave jofinanciare jo të trupëzuara.

Në këtë ndarje është përfshirë vetëm sigurimi i qerave operative.

Kjo ndarje nuk përfshin:

- huadhënien financiare, shih 64.91
- dhënien me qira të pronave të paluajtëshme, shih seksionin L
- dhënien me qira të pajisjeve me operatorë, shih klasat korresponduese sipas aktiviteteve të kryera me këto pajisje, p.sh. ndërtim, (seksioni F), transporti (seksioni H)

77.1 Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit

77.11 Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe huadhënien operacionale të automjeteve pa shofer :
 - veturave të pasagjerëve dhe mjete të tjera të lehta motorike pa shofer (më pak se 3.5 ton)

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënien me qira dhe huadhënien e veturave ose mjeteve të tjera motorike të lehta me shofer, shih 49.39
- huadhënien financiare, shih 64.91

77.12 Dhënia me qira dhe hua e kamionëve

Kjo klasë përfshin:

- dhënien me qira dhe huadhënien operacionale të llojeve të mëposhtme të automjeteve:
 - kamiona, furgona familjarë dhe mjete të rënda motorike (më shumë se 3.5 ton)
 - automjete për kohën e lirë

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënien me qira dhe huadhënien e automjeteve të mallrave ose të kamionëve me shofer, shih 49.41
- huadhënien financiare, shih 64.91

77.2 Dhënia me qira dhe hua e orendive personale dhe shtëpiake

Ky grup përfshin dhënien me qira të sendeve personale dhe orendive shtëpiake si edhe dhënien me qira të pajisjeve të kohës së lirë dhe atyre sportive dhe video. Këto aktivitete zakonisht mbulojnë dhënien me qira me afat të shkurtër të mallrave megjithatë në disa raste mallrat mund të jepen me qira për periudha me të gjata.

77.21 Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve për kalimin e kohës së lirë dhe mallrave sportive

Kjo klasë përfshin dhënie me qira të pajisjeve për kalimin e kohës së lirë ose atyre sportive:

- anije shëtitëse, kanoe, varka me vela
- biçikleta
- ndenjës plazhi dhe çadra plazhi
- të tjera pajisje sportive
- ski

Kjo klasë nuk përfshin :

- dhënie me qira të video-kasetave dhe disqe, shih 77.22
- dhënie me qira të sendeve të tjera personale dhe orendive shtëpiake, shih 77.29
- dhënie me qira të pajisjeve me kalimin e kohës së lirë si pjesë e lehtësirave të kohës argëtuese, shih 93.29

77.22 Dhënia me qira e video-kasetave dhe disqeve

Kjo klasë përfshin dhënie me qira të shiritave video, kasetave të regjistrimeve, në CD, DVD etj.

77.29 Dhënia me qira dhe hua e sendeve personale dhe e orendive shtëpiake të përfshira

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira të të gjitha llojeve të sendeve personale dhe orendive shtëpiake, familjeve ose ndërmarrjeve (përveç pajisjeve sportive dhe të kohës së lirë):
 - tekstile, veshje dhe këpucë
 - mobilje, qeramikë dhe qelq, shtesa tavoline dhe kuzhine, pajisje elektrike dhe artikuj poçerie shtëpiake
 - bizhuteri, instrumente muzikorë, kostume skenike dhe veshje
 - libra, periodikë dhe revista
 - makineri dhe pajisje përdorur nga amatorët si hobi p.sh. vegla për riparime në shtëpi etj.,
 - lule dhe bimë
 - pajisje elektronike për përdorim familjar

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënie me qira të veturave, kamionëve, furgonëve dhe mjeteve të tjera të kohës së lirë pa shofer, shih 77.1
- dhënie me qira të mjeteve sportive të kohës së lirë, shih 77.21
- dhënie me qira të video-kasetave dhe disqeve, shih 77.22
- dhënie me qira të motorçikletave dhe furgonëve pa shofer, shih 77.39
- dhënie me qira të mobiljeve të zyrës, shih 77.33
- dhënie e uniformave të punës të linjta dhe artikuj të ngjajshëm nga lavanderitë, shih 96.01

77.3 Dhënia me qira dhe hua e makinerive, pajisjeve dhe mallra të tjera të trupëzuara**77.31 Dhënia me qira dhe hua e makinerive bujqësore dhe pajisjeve**

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira dhe hua operacionale të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe të pyjeve pa operatorë
 - dhënie me qira të produkteve të prodhuara në klasën 28.21, si traktorë bujqësorë etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënie me qira dhe hua operacionale të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe të pyjeve me operatorë, shih 01.61, 02.40
- huadhënie financiare, shih 64.91

77.32 Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinjrike

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira dhe hua operationale të makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinjrike pa operatorë:
 - kamiona vinç
 - skela dhe platforma pune, pa ngrehina dhe çmontime

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënia me qira e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinjrike me operatorë, shih 43
- huadhënie financiare, shih 64.91

77.33 Dhënia me qira dhe hua e makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përfshirë kompjuterat)

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira dhe hua të makinerive dhe pajisjeve të zyrës pa operatorë:
 - pajisje kompjuterike dhe periferike të kompjuterave
 - makina shumfishimi, makina shkrimi dhe makina të përpunimit të të dhënave
 - makineri dhe pajisje të llogarive: regjistruer të parave, kalkulatorë elektronikë.
 - mobilje zyre

Kjo klasë nuk përfshin:

- huadhënie financiare, shih 64.91

77.34 Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të transportit të ujit

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira dhe hua operationale të pajisjeve të transportit të ujit pa operatorë :
 - anije dhe varka tregtare

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënie me qira të pajisjeve të transportit të ujit me operatorë, shih ndarjen 50
- huadhënie financiare, shih 64.91
- dhënie me qira të anijeve të shëtijve, shih 77.21

77.35 Dhënia me qira dhe hua të pajisjeve të transportit ajror

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira dhe hua operationale të pajisjeve të transportit ajror pa operatorë:
 - aeroplan
 - ballonat me ajër të ngrohtë

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënie me qira të pajisjeve të transportit ajror me operatorë, shih ndarjen 51
- huadhënie financiare, shih 64.91

77.39 Dhënie me qira dhe hua të makinerive dhe pajisjeve të tjera dhe mallrave të prekshëm të papërfshira

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira dhe hua operationale pa operatorë të pajisjeve dhe makinerive që janë përdorur në përgjithësi si mallra kapitale nga industritë

- motora dhe turbina
- vegla pune
- pajisje miniere dhe pajisje të fushave të naftës
- radio profesionale, televizion dhe pajisje komunikimi
- pajisje për prodhimin e filmave
- pajisje matje dhe kontrolli
- makineri të tjera tregtare, shkencore dhe industriale
- dhënie me qira dhe hua operacionale të pajisjeve të transportit tokësor (përveç automjeteve) pa shoferë
 - motorçikleta, karavane dhe kampingje etj.
 - mjete hekurudhe

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- dhënie me qira të akomodimit ose ambalazheve (konteniera) të zyrave
- dhënie me qira të kafshëve (p.sh. tufë, kuaj gare)
- dhënie me qira të ambalazheve
- dhënie me qira të paletave

Kjo klasë nuk përfshin:

- huadhënie financiare, shih 64.91
- dhënie me qira të biçikletave, shih 77.21
- dhënie me qira të makinerive dhe pajisjeve bujqësore, shih 77.31
- dhënie me qira të makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit e të punimeve inxhinjerike, shih 77.32
- dhënie me qira të makinerive dhe pajisjeve, përfshirë kompjuterat, shih 77.33

77.4 Dhënie me qira e të mirave jo-financiare të patrupëzuara

77.40 Dhënie me qira e të mirave jo-financiare të patrupëzuara

Kjo klasë përfshin aktivitetet e lejimit të të tjerëve të përdorin të mira jo financiare për të cilat është bërë një pagesë bazë ose një pagesë liçence ndaj mbajtësit të të mirave. Përdorimi i tyre mund të marrë formë të ndryshme, si leje për riprodhim, përdorim në proceset e prodhimit, biznese që operojnë nën një të drejtë të posaçme etj. Pronarët aktualë mundet ose jo të kenë krijuar këto të mira.

Kjo klasë përfshin:

- dhënie me qira të të mirave jo –financiare të patrupëzuara (përveç punimeve copyright, si libra ose programe)
- marrjen e të drejtës ligjore ose pagesa liçencimi për përdorimin e
 - njësive të patentuara (subjekteve të patentuara)
 - markë fabrike ose shërbime të markës
 - emri i firmës
 - të drejta të shfrytëzimit të të drejtës
 - marrëveshje të ekskluzivitetit
 - të mira të tjera jo –financiare të patrupëzuara

Kjo klasë nuk përfshin:

- blerjen e të drejtave dhe publikimin, shih ndarjen 58 dhe 59
- prodhimin, riprodhimin dhe shpërndarjen e punimeve copyright (libra, programe, filma), shih ndarjet 58, 59
- dhënie me qira të pronave të patundshme, shih 68.2
- dhënie me qira të të mirave të trupëzuara, shih grupet 77.1, 77.2, 77.3
- dhënie me qira të videove dhe disqeve, shih 77.22
- huadhënie e librave, shih 77.29

78 Aktivitete të punësimit

Kjo ndarje përfshin aktivitete të listimit të vendeve vakante dhe orientimin ose punësimin e kandidatëve për punë, kur individët referues ose të vendosur në punë nuk janë të punësuar të agjencive të punësimit, duke ju ofruar të punësuar shtesë klientëve (ndërmarrjeve) për periudha të caktuara kohe për krahë pune dhe aktivitete të sigurimit të burimeve njerëzore si dhe shërbimet e menaxhimit të tyre.

Kjo ndarje përfshin:

- aktivitetet e kërkimit të burimeve njerëzore dhe përzgjedhja e tyre
- aktivitetet e agjencive të punësimit për trupat artistike

Kjo ndarje nuk përfshin:

- aktivitetet e agjentëve për artistë individualë, shih 74.90

78.1 Aktivitete të agjencive të punësimit**78.10 Aktivitete të agjencive të punësimit**

Kjo ndarje përfshin aktivitete të listimit të vendeve vakante dhe orientimin ose punësimin e kandidatëve për punë, kur individët referues ose të vendosur në punë nuk janë të punësuar të agjencive të punësimit.

Kjo klasë përfshin:

- kërkim personeli, përzgjedhja dhe vendosja në punë e tyre
- aktivitetet e agjencive të punësimit për trupat artistike
- agjencitë e punësimit on-line

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e agjentëve për artistë individualë, shih 74.90

78.2 Agjenci të punësimit të përkohshëm**78.20 Agjenci të punësimit të përkohshëm**

Kjo klasë përfshin aktivitetet e furnizimit me punëtorë klientëve (ndërmarrjeve) për periudha kohe të kufizuara për të shtuar krahun e punës, ku individët e ofruar janë të punësuar të ndihmës së përkohëshme të njësisë së shërbimit. Megjithatë, njësitë e klasifikuara këtu nuk japin mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të të punësuarve të tyre në vendet e punës së klientit.

78.3 Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore**78.30 Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore**

Kjo klasë përfshin aktivitete të sigurimit të burimeve njerëzore dhe shërbimet e menaxhimit të burimeve njerëzore për klientët. Ato janë të specializuara në kryerjen e një game të gjerë të funksionimit të burimeve njerëzore dhe të menaxhimit të personelit. Ato prezantojnë të punësuarin në regjistrin e punëdhënësit me pagat, taksat dhe të tjera çështje fiskale dhe të burimeve njerëzore por ato nuk janë përgjegjës për drejtimin dhe mbikëqyrjen e të punësuarve.

Kjo klasë nuk përfshin:

- sigurimin e funksioneve të burimeve njerëzore së bashku me mbikëqyrjen ose ndjekjen e punëve të ndërmarrjes, shih klasën në aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes.
- sigurimin e vetëm njërit nga funksionet e burimeve njerëzore, shih klasën në aktivitetin ekonomik respektiv të atij funksioni.

79 Agjenci udhëtimi, operator turistik dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit

Kjo ndarje përfshin aktivitetin e agjencive, që merren kryesisht me shitjen e shërbimeve të udhëtimit, eskursionit, transportit dhe akomodimit ndaj publikut të gjerë dhe klientëve tregtarë dhe aktivitetin e rregullimit dhe organizimit të eskursioneve të cilat shiten nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose drejtpërdrejt nga agjentë si operatorë turistikë.

79.1 Agjenci udhëtimi dhe aktivitete të operatorëve turistikë

Kjo ndarje përfshin aktivitetin e agjencive, që merren kryesisht me shitjen e shërbimeve të udhëtimit, eskursionit, transportit dhe akomodimit ndaj publikut të gjerë dhe klientëve tregtarë dhe aktivitetin e rregullimit dhe organizimit të eskursioneve të cilat shiten nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose drejtpërdrejt nga agjentë si operatorë turistikë

79.11 Aktivitete të agjencive të udhëtimit

Kjo klasë përfshin aktivitetet e agjencive, që kryesisht merren me shitjen e shërbimeve të udhëtimit, eskursionit, transportit dhe akomodimit me shumicë, ose pakicë drejt publikut të gjerë ose klientëve tregtarë.

79.12 Aktivitete të operatorëve turistikë

Kjo klasë përfshin aktivitetet e organizimit dhe rregullimit të eskursioneve që shiten nëpërmjet agjencive të udhëtimit ose drejtpërdrejt nga operatorët turistikë. Eskursionet mund të përfshijnë ndonjë ose të gjitha lehtësirat e mëposhtme: transport, akomodim, ushqim, vizita në muze, vende turistike ose historike, shfaqje teatrale, muzikore ose sportive.

79.9 Të tjera aktivitete shërbimi për rezervim**79.90 Të tjera aktivitete shërbimi për rezervim**

Kjo klasë përfshin aktivitetin e marketingut dhe promovimit të shërbimeve për dëfrim dhe zbavitje duke siguruar informacion dhe asistencë organizatave për të gjetur akomodimin, qendra kongresi dhe vende argëtimi, shërbime të guidave turistike, shërbime të shkëmbimit të hapësirave të godinave në bashkëpronësi dhe të tjera shërbime rezervimi të udhëtimit (përfshirë për udhëtim, hotele, restorante, vetura me qira, argëtim dhe sport). Gjithashtu përfshihen aktivitetet e shitjes së biletave për teatër, sporte dhe të tjera aktivitete të ngjashme.

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë, shih klasat 79.11 and 79.12
- organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve si mbledhje, takime e konferenca, shih 82.30

80 Aktivitete të sigurimit dhe hetimit

Kjo ndarje përfshin shërbime sigurimi si shërbime hetimi dhe dedektimi, shërbime mbrojtëse dhe patrullimi, marrja dhe shpërndarja e parave, faturave, ose artikujve të tjerë me vlerë, me personel dhe pajisje për të mbrojtur këto në tranzit, funksionimin e sistemeve të alarmit elektronik, si alarme kundër vjedhjes dhe zjarrit, ku aktiviteti fokusohet në monitorimin e mëparshëm të këtyre sistemeve, por shpesh përfshin gjithashtu shitjen, instalimin dhe shërbime riparimi. Nëse komponentët e fundit janë siguruar veçmas, ato përjashtohen nga kjo ndarje dhe klasifikohen në tregti me pakicë, ndërtim etj.

80.1 Aktivitete private sigurimi**80.10 Aktivitete private sigurimi**

Kjo klasë përfshin sigurimin e një ose më shumë të aktiviteteve të mëposhtme: shërbime mbrojtëse dhe patrullimi, marrja dhe shpërndarja e parave, faturave, ose të tjera artikujve me vlerë, me personel dhe pajisje për të mbrojtur këto në tranzit.

Kjo klasë përfshin:

- shërbimet e makinave të blinduara
- shërbimet e truprojave
- shërbimet e poligrafit
- shërbimet e marrjes së gjurmëve të gishtave
- shërbimet e rojeve të sigurimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e sigurimit dhe të rendit publik, shih 84.24

80.2 Aktivitete të shërbimeve të sigurimit

80.20 Aktivitete të shërbimeve të sigurimit

Kjo klasë përfshin:

- monitorimin ose monitorimin e mëparshëm të sistemeve të alarmit të sigurimit elektronik, si alarme kundër vjedhësve dhe zjarrit, përfshirë instalimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- instalimin, riparimin, rindërtimin dhe rregullimin mekanik ose elektronik të pajisjeve mbyllëse, kasafortave të sigurta të sigurisë.

Kjo klasë nuk përfshin:

- instalimin e sistemeve të sigurimit, shih 43.21
- shitjen e sistemeve të sigurimit, pajisje mbyllëse mekanike ose elektronike, kasaforta të sigurta të sigurisë pa monitorim, instalim ose shërbime mirëmbajtje, shih 47.59
- konsulentë sigurimi, shih 74.90
- aktivitetet e rendit publik dhe sigurisë, shih 84.24
- shërbimet e bërjes së kopjes së çelësve, shih 95.29

80.3 Aktivitete hetimi

80.30 Aktivitete hetimi

Kjo klasë përfshin shërbime hetimi dhe detektiv. Këtu përfshihen aktivitetet e të gjithë hetuesve privatë të pavarur pavarësisht nga lloji i klientit ose qëllimi i hetimit.

81 Shërbime ndaj ndërtesave dhe shesheve

Kjo ndarje përfshin pajisjen me një personel të aftë të kryejë një kombinim të shërbimeve mbështetëse për strukturat e klientit. Këto njësi ekonomike sigurojnë personel të aftë për kryerjen e këtyre aktiviteteve mbështetëse, por nuk janë të përfshira në thelbin e aktivitetit të ndërmarrjes ose me aktivitetet ndaj klientit.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin aktivitete të pastrimit të jashtëm dhe të brendshëm të ndërtesave të të gjitha tipeve, pastrimin e makinerive industriale, pastrimin e trenave, autobusëve, aeroplanëve, etj., pastrimin e pjesës të brendshme të rrugëve dhe të anijeve çisternë, disinfektimin dhe aktivitete asgjësimi për ndërtesat, anijet, trenat, etj., pastrim shishesh, fshirje rrugësh, heqje akulli dhe bore, kujdesje për sheshet dhe shërbime mirëmbajtje dhe kryerje të këtyre aktiviteteve sipas projektit të sheshit dhe /ose ndërtimin e (p.dh. instalimet) e trotuareve, mureve mbajtës, dysHEMEVE, gardheve, hauzeve, dhe struktura të ngjajshme.

81.1 Aktivitete të kombinuara për mbështetjen e strukturave

81.10 Aktivitete të kombinuara për mbështetjen e strukturave

Kjo ndarje përfshin pajisjen me një personel të aftë të kryejë një kombinim të shërbimeve mbështetëse brenda një strukture të klientit. Njësitë e klasifikuara këtu zakonisht japin shërbim të kombinuar si pastrim i brendshëm i përgjithshëm, mirëmbajtje, kosha mbeturinash, roje dhe sigurim, postëm, pritje, lavaxi dhe shërbime të

lidhura për mbështetjen e punëve brenda strukturës. Këto njësi pajisin me personel të aftë të kryejnë këto aktivitete por nuk janë të përfshirë në ose me thelbin e aktivitetit të ndërmarrjes ose me aktivitetet ndaj klientit.

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënie e vetëm një prej shërbimeve mbështetëse (p.sh. shërbime pastrimi të përgjithshme të brendshme), shih klasën e përshtatshme për këtë shërbim të kryer
- dhënie e personelit menaxhues dhe funksional për funksionimin e plotë të një ndërmarrje si hotel, restorant, minierë ose spital, shih klasën e njësisë operuese
- sigurimin e menaxhimit në vend dhe funksionimin e sistemit kompjuterik të klientit dhe /ose për punimin të lehtësirave, shih 62.03
- funksionin e lehtësirave korrektuese me kontratë ose me pagesë, shih 84.23

81.2 Aktivitete pastrimi

Ky grup përfshin aktivitetet e pastrimit të përgjithshëm të brendshëm të të gjitha llojeve të ndërtesave, pastrimin e jashtëm të ndërtesave, aktivitete të specializuara pastrimi për ndërtesa ose aktivitete të tjera pastrimi, pastrimi i makinerive industriale, pastrimi i pjesës së brendshme të rrugëve dhe çisternave të detit, disinfektim dhe aktivitete asgjësimi për ndërtesat dhe makineritë industriale, pastrim shishesh, fshirje rrugësh, heqje akulli dhe bore.

Ky grup nuk përfshin kontrollin e sëmundjeve në bujqësi, pastrimin me avull, pastrimi me rërë dhe të tjera aktivitete të ngjashme ndaj pjesës së jashtme të ndërtesave (Ndërtim), larje qilimash dhe tapete, pastrim perdeshe dhe çarçafë (aktivitete të tjera pastrimi). Pastrimi i menjëhershëm i ndërtesave pas përfundimit të tyre nuk përfshihet (Ndërtim).

81.21 Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave

Kjo klasë përfshin aktivitetin e pastrimit të përgjithshëm (jo të specializuar) të ndërtesave të të gjitha llojeve, si:

- zyra
- shtëpi ose apartamente
- fabrika
- dyqane
- institucione;

dhe të tjera biznese dhe godina profesionale dhe ndërtesa shumë funksionale.

Këto aktivitete janë kryesisht pastrim i brendshëm, megjithatë ato mund të përfshijnë pastrimin e kombinuar të pjesëve të jashtme si dritare dhe korridore kalimi.

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e specializuara të pastrimit të brendshëm, si pastrim oxhakësh, pastrim i vatrave të zjarrit, soba, furrnaltë, furrave të djegies së plehrave, kazanëve të ujit (boliera), tubacioneve të ajrimit dhe tubave të shkarkimit, shih 81.22

81.22 Aktivitete të tjera pastrimi të ndërtesave dhe pastrimi i objekteve industriale

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- pastrimit të jashtëm të ndërtesave të të gjitha llojeve, përfshirë zyra, fabrika, dyqane, institucione dhe ndërtesa të tjera biznesi dhe profesionale dhe ndërtesa shumë funksionale.
- pastrimit të specializuara për ndërtesa si pastrim dritaresh, pastrim oxhakësh dhe vatra zjarri, soba, furrnaltë, furra të djegies së plehrave, kazanëve të ujit (boliera), tubacioneve të ajrimit dhe tubave të shkarkimit
- pastrimit të makinerive industriale
- pastrimit të ndërtesave industriale të papërfshira

81.29 Aktivitete të tjera pastrimi të papërfshira

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- shërbimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes së pishinave
- pastrimit të trenave, autobusëve, aeroplanëve etj.
- pastrimit të pjesës së brendshme të rrugëve dhe çisternave të detit
- disinfektimit dhe asgjësimit
- pastrimit të shisheve
- fshirjes së rrugëve dhe heqjen e borës dhe akullit
- tjera pastrimi p.k.t.

Kjo klasë nuk përfshin:

- kontrollin e sëmundjeve (pest) në bujqësi, shih 01.61
- pastrimin e automjeteve, larjen e veturave, shih 45.20

81.3 Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe të kujdesit të shesheve**81.30 Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve**

Kjo klasë përfshin:

- mbjelljen, kujdesin dhe mirëmbajtjen e :
 - parqeve dhe kopshteve për
 - mjediseve private dhe publike
 - ndërtesa publike dhe gjysmë publike (shkolla, spitale, ndërtesa administrative, kisha etj.)
 - shesheve të bashkisë (parqe, zona të gjelbërta, varreza etj.)
 - gjelbërimit e autostradave (rrugë, linja hekurudhore dhe tramvaj, rrugë ujore, porte)
 - ndërtesave industriale dhe tregtare
 - gjelbërimit për:
 - ndërtesa (kopshte në çati, gjelbërim i fasadës, kopshte të brendshëm)
 - shesheve sportive, sheshe lojrash dhe të tjerë sheshe argëtuese (sportive, lojrash, lëndina për banja dielli, për kurse goli)
 - ujrave të qëndrueshme dhe të rrjedhshëm (basenë, zona të lagështa alternative, liqene, pishina, hendek, kanale, sisteme uzinash të ujrave të zeza)
 - impjanteve për mbrojtjen kundër zhurmës, erës, erozionit, pamshmërisë dhe verbërisë.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitete shërbimi të vogla lidhur me projektin dhe ndërtimin
- mirëmbajtjen e tokës për ta mbajtur në gjendje të mirë bujqësore dhe ekologjike

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin tregtar dhe mbjelljen për prodhim tregtar të bimëve, pemëve, shih ndarjen 01, 02
- fidanishtet e pemëve (përveç fidanishteve dhe drurëve të pyjeve), shih 01.30
- aktivitete ndërtimi për sheshet, shih seksionin F
- aktivitetet e projektimit të shesheve dhe arkitekturës, shih 71.11

82 Administrim zyrash, mbështetje administrative dhe të tjera aktivitete mbështetëse të ndërmarrjeve

Kjo ndarje përfshin kryerjen e shërbimeve të përditshme administrative të zyrave, si edhe funksionet e vazhdueshme mbështetëse rutinë të biznesit për të tjerë, me kontratë ose me pagesë.

Kjo ndarje gjithashtu përfshin të gjitha shërbimet mbështetëse zakonisht kryer ndaj bizneseve të paklasifikuara në vend tjetër.

Njësitë e klasifikuara në këtë ndarje nuk japin personel për kryerjen e aktivitetit të plotë të një biznesi.

82.1 Administrim zyrash dhe aktivitete mbështetëse

Ky grup përfshin kryerjen e një game të gjerë shërbimesh administrative të përditshme të zyrave, si planifikim financiar, mbajtja e faturave dhe regjistrimi, shpërndarja e personelit dhe logjistikës për të tretë me kontratë ose pagesë.

Ky grup përfshin gjithashtu aktivitete mbështetëse për të tretë me kontratë ose pagesë, që janë funksione mbështetëse të vazhdueshme rutinë që bizneset ose organizatorët zakonisht i kryejnë vetë.

Njësitë e klasifikuara në këtë grup nuk sigurojnë personel për kryerjen e plotë të aktivitetit të ndërmarrjes.

Njësitë që merren me kryerjen e një aspekti të vecantë të këtyre aktiviteteve klasifikohen sipas këtij aktiviteti të vecantë.

82.11 Aktivitete të kombinuara të shërbimit të administrimit të zyrave

Kjo klasë përfshin kryerjen e shërbimeve të kombinuara të përditshme të zyrave, si pritje, planifikim financiar, mbajtjen e faturave dhe regjistrave, shërbime personeli dhe postare etj. për të tretë me kontratë ose pagesë. Kjo klasë nuk përfshin njësitë që gjithashtu sigurojnë personel për kryerjen e plotë të veprimeve të një ndërmarrje. Njësi të tilla klasifikohen sipas aktivitetit që ato kryejnë.

Kjo klasë gjithashtu nuk përfshin njësitë që merren vetëm me një nga aktivitetet e listuara në paragrafin e parë. Këto njësi janë klasifikuar në atë aktivitet të veçantë.

82.19 Fotokopjim, përgatitje dokumentash dhe të tjera aktivitete mbështetëse të specializuara të zyrave

Kjo klasë përfshin forma kopjimi të ndryshme, përgatitje dokumentash dhe aktivitete të specializuara mbështetëse të zyrave. Aktiviteti i kopjimit/stampimit të dokumentave që përfshihen këtu mbulojnë vetëm aktivitete stampimi me karakter të shkurtër.

Kjo klasë përfshin:

- përgatitjen e dokumentit
- kontrollin dhe përshtatjen e dokumentit për lexim
- shtypjen dhe publikimin
- shërbimet mbështetëse të sekretarisë
- transkriptimin e dokumenteve dhe shërbime të tjera sekretarie
- shkrimin e letrave ose përmbledhje shkrimi
- dhënien e kutive postare me qera ose e shërbimeve të tjera postare (përveç publiciteteve të drejtpërdrejta postare)
- fotokopjimin
- dyfishimin
- kopjen e vizatimeve
- shërbime përpunimi të fjalëve
- shërbime të tjera të kopjimit të dokumentave pa shërbimin e stampimit, si stampim offset, stampim të shpejtë, stampim dixhital, shërbime para shtypit.
- shërbime postare

Kjo klasë nuk përfshin:

- stampimin e dokumentit (stampim offset, stampim të shpejtë etj.), shih 18.12
- shërbimet e specializuara stenografie si raporte çështjesh gjyqsore, shih 82.99
- shërbimet publike stenografie, shih 82.99

82.2 Aktivitete të qendrave telefonike (call center)

82.20 Aktivitete të qendrave telefonike (call center)

Kjo klasë përfshin aktivitetet e:

- qendrave të telefonimeve të brendshme, përgjigje telefonike të klientëve me operatorë, shpërndarjen e telefonimeve automatike, integrim telefonik në kompjuter, sistem përgjigje me zë interaktiv ose metoda të ngjashme për të marrë porosi, për të dhënë informacion mbi produktet, trajtimi i kërkesave të klientëve për asistencë ose ankesa të klientëve lidhur me adresën.
- qendrave të telefonimit me jashtë, duke përdorur metoda të ngjashme për të shitur ose për të bërë publicitet për mallra ose shërbime ndaj klientëve të mundshëm, për të bërë vërtetim tregu ose opinionin publik për zgjedhjet dhe aktivitete të ngjashme për klientët.

82.3 Organizatorë të konferencave dhe panairëve**82.30 Organizatorë të konferencave dhe panairëve**

Kjo klasë përfshin organizimin, promovimin dhe /ose menaxhimin e panairëve të ndërmarrjeve dhe ato tregtare, konferencave dhe mbledhjeve, nëse përfshijnë ose jo menaxhimin dhe sigurimin e personelit për manovrimin e strukturave në të cilin zhvillohen këto aktivitete.

82.9 Aktivitete shërbimi mbështetëse për bizneset p.k.t.

Ky grup përfshin agjensi mbledhje dokumentash, zyra krediti dhe aktivitete mbështetëse zakonisht të bëra ndaj ndërmarrjeve dhe jo të klasifikuara në vend tjerë.

82.91 Aktivitete të agjencive të mbledhjes së dokumentacionit dhe zyra krediti.

Kjo klasë përfshin mbledhjen e pagesave për ankesat dhe dërgimi i parave për pagesat e mbledhura të klientëve, si fatura, ose shërbimi i mbledhjes së borxheve.

Kjo klasë gjithashtu përfshin aktivitetin e hartimit të informacionit si historikun e kreditit dhe të punësimit të individëve dhe historikun e kreditit të ndërmarrjeve, sigurimin e informacionit ndaj institucioneve financiare, tregtarëve me pakicë dhe të tjerëve që kanë nevojë të vlerësojnë vlerën e kreditit të këtyre personave dhe ndërmarrjeve.

82.92 Aktivitete paketimi

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e paketimit me pagesë ose me kontratë, nëse kanë ose jo një proces të automatizuar:
 - mbushja në shishe e lëndëve të lëngëta, përfshirë pije dhe ushqim
 - paketimi i lëndëve të ngurta (paketim blister, mbështjellë me letër etj.)
 - paketim i sigurtë i preparateve farmaceutike
 - etiketimi, shtypshkrimi dhe stampimi
 - paketimi i pakove dhe mbështjellja e dhuratave

Kjo klasë nuk përfshin:

- fabrikimin e pijeve të buta dhe prodhimin e ujit mineral, shih 11.07
- aktivitetet e paketimit për transport, shih 52.29

82.99 Aktivitete të tjera shërbimi mbështetëse për bizneset p.k.t

Kjo klasë përfshin aktivitete mbështetëse si:

- mbajtjen e raportimin fjalë për fjalë dhe regjistrimi stenograf dhe stenotip të procedimit juridik të drejtpërdrejtë dhe transkriptimin në vazhdimësi të materialeve të regjistruara si:
 - shërbime raportimi të seancave gjyqësore ose regjistrime stenotip
 - shërbime publike stenografie

- titrimin e mbyllur të dhënies në television drejtpërdrejt të mbledhjeve dhe konferencave
- shërbimet e kodimit bar të adresave
- shërbimet e stampimit të kodeve bar
- organizata shërbimi të sigurimit të fondeve për të tretë
- shërbimet e mbledhjes së monedhave të parkingut
- aktivitetet e drejtuesve të pavarur të ankandeve
- administrimin e programeve të besueshmërisë
- aktivitetet e tjera mbështetëse zakonisht kryer ndaj ndërmarrjeve të pa klasifikuara në vend tjetër

Kjo klasë nuk përfshin:

- dhënien e filmave ose shërbime titrimi ose vendosjes së nën titujve, shih 59.12
- regjistrimin steneotip i korrespondencave, raporteve dhe dokumenta të tjerë ose shërbime transkriptimi të dokumentave, shih 82.99

SEKSIONI O - ADMINISTRIM PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM

Ky seksion përfshin aktivitete me natyrë qeveritare, normalisht të kryera nga administrata publike. Kjo përfshin dekretimin dhe interpretimin juridik të ligjeve dhe rregulloreve të tyre, si edhe administrimin e programeve bazuar në to, aktivitete legjislative, taksimi, mbrojtja kombëtare, rendi publik dhe sigurimi, shërbime imigrimi, punët e jashtme dhe administrimi i programeve qeveritare.

Statusi ligjor ose institucional nuk është në vetvete faktori vendimtar që një veprimtari të bëjë pjesë në këtë seksion, por aktiviteti që ka një natyrë të specifikuar në paragrafin e mëparshëm.

Kjo do të thotë që aktivitetet e klasifikuara gjetkë në NVE nuk janë në këtë seksion, edhe nëse kryhen nga njësi publike. Për shembull, administrimi i sistemit arsimor (rregullore, kontrolle, curricula) janë në këtë seksion kurse mësimdhënia në vetvete nuk është (shih seksionin P), një spital burgu ose ushtarak klasifikohet në shëndetësi (shih seksionin Q). Në mënyrë të ngjashme disa aktivitete të përshkruara në këtë seksion mund të kryhen nga njësi jo-qeveritare.

Ky seksion gjithashtu përfshin aktivitete të sigurimit social të detyrueshëm.

84 Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm

84.1 Administrimi i Shtetit dhe politikat ekonomike e sociale të komunitetit

Ky grup përfshin administratën e përgjithshme (p.sh., ekzekutivin, legjislativin, administratën publike etj në nivel qeverie) dhe mbikëqyrjen në fushën sociale dhe jetën ekonomike.

84.11 Aktivitete të administratës së përgjithshme publike

Kjo klasë përfshin:

- administratën ekzekutive dhe legjislative qendrore, rajonale dhe lokale
- administrimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve fiskale :
 - funksionimi i skemave të taksimit
 - mbledhja e tatimeve e taksave mbi mallrat dhe hetimi i shkeljes së legjislacionit fiskal
 - administrata doganore
- zbatimin e buxhetit dhe manaxhimin e fondeve publike dhe borxhit publik:
 - mbledhja dhe përdorimi i fondeve dhe kontrolli i shpenzimeve
- administratën e përgjithshme të politikave të kërkim zhvillimit (civile) dhe fondeve përkatëse
- administratën dhe punën e shërbimeve statistikore dhe të planifikimit ekonomik e social në nivele të ndryshme të qeverisë.

Kjo klasë nuk përfshin:

- funksionimin e ndërtesave pronë ose të zëna qeveritare, shih 68.2, 68.3
- administrimin e politikave të kërkim zhvillimit që synojnë rritjen mirëqënies personale dhe të fondeve përkatëse, shih 84.12
- administrimin e politikave të kërkim zhvillimit që synojnë përmirësimin e ecursisë ekonomike dhe konkurrencës, shih 84.13
- administrimin e politikave të kërkim zhvillimit lidhur me mbrojtjen dhe fondet shoqëruese, shih 84.22
- funksionimin e arshivave qeveritare, shih 91.01

84.12 Aktivitete të organizmave drejtuese për shëndetin, arsimin, kulturën dhe të tjera shërbime sociale, përveç sigurimit social

Kjo klasë përfshin:

- administrimin publik të programeve që synojnë rritjen e mirëqënies personale:
 - shëndeti
 - arsimimi
 - kultura
 - sporti
 - argëtimi
 - mjedisi
 - strehimi
 - shërbimet sociale
- administrimin publik të politikave të kërkim zhvillimit dhe fondeve përkatëse në këto fusha

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- sponsorizimin e aktiviteteve argëtuese dhe kulturore
- shpërndarjen e granteve publike artistëve
- administrimin e programeve të furnizimit me ujë të pijshëm
- administrimin e grumbullimit të mbeturinave dhe heqjes së tyre
- administrimin e programeve të mbrojtjes së mjedisit
- administrimin e programeve të strehimit

Kjo klasë nuk përfshin:

- ujrat e zeza, heqjen e mbeturinave dhe kanalizime, shih grupet 37, 38, 39
- aktivitetet e detyrueshme sigurimi social, shih 84.30
- aktivitetet e arsimimit, shih seksionin P
- aktivitetet që lidhen me shëndetin e njerëzve, shih grupin 86
- muzeumet dhe institucione të tjera kulturore, shih grupin 91
- aktivitetet e librarive dhe arkivave publike, shih 91.01
- aktivitetet sportive dhe të tjera argëtuese, shih grupin 93

84.13 Aktivitete të organizmave drejtuese për aktivitetin ekonomik

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e administrimit publik të sektorëve të ndryshëm ekonomik, përfshirë shpërndarjen e-subvencioneve:
 - bujqësia
 - përdorimi i tokës
 - burimet energjitike dhe miniera
 - infrastruktura
 - transporti
 - komunikacioni
 - hotele dhe turizmi
 - tregtia me shumicë dhe pakicë
- administrimin e politikave të kërkim zhvillimit dhe fondeve përkatëse për përmirësimin e ecurisë ekonomike
- administrimin e çështjeve të përgjithshme të punës
- zbatimin e masave politike të zhvillimit rajonal p.sh. për reduktimin e papunësisë

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitete kërkimi dhe zhvillimi eksperimental, shih ndarjen 72

84.2 Kryerja e shërbimeve ndaj komunitetit

Ky grup përfshin punët e jashtme, mbrojtjen dhe rendin publik, dhe aktivitete sigurimi.

84.21 Punët e jashtme

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetin administrativ dhe operativ të ministrisë së punëve të jashtme, të misioneve diplomatike dhe konsullore të vendosura jashtë ose në zyra të organizatave ndërkombëtare
- administrimin, funksionimin dhe mbështetjen e informacionit dhe shërbimeve kulturore të destinuara për tu shpërndarë përtej kufijve kombëtarë
- ndihmën ndaj vendeve të huaja, nëse kryhet ose jo nëpërmjet organizatave ndërkombëtare
- dhënien e ndihmës ushtarake vendeve të huaja
- menaxhimin e tregtisë së jashtme, çështjeve ndërkombëtare financiare dhe atyre teknike të jashtme.

Kjo klasë nuk përfshin:

- shërbimet ndaj katastrofave ndërkombëtare dhe konflikteve të refugjatëve, shih 88.99

84.22 Aktivitete të mbrojtjes

Kjo klasë përfshin:

- administrimin mbikëqyrjen dhe funksionimin e mbrojtjes ushtarake dhe të forcave të mbrojtjes tokësore, detare, ajrore dhe hapsinore si:
 - forcat luftarake të ushtrisë, flotës detare dhe forcës ajrore
 - xhenierit, transportin, komunikacionin, materialet, personelin dhe forcat komando të tjera jo luftarake
 - forca rezervë dhe mbështetëse të institucioneve të mbrojtjes
 - logjistika ushtarake (pajisje, struktura, rezerva ushqimore etj.)
 - aktivitete shëndetsore për personelin ushtarak në terren
- administrimin, funksionimin dhe mbështetjen e forcave civile të mbrojtjes
- përgatitjen e planeve për situata emergjente dhe kryerjen e provave me pjesëmarrjen e institucioneve e popullsisë civile
- administrimin e politikave të kërkim zhvillimit të lidhura me mbrojtjen dhe fondeve përkatëse

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit eksperimental, shih ndarjen 72
- dhënien e ndihmës ushtarake vendeve të tjera, shih 84.21
- aktivitetet e gjykatave ushtarake, shih 84.23
- furnizimin e popullatës me artikuj të domosdoshëm për urgjenca të brendshme në raste të katastrofave në kohë paqe, shih 84.24
- aktivitetet arsimore të shkollave ushtarake, kolegje dhe akademi, shih 85.4
- aktivitetet e spitaleve ushtarake, shih 86.10

84.23 Drejtësi dhe aktivitete juridike

Kjo klasë përfshin:

- administrimin dhe funksionimin e gjykatave të çështjeve kriminale dhe atyre administrative civile, gjykata ushtarake dhe sistemi juridik, përfshirë përfaqësimin juridik dhe njoftimin në emër të qeverisë ose kur kryhet nga qeveria me pagesë ose shërbime
- pasqyrimin e gjykimit dhe interpretimin e ligjit
- gjykimin e çështjeve civile
- administratat e burgjeve dhe shërbimet e riedukimit (korrektimit), përfshirë shërbimet e rehabilitimit, pavarësisht nëse administrimi dhe kryerja e tyre bëhet nga njësi qeveritare ose nga njësi private me kontratë ose me pagesë.

Kjo klasë nuk përfshin:

- këshillimin dhe përfaqësimin në çështjet civile, kriminale dhe çështje të tjera, shih 69.10
- aktivitetet e shkollave të burgjeve, shih ndarjen 85
- aktivitetet e spitaleve të burgjeve, shih 86.10

84.24 Aktivitete të rendit publik dhe sigurimit

Kjo klasë përfshin:

- administratën dhe funksionimin e forcave policore të rregullta ose ndihmëse mbështetur nga autoritetet publike të porteve, kufirit, rojes bregdetare dhe të tjera forca speciale të policisë, përfshirë rregullimin e trafikut, regjistrimi i të huajve, mbajtja e regjistrave të ndalimeve
- furnizimin e popullatës me artikuj të domosdoshëm për urgjenca të brëndshme në raste të katastrofave në kohë paqe

Kjo klasë nuk përfshin:

- funksionimin e laboratorëve të policisë, shih 71.20
- administratën dhe funksionimin e forcave të armatosura ushtarake, shih 84.22

84.25 Aktivitete shërbimi kundra zjarrit

Kjo klasë përfshin:

- luftën kundër zjarrit dhe parandalimin e tij:
 - administratën dhe funksionimin e brigadave të rregullta dhe ndihmëse për parandalimin e zjarrit dhe shuarjen e tij, shpëtimin e njerëzve dhe kafshëve, asistencë në katastrofat civile, përmbytje, aksidenteve rrugore etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- shërbimet e mbrojtjes kundra zjarrit të pyjeve dhe shuarjes të këtyre zjarreve, shih 02.40
- shuarjen e zjarrit në zona gazi dhe naftëmbajtëse, shih 09.10
- shërbimet e shuarjes së zjarrit dhe parandalimit të tij në aeroporte, të ofruara nga njësi jo të specializuara shih 52.23

84.3 Aktivite të sigurimit të detyrueshëm

84.30 Aktivite të sigurimit të detyrueshëm

Kjo klasë përfshin:

- financimin dhe administrimin e programeve qeveritare të sigurimit social:
 - sigurimet për sëmundje, aksidente në punë, dhe papunësi
 - pensione pleqërie
 - programe që mbulojnë humbjen në të ardhura për shkak të shtatzanisë, paaftësisë së përkohëshme, vejani etj.

Kjo klasë nuk përfshin:

- sigurimin social jo të detyrueshëm, shih 65.30
- shërbimin e bamirësisë dhe punës sociale (pa akomodim), shih 88.10, 88.90

SEKSIONI P - ARSIMI

Ky seksion përfshin arsimimin në çdo nivel dhe për çdo profesion. Mësimet mund të jenë në formë verbale apo me shkrim, si dhe mund të sigurohen përmes radios dhe televizionit ose të tjera mjete komunikimi.

Ky seksion përfshin arsimimin nga institucione të ndryshme në sistemin e rregullt arsimor në nivele të ndryshme si edhe arsimin e të rriturve, programe të mësimi të shkrimit e leximit etj. Gjithashtu janë përfshirë shkollat ushtarake dhe akademitë, shkollat e burgjeve etj, në nivelet e tyre respektive.

Seksioni përfshin arsimin publik si dhe atë privat.

Për çdo nivel të arsimit fillestar, përfshihet gjithashtu arsimimi i posaçëm për nxënës me prapambetje mendore ose fizike.

Ndarja e kategorive në këtë seksion bazohet në nivelet e arsimit sikurse përcaktohet nga nivelet e ISCED 1997. Aktivitetet e institucioneve arsimore që ofrojnë arsimimin në nivelin 0 të ISCED janë klasifikuar në 85.10, te nivelit 1 të ISCED në 85.20, të nivelit 2-3 të ISCED në grupin 85.3, te nivelit 4 në 85.41 dhe të nivelit 5-6 të ISCED në 85.42.

Ky seksion përfshin gjithashtu instruktimin që merret kryesisht me sportin dhe kulturën, si dhe aktivitete mbështetëse të arsimit.

85 Arsimi

85.1 Arsimi parashkollor

85.10 Arsimi parashkollor

Kjo klasë përfshin:

- arsimin para shkollor (arsimin përpara nivelit të parë). Arsimi parashkollor është përcaktuar si faza fillestare e organizuar për përshtatjen e të vegjëlvë në një ambient të tipit "shkollë" në mënyrë që ta kenë më të lehtë kalimin nga ambienti i shtëpisë në atë të shkollës

Kjo klasë nuk përfshin:

- mbajtjen në kujdes ditor të fëmijëve, shih 88.91

85.2 Arsimi fillor

85.20 Arsimi fillor

Kjo klasë përfshin arsimin fillor: kryerjen e kurseve shkollore dhe kurse shoqëruese pune që u japin nxënësve njohuri fillestare në lexim, shkrim dhe matematikë si dhe njohuri fillestare të lëndëve të tjera si histori, gjeografi, shkenca natyrore, art dhe muzikë. Një arsimim i tillë zakonisht ofrohet për fëmijë, megjithatë këtu përfshihen edhe programet e mësimi të shkrimit e leximit brenda ose jashtë sistemit shkollor, të cilët janë të ngjashëm në përmbajtje me programet e arsimit fillestar por që bëhen për ata që konsiderohen të mëdhenj për të qënë në shkolla fillore (p.sh. programet e të mësuarit për të rritur).

Kjo klasë nuk përfshin:

- arsimin e të rriturve sikurse përcaktohet në 85.5
- mbajtjen në kujdes ditor të fëmijëve, shih 88.91

85.3 Arsimi mesëm

Ky grup përfshin ciklin e lartë të 9 vjeçares dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm, teknik dhe profesional.

Ky grup nuk përfshin:

- arsimin e të rriturve siç përcaktohet tek 85.5.

85.31 Arsimi mesëm i përgjithshëm

Kjo klasë përfshin dhënien e atij arsimi që vendos bazat e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit njerëzor dhe mundëson vazhdimin e të mësuarit të mëtejshëm. Këto institucione ofrojnë programe që zakonisht janë me një orientim më të gjerë lëndësh, duke përdorur mësues më të specializuar dhe shpesh punësojnë mësues që zhvillojnë mësimet në fushën e tyre të specializimit.

Specializimi sipas lëndëve në këtë nivel, shpesh fillon të ketë ndikim madje edhe në eksperiencën arsimore të atyre që ndjekin programe të arsimit të përgjithshëm. Këto programe janë hartuar të kualifikojnë studentët si për arsimin teknik edhe për atë profesional ose për tu pranuar në arsimin e lartë pa ndonjë kërkesë paraprake për njohuri në lëndë të veçanta.

Kjo klasë përfshin:

- ciklin e lartë të 9 vjeçares (klasat 7-8-9)
- arsimin e mesëm të përgjithshëm e cila në parim jep mundësi hyrje në arsimin e lartë (klasat 10-11-12)

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- arsim të posaçëm të këtij niveli për studentë me prapambetje

Kjo klasë nuk përfshin:

- arsimimin e të rriturve sikurse përcaktohet në 85.5

85.32 Arsim i mesëm teknik dhe profesional

Kjo klasë përfshin dhënien e atij arsimi ku përgjithësisht programet i vënë theksin specializimit sipas lëndëve dhe mësimi si në teori dhe në praktikë, në përgjithësi shoqëruar me punësim aktual ose në të ardhmen. Synimi i një programi mund të ndryshojë nga përgatitja për një fushë të përgjithshme punësimi deri në një vend pune shumë specifik.

Kjo klasë përfshin:

- arsimin teknik dhe profesional nën nivelin e arsimit të lartë sikurse është përcaktuar në 85.4

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- instruktimin e guidave turistike
- instruktimin për kuzhinierë, hotelierë dhe punonjës të restoranteve
- shkollat kozmetike dhe berberi
- trajnimin për riparim kompjuterash
- shkollat për shoferë profesionistë p.sh. për kamionë, autobuzë, tren, pilotë

Kjo klasë nuk përfshin:

- arsimin teknik dhe profesional të lartë, shih 85.4
- kryerjen e instruktimit artistik për argëtim, hobet dhe qëllime vet-zhvilluese, shih 85.52
- shkollat për të drejtuar automjetin jo për shoferë profesionistë, shih 85.53
- trainime pune si pjesë e aktiviteteve të punës sociale pa akomodim, shih 88.10, 88.99

85.4 Arsimi i lartë

Kjo klasë përfshin dhënien e arsimit pas të mesmes jo të lartë dhe dhënien e arsimit të lartë për sigurimin e diplomave të nivelit të parë, të nivelit të dytë dhe niveleve më të larta. Kërkesa për pranim është të paktën një diplomë e shkollës së mesme.

Ky grup nuk përfshin:

- arsimin për të rritur siç është përcaktuar tek 85.5

85.41 Arsimi pas të mesmes jo i lartë

Kjo klasë përfshin arsimin pas të mesëm, i cili nuk konsiderohet arsim i lartë. Si shembull është marrja e arsimit plotësues pas të mesëm për përgatitjen e hyrjes në arsimin e lartë ose në pas të mesme jo të lartë profesionale.

85.42 Arsimi i lartë

Kjo klasë përfshin:

- fazën e parë, të dytë dhe të tretë të arsimit të lartë:

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- shkollat e artit që ofrojnë arsim të lartë

85.5 Shërbime të tjera arsimit

Ky grup përfshin vazhdimin e arsimit të përgjithshëm ose profesional si dhe trajnimet për çdo profesion, hobi ose me qëllim vet-zhvillimi. Këtu përjashtohen aktivitetet arsimore sikurse janë paraqitur në grupet 85.1-85.4, arsimi para shkollor, arsimi fillor, arsimi sekondar dhe arsimi i lartë.

Këtu përfshihen qendrat dhe shkollat që ofrojnë instruksione në sport ndaj grupeve ose individëve, instruksione të gjuhës së huaj, në arte, dramë ose muzikë, ose trainime të specializuara, në përgjithësi për të rritur dhe jo të krahasueshme me arsimin e grupeve 85.1-85.4

85.51 Arsimi për sporte dhe argëtim

Kjo klasë përfshin formimin sportiv për grupe ose individë në qendra dhe shkolla me ose pa akomodim. Nuk përfshihen shkollat akademike, kolegjet dhe universitetet. Instruktimi mund të kryhet në mjedise të ndryshme, në ato të qendrës apo shkollës ose të klientëve. Instruktimi i përfshirë në këtë klasë është i organizuar në formë zyrtare.

Kjo klasë përfshin:

- formimin sportiv (futboll, basketboll, beizboll, kriket, etj)
- qendrat që ofrojnë formim sportiv
- instruksionet e gjimnastikës
- instruksionet e kalërimit
- instruksionet e notit
- instruktorë, mësues dhe trajnerë të sporteve profesionale
- instruksione të arteve marciale
- instruksione të lojrave me letra (si brixhi)
- instruksione të jogës

Kjo klasë nuk përfshin:

- arsimin kulturor, shih 85.52

85.52 Arsim kulturor

Kjo klasë përfshin instruktimin në arte, dramë dhe muzikë. Institucionet që japin këtë lloj instruktimi mund të quhen “shkolla”, “studio”, “klasa” etj. Ato japin instruksione të organizuara në formë zyrtare, kryesisht për hobet, argëtim ose për zhvillim të vetvetes, por këto instruksione nuk të çojnë në marrjen e një diplomë profesionale apo diplomave të arsimit të lartë

Kjo klasë përfshin:

- mësuesit e pianos dhe të tjera instruksione muzike
- instruksione arti
- instruksione vallëzimi dhe studio vallëzimi
- shkollat e dramës (përveç atyre akademike)

- shkollat e arteve të bukura (përveç atyre akademike)
- shkollat e bërjes së artit (përveç atyre akademike)
- shkollat fotografike (përveç atyre profesionale)

Kjo klasë nuk përfshin:

- kurset për gjuhët e huaja, shih 85.59

85.53 Aktivitete të shkollave të drejtimit të mjeteve

Kjo klasë përfshin:

- autoshkollat, shkollat për fluturim, lundrim, transport detar që nuk japin çertifikata tregtare dhe leje

Kjo klasë nuk përfshin:

- shkollat për drejtues profesionistë automjetesh, shih 85.32

85.59 Shërbime të tjera shkollimi

Kjo klasë përfshin:

- arsimin që nuk është i përcaktuar sipas niveleve
- shërbimet e mbikqyrjes akademike
- kurse trainimi të rikuperimit arsimor
- kurse përgatitore për provimet
- instruktive gjuhësore dhe të biseduarit
- trajnime kompjuteri
- instruktive fetare

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- trajnimin për mbrojtjen e jetës
- trajnimin për të mbijetuar
- trajnimin për të folur në publik
- instruktimin për shpejtësinë e të lexuarit

Kjo klasë nuk përfshin:

- programet e mësimi të shkrimit e leximit të të rriturve, shih 85.20
- arsimin sekondar të përgjithshëm, shih 85.31
- arsimin sekondar teknik dhe profesional, shih 85.32
- arsimin e lartë, shih 85.4

85.6 Shërbime arsimore mbështetëse

85.60 Shërbime arsimore mbështetëse

Kjo klasë përfshin dhënien e shërbimeve jo të instruktimit që mbështesin procesin arsimor ose sistemet arsimore:

- konsultimin arsimor
- shërbimet këshillimore për orientimin arsimor
- shërbime të vlerësimit të testeve arsimore
- shërbimet e testimit arsimor
- organizimin e programeve të shkëmbimit të studentëve

Kjo klasë nuk përfshin:

- punën kërkimore dhe eksperimentale në shkencat sociale dhe humane, shih 72.20

SEKSIONI Q - SHËNDETËSIA DHE AKTIVITETE TË PUNËS SOCIALE

Ky seksion përfshin aktivitetet në lidhje me shëndetin për njerëzit dhe punën sociale. Këtu përfshihen një gamë e gjerë veprimtarish duke filluar prej kujdesit shëndetësor që kryhet nga mjekë profesionistë, në spitale dhe në struktura të tjera, aktivitete të kujdesit në familje që përfshin aktivitete të kujdesit shëndetësor dhe aktivitete të punës sociale pa patur përfshirje të kujdesit shëndetësor profesional.

86 Aktivitete të shëndetit

Kjo ndarje përfshin aktivitetet e spitaleve me qëndrim të shkurtër ose të gjatë, spitale të përgjithshëm ose të specializuar, kirurgjikalë, qendrat e reabilitimit dhe detoksikimit, institucione të shëndetit mendor, leprozarë, shtëpi të të moshuarve, qendra të parandalimit të sëmundjeve, shërbimi infermieror në shtëpi dhe institucione të tjera të trajtimit të shëndetit që kanë struktura akomodimi, të cilat merren me diagnostikimin e sëmundjeve, trajtimin mjekësor sipas gjëndjes shëndetsore të pacientëve.

Gjithashtu përfshihen konsultimet mjekësore dhe trajtimi mjekësor i përgjithshëm dhe i specializuar nga mjekë të përgjithshëm, mjekë specialistë dhe kirurgë.

Përfshihen aktivitetet dentare të natyrës së përgjithshme ose të specializuar dhe aktivitete ortodontike.

Veç këtyre kjo ndarje përfshin aktivitetet për shëndetin njerëzor jo të kryera në spitale ose nga mjekë profesionistë, por nga profesionistë paramjekësorë të njohur ligjërisht për trajtimin e pacientëve.

86.1 Aktivitete të spitaleve

86.10 Aktivitete të spitaleve

Kjo klasë përfshin:

- aktivitetet e spitaleve me qëndrim të shkurtër ose të gjatë, spitale të përgjithshëm për diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor (p.sh. spitale lokale dhe rajonale, spitale të organizatave jo fitim prurëse, spitale universitare, spitale të bazave ushtarake dhe të burgjeve) dhe spitale të specializuara (p.sh. spitale të shëndetit mendor dhe detoksikimit, spitale për sëmundje infektive, obstretikale e gjinekologjike, qendrat e reabilitimit të specializuara).

Këto aktivitete kryhen kryesisht për pacientët e shtruar në spital nën vëzhgimin e drejtpërdrejtë të mjekëve dhe përfshijnë:

- shërbimet e personelit mjekësor dhe paramjekësor
- shërbimet e laboratorëve dhe strukturave teknike, përfshirë shërbimet të radiologjisë dhe anesteziës
- shërbimet e urgjencës
- shërbimet e sallave të operimit, farmaceutike, shërbime hotelerisë, të ushqimit dhe të tjera spitalore
- shërbimet e qendrave të planifikimit familjar me akomodim që japin trajtim mjekësor si sterilizim dhe ndërprerje shtatzanie

Kjo klasë nuk përfshin:

- testimin laboratorik dhe analizat e të gjitha llojeve të materialeve dhe produkteve,
- përveç atyre mjekësore, shih 71.20
- aktivitetet veterinare, shih 75.00
- aktivitetet e shëndetit për personelin ushtarak në fushim, shih 84.22
- praktikant dentare të përgjithshme ose të specializuara, p.sh. dentistë, dentistë endodontikë dhe pediatrikë; patologji orale, aktivitete ortodontike, shih 86.23
- konsultat private mjekësore ndaj pacientëve të shtruar, shih 86.2
- testimet laboratorike mjekësore, shih 86.90
- aktivitetet e transportit të ambulancave, shih 86.90

86.2 Aktivitete të mjekëve dhe dentistëve

Kjo klasë përfshin konsultat mjekësore dhe trajtimin mjekësor të bërë nga mjekë të përgjithshëm dhe mjekë specialistë, përfshirë kirurgji, dentistë etj.

Këto aktivitete mund të praktikohen privatisht në mënyrë individuale, në grup dhe në klinika jospitalore (ambulatorisht), si dhe në klinikat pranë ndërmarrjeve, shkollave, shtëpive të të moshuarve, sindikatave dhe atyre vllazërore si edhe shtëpitë e pacientëve.

Ky grup gjithashtu përfshin:

- konsultat private mjekësore ndaj pacientëve të shtruar në spitale

86.21 Aktivitete të mjekëve të përgjithshëm

Kjo klasë përfshin:

- konsultat dhe trajtimet mjekësore në fushën e mjekësisë së përgjithshme, nga mjekë të përgjithshëm

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet ambulatorë spitalore për të shtruarit në spitale, shih 86.10
- aktivitetet paramjekësore të kryera nga mamitë, infermierët dhe fizioterapistët, shih 86.90

86.22 Aktivitete të mjekëve të specializuar

Kjo klasë përfshin:

- konsultat dhe trajtimet mjekësore në fushën e mjekësisë së specializuar nga mjekë specialistë dhe kirurgë
- shërbimet e qendrave të planifikimit familjar pa akomodim që japin trajtim mjekësor si sterilizim dhe ndërprerje shtatzënie

Kjo klasë nuk përfshin:

- aktivitetet ambulatorë spitalore për të shtruarit në spitale, shih 86.10
- aktivitetet paramjekësore të kryera nga mamitë, infermierët dhe fizioterapistët, shih 86.90

86.23 Aktivitete të dentistëve

Kjo klasë përfshin:

- konsultat dhe trajtimet mjekësore dentare, të përgjithshme ose të specializuara, p.sh.dentistë, shërbime dentare endodontike dhe pediatrike; patologji orale.
- aktivitetet ortodontike

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet dentare në salla operimi

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e dhëmbëve artificialë, denturave dhe protezave nga laboratorët dentarë, shih 32.50
- aktivitetet ambulatorë spitalore për të shtruarit në spitale, shih 86.10
- aktivitetet paramjekësore dentare si higjienistët dentarë, shih 86.90

86.9 Të tjera aktivitete të shëndetit

86.90 Të tjera aktivitete të shëndetit

Kjo klasë përfshin aktivitete të shëndetit që nuk kryhen nga spitale ose mjekë dhe dentistë:

- aktivitete të infermierëve, mamive, fizioterapistëve ose të tjerë personel paramjekësor në fushën e optometrisë, hidroterapisë, masazhit mjekësor, terapisë profesionale, terapisë të të folurit, chiropody
- homeopathy, chiropractic, acupuncture etj.

Këto aktivitete mund të praktikohen privatisht në mënyrë individuale, në grup dhe në klinika jospitale (ambulatorisht), si dhe në klinikat pranë ndërmarrjeve, shkollave, shtëpive të të moshuarve, sindikatave dhe atyre vllazërore si edhe shtëpitë e pacientëve.

Këto aktivitete mund të kryhen në klinika shëndetësore, si dhe në klinikat pranë ndërmarrjeve, shkollave, shtëpive të të moshuarve, sindikatave dhe në strukturat e tjera shëndetësore përveç spitaleve, si edhe në shtëpinë e pacientit ose në ambjente të tjera.

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- aktivitetet e personelit paramjekësor dentar, si terapistë dentarë, infermierë dentarë në shkolla dhe higjienistë dentarë, që mund të punojnë të pavarur por që janë të mbikqyrur periodikisht nga dentisti.
- aktivitetet e laboratorëve mjekësorë si:
 - laboratorë me rreze X dhe të tjera qendra diagnostikimi me imazh
 - laboratorë të analizave të gjakut
- aktivitetet e bankave të gjakut, bankave të spermës, bankave të organeve të transplantit, etj.
- transportin me ambulancë i pacientëve me çfarëdolloj transporti përfshirë avionët. Këto shërbime shpesh jepen gjatë një urgjence mjekësore.

Kjo klasë nuk përfshin:

- prodhimin e dhëmbëve artificialë, denture dhe protezave nga laboratorët dentarë, shih 32.50
- transferimin e pacientëve pa pajisje për shpëtimin e jetës dhe pa personel mjekësor, shih ndarjet 49, 50, 51
- testimin nga laboratorë jo mjekësorë, shih 71.20
- aktivitetet e testimit në fushën e higjienës së ushqimit, shih 71.20
- aktivitetet spitalore, shih 86.10
- aktivitetet e mjekëve dhe dentistëve, shih 86.2
- qendrat e kujdesit infermior, shih 87.10

87 Aktivitete të qendrave të kujdesit mjekësor e social.

Kjo ndarje përfshin dhënien e kujdesit shëndetësor në qendra, të kombinuar me shërbim infermior, mbikqyrje ose lloje të tjera kujdesi sipa kërkesës. Strukturat janë një pjesë e rëndësishme e procesit të realizimit të aktivitetit dhe kujdesi i dhënë, është një miks i shërbimeve mjekësore dhe sociale në nivele më të gjerë se shërbimet e infermierisë.

87.1 Aktivitete të qendrave të kujdesit infermior**87.10 Aktivitete të qendrave të kujdesit infermior**

Kjo klasë përfshin:

- shtëpitë për të moshuar me kujdes infermior
- shtëpitë e pushimit
- shtëpitë e pushimit me kujdes infermior
- lehtësirat e kujdesit infermior
- shtëpitë e kujdesit infermior

Kjo klasë nuk përfshin:

- shërbimet e kryera në shtëpi nga profesionistë të kujdesit shëndetësor, shih ndarjen 86
- shtëpitë për të moshuarit pa ose me kujdes infermior minimal, shih 87.30
- aktivitetet e kujdesit social me akomodim, si jetimore, qendra për mbajtjen e fëmijëve dhe konvikte, strehim i përkohshëm për të pastrehët, shih 87.90

87.2 Aktivitete të qendrave të kujdesit për prapambetjet mendore, shëndetit mendor dhe abuzimit me substanca narkotike

87.20 Aktivitete të qendrave të kujdesit për prapambetjet mendore, shëndetit mendor dhe abuzimit me substanca narkotike

Kjo klasë përfshin qendrat për dhënien e kujdesit shëndetësor (por të pa licencuar për kujdes spitalor), njerëzve me prapambetje mendore, sëmundje mendore, ose me probleme të abuzimit me substanca narkotike. Kujdesi përfshin strehimin, mbikqyrjen mbrojtjen dhe konsulencën dhe disa shërbime të kujdesit shëndetësor.

Kjo klasë përfshin aktivitetet:

- ndihmën për trajtimin e varësisë nga alkoli dhe droga
- shtëpitë e kujdesit psikiatrik
- qendrat për personat me çrregullime emocionale
- qendrat për personat me prapambetje mendore
- qendrat e rehabilitimit të shëndetit mendor

Kjo klasë gjithashtu përfshin:

- qendrat për kujdesin dhe trajtimin e pacientëve me sëmundje të shëndetit mendor dhe abuzimin me substancat

Kjo klasë nuk përfshin:

- spitalet mendore, shih 87.90
- aktivitetet e kujdesit social me akomodim, si strehim i përkohshëm i të pastrehëve, shih 87.90

87.3 Aktivitetet e qendrave të kujdesit shëndetësor për të moshuarit dhe personave me paaftësi

87.30 Aktivitetet e qendrave të kujdesit shëndetësor për të moshuarit dhe personave me paaftësi

Kjo klasë përfshin dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në qendra dhe asistencë jo mjekësore për të moshuarit dhe personave me paaftësi të cilët janë të paaftë të kujdesen për veten e tyre dhe /ose nuk dëshirojnë të jetojnë të pavarur. Kujdesi zakonisht përfshin: strehimin, mbikqyrjen, asistencë gjatë ditës si kujdesje për mirëmbajtjen e shtëpisë. Në disa raste këto njësi japin kujdes të posaçëm infermior për individët në vende të veçuara nga të tjerët.

Kjo klasë përfshin aktivitetet:

